REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I TIRANËS

FAKULTETI I DREJTËSISË

DEPARTAMENTI I SË DREJTËS PENALE

REFLEKSIONE MBI ANËN OBJEKTIVE TË FIGURËS SË VEPRËS PENALE

(DISERTACION PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR")

Doktorante **Udhëheqës shkencor**

Ela PODGORICA (KERKA) **Prof. Dr. Kudret ÇELA**

Tiranë, 2014

MIRËNJOHJE

Mirënjohja ime e thellë i shkon së pari udhëheqësit tim shkencor, Prof. Kudret ÇELA, si dhe Prof. Spiro SPIRO, të cilët më nderuan duke më dhënë mundësinë të punoj nën udhëheqjen dhe mbështetjen e pakursyer akademike të tyre përmes konsultimeve, ideve dhe nxitjen e duhur për t'u thelluar në këtë çështje sa komplekse, aq edhe tërheqëse.

Falenderime të veçanta u shkojnë për shefin e departamentit të së drejtës penale, Prof. Dr. Skënder KAÇUPIN, Dekanin e Fakultetit të Drejtësisë, Prof. Dr Altin SHEGANIN për kolegët e Departamentit të së Drejtës Penale të Fakultetit për mbështetjen e vazhdueshme në të gjitha fazat e studimeve doktorale.

Në këtë hap tepër të veçantë dhe të rëndësishëm, falenderoj Zotin dhe gjithë familjarët e mi, nga të cilët mësova dhe trashëgova gjithçka sot jam.

Së fundmi, falenderoj ata që besuan tek unë….

LISTA E SHKURTIMEVE

KSH	Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
KP	Kodi Penal
KPrP	Kodi Procedurës Penale
KPrA	Kodi Procedurës Administrative
KE	Këshilli Evropës
BE	Bashkimi Europian
MD	Ministria e Drejtësisë
MSA	Marrëveshja Stabilizim Asocimit
GJL	Gjykata e Lartë
GJK	Gjykata Kushtetuese
GJA	Gjykata e Apelit
GJEDNJ	Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut

METODOLOGJITË E PËRDORURA

Gjatë hartimit të punimit kam përdorur metodat shkencore bashkëkohore. Si të tilla ashtu kam përfshirë analizën dhe sintezën, (greq. Analysis-zbërthim, ndarje; synthesis-bashkim), që janë dy metodat universale të njohjes. Analiza përfaqeson në punim ndarjen e objektit që studiohet në pjesën e tij përbërëse. Ndërkohë, sinteza përfaqëson një bashkim përmbledhës të elementëve të objektit të studimit. Analiza dhe sinteza në punim janë në unitet me njëra tjetrën. Pa analyze, nuk mund të ketë sintezë, ndërsa pa sintezë, analiza nuk do kishte kuptim.

Metoda historike dhe llogjike, të ndjekura gjatë punimit, janë gjithashtu metoda mjaft të rëndësishme. Metoda historike, është një metodë sipas së cilës dukuritë juridike penale studiohen në zhvillimin e tyre historik, (nga e shkuara në të tashmen). Ndryshe nga metoda historike, metoda logjike dikton që dukuritë të shpjegohen jo nga historia e tyre por nga ligjet e zhvillimit.

Së fundi, punimi im bazohet edhe mbi metodën krahasuese dhe metodën normative. Metoda krahasuese përbën zemrën e metodologjisë shkencore. Ajo nënkupton konstatimin e ngjashmërive dhe ndryshimeve midis dukurive të jetës shoqërore dhe instituteve respective të së drejtës penale.

Me anë të metodës krahasuese dalin në pah të rejat dhe përparësitë e objektit të studimit. Vetëm pas një metode krahasuese, mund të nxjerrim përfundime të sakta dhe të bazuara në argumenta bindës, po ashtu, edhe problematika në lidhje me objektin e studimit.

Hipotezat e ngritura

Po ashtu literatura e përdorur është e gjërë dhe e shumllojshme. Burimet e shfrytëzuara janë legjislacioni penal, artikuj shkencor, komentarë të jurisprudencës, të brëndëshëm dhe të huaj, vendime të Gjykatës së Lartë, vemdime të gjykatave në periudhat e marra në studim, legjislacioni i shteteve të huaja, etj.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

HYRJE…….10

KREU I Vepra penale, bazë e përgjegjësisë penale.

1.1 Kuptimi, Përmbajtja dhe elementët e përgjegjësisë penale…….....15

1.2 Analizë e shkurtër e kuptimit të veprës penale . Elementët përbërës të veprës penale…....16

1.3 Ndarja e veprës penale në: Krime dhe Kundravajtje penale……....24

KREU II Figura e veprës penale si parakusht i përgjegjësisë penale.

2.1 Vepra penale dhe figura e veprës penale. Të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet këtyre dy kategorive kryesore të së drejtës penale……32

2.2 Elementët përbërës të figurës së veprës penale ……...32

2.3 Njohuri të përmbledhura rreth kuptimit të secilit prej katër elementëve përbërës të figurës së veprës penale, (objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive)…….35

KREU III Ana objektive e figurës së veprës penale, elementët përbërës. Veprimi ose mosveprimi, si element i anës objektive të veprës penale.

3.1 Ndarja e elementeve përbërës të anës objektive të figurës së veprës penale në: ……56

a) element të domosdoshëm për anën objektive të llojeve të figurave të veprave penale të cilat parashikohen në pjesën e posaçme të Kodit Penal.

b) elementë jo të domosdoshëm të anës objektive të llojeve të figurave te veprave penale, që parashikohen në pjesën e posaçme të Kodit Penal.

3.2 Kuptimi juridiko-penal i veprimit, si element i anës objektive të figurës së veprës penale……...……..63

3.3 Kuptimi juridiko-penal i mosveprimit, si element i anës objektive të figurës së veprës penale……...……..67

KREU IV Rrezikshmëria shoqërore, si element i anës objektive të figurës së veprës penale dhe i vet veprës penale.

4.1 Kuptimi juridiko-penal i rrezikshmërisë shoqërore, si element i anës objektive të figurës së veprës penale dhe i vet veprës penale……...70

4.2 Rrethanat që përjashtojnë përgjegjsnë penale (mbrojtja e nevojshme; nevoja ekstreme; ushtrimi i një të drejte; përmbushja e detyrës; zbatimi i urdhërit; qëndrimi i të dënuarit dhe heqja dorë nga kryerja e veprës penale), në raport me rezikshmërinë shoqërore, si element i anës objektive të figurës së veprës penale……74

KREU V Kundërligjshmëria dhe pasoja, si elemente të anës objective të figurës së veprës penale.

5.1 Kundërligjshmëria dhe parashikimet në ligj……91

5.2 Pasoja, si element i anës objektive të figurës së veprës penale. Kuptimi juridiko-penal i pasojës …….….95

5.3 Forma e trajtimit të pasojës nga e drejta penale …….96

5.4 Pasoja, si element i domosdoshëm përbërës i anës objektive të figurës së veprës penale ……99

5.5 Karakteristikat konkrete të pasojës…….…...101

KREU VI Lidhja shkaksore (kauzale), si element i domosdoshëm i anës objektive të figurës së veprës penale.

6.1 Lidhja shkakësore sipas ligjeve të natyrës ……...…….108

6.2 Kapërcimi i problemeve të teorive shkakësore, duke u referuar tek ligjet e shkencore …….110

6.3 Kuptimi i përgjithshëm i lidhjes shkakësore……..112

6.4 Trajtimi doktrinal i lidhjes shkakësore në të drejtën penale bashkohore në përgjithësi dhe në të drejtën pënale të Republikës së Shqipërisë…….…….115

6.5 Funksioni i teorive shkakësore, analizë, anët negative……..……118

KREU VII Koha, vëndi, mjetet e mënyra e kryerjes së veprës penale, si element përbërës të anës objektive të figurës së veprës penale.

7.1 Koha si element pëbërës i anës objektive të figurës së veprës penale……..128

7.2 Vëndi, si element përbërës i anës objektive të figurës së veprës penale……...……135

7.3 Mënyra, si element i anës objektive të figurës së veprës penale……...…137

7.4 Mjeti, si element përbërës i anës objektive të figurës së veprës penale……...….…138

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME …….……...143

BIBLIOGRAFIA……..…….....150

HYRJE

Gjatë studimeve të deritanishme, më duhet të pranoj se më kanë tërhequr veçanërisht disiplinat shkencore në fushën e së drejtës penale. Por, interes të posaçëm për mua paraqet disiplina qëndrore në këtë fushë të së drejtës, sikurse është e drejta penale (studimi i thelluar i institutive themelore të saj). Duke u njohur me ecurinë e legjislacionit penal, qe me krijimin e Shtetit Shqiptar deri ne ditet tona, duke studjuar literaturën përkatëse që ekziston në këtë fushë,si dhe duke u njohur sistematikisht edhe me praktikën gjyqësore respektive, konstatoj se edhe pse tema, të cilën unë kam zgjedhur për mbrojtjen e gradës shkencore "Doktor", në pamje të pare, duket thjesht "teorike", në realitet ajo në vetvete, paraqet edhe vlera të rëndësishme praktike.

Vlerat teorike dhe praktike të këtij punimi mendoj se mund të përmblidhen si më poshtë:

Përgjegjësia penale, edhe në Shqiperi, është lloji më i rëndë i përgjrgjësisë juridike, nga këndvështrimi i pasojave që sjell për individin. (Krahasuar me përgjegjësinë juridike administrative, civile, disiplinore). Kjo, është dhe një nga arësyet, madje kryesorja, që kësaj lloj përgjegjësie, si në doktrine, në legjislacion, edhe në veprimtarinë praktike të organeve të prokurorisë dhe gjykatës në vëndet demokratike, pavarësisht familjes ligjore (Romano-Gjermanike apo Common Loë), i kushtohet vëmëndje e posaçme. Dihet se, përgjegjësia penale nuk është gjë tjetër veç detyrimi i autorit të veprës penale që ti nënshtrohet dënimit penal për veprën penale të kryer prej tij, nga njëra anë, dhe të drejtës së shtetit, që nëpërmjet përmbushjes së një sërë kërkesash ligjore të së drejtës material dhe asaj proceduriale penale, të kërkojë prej tij që të plotësojë këtë detyrim, nga ana tjetër.

Bazën e përgjegjësisë penale e përbën prania e veprës penale. Ndërsa kushtin paraprak apo parakushtin e saj, e përbën përcaktimi i figurës së veprës penale konkrete, e cila parashikohet në dispozitën, konkrete të pjesës së posaçme të Kodit Penal ose të ligjeve të posaçme penale. Është pikërisht dispozita konkrete e Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, në të cilën parashikohet lloji konkret i figurës së veprës penale në bazë të së cilës do të akuzohet personi, apo personat e dyshuar, si autorë të veprës penale.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i kushton një kre të veçantë përgjegjësisë penale, (Kreu i dytë i Pjesës së Përgjithëshme të Kodit Penal në nenet 12-21). Në këtë kre përfshihen dy kategori dispozitash. Në kategorinë e pare, përfshihen dispozita të tilla si neni 12 i Kodit Penal, në të cilin parashikohet mosha për përgjegjësi penale për krimet dhe kundravajtjet penale. Neni 13 i Kodit Penal që parashikon lidhjen shkakësore, e cila duhet të ekzistojë ndërmjet veprimit ose mosveprimit të autorit të veprës dhe pasojave, apo mundësisë së ardhjes së tyre. Neni 14 i Kodit Penal që parashikon fajin, në mungesë të të cilit nuk mund të dënohet askush për një veprim ose mosveprim që ligji e parashikon si vepër penale. Ndërsa, nenet 15 e 16 të Kodit Penal, japin karakteristikat thelbësore të të dy formave të fajit, si dashja dhe pakujdesia.

Në kategorinë e dytë përfshihen dispozitat në lidhje me disa rrethana të posaçme, prania e të cilave bën që personi, i cili ka kryer një vepër penale, që formalisht duket si vepër penale , përjashtohet nga përgjegjësia penale. Të tilla janë, neni 17 i Kodit Penal, në të cilën përcaktohet kuptimi juridiko-penal i papërgjegjshmërisë për shkak të gjëndjes mendore dhe, neni 18 i Kodit Penal, në të cilin parashikohen rastet e asaj, që nga disa penalistë quhet ndryshe dhe përgjegjësi penale “e kufizuar”, (sikundër janë rrethant e kryerjes së veprës penale në gjëndje të dehur ose nën efektin e narkotikëve apo simulantëve të tjerë). Në vargun e rrethanave, të cilat përjashtojnë përgjegjësinë penale, edhe pse vepra në dukje përmban formalisht elementët e ndonjë vepre penale, përfshihen edhe rrethana të tilla si, mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme, si dhe ushtrimi i një të drejte apo përmbushje të detyrës, si dhe kryerja e veprës si rezultat i zbatimit të urdhrit të paligjshëm.

Për sa u përket çështjeve, të cilat kanë të bëjnë me kategorinë e parë të dispozitave të nenit të 2-të të Kodit Penal (të Pjesës së Përgjithëshme), shihet qartë, se ato parashikojnë elementë të tillë thelbësorë të përgjegjësisë penale, të cilat në një kuptim të përgjithshëm, nuk janë gjë tjetër veçse elementë përbërës, të domosdoshëm për secilën prej veprave penale që parashikohen në Pjesën e Posaçme të Kodit Penal. Mungesa, qoftë edhe e njërit prej tyre, pasjellë domosdoshmërisht edhe mungesën e vetë veprës penale. Ajo që mendoj se duhet të vihet në dukje, është fakti që, nga njëra anë, pavarësisht se këto elementë janë njëlloj të domosdoshëm për praninë e veprave penale, përmbajtja dhe karakteristikat juridike të tyre nuk janë as të barabarta as edhe të njëjta për të gjitha veprat penale, të cilat përfshihen në Pjesën e Posaçme të Kodit Penal. Kurse, nga ana tjetër, ato nuk janë të vetmit elementë që duhet të plotësohen për të arritur në përfundimin nëse, në njërin ose tjetrin rast, ndodhemi para njërës ose tjetrës vepër penale konkrete, (në numrin relativisht të madh të veprave të cilat ligjvënësi i konsideron vepra penale).

Siç përpiqem të argumentoj më me hollësi gjatë trajtimit të këtij punimi, dallimet jo gjithmonë gjenden në elementët e vetë veprës penale, por më së shumti, në elementët e një kategorie tjetër juridiko-penale, të prejardhur pazgjidhshmërisht prej saj, veprës penale, sikundër është ajo që në doktrinën e së drejtës penale emërtohet FIGURA E VEPRËS PENALE. Janë pikërisht elementët e figurës së veprës penale, tiparet që krijojnë mundësi praktike për juristin

për të përcaktuar në aspektin teorik, edhe praktik, dallimin ndërmjet veprave penale të së njëjtës natyrë, (nga njëra-tjetra), proçes ky i domosdoshëm për të bërë cilësimin e drejtë ligjor të veprës penale, rast pas rasti.

Pikërisht, në dispozitën konkrete të pjesës së posaçme të Kodit Penal, në të cilën parashikohet figura e veprës penale konkrete apo lloji konkret i veprës penale, për kryerjen e së cilës do të akuzohet personi apo personat e dyshuar si autor të veprës penale, rast pas rasti gjëndet edhe lloji edhe masa e dënimit penal, e cila mund të caktohet nga gjykata, nëse, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, personi i akuzuar gjëndet fajtor.

Por, në vetvete çfarë është figura e vepes penale? A do të konsiderohet figura e veprës penale kategori më vete e së drejtës penale, e veçantë nga kategoria tjetër e kësaj disipline të së drejtës, sikurse është vepra penale, nga e cila rrjedh, apo është plotësuese e kësaj të fundit? Pavarësisht përgjigjes, të cilat do të marrin pyetjet e mësipërme dhe, shume të tjera si këto, ajo që mendoj se duhet vënë theksi është fakti se, është pikërisht figura e veprës penale, ajo e cila garanton zbatimin në praktikë të parimit universal, që në kohën e së drejtës Romake quhej, *nullum crimen nullum poena sine lege, scripta* (nuk ka krim nuk ka dënim pa ligj të shkruar).

Ky parim, pavarësisht ndryshimeve në formulim, është sanksionuar në kodet penale kudo, përfshirë edhe në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, në nenin 2. Sipas kësaj dispozite, "Askush nuk mund të dënohet penalisht për një vepër që më parë nuk është e parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose kundravajtje penale. Askush nuk mund të dënohet me një lloj dhe masë dënimi të paparashikuar në ligj". Kuptohet, se me parashikimin nuk duhet kuptuar vetëm emërtimi i llojit të veprës penale, i cili nuk përfaqëson gjë tjetër veçse sintezën e elementëve përbërës të saj, por edhe përshkrime, pavarësisht formës dhe masës, të tipareve objektivë dhe subjektivë konkretë të veprës penale të caktuar, tërësia e të cilave nuk përbën gjë tjetër, veçse figurën e veprës penale konkrete që parashikohet në një dispozitë, të caktuar në tërësinë e dispozitave, neneve që përmban Pjesa e Posaçme e Kodit Penal.

Ky parim ka gjetur pasqyrim edhe në nenin 7 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në të cilën thuhet se "1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim i cili, në çastin kur ka ndodhur, nuk përbënte shkelje sipas së drejtës kombëtare ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që do të zbatohej në çastin e kryerjes së shkeljes. 2. Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe dënimin e një personi fajtor për një veprim ose një mosveprim, i cili në çastin kur është kryer, ishte krim sipas parimeve të përgjithëshme të së drejtës të njohura nga kombet e qytetëruara."

Në ligjin material, në Kodin Penal, nuk është e parashikuar thjesht vepra penale si e tillë, por edhe lloji konkret i saj. Lloji konkret i veprës penale nuk është gjë tjetër, veçse figura e veprës penale konkrete me elementët e veçantë përbërës të saj.

Në pjesën më të madhe të dispozitave të pjesës së posaçme të kodeve penale bashkëkohore, përfshirë edhe Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, është e parashikuar në formë konkrete, shprehimisht vetëm ana objektive e figurës së veprës penale konkrete, e cila është një prej katër elementeve përbërës, të domosdoshëm të saj, (objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive). Në disa të tjera, veç anës objektive, është parashikuar dhe ana subjektive[1] dhe ndonjëherë edhe subjekti[2].

Përshkrimi me saktësi, të anës objektive të figurës së veprës penale konkrete, para së cilës ndodhemi rast pas rasti, në dispozitën përkatëse të pjesës së posaçme të Kodit Penal, përbën garanci reale juridike për ndalimin kategorik të zbatimit të ligjit penal me analogji, si një nga parimet universale të legjislacioneve bashkohore, përfshirë dhe Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë[3].

Përmes zbulimit të pranisë ose jo, dhe përcaktimit të elementëve të anës objektive të figurës së veprës penale në çdo rast ngjarjeje, e cila dyshohet si kriminale apo kallëzim penal, i duhet dhënë përgjigje shtatë pyetjeve te pashmangshme, të cilat shtrohen për zgjidhje në çdo proçes penal si: Ç'farë ndodhi? Ku ndodhi? Kur ndodhi? Kush e kreu? Me se e kreu? Si e kreu? Pse e kreu?

Në punim, në formë të përmbledhur, përqëndrohem në çështje të tilla si:

- Vepra penale si kategoria qëndrore e së drejtës penale, kuptimi sociologjiko-juridik dhe historik i veprës penale, elementët përbërës së veprës penale, faktorët përcaktues të ndryshueshmërisë në kohë të veprave që janë konsideruar si vepra penale.
- Figura e veprës edhe pse e lidhur pazgjithshmërisht me veprën penale si kategori shumë e rëndësishme e së drejtës penale, elementët përbërës të domosdoshëm të figurës së veprës penale.
- Raporti i veprës penale, figura e veprës penale, si ka gjetur pasqyrim ky raport në disa prej kodeve penale, veçanërisht me Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë.
- Ana objektive e figurës së veprës penale, kuptimi, elementët përbërës të anës objektive të figurës së veprës penale, ndarja ligjore dhe teorike e këtyre elementëve në elementë të domosdoshëm dhe jo të domosdoshëm, etj.

[1] Shiko nenin 76 "Vrasja me dashje"; nenin 77 "Vrasje me dashje ne lidhje me nje krim tjetër"; nenin 78 "Vrasje me paramendim"; nenin 79 "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese", të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

[2] Shiko nenin 86 "Tortura"; nenin 96 "Mjekimi i pakujdesshëm"; nenin 97 "Mosdhënia ndihmë"; nenin 181/a "Moskryerja e detyrave nga organet tatimore"; nenin 248 "Shpërdorimi i detyrës", të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

[3] Neni 1/c paragrafi II, i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

- Problematika e legjislacionit penal të Republikës së Shqipërisë rreth masës, mënyrës dhe saktësisë së përshkrimit të elementëve të anës objektive të figurave të veprave penale në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, sugjerime përmirësuese bazuar në praktikën gjyqësore shqiptare dhe të huaj, si dhe përvoja përafruese të tij me legjislacione penale më të përparuar të kohës.
- Trajtimi dhe kuptimi i saktë i lidhjes shkakësore, ka qënë dhe mbetet gjithnjë një çështje e nxehtë e doktrinës dhe jurisprudencës. Ekzistenca e teorive të ndryshme mbi lidhjen shkakësore. Secila nga teoritë e ka trajtuar lidhjen shkakësore në periudha të ndryshme kohe, ka patur të mirat dhe të metat e saj.
- Rëndësia e lidhjes shkaksore, në kuptimin e raportit ndërmjet shkakut dhe pasojës së ardhur nga kryerja e veprës penale. Mungesa e mosplotësimit të këtij elementi të anës objektive, passjell mungesën e përgjegjësisë penale të autorit të saj. Praktika ka treguar, se përcaktimi i lidhjes shkaksore në një vepërt penale nga organet e procedimit, nuk është e thjeshtë, madje jo në pak raste, është keqinterpretuar.
- Rëndësia e studimit të pasojës, nga pikëpamja praktike , qëndron në faktin se, duke u nisur prej saj, bëhet dallimi ndërmjet fazave të veprimtarisë, përmes të cilave kalon vepra penale, veçanërisht, ndërmjet fazes së tentativës dhe kryerjes së plotë të veprës penale. Në disa raste, arrihet në përfundimin nëse veprimet apo mosveprimet e një personi përbëjnë ose jo një vepër penale, ekzistenca e së cilës shërben për të cilësuar veprën penale sipas njërës apo tjetrës dispozitë konkrete të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal. Në varësi të pasojës, përcaktohet edhe shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, faktor ky që ndikon në llojin dhe masën e dënimit që duhet të caktohet ndaj personit, i cili ka kryer veprën penale.
- Koha, si elementët e tjerë dytësorë të anës objektive, është element plotësues, por mund të marrrë dhe një vlerë të veçantë, si element përbërës i domosdoshëm i veprës penale ose si rrethanë cilësuese e figurës së saj. Sipas këtij profili, koha mund të ndikojë tek vepra penale, duke çuar në përfundime të ndryshme.

KREU I

VEPRA PENALE BAZË E PËRGJEGJËSISË JURIDIKE PENALE.

1.1 Kuptimi, përmbajtja dhe elementët e përgjegjësisë penale.

Me përgjegjësi penale kuptohet zbatimi i kërkesave të cilat lidhen së pari, me procedurën e marrjes në përgjegjësi penale të parashikuar nga legjislacioni procedurial penal, së dyti, shqyrtimin dhe hetimin e çështjes gjatë gjykimit, së treti, marrjen e vendimit gjyqësor, së katërti, vuajtjen e dënimit të dhënë nga gjykata, së pesti, kufizimet e tjera të përcaktuara në vendimin e gjykatës ndaj personit të marrë si i pandehur për kryerjen e veprës penale[4]

Kuptimi i përgjithshëm i përgjegjësisë në doktrinën e së drejtës ka kuptime të ndryshme. Për shëmbull, përgjegjësi për pasojën e shkaktuar me veprimet e veta, përgjegjësi si detyrim për përmbushjen e detyrave të caktuara juridike. Sipas përkufizimeve të dhëna, përgjegjësia, përfaqëson një raport të dyanshëm ndërmjet dy subjekteve. Raport midis atij që përgjigjet dhe atij para të cilit përgjigjet i pari. Askush nuk mund që për veprimet e tij të përgjigjet para vetes së tij, përveç se në formë të përgjegjësisë para ndërgjegjes së tij.

Vepra penale është kategoria kryesore në sistemin e së drejtës penale. Vepra penale legjitimon të drejtën e ndëshkimit dhe përcakton gjerësinë e represionin penal-juridik, kurse nga nocioni i saj nxirren edhe kategori të tjera themelore, si përgjegjësia penale dhe dënimi[5].

Përgjegjësia penale përcaktohet sipas disa kritereve shkencore të parashikuar ne ligjin material dhe që trajtohen nga doktrina, nga teoria e së drejtës penale. Këto kritere janë të natyrës juridike dhe faktike. Kriteret juridike kanë të bëjnë kryesisht me disa percaktime të ligjit, ose të teorisë të së drejtës penale. I tillë është parimi i mosdënimit pa ligj, sipas të cilit askush nuk

[4] I. Elezi., S. Kaçupi., M. Haxhia., "Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë", Tiranë 2009, Fq.87

[5] V.Kambovski., E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme. Shkup 2010, fq 123

mund të dënohet penalisht për një vepër që më parë nuk është parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose si kundravajtje penale[6].

Kriteret e natyrës faktike kanë të bëjnë me rrathanat e kryerjes së veprës. Prej tyre, të drejtës penale i interesojnë së pari, ato rrethana që përbëjnë anën objektive të figurës së veprës penale dhe së dyti, rrethanat, të cilat shërbejnë për të arritur në përfundimin nësë ekziston apo jo ana subjektive e figurës së veprës penale, nëse personi ka vepruar me faj, rast pas rasti.

Thelbësore në zgjidhjen e problemit të përgjegjësisë penale për vepra që parashikohen në ligj si vepra penale, është që personi të ketë mbushur moshën e kërkuar nga ligji, 14 vjeç për krime dhe 16 vjeç për kundravajtjet penale në kohën e kryerjes së tyre[7], të ketë vepruar me faj[8] dhe të ketë lidhje shkakësore midis veprimit ose mosveprimit të tij[9] dhe pasojave shoqërisht të rrezikëshme.

Megjithëse jo i shprehur në ligj, kusht i domosdoshëm është edhe që personi të jetë i përgjegjshëm. Për përgjegjshmërinë, as për sa i përket kuptimit dhe përmbajtjes së saj, as edhe thjesht si nocion, nuk bëhet fjalë, jo vetëm në Kodin Penal, i cili është në fuqi, por as edhe në dy kodet e mëparëshme[10]. Kuptimin e këtij instituti, jo vetëm si nocion thjesht tekniko-juridik, por në rradhë të parë e mbi të gjitha, si nocion shoqëror, me përmbajtje të theksuar të natyrës psikiko-psikologjike, e jep doktrina e së drejtës penale[11].

Një nga kushtet që veprimi apo mosveprimi të jetë shkak për përgjegjësi penale, është që personi, i cili e kryen atë, të ketë atë që në teorinë e së drejtës penale, quhet "ndërgjegja e cënimit"[12]. Me këtë duhet kuptuar që personi të jetë në gjendje të vlerësojë nëse veprimi apo mosveprimi i tij është i dobishëm ose i dëmshëm për shoqërinë, apo për individë të veçantë.

Përgjegjësia penale është detyrimi i autorit të veprës penale për t'ju nënshtruar kërkesave ligjore dhe dënimit të caktuar ndaj tij për veprën penale të kryer. Pra, përgjegjësia penale lidhet me përgjegjshmërinë e personit, me aftësinë për të kuptuar dhe kontrolluar sjelljen e tij. Nga ana

[6] Neni 2, i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Tetor 2010

[7] Neni 12, i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Tetor 2010

[8] Neni 14, i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Tetor 2010

[9] Neni 13, i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Tetor 2010

[10] Neni 7, i Kodit Penal të vitit 1952 dhe neni 8, i Kodit Penal të vitit 1977 titulloheshin "Personat e Papërgjegjshëm", kurse në nenin 17 të Kodit Penal të vitit 1995 titullohet "Papërgjegjshmëria për shkak të gjëndjes mendore"

[11] Në tekstin "Ugollovnoje Pravo, Obshçaja Çast" grup autorësh, Moskë 1999, faqe 181 "Përgjegjshmëria përkufizohet si gjëndje psikike e njeriut në të cilën ai në momntin e kryerjes së krimit kishte ndërgjegjen e karakterit shoqërisht të rrezikshëm të sjelljes së tij, si dhe te udhëhiqte veten"

[12] S.Spiro., Cikël leksionesh, Përgjegjshmëria dhe papërgjegjshmëria, UET, Tiranë 2008, Fq 2

tjetër, lindja e përgjegjësisë penale detyron organet kompetente të fillojnë procedimin penal ne përputhje me rregullat e ligjit proçedurial, me qëllimin e vetëm për të materializuar këtë përgjegjësi. Përgjegjësia penale është pergjegjësi individuale[13].

1.2 Analizë e shkurtër e kuptimit të veprës penale, dhe elementët përbërës të saj.

Përcaktimi i kuptimit të veprës penale është një ndër detyrat kryesore të legjislacionit penal dhe të shkencës së të drejtes penale. Do të thotë, përcaktimi i nocionit të veprës penale, i përgjegjësisë penale dhe i sanksioneve penale përbëjnë tre çështje kryesore të cilat i shqyrton e drejta penale. Në rradhën e ketyre tre çështjeve, vepra penale zë vëndin e parë sepse vepra penale shërben si bazë për përgjegjësinë penale.

Kur ligjvënësi parashikon një fakt si vepër penale ka si qëllim goditjen e atyre sjelljeve njerëzore të cilat prekin të mira që kanë një vlerë themelore për të gjithë shoqërinë. Bëhet fjalë për të mira juridike, të cilat mund të jenë të drejta personale të individit, por edhe interesa të tij apo të shoqërisë[14]. Pikërisht për të kuptuar vlerën juridike të fakteve të parashikuara nga ligji si vepra penale në lidhje me të mirat juridike të cilat ligjvënësi synon të mbrojë, është e nevojshme ndarja dhe analizimi shkencor i të gjithë elementëve përbërës të veprës penale[15]. Analizimi i veprës penale kalon domosdoshmërisht në ndarjen e saj në disa element që përbëjnë thelbin strukturor. Kjo është e nevojshme jo vetëm pasi lehtëson studimin e saj, por edhe për faktin se përbën një mjet solid për gjykatësin në interpretimin korrekt të ligjit penal. Vetëm me anë të një analize të thellë të elementëve përbërës të veprës penale, gjykatësi mund të jap një gjykim të saktë dhe të drejtë mbi përgjegjësinë penale të një individi. Pra, studimi shkencor i strukturës së veprës penale është i nevojshëm për të verifikuar korrektësinë e vendimeve gjyqësore[16].

[13] Në legjislacionet e shume shteteve, përfshirë në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë , në nenin 45 parashikohet edhe përgjegjësia penale e personave juridikë.

[14] Mbi rolin themelor të së mirës juridike në teorinë e përgjithëshme të veprës penale është kryesore vepra e A.Rocco, L'oggeto del reato, Torino, 1913 dhe në vazhdim F.Bricola, teoria generale del reato, Nuovissimo Digesto Italiano, Torino,1973

[15] Në doktrinën botërore janë afirmuar dy modele në analizimin e strukturës së veprës penale, konceptimi i unitetit të veprës penale në bazë të të cilit vepra penale konsiderohet si një moment emotive i pandashëm dhe konceptimi analitik i veprës penale, sipas të cilit vepra penale duhet të analizohet në në mënyrë racionale dhe analitike. I. Padova, 1969, fq.151

[16] Në këtë drejtim, në jurisprudencën shqiptare tepër me vlerë është vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë, nr4 datë15.04.2011, ku pas një analizë të thellë, nga një anë të elementeve përberës të veprës penale, nga ana tjetër e parimeve bazë që rregullojnë institutin e bashkëpunimit i parashikuar nga neni 25 i Kodit Penal, gjykata arrin në konkluzionin se "kur nga pikëpamja e anës objektive provohet se vepra penale është kryer nga dy ose më shumë persona, vepra do të konsiderohet e kryer në bashkëpunim. Kjo si për rastet që nuk identifikohen bashkëpuntorët, ashtu edhe për rastet kur bashkëpuntori nuk ka përgjegjësi penale për shkak

Me fjalën strukturë të veprës penale duhet të kuptuar elementët e domosdoshëm në të gjitha veprat penale. Si rrjedhojë analiza e strukturës ka të bëj me gjetjen e elementëve thelbësor pa të cilën nuk mund të ketë vepër penale[17]. Analiza e veçantë e secilit element të veprës penale është e nevojshme nga ana metodologjike në studimin dhe interpretimin e veprës penale. Por, për të patur vepër penale, është e domosdoshme ekzistenca e të gjithë elementëve përbërës të saj[18]

Në teorinë e së drejtës penale janë shfaqur mendime të ndryshme në lidhje me kuptimin e veprës penale. Së pari, vepra penale trajtohet si një fenomen juridik. Por vepra penale konsiderohet edhe si fenomen social. Si veprim apo sjellje e njëriut të caktuar nga e cila dëmtohen apo rrezikohen vlera të caktuara të shoqërisë apo të individit. Në këtë aspekt, kjo sjellje e njeriut, (veprimi apo mosveprimi) e cila është në kundërshtim me interesat e shoqërisë ose të individit, midis të tjerash është një manifestim i personalitetit të tij, është një shprehje e gjëndjes së tij psikike në një moment të caktuar.

Vepra penale konsiderohet si fenomen juridik apo fakt juridik, i cili shkakëton pasoja juridike në botën e jashtëme. Pra, me vepër penale në aspektin formal do të kuptojmë atë sjellje njerëzore, e cila me ligj është sanksionuar si vepër penale. Sipas këtij përkufizimi, nuk shqyrtohet se vepra penale është vepër penale kundër moralit dhe shoqërisë, por vetëm nëse ajo është e kundërligjëshme. Një përkufizim i tillë nuk parashikon se për cilat shkaqe kjo sjellje konsiderohet vepër penale, por e lidh vetëm me atë që kjo sjellje duhet të jetë e kundërligjëshme.

Në aspektin material, vepra penale është vepër apo sjellje e njëriut, e cila dëmton apo rrezikon vlerat elementare të njeriut, të shoqërisë dhe sistemit juridik[19]. Bëhet fjalë për vlera jetike nga të cilat varet ekzistenca e individit dhe e shoqërisë. Do të konsiderohet vepër penale ajo sjellje e njëriut që duhet të paraqesë rrezikshmëri shoqërore. Sipas këtij përkufizimi, kjo sjellje e njëriut, pavarësisht se është e kundërligjëshme, por që nuk është e rrezikshme për shoqërinë, nuk përbën vepër penale.

---

të paaftësisë apo moshës për përgjegjësi penale. cilësitë e veçanta të cilat shtojnë, pakësojnë apo përjashtojnë dënimin merren parasysh vetëm për bashkpunëtorin tek i cilia to ekzistojnë"

[17] F. Mantovani, Diritto Penale, parte generale, Padova ,2007, fq.100

[18] Kur flasim për autonominë e një elementi përbërës të veprës penale duhet saktësuar se duke ndjekur metodën e analizimit ekzistojnë arsye të qëndrueshme nga ana llogjike dhe juridike për të dalluar një element nga jë tjetër dhe për ta vlerësuar në mënyrë të izoluar, megjithatë në kuadrin e veprës penale vetëm prania e të gjithë elementëve bën të mundur ekzistencën e një vepre penale. pikërisht për këtë gjyqtari i cili thërritet në aplikimin e ligjit penal ka si detyrë të kontrollojë ekzistencën e të gjithë elementeve përbërës në faktin konkret, në rast se ndonjë element mungon duhet të shpall pafajsinë e të pandehurit.

[19] I.Salihu., E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithëshme. Prishtinë, Tetor 2010, fq 180

Përcaktimin e rrezikshmërisë shoqërore ligjvënësi e bën në bazë të kushteve objektive të shoqërisë. Vlerësimi, nëse një veprim apo mosveprim paraqet rrezikshmëri shoqërore, bëhet duke u nisur nga interesat e kësaj shoqërie.

Nga këto nocione të veprës penale vihet re se kuptimi formal e shpjegon faktin vetëm në aspektin juridike formal. Kurse, nocioni material, jep përgjigje se për çfarë shkaqesh një vepër konsiderohet vepër penale, arësyet se përse ai veprim është i dëmshëm. Të marra në mënyrë të shkëputur, këto dy teori, nuk e përcaktojnë në menyrë adekuate dhe në tërësi nocionin e veprës penale.

Si konkluzion, mund të thuhet se vepra penale përkufizohet vetëm nëse merren parasysh elementët formal dhe material të saj.

Numri më i madh i kodeve penale të shteteve perëndimore si, Kodi Penal Francez, Kodi Penal Gjerman dhe ai Zvicerian, nuk njohin përkufizim ligjor të nocionit të veprës penale. Në legjislacione të tjera janë pranuar dy përkufizime ligjore, ai formal dhe material[20].

Edhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë nuk e jep përkufizimin e veprës penale. Por, sipas nenit 1 të tij ligji penal përcakton veprën penale, dënimet dhe masat që merren ndaj autorëve të tyre[21]. Kjo mund të konsiderohet si një mangësi që ka ky kod. Qëndrimi i ndryshëm mbahej nga ligjvënësi Shqiptar në dy kodet e mëparshme penale. Kështu, në dispozitat e nenit 3 të Kodit Penal të vitit 1952, e cila titullohej "Përcaktimi i krimit", përcaktohej: "Krimi është çdo vepër (veprim ose mosveprim) shoqërisht e rrezikshme, e kryer me faj dhe e parashikuar nga ligji". Kurse në dispozitën e nenit 3 të Kodit Penal të vitit1977, që titullohej "Kuptimi i veprës penale", përcaktohej: "Vepra penale është çdo veprim ose mosveprim shoqërisht i rrezikshëm, i kryer me faj dhe i parashikuar nga ligji"[22]

Përsa i përket doktrinës të së drejtës penale Shqipëtare, në dhënien e një përkufizimi të saktë, i është përmbajtur të dy parimeve: të aspektit formal dhe atij material. Sipas këtij nocioni, formal-material, vepër penale është ai veprim ose mosveprim i kundërligjshëm, shoqërisht i rrezikshëm, i cili kryhet me faj. Pra, baza juridike për përcaktimin e veprës penale është rrezikshmëria shoqërore dhe kundërligjshmëria e veprës.

Rrezikshmëria shoqërore e veprës përbën tiparin material të veprës, kurse kundërligjshmëria, tiparin formal-juridik të saj.

[20] V.Kambovski., E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithëshme. Shkup 2010, fq 123

[21] Neni 1, të Kodit Penal të Rrepublikës së Shqipërisë

[22] Ndryshimi në formulimin e titujve të neneve 3 të dy kodeve penale të sipërpërmëndura, buron nga fakti që deri në vitin 1977 kur u miratua Kodi i dytë Penal i Republikës së Shqipërisë, mbas çlirimit të vëndit nuk ekzistonta ndarja e veprave penale në krime dhe kundërvajtje penale.

Studimi i veprës penale merr rëndësi se duke përcaktuar se çfarë është vepër penale, e drejta penale hedh bazat për një luftë kundër kriminalitetit. Synohet që të vendosen përpara përgjegjësisë penale vetëm personat që kryejnë vepra penale, vepra të cilat plotësojnë kushtet e përkufizimit që jep doktrina e së drejtës penale. Kjo përbën edhe garancinë themelore të procesit penal.

Shihet, pavarësisht diferencave, më së shumti për shkak të mënyrës së formulimeve që bëhen, vepra penale përkufizohet si një vepër (veprim ose mosveprim) shoqërisht e rrezikshme e parashikuar në ligj (e kundraligjëshme) dhe e kryer me faj.

Nisur nga këto përkufizime, si element të veprës penale, në doktrinë, përcaktohen:

a) Veprimi ose mosveprimi (vepra);

b) Rrezikshmëria shoqërore;

c) Kundërligjshmëria dhe

d) Faji

Veprimi ose mosveprimi.

Vepra penale mund të kryhet si me veprim ashtu edhe me mosveprim. Nëse veprimi do të konsiderohet sjellja aktive e personit, e perceptueshme duke kryer diçka, me mosveprim do të kuptojmë atë qëndrim pasiv të njeriut, duke mos kryer diçka që duhej ta kryente. Nëse veprimi është ajo sjellje aktive, si një lëvizje trupore e vullnetëshme, mosveprimi paraqitet si sjellje pasive e personit në botën e jashtëme. Mosveprimi është një nocion i kundërt i veprimit. Të drejtës penale nuk i intreson cilido qëndrim pasiv i personit, thjesht mos bërja e diçkaje. I intreson qëndrimi pasiv ndaj diçkaje që personi duhet të kryente sipas ligjit apo sipas detyrës së tij. Për shëmbull, "Mosdhënia e ndihmës, pa shkaqe të arsyeshme nga ana e personit që me ligj ose për shkak të detyrës detyrohej ta jepte atë,……."[23] ose "Mosdhënia e mjeteve të nevojshme për jetesën e fëmijëve, të prindërve ose të bashkëshortit, nga personi që në zbatim të një vendimi gjyqësor detyrohet ta japë,……"[24] përbëjnë kundërvajtje penale.

[23] Neni 97 i Kodit Penal të Rrepublikës së Shqipërisë, Mosdhënia ndihmë.

[24] Neni 125 i Kodit Penal të Rrepublikës së Shqipërisë, Mosdhënia e mjeteve për jetesë.

Si veprimi ashtu edhe mosveprimi, kur përmbushin kushtet e mësipërme kanë rëndësi për të drejtën penale. Megjithatë shkalla e rrezikshmërisë e veprave penale të kryera me veprim, si regull është më e madhe se ajo e veprave penale të kryera me mosveprim.

Mosveprimi përcaktohet në dispozitën përkatëse në të cilën parashikohet figura konkrete. Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë ka dispozita në të cilat parashikohen vepra penale, të cilat kryhen vetëm më veprim[25], ashtu sikurëse ka dispozita në të cilat parashikohen vepra penale, të cilat mund të kryhen vetëm më mosveprim[26]. Por, në pjesën më të madhe të dispozitave të pjesës së posaçme të Kodit Penal, parashikohen vepra penale që mund të kryhen si me veprim ashtu edhe me mosveprim[27].

Kundërligjshmëria.

Një veprim ose mosveprim si element përbërës i veprës penale që të jetë i kundërligjshëm duhet të vijë në kundërshtim me normat dhe rendin juridik, pra duhet të jetë në kundershtim me ligjin. Kundërligjshmëria paraqet bazën juridike për përcaktimin e veprës penale. Në asnjë rast, veprimi ose mosveprimi, nuk mund të përbëjë vepër penale pa u parashikuar shprehimisht në ligj një gjë e tillë. Përkufizimi për kundërligjshmërinë e veprës rezulton nga përshkrimi që i bëhet veprës nga norma e caktuar. Vepra mund të jetë e kundërligjëshme, por jo gjithmonë mund të përbëjë një vepër penale. Ajo mund të jetë shkelje administrative ose civile. Për shëmbull, shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor mund të përbëjë kundravajtje administrative nëse nuk ka sjellë pasojat e parashikuara me ligj. Ajo mund të përbëjë vepër penale dhe ka sjellë ndonjërën prej pasojave, që parashikohen në dispozitën e nenit 290 të Kodit Penal[28].

Nocioni i kundërligjshmërisë është i përbashkët në të gjitha degët e së drejtës, në të drejtën civile dhe në të drejtën administrative. Dallimi ekziston tek pasojat që sjell kjo kundërligjshmëri tek vepra penale nga pasojat që sjell kundërligjshmëria tek degët e tjera të së

[25] Neni 134 "Vjedhja"; neni 161 "Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia", të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

[26] Neni 97 "Mosdhënia ndihmë"; neni 98 "Mosdhënia e ndihmës nga kapiteni i anijes"; neni 124 "Braktisja e fëmijëve të mitur"; neni 170 "Mosbërja e shënimeve të detyrueshme", të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

[27] Neni 76 "Vrasja me dashje"; neni 78 "Vrasja me paramendim"; neni 79 "Vrasja në rrethana të tjera cilësuese"; neni 96 "Mjekimi i pakujdesshëm"; neni 248 "Shpërdorimi i detyrës"; neni 290 "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor", të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

[28] "Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar vdekjen, plagosjen e rëndë të një personi ose plagosjen e lehtë të disa personave, dënohet më ….." nëse nuk janë sjellë këto pasoja atëhere nuk jemi përpara kësaj figure krimi, edhe nëse jemi përballë shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor por nuk ka ardhur pasoja, peroni do të përgjigjet administrativisht.

drejtës[29]. Dallim tjetër është përsa i përket llojit të sanksioneve që parashikohen për çdo rast konkret të kundërligjshmërisë.

Që të jetë i kundërligjshëm veprimi ose mosveprimi, duhet të parashikohet nga norma juridike-penale. Kërkesa e kundërligjshmërisë, buron nga parimi i ligjshmerisë, i parashikuar në nenin 2 të Kodit Penal se "askush nuk mund të dënohet penalisht për një vepër që më parë nuk është parashikuar shprehimisht me ligj si krim ose kundërvajtje penale". Parim ky i shprehur edhe me shprehjen : *"Nullum crimen sine lege", "Nullum poena sine crimen"*.

Kundërligjshmëria, sipas brendësisë së saj, është e natyrës objektive. Kjo përcaktohet duke vënë në relacion veprimin ose mosveprimin e individit me normat e së drejtës penale. Kësisoj, në të gjitha rastet kur sjellja e njëriut është në kundërshtim me normat e legjislacionit penal, të cilat urdhërojnë apo ndalojnë ndonjë veprim, mund të konstatojmë se sjellja e njeriut është e kundërligjëshme. Mirëpo, kundërligjshmëria, edhe pse sipas natyrës së saj është komponent i natyrës objektive, në disa raste ajo përmban edhe elementë subjektive. Si shëmbull mund të merret neni 247 i Kodit Penal sipas të cilit "mbajtja pa të drejtë e uniformës, e një dokumenti apo e një shenje dalluese që tregojnë cilësinë e një punonjësi që kryen detyrë shtetërore apo një shërbim publik". Në kuadër të këtij paragrafi kemi kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet, por nëse kjo mbajtje e uniformës është bërë me qëllim fitimi ose ka prekur liritë apo të drejtat e shtetasve përbën vepër penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Nga ekzistenca ose jo e këtij elementi, varet dhe cilësimi ligjor i veprës penal. Si konkluzion mund të thuhet se veprimi ose mosveprimi është i kundërligjshëm, kur ai vjen në kundërshtim me ndonjë normë ndaluese apo urdhëruese të ligjit.

Supozimi i mësipërm është plotësisht i arsyeshëm, sepse nëse një vepër nuk është e kundërligjshme, ajo nuk mund të konsiderohet vepër penale. Ndërsa, ne disa figura të tjera kundërligjshmëria shprehet qartë. Përmëndja në mënyrë të shprehur i elementit të kundërligjshmërisë në disa figura të veprës penale, kursesi nuk do të thotë se veprat e tjera penale, te të cilat nuk është shprehur kundërligjshmëria në figurën e tyre, nuk janë të kundërligjëshme. Përkundrazi, kundërligjshmëria është element themelor dhe konstuitiv i të gjitha veprave penale. Por, në disa raste, për shkaqe praktike, ky element përmëndet në mënyrë të shprehur.

Disa autorë të së drejtës penale bëjnë dallimin ndërmjet kundërligjshmërisë në aspektin formal dhe kundërligjshmërisë në aspektin material[30]. Kundërligjshmëria në aspektin formal është kur veprimi ose mosveprimi paraqitet si shkelje e normës urdhëruese apo ndaluese, e cila

[29] V.Kambovski., E Drejta Penale, Pjesë e Pergjithshme, Shkup 2010, Fq.201

[30] V.Kambovski., E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithëshme, Shkup 2010, fq 201

me ligj përcaktohet si vepër penale. Kundërligjshmëri, në aspektin material, është veprimi, i cili vjen në kundërshtim me normën e caktuar penale juridike, por në të njëjtën kohë, edhe dëmton marrëdhënien shoqërore, e cila është e mbrojtur posaçërisht nga kjo normë. Ky kuptim material i kundërligjshmërisë nxjerrë në pah dhe rrezikshmërinë shoqërore, si element tjetër i përbashkët ndërmjet veprës penale dhe figurës së veprës penale.

Rrezikshmëria shoqërore.

Rrezikshmëria është vlerësimi negativ që i bëhet një vepre (veprim ose mosveprim) në një shoqëri të caktuar dhe në një periudhë kohe të caktuar, nga ligjëvenesi. Kriteri që ka patur parasysh ligjvënësi në vlerësimin e një vepre, është sjellja e njeriut që paraqet rrezik për shoqerinë dhe individin.

Ky vlerësim ka karakter objektiv dhe jo subjektiv. Ai merrë për bazë marredhëniet shoqërore, të cilat cënohen nga kjo sjellje. Sa më të rëndësishme të jenë këto marrëdhënie shoqërore të mbrojtura posaçërisht nga ligji penal, aq më e rrezikëshme është edhe vepra. Dhe sa më pak e rëndësishme të jetë kjo marrëdhënie shoqërore, aq më pak e rrezikshme është edhe vepra.

Nuk mund të konsiderohet vepër penale ajo vepër e cila nuk është e rrezikshme për shoqërinë. Në Kodin Penal, rrezikshmëria shoqërore nuk përmëndet në mënyrë të veçantë si element i figurës së veprës penale. Shpesh kjo nënkuptohet, si pjesë përbërëse e veprës penale. Pikërisht, çmimi negativ që i bën shoqëria veprave (veprimeve ose mosveprimeve), të cilat cënojnë vlera të rëndësishme shoqërore, të cilat përbëjnë objekt studimi të së Drejtës Penale, kjo degë e së drejtës e quan rrezikshmëri shoqërore.

Meqënëse janë marrëdhëniet shoqërore-juridike që vendosen për mbrojtjen pikërisht të kësaj kategorie vlerash në një shoqëri të caktuar, në një periudhë kohore të dhënë, ato që përbëjnë thelbin e veprës penale, objektin e saj, e Drejta Penale rrezikshmërinë shoqërore e konsideron tiparin material të vetë veprës penale[31]. Ky tipar përfaqëson një nga elementët në të cilën gjen shprehje ana e jashtme e veprës penale dhe figurës së saj. Pikërisht mungesa e rrezikshmërisë shoqërore e veprës ka shërbyer për ligjvënësin si bazë juridike për të moskonsideruar si vepra penale disa vepra, të cilat sjellin pasoja të dëmshme për interesat e individit, të shtetit, apo të shoqërisë. Të tilla janë rastet e pasojave që vijnë në rastet kur personi vepron në kushtet e mbrojtjes së nevojshme (parashikuar nga dispozita e nenit 19 të Kodit Penal), nevojës ekstreme (parashikuar nga dispozita e nenit 20 të Kodit Penal), ushtrimi i një të drejte apo përmbushja e detyrës (parashikuar nga dispozita e nenit 21 të Kodit Penal) dhe heqjes dorë nga kryerja e veprës penale (parashikuar nga dispozita e nenit 24 të Kodit Penal).

[31] Po aty

Rrezikshmëria shoqërore ka karakter dinamik, është e ndryshme në varësi nga rrethanat, koha, vëndi si dhe nga ana subjektive e veprës penale. Mirpo, përkundër karakterit relativ dhe dianmik të nocionit të rrezikshmërisë shoqërore, ekzistojnë disa vlera të përgjithëshme që tani konsiderohen universale, siç është jeta, shëndeti, etj. Rrezikimi apo dëmtimi i tyre janë konsideruar, po konsiderohen dhe do të konsiderohen si vepra penale[32].

Fakti që rrezikshmëria shoqërore përbën tiparin material të veprës penale reflektohet sidomos nga ligjvënësi në hartimin dhe miratimin e Kodit Penal. Reflekton, së pari, në përcaktimin e rrethit të veprave, të cilat do të konsiderohen prej tij si vepra penale në periudha të ndryshme kohe. Së dyti, reflekton në ndarjen e veprave penale në krimë dhe kundërvajtje penale. Së treti, në përcaktimin e llojit dhe masës së dënimit për çdo figurë vepre penale konkrete që parashikohet në pjesën e posaçme të Kodit Penal. Në masë jo të vogël, rrezikshmëria shoqërore (shkalla e saj) ndikon edhe në rastet e përjashtimit të të miturit nga dënimi (parashikuar nga dispozita e nenit 52, e Kodit Penal); në rastet e uljes së dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji (parashikuar nga dispozita e nenit 53, e Kodit Penal), etj.

Faji.

Në përkufizimin i cili u dha për veprën penale, përveç kundërligjshmërisë dhe rrezikshmërisë shoqërore, si element të përbashkët me figurën e veprës penale, është edhe faji. Realizimi i figurës së veprës penale, në mënyrë të kundërligjëshme nuk është mjaftueshëm që ai veprim të trajtohet si vepër penale në kuptimin objektiv. Por, për të drejtën penale është i pranueshëm nocioni objektiv-subjektiv. Për të ekzistuar vepra penale nuk mjafton vetëm realizimi i figurës së veprës penale, është i nevojshëm edhe faji nga ana e autorit. Faji paraqet në vetvete qëndrimin psiqik që mban personi kundrejt veprës shoqërisht të rrezikëshme që vijnë apo mund të vijnë prej saj, të kundërligjëshme dhe pasojës së dëmshme. Faji shprehet ne formën e dashjes ose të pakujdesise.

Një person do të konsiderohet se ka kryer vepër penale me faj në rastet kur ka ditur se me veprim ose mosveprimin e tij do të shkakëtojë pasojën e ndaluar në botën e jashtëme, pasojë që në ligj është e parashikuar si vepër penale. Për të konstatuar se personi ka ditur apo jo se po kryen një vepër penale duhet depërtuar në qëndrimin e tij psikik. Qëndrimi psikik është në radhë të parë një proçes i caktuar i brendshëm të të menduarit, që zhvillohet në trurin e njeriut, në ndërgjegjen e tij. Ky proçes zhvillohet nën ngacmimet e faktorëve të jashtëm, të cilët e rrethojnë personin. Janë faktorë që ndikojnë në formimin e personalitetit të tij. Kur flasim për personalitet, nuk mund të lëmë pa përmendur edhe faktorët biologjikë apo të trashëgimnisë që ndikojnë në të. Për këtë arsye, me të drejtë disa penalistë theksojnë në mënyrë figurative se faji është një lloj ure

[32] I. Salihu., E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithëshme, Prishtinë 2010, fq 230

ndërmjet veprës dhe personalitetit të autorit, përkatësisht faji konsiderohet si portë në të cilën autori hyn në fushën e së drejtës penale[33]. Personi për të vepruar me faj duhet të jetë edhe i përgjegjshëm, duhet të ketë zhvillim intelektual normal dhe të jetë në gjëndje të udhëheqë në mënyrë të vetëdijshme veprimet e tij.

Faji është element i domosdoshëm i figurës së veprës penale të përgjithëshme, sepse faji është një nga shtyllat kryesore mbi të cilën mbështetet sistemi i së drejtës penale. Vepër penale, faj, denim. Por, nëse nocioni i tillë i fajit largohet nga ky sistem, bëhet problematik dhe vetë nocioni i veprës penale, i cili në atë rast nuk do të duhej të koncentrohet në veprimin e njeriut dhe shkakëtimin e cënimit të marrëdhënieve shoqërore të mbrojtura nga ligji penal. Nuk ka vepër penale, nuk ka dënim pa faj *(nullum crimen, nulla poena, sine culpa).*

Faji në çdo rast ka karakter individual dhe duhet të vërtetohet gjatë procesit penal. Kjo garanton paprekshmërinë e personit të pafajshëm, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe nuk lejon që asnjë person të pafajshëm të dënohet, e anasjelltas, asnjë person fajtor të mos mbetet pa u dënuar. Problem i fajit në të drejtën penale, lidhet ngushtë me parimin e ligjshmërisë dhe me parimin kushtetues të prezumimit të pafajësisë.

Format e fajit janë dashja[34] , parashikuar nga dispozita e nenit 15 të Kodit Penal dhe pakujdesia[35], parashikuar nga dispozita e nenit 16 të Kodit Penal .

1.3 Ndarja e veprës penale në krim dhe kundërvajtje penale.

Duke iu referuar Kodit Penal[36], veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Në qoftë se do t'i referoheshim disa prej legjislacioneve të huaja, shohim se veprat penale i ndajnë në tre grupe krime, delikte dhe kundërvajtje. Kjo ndarje për herë të parë është

[33] Po aty, fq, 292

[34] Dashja është përfytyrimi i te gjithë elementëve të faktit të kundërligjshëm, si rrjedhojë duhet të përfytyrohen dhe të duhen veprimi ose mosveprimi, lidhja shkakësore, pasojat dhe të gjithë elementët e faktit tipik. Për shëmbull një gjuetar i cili mëndon se pas një shkurre është një derr, edhe pse në fakt është një gjyetar tjetër, dhe qëllon duke shkaktuar vdekjen e këtij të fundit, dashja e veprës penale të vrasjes nuk mund të afirmohet, gjuhetari kishtepërfytyruar dhe dashur një fakt tjetër nga ai i realizuar siç është vrasja e derrit dhe jo e kolegut të tij.

[35] Pakujdesi aështë kur personi nuk dëshiron pasojat e veprimit apo mosveprimit të tij por është mëndjelehtë dhe shpreson ti shmangë ato, ose nuk i parashikon edhe pse mund ti parashikonte pasojat. Rasti tipik i pakujdesisë është shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor që sjellin si pasojë realizimin e një vepre penale. Për shëmbull, e di që po të qarkullojë me shpejtësi të madhe në qytet mund të vrasë ndonjë person por me mëndjelehtësi shpreson se mund ta evitojë këtë ndodhi pasi ka tepër besim te aftësitë e tij si shofer, por ndodh që shtyp një person , nga shpejtësia e madhe nuk mundi të kontrollonte makinën, do të përgjigjet për vrasje me pakujdesi.

[36] Neni 1 i Kodit Penal të Rrepublikës së Shqipërisë "Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale"

bërë në Kodin Penal Francez, të vitit 1791 dhe në vitin 1980[37]. Nën ndikimin e këtij kodi, kjo ndarje bëhet edhe në disa shtete të tjera si Gjermania, Hollanda etj. Këtë ndarje të trefishtë të veprave penale legjislacione të ndryshme e bëjnë në bazë të dënimit të paraparë[38]. Ka edhe kode penale, të cilat të gjitha llojet e veprave penale i konsiderojnë krime. Për shëmbull Kodi Penal i Federatës Ruse i vitit 1996.

Kështu, krime konsiderohen ato vepra penale për të cilat ligji parashikon dënime më të rënda. Delikte konsiderohen ato vepra penale, për të cilat ligji parashikon dënime më të lehta. Kundërvajtje konsiderohen vepra penale, për të cilat ligji parashikon dënime edhe më të lehta, dënime me heqje lirie me afat të shkurtër ose dënime në të holla.

Në vëndet ku ekzistojnë ndarja e veprave penale në kategori, është përcaktuar edhe gjykata kompetente, afati i parashkrimit dhe mundësia e ekstradimit. Kodi i ri Penal Francez ka këtë klasifikim trefish, por në dallim nga më i vjetri, afirmon parimin e ligjshmërisë, duke përcaktuar se krimet dhe shkeljet janë të përcaktuara me ligj, ndërsa kundërvajtjet me vendim të qeverisë[39].

Parimisht, krimet duhet të paraqesin format më të rënda të kundërligjshmërisë penale, shkallën më të lartë të rrezikshmërisë shoqërore. Kundërvajtjet, nga ana tjetër, paraqesin format më pak të rënda. Doktrina juridike është përpjekur prej shumë kohësh në gjetjen e një dallimi substancial ndërmjet krimeve dhe kundërvajtjeve, u arrit në përfundimin se për çdo rast do të bëhet e mundur ndarja ndërmjet koncepteve politiko-kriminale që dominojnë rast pas rasti. Sipas një këndvështrimi të bërë nga Beccaria, ndërkohë që krimet dhunojnë sigurinë publike dhe private, që përputhet me integritetin e të drejtave natyrore, kundërvajtjet do të cënonin vetëm ligjet e destinuara për të promovuar një të mirë publike[40]. Kjo përbën edhe thelbin e kriterit ndarës midis kundërvajtjeve penale dhe kundërvajtjeve administrative.

Sipas një teorie në të drejtën penale Italiane, krimet dhunojnë kushtet parësore, esenciale dhe të përherëshme të jetës civile, ndërsa kundërvajtjet kërcënojnë kushtet dytësore dhe kontigjentët e bashkëjetesës[41].

Si rrjedhim i manifestimit, i pavendosshmërisë të kriterit të paraqitur, është për t'u kundërshtuar që edhe kundërvajtjet mund të cënojnë kushtet parësore të jetës sociale. Dallimi me

---

[37] S.Spiro., Cikël leksionesh, "Nocioni i veprës penale, elementët përbërës të saj", UET, Tiranë 2008, Fq 1

[38] I.Salihu., E Drejta Penale, Pjesa e Pergjithëshme", Prishtinë 2010, fq. 208

[39] V.Kambovski., "E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithëshme", Shkup 2010, fq. 158

[40] Beccaria, Dei delitti e delle pene, Venezia, 1781, VIII e XI, Teoria delle leggi della sigurezza sociale, III,1832.

[41] Impallomeni, Instituzioni di diritto penale, Torino, 1908,84 ss, Zerboglio, La teoria e la pratica delle contravvenzioni, Milano, 1899,20

krimet mund të konceptohet në inferioritetin e shkallës së ofendimit prodhuar nga kundërvajtjet në kushtet parësore të bashkëjetesës.

Gjithsesi, asnjë nga këto kritere nuk ka arritur të bëjë një ndarje të saktë midis krimeve dhe kundërvajtjeve, kjo sepse roli ndërhyrës dhe inspirues solidar i shtetit është rritur paralelisht me zhvillimin e këtyre formave të kundërligjshmërisë penale dhe hipotezave kriminale. Ka patur shumë diskutime për të arritur në përcaktimin e dallimeve substiancale ndërmjet kundërvajtjeve dhe krimeve, dhe është arritur në një përfundim skeptik në lidhje me këtë çështje nga doktrina tradicionale, e cila ka përcaktuar se ndryshimi midis këtyre dy veprave penale bazohet në kriterin sasior, pra këto dy vepra penale ndahen vetëm sipas shkallës së cënimit të së drejtës[42].

Në planin e së drejtës pozitive në fuqi, kriteri më i sigurt për dallimin ndërmjet kundërvajtjeve dhe krimeve mbetet ai i natyrës formale, por duke u bazuar në sanksionet respektive të ndryshme që zbatohen për secilën vepër penale.

Pavarësisht se nuk sanksionohet shrehimisht në kod, literatura juridike penale sidomos në të kaluarën kriter bazë të kësaj ndarjeje të veprave penale përmënd kriterin material, rrezikshmëria shoqërore. Duke marë për bazë shkallën e rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale, e cila bën ndarjen kryesore në krim dhe kundërvajtje. Brënda këtyre dy grupeve, duke u nisur nga shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të veprës, dallohen figura me rrethana cilësuese, me rrethana lehtësuese ose pa rrethana të tilla[43]. Veprat e rënda, me shkallë rrezikshmërie më të lartë, përfshihen në grupin e krimeve, ndërsa ato me shkallë rrezikshmërie më të vogël, në grupin e kundërvajtjeve penale.

Për disa lloje veprash penale, në vlerësimin e shkallës së rrezikshmërisë së tyre, për t'i klasifikuar në grupin e krimeve apo të kundërvajtjeve penale, ndikojnë edhe faktorë të tjerë si forma e fajësisë, kryerja e veprës në bashkëpunim, më shumë se një herë, pasojat e shkaktuara, etj. Për shëmbull, neni 110 i Kodit Penal "Heqja e paligjëshme e lirisë", paragrafi i parë përbën kundërvajtje penale. Por nëse heqja e paligjëshme e lirisë shoqërohet me vuajtje të rënda fizike, ose bashkëpunimin kundër disa personave ose më shumë se njëherë, përbën krim. "Plagosja e rëndë nga pakujdesia", e cila është e parashikuar nga dispozita e nenit 91 të Kodit Penal përbën kundërvajtje penale, kurse "Plagosja e rëndë me dashje" e parashikuar nga dispozita e nenit 88 të Kodit Penal përbën krim, formë e njëjtë faji. "Plagosja e rëndë me dashje" përbën krim, kurse "Plagosje e lehtë me dashje" parashikuar nga dispozita e nenit 89 e Kodit Penal, përbën kundërvajtje penale, formë e ndryshme e fajit.

Kundërvajtjet penale dallojnë nga krimi, referuar vetë dispozitës përkatëse të pjesës së posaçme të Kodit Penal me togfjalëshin "përbën kundërvajtje penale": Mosha për përgjegjësi

[42] V.Kambovski., vepër e cituar, Fq.128

[43] E Drejta Penale e Rrepublikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Pjesa e Përgjithëshme. Tiranë 1982. Fq 82

penale për kryerjen e krimit është 14 vjeç, ndërsa për kundërvajtjet është 16 vjeç. Këtë diferencim moshe që ka bërë ligjvënësi, bëhet duke marrë për bazë kriterin e shkallës së aftësisë së personit fizik për të kuptuar rëndësinë e veprimeve apo mosveprimeve të tij dhe të pasojave që mund të vijnë prej tyre[44].

Dallimi tjetër është në masën e dënimit. Maksimalja e masës së dënimit për kundërvajtje penale është deri në dy vjet, ndërsa tek krimet maksimalja me burgim deri në 35 vjet ose me burgim të përjetshëm.

Tentativa si fazë e kryerjes së veprës penale është e dënueshme vetëm për krimet dhe jo edhe për kundërvajtjet penale.

Kodi Penal, në pjesën e posaçme i ndan veprat penale sipas objektit grupor të tyre, sipas fushës ose sferës së marrëdhënieve juridiko-penale që cënohen prej tyre, duke i përfshirë në krerë dhe seksione të veçantë, si krime kundër njerëzimit, vepra penale kundër personit, vepra penale kundër pasurisë, etj.

Kriteret kryesore të ndarjes në llojet e veprave penale, sipas doktrinës së të drejtës penale, janë natyra e veprës, ndërtimi strukturor, objekti, forma e fajësisë dhe shkalla e rrezikshmërisë. Po të ndalemi në format ose llojet që kanë vlera të dyfishta teorike dhe praktike dallojmë:

- Vepra penale të përbëra, quhen ato të cilat formohen nga dy vepra penale. Për shëmbull, vjedhja me pasojë vdekjen e personit, që formohet si rezultat i bashkimit të krimit të vjedhjes dhe krimit të vrasjes me dashje, të parshikuara përkatësisht nga dipsozita e nenit76 dhe 134 i Kodit Penal, etj.

- Vepra penale me dy objekte, quhen ato që cënojnë ose rrezikojnë njëkohësisht dy ose më shumë marrëdhënie shoqërore të mbrojtura nga ligji penal. Ato prekin dy objekte, për shëmbull, shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, e parashikuar nga dispozita e nenit 290 e Kodit Penal, që cënon njëkohësisht sigurinë publike dhe shëndetin ose jetën e personit.

- Vepra penale me dy ose më shumë veprime janë ato që mund të kryhen me një veprim ose me një, varg veprimesh, të cilat edhe po të shkëputen nga njëri tjetri, formojnë figurën të njëjtës vepër. Për shëmbull, format e krimit të kondrabandës. Kontrabanda mund të kryhet me anën e importimit, eksportimit apo tranzitimit të mallrave nëpermjet kalimit jashtë pikave doganore, fshehjes së plotë apo të pjesshëm, mosdeklarimit të saktë në doganë, deklarimit të rremë për natyrën, llojin, cilësinë, çmimin, destinacionin e mallit apo apo të tjera forma të cilat kanë për qëllim shmangien nga detyrimet doganore.

[44] S.Spiro., Cikël leksionesh, "Subjekti i veprës penale", UET, Tiranë 2008, fq.3

- Vepra penale me dy forma faji quhen ato në të cilat qëndrimi psikik i autorit të tyre ndaj veprimit dhe pasojës është i ndryshëm. Vepra të tilla, janë zakonisht ato të cilat kryhen me pakujdesi në formën e vetbesimit të tepruar, ku veprimi kryhet me dashje ndërsa pasoja vjen nga pakujdesia. Siç është shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor me pasojë vdekjen, e shkaktuar nga ecja tej normave të lejuara.

- Veprat penale materiale, quhen ato të cilat shkaktojnë pasoja ose mundësinë e ardhjes së tyre.

- Vepra penale formale, janë ato që nuk kërkojnë ardhjen e poasojës, por quhen të përfunduara me kryerjen e veprimit ose të mosveprimit. Për shëmbull kanosja, kallzim i rrem, fyerja, shpifja etj.

- Vepra penale të qëndrueshme ose permanente, quhen ato të cilat cënojnë marrëdhëniet juridike penale për një kohë të caktuar në mënyrë të pandërprerë. Për shëmbull mbajtja e armëve pa leje, rrëmbim ose mbajtja peng e personit.

- Vepra penale vazhduese, quhen ato të cilat kryhen me dy ose më shumë veprime ose mosveprime të njëllojta, në kuadrin e zbatimit të një mendimi të vetëm kriminal.

- Vepra penale të cunguara janë ato që quhen të konsumuara me kryerjen e veprimit që bëhet për kryerjen e veprave penale në të ardhmen sic janë organizatat kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal të cilat konsiderohen vepra të konsumuara që në momentin e krijimit.

- Vepra penale politike quhen ato të cilat kryhen kundër pavarësisë dhe integritetit të shtetit, kundër rendit kushtetues ose për motive të tjera politike, të cilat parashikohen në krerët V,VI,VII të Kodit Penal[45].

[45] S.Spiro., Cikël leksionesh, "Analiza e figurës së veprës penale ", UET, Tiranë 2008, fq.6

KREU II

FIGURA E VEPRËS PENALE SI PARAKUSHT I PËRGJEGJËSISË PENALE.

2.1 Vepra penale dhe figura e veprës penale. Të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet këtyre dy kategorive kryesore te së drejtës penale.

Për dallimin e figurës së veprës penale nga vepra penale, (si nocione juridiko-penale, megjithëse në lidhje të drejtpërdrejtë dhe të pashmangshme njëri me tjetrin), në teorinë e së Drejtës Penale janë mbajtur dhe vazhdojnë të ekzistojnë qëndrime të ndryshme. Dallimi kryesor midis këtyre qëndrimeve, për mendimin tim, gjënden në faktin se, ndërsa për kuptimin e vetë veprës penale nuk janë të pakta kodet penale, që në njërën apo tjetrën formë, shprehen për të; për figurën e veprës penale nuk ndodh një gjë e tillë. Edhe në literaturën juridiko-penale, kryesisht në ato tekste universitare me të cilat kam mundur të konsultohem gjatë studimit për shtjellimin e temës, jo të gjithë ata e trajtojnë figurën e veprës penale veçmas trajtimit që i bëjnë vetë veprës

penale. Kjo ndeshet edhe në punimet e autorëve Shqiptarë, të cilët përdoren si tekste mësimore për studentët në vëndin tonë.

Kështu, ndërsa në tekstet e së Drejtës Penale të para viteve 1990[46] , jo vetëm që bëhej ky dallim, por figurës së veprës penale i kushtohej vënd i veçantë. Në tekstet e mëvonëshme të cilat janë edhe aktualisht në përdorim, ose nuk bëhët fjalë aspak[47] ose edhe pse përmendet figura e veprës penale si nocion dhe, jepet shkurtimisht përkufizimi teorik i saj[48], vëndi që i kushtohet përsa i përket trajtimit, për mendimin tim, është fare i parëndësishëm.

Sikurse u vu në dukje, në tekstin e vitit 1982, trajtimit të figurës së veprës penale, si nocion, dhe elementeve përbërës të saj, i kushtohet një vënd i veçantë. Në këtë tekst, figura e veprës penale përkufizohet si tërësia e tipareve, elementeve objektivë e subjektivë të marra sëbashku, ekzistenca e të cilave bën që vepra shoqërisht e rrezikshme, e parashikuar nga ligji penal, dhe e kryer me faj të konsiderohet krim ose kundravajtje penale[49].

Figura e veprës penale, në këtë tekst, konsiderohet si e vetmja bazë për marrjen e një personi në përgjegjësi penale, për një vepër penale të kryer prej tij dhe se, pa konstatimin e figurës së veprës penale, nuk mund të realizohet dhënia e drejtësisë. Vazhdohet më tej, me rolin parësor që luan figura e veprës penale për cilësimin ligjor të veprës[50]. Me këtë do të kuptonte se zbulimi dhe përcaktimi i saktë i elementeve përbërës të një figure vepre penale konkrete si dhe përcaktimi në bazë të tyre, të dispozitës përkatëse të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, në të cilën parashikohen, në formë të shprehur ose të nënkuptuar, elementët përbërës të saj të nxjerra nëpërmjet interpretimit këto element shërbejnë si bazë e përgjegjësisë penale. Nëpërmjet cilësimit të drejtë ligjor të veprës penale, bëhet dallimi i veprave penale nga njëra-tjetra, jo vetëm kur dispozitat në të cilat ato parashikohen gjenden në krerë dhe seksione të ndryshme të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, por edhe ndërmjet veprave penale, të cilat parshikohen në dispozita të vendosura nga ligjvënësi, (jo vetëm në të njëjtin kre, por edhe në të njëjtin seksion të tij). Rëndësi kjo, e cila do të shërbente për një cilësim ligjor dhe të drejtë të veprës penale rast pas rasti.

Nocioni i figurës së veprës penale, i cili mund të quhet ndryshe edhe "Figurë Ligjore", sipas penalistit Maqedonas V.Kambovski[51], përfshin veçoritë ligjore me të cilat vepra penale

[46] E Drejta Penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Pjesa e Përgjithshme, grup autorësh, Tiranë 1982.

[47] Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, bashkautorë, Tiranë 2006

[48] E Drejta Penale, Pjesa Përgjithëshme, Dr. Sh.Muçi, Tiranë 2007.

[49] E Drejta Penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Pjesa e Përgjithshme, grup autorësh, Tiranë 1982. Fq. 82

[50] S.Spiro., Përmbledhje leksionesh të së Drejtës Penale, Pjesa e Përgjithëshme, Universiteti Luarasi.

[51] Po aty, fq 2

përcaktohet si entitet i posaçëm dhe dallohet nga veprat e tjera penale. Figurën ligjore, sipas tij, e përbëjnë vetëm veçoritë e përqëndruara rreth shkeljes të së mirës juridike dhe funksionit themeltar të saj. Po sipas tij, rëndësia konsiston në faktin e përcaktimit të padrejtën objektive materiale të veprës penale. Përcaktimi i figurës ligjore dhe mënyra e përshkrimit të veçorive të saj, është detyrë e ligjvënësit, vazhdon më tej penalisti V.Kambovski.

Pavarësisht kuptimit dhe formës e cila përdoret për dhenien e tij, si në tekstet që u cituan më sipër, ashtu edhe autorë të tjerë që pranojnë ndarjen e nocionit të figurës së veprës penale nga vetë vepra penale, të gjithë autorët shprehen se elementët objektivë dhe subjektivë përbërës të figurës së veprës penale jane katër:

- objekti i figurës së veprës penale,
- ana objektive e figurës së veprës penale,
- subjekti i figurës së veprës penale,
- ana subjektive e figurës së veprës penale.

Më së shumti, pranohet gjithashtu që, të katër këto elementë janë njëlloj të domosdoshëm për ekzistencën e figurës së veprës penale, si dhe që mungesa qoftë edhe e njërit prej tyre, pasjellë domosdoshmërisht edhe mungesën e vetë figurës së veprës penale.

Analiza e dallimit të figurës së veprës penale nga vepra penale, ka rëndësi të dyfishtë. Rëndësia e saj qëndron, së pari në aspektin teorik, për zhvillimin e mëtejshëm të kësaj dege të së drejtës, sidomos të pjesës së përgjithshme të saj. Nëpërmjet studimit të kuptimit të figurës së veprës penale, të elementëve përbërës të saj dhe llojet e figurave të veprave penale në përgjithësi, e Drejta Penale përpunon kriteret teorike të cilat shërbejnë për të përcaktuar llojin dhe rrethin e vlerave që duhet të mbrohen në mënyrë të posaçme nga shoqëria, nëpërmjet parashikimit të veprave, të cilat cënojnë apo vënë në rrezik ato, si vepra penale në periudha të ndryshme të zhvillimit të saj.

Gjithashtu, kjo analizë përpunon në të njëjtën kohë dhe bazën teorike të diferencimit të shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale të llojeve të ndryshme, apo të figurave të veçanta të tyre. Ky diferencim nga ana e vet, shërben si premisë për të riparë bazën teorike të përcaktimit të llojeve dhe masave të dënimit, të cilat parashikohen nga ligjvënësi për autorët, subjektet e se cilës prej veprave që ligjvënësi vlerëson se duhet të përfshihet në numrin e përgjithshëm të veprave penale, në një periudhë të dhënë kohe.[52]

Ndihmesë mjaft të madhe, për mendimin tim, studimi i figurës së veprës penale, jep edhe për zhvillimin teorik të Pjesës së Posaçme të së Drejtës Penale. Nëpërmjet dhënies së kuptimit të figurës së veprës penale, (të katër tipareve të domosdoshëm të saj), nga njëra anë, dhe kuptimit të elementëve përbërës të secilit prej këtyre katër tipareve, nga ana tjetër, kontribuohet për

[52] Komentari i Kodit Penal, Rrepublikes së Shqipërisë, Tirane 2012, fq.65

zbërthimin e përmbajtjes së saktë të secilës prej dispozitave të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, çdo njëra prej të cilave përmban një figurë më vete vepre penale, objekt ky i studimit të Pjesës së Posaçme të së Drejtës Penale.

Studimi i figurës së veprës penale luan rol të rëndësishëm edhe në aspektin praktik të zbatimit të dispozitave të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, në të cilat parashikohen të gjitha ato vepra, të cilat, kur plotësojnë katër elementë përbërës të ndonjërës prej figurave të veprave penale që sanksionohet në secilën prej tyre, ndaj personit që ka kryer veprën konkrete penale, gjykata zbaton pikërisht dispozitën përkatëse. Zbaton dispozitën në të cilën parashikohen katër elementët përbërës të figurës së veprës penale konkrete.

Në analizë të fundit, kësisoj gjen zbatim në praktikë, njëri prej parimeve më të rëndësishëm të së drejtës penale, sikurse është parimi i ligjshmërisë, *(nullum crimen sine lege, nullum poena sine lege).* Ky parim sikurse dihet, është sanksionuar nga ligjvënësi në nenin 2 të Kodit Penal. Sipas kësaj dispozite, askush nuk mund të dënohet penalisht për një vepër që më parë nuk është e parashikuar shprehimisht në ligj, si krim ose kundravajtje penale. Thënë ndryshe, zbulimi dhe përcaktimi i katër elementëve të domosdoshëm përbërës të figurës së veprës penale, rast pas rasti, shërben në fund të fundit, për të bërë cilësimin ligjor të drejtë të veprës penale para të cilës ndodhemi, (në çdo rast konkret).

Analiza e mësipërme shërben gjithashtu edhe për ti dhënë përgjigje shtatë pyetjeve të cilat shtrohen, në të gjitha rastet e një ngjarje me natyrë penale, sikurëse janë: Çfarë ndodhi? Ku ndodhi? Kur ndodhi? Me çfarë ndodhi? Si ndodhi? Kush e kreu? Pse e kreu?

Pikërisht këto janë edhe shtatë momentet faktike- juridike, të cilat përbëjnë si për strukturën, ashtu edhe thelbin e objektit të të provuarit të çdo procesi penal, pavarësisht llojit të veprës penale dhe figurës së saj, (për shkak të ekzistencës apo dyshimit për ekzistencën e së cilës, organi procedues është vënë në lëvizje, duke regjistruar procedimin penal). Dihet se me përjashtim të tre prej këtyre pyetjeve: Çfarë ndodhi, Kush e kreu dhe Pse e kreu, (tek të cilat, e para ka lidhje me objektin e figurës së veprës penale, kurse dy të tjerët me subjektin ose anën subjektive të tij), katër të tjerat nuk përfaqsojnë gjë tjetër, veçse disa prej elementëve përbërës të anës objektive të figurës së veprës penale.

2.2 Elementët përbërës të figurës së veprës penale.

Që në fillim më duhet të vë në dukje faktin se, vepra penale, si nocion, është më e gjerë dhe më e përgjithshme se nocioni i figurës së veprës penale. Pjesa më e madhe e elementëve përbërës të figurës së veprës penale, sidomos ana objektive e saj, dhe vetë përkufizimi që jepet për kuptimin e figurës së veprës penale si nocion, burojnë nga përkufizimi teorik që jepet në të Drejtën Penale, për kuptimin e veprës penale dhe elementëve përbërës të saj. Kështu, sikurse

dihet, pavarësisht diferencave (më shumë për shkak të mënyrës së formulimit që bëhet), vepra penale përkufizohet si vepër, (veprim ose mosveprim) shoqërisht e rrezikshme, e parashikuar në ligj e kundërligjshme dhe e kryer me faj. Kurse si elementë përbërës të saj renditen:

- veprimi ose mosveprimi,
- rrezikshmëria shoqërore,
- kundërligjshmëria, (parashkrimi në ligj)
- faji

Sikundër u përmënd, figura e veprës penale përkufizohet si tërësia e elementëve objektivë dhe subjektivë që karakterizojnë një vepër, si një vepër penale, krim apo kundravajtje penale qoftë ajo, e cila parashikohet në një dispozitë konkrete të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal. Kurse si element përbërës të saj renditen:

- Objekti,
- Ana objektive,
- Subjekti,
- Ana subjektive

Nga zbërthimi edhe i vetëm i këtyre dy përkufizimeve, është i njohur mendimi sipas të cilit, kur thuhet vepër penale, duhet kuptuar se ndodhemi para një vepre përgjithësisht të dënueshme nga ligji penal, kurse kur thuhet figurë e veprës penale, duhet kuptuar se ndodhemi para një vepre penale konkrete, me elementë objektivë dhe subjektivë (të gjithë bashkë apo vetëm njëri apo disa prej tyre), të veçantë nga elementët objektivë dhe subjektivë (të gjitha bashkë apo vetëm njëri apo disa prej tyre), të cilat u përkasin veprave të tjera penale, qoftë edhe brenda të të njëjtit lloj apo kategorie[53]. Për shëmbull, kur thuhet që, personi X ka kryer veprën penale të vjedhjes, duhet kuptuar se ai ka kryer vepër për të cilën duhet të dënohet penalisht. Por ende nuk kemi përcaktuar dispozitën konkrete të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, në bazë të së cilës gjykata do të caktojë llojin dhe masën e dënimit që do të japë për këtë person.

Për të përcaktuar llojin konkret të figurës së krimit të vjedhjes[54] dhe mandej, për të gjetur dispozitën përkatëse të pjesës së posaçme të Kodit Penal, në të cilën ajo parashikohet duhet të zbulojmë dhe përcaktojmë edhe elementët e veçantë të vetë elementëve (kryesisht të anës objektive para të cilave ndodhemi rast pas rasti). Element të tillë janë për shëmbull, vëndi (vjedhja e bankave dhe e arkave të kursimit, neni 136 i Kodit Penal; vjedhja e energjisë elektrike ose impulsive telefonike, neni 137 i Kodit Penal dhe vjedhja e veprave të artit e kulturës, neni

[53] E Drejta Penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Pjesa e Përgjithshme, grup autorësh, Tiranë 1982, fq.79

[54] Nenet 134-141 të Kodit Penal të Republikës së Shqiprisë.

138 i Kodit Penal); mënyra (vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën, neni 135 i Kodit Penal dhe vjedhja me dhunë, neni 139 i Kodit Penal); mjeti (vjedhja me armë, neni 140 i Kodit Penal) dhe pasoja (vjedhja me pasojë vdekjen, neni 141 i Kodit Penal).

Edhe pse të gjitha këto lloje të ndryshme të veprave penale të vjedhjes kanë të përbashkët, shtënien në dorë në mënyrë të kundraligjshme, të fshehtë apo të hapur, të pasurisë së tjetrit, me qëllim për të nxjerrë prej saj përfitime materiale, për vete ose për persona të tjerë, (pra elementët e përgjithshëm: veprimin, rrezikshmërinë, kundraligjshmërinë dhe fajin i kanë krejtësisht të njëjtë). Por ato dallohen nga njëra tjetra, për shkak të dallimit që ekziston në tipare apo karakteristika të veçanta. Tipare apo karakteristika të tilla janë për shëmbull: karakteristika "vënd" në veprat penale të vjedhjes që parashikohet në nenet 136, 137 të Kodit Penal, përkatësisht vjedhja në banka dhe në arkat e kursimit, si dhe vjedhja nëpërmjet lidhjes së paligjshme në rrjetin e energjisë elektrike, karakteristikë kjo nga e cila përcaktohet edhe objekti i drejtpërdrejtë i secilës prej këtyre dy figurave të veçanta, të ndryshme nga njëra tjetra, (të të njëjtit lloj vepre penale, të veprës penale të vjedhjes së pasurisë). Po kështu, mënyra e përdorur për të realizuar vjedhjen e pasurisë, në vjedhjen e kryer duke shpërdoruar detyrën (neni 135 i Kodit Penal) dhe vjedhja e pasurisë e shoqëruar me përdorim dhune (neni 139 i Kodit Penal), shërben si karakteristikë dalluese për ligjvënësin për të bërë veçimin e njërit lloj të vjedhjes së pasurisë, si më sipër, nga llojet e tjerë të krimit të vjedhjes së pasurisë, që parashikohen në të njëjtin seksion të kreut të tretë të pjesës së posaçme të Kodit Penal. Po kështu, edhe mjeti apo dhe pasoja që përkatësisht përdoret ose vjen gjatë vjedhjes së pasurisë. Në veprën penale të vjedhjes së pasurisë që parashikohet në nenin 140 (Vjedhja me armë) të Kodit Penal, mjeti i shoqërimit të vjedhjes (me mbajtjen e armës apo përdorimin e saj), është karakteristika e cila e bën më specifike si figurë vepre penale, që e veçon atë nga të shtatë llojet e tjerë të vjedhjes së pasurisë.

Kurse, në veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, që parashikohet në nenin 141 të Kodit Penal, është pasoja, vdekja e përsonit si rrjedhojë e dhunimeve që shoqërojnë vjedhjen, karakteristikë që e veçon këtë lloj vjedhje nga shtatë llojet e tjerë të vjedhjes së pasurisë. Mirëpo, si karakteristika "vënd" ashtu edhe karakteristikat e tjera si "mënyra", "mjetet" dhe "pasoja", nuk janë gjë tjetër veçse elementë përbërës të njërit prej elementëve, tipareve të domosdoshëm përbërës të figurës së veprës penale në përgjithësi dhe asaj të vjedhjes në veçanti.

Për të argumentuar sa më sipër, midis shumë prej llojeve të veprave penale, që parashikohen në Pjesën e Posaçme të Kodit Penal, mund të merret si shëmbull edhe vepra penale e kondrabandës. Për veprën penale të kondrabandës, ligjvënësi, në kreun e III-të të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, ka krijuar një seksion më vete, seksionin e V-të të tij, të cilin e ka titulluar "Krime në fushën e doganave" (nenet 171-179/a). Me përjashtim të dy prej këtyre dispozitave, neneve 178 (Tregëtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë) dhe 179 (Ruajtja apo depozitimi i mallrave kontrabandë) në të cilat parshikohen figura krimi që kanë lidhje me kondrabandën, të gjitha të tjerat nuk parashikojnë gjë tjetër veçse lloje të veçanta të të

njëjtës vepre penale, të veprës penale të kondrabandës. Secila prej këtyre llojeve të veprës penale të kondrabandës, përbën nga një figurë më vete, të krimit të kondrabandës. Objektin grupor dhe anën subjektive, të gjitha këto figura krimi, i kanë të njëjta, të përbashkëta.

Me përjashtim të figurës së krimit të kondrabandës nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore, që parashikohet në nenin 175 të Kodit Penal, e cila ka subjekt të posaçëm, (punonjës të doganave ose punonjës të cilët kanë lidhje me veprimtarinë doganore), element ky që ka shërbyer si bazë për ligjvënësin që të nxjerrë atë si figurë më vete krimi, po të kondrabandës, të gjitha figurat e tjera të krimit të kondrabandës, si kontrabanda me mallra të ndaluar (neni 171), kontrabanda me mallra për të cilat paguhet akcizë (neni 172), kontrabanda me mallra të liçensuar (neni 173), kondrabanda me mallrat ë tjerë (neni (174), kontrabanda e vlerave kulturore (neni 176), kondrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm (neni 177) dhe mos deklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë (neni 179), subjektin e kanë të përgjithshëm, çdo person fizik që në kohën e kryerjes së veprimeve ose mosveprimeve konkrete të cilat përbëjnë anën objektive të figurës së krimit të kondrabandës, ka mbushur moshën 14 vjeç dhe që është i përgjegjshëm.

Edhe ana objektive e këtyre figurave të veçanta të krimit të kondrabandës, me një ndryshim jo të madh të figurës së krimit të mosdeklarimit në kufi të të hollave dhe sendeve me vlerë, neni 179/a, konsiton në kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve të njëjta. Ana objektive e tyre konsiston në importimin, eksportimin apo tranzitimin e mallrave, nëpërmjet kalimit jashtë pikave doganore, fshehjes së plotë apo të pjesshme,mosdeklarimit të saktë në doganë, deklarimit të rremë për natyrën, llojin, cilësinë, çmimin, destinacionin e mallit, apo forma të tjera që kanë për qëllim, nga ana subjektive, shmangien nga detyrimet doganore.

Dallimi midis të gjitha llojeve të figurave të veçanta të krimit të kondrabandës, përveç figurës së krimit të kondrabandës nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore, neni 175, konsiston në objektin e drejtpërdrejtë të tyre. Kjo për shkak të faktit që lloji i mallrave që janë bartës të marëdhënieve shoqërore që preken apo vihen në rrezik nga veprimet kontrabandë është i ndryshëm.

Kështu, në figurën e krimit që parashikohet në nenin 171 të Kodit Penal, kontrabanda bëhet me mallra të ndaluar, në atë të nenit 172 të Kodit Penal, me mallra për të cilat paguhet akcizë, në atë të nenit 173 me mallrat ë liçensuar, në atë të nenit 176 me vlera kulturore, në atë të nenit 177 me mallra me regjim të ndërmjetëm, në atë të nenit 179/a me të holla dhe sende me vlerë, kurse në figurat e krimeve që parashikohen në nenet 174 dhe 175 të Kodit Penal, kontrabanda mund të bëhet me çdo lloj malli tjetër përjashto llojet e mallrave që renditëm menjëherë më lart.

2.3 Njohuri të përmbledhura rreth kuptimit të secilit prej katër elementëve përbërës të figurës së veprës penale.

Siaps teorisë së të drejtës penale, edhe pse shkollave të ndryshme, kanë edhe diferenca, elementët ose tiparet e figurës së veprës penale në doktrinën tonë pranohen katër:

- Objekti i figurës së veprës penale.
- Ana objektive e figurës së veprës penale.
- Subjekti i figurës së veprës penale.
- Ana subjektive e figurës së veprës penale.

OBJEKTI I FIGURËS SË VEPRËS PENALE

Objekti i figurës së veprës penale është "marrëdhënia" ndaj së cilës drejtohet vepra penale Është "marrëdhënia" që preket apo vihet në rrezik për tu prekur nga vepra penale. Shtrohet pyetja se cila është ajo "marrëdhënie", e cila përbën dhe objektin e figurës të një vepre penale? Në qoftë se do t'i referoheshim teksteve të vitit 1982 apo 1987, si objekt kishin marrëdhëniet shoqërore që janë vendosur në një shtet të caktuar në prodhim dhe për shkak të tij, të cilat mbrohen në mënyrë të posaçme nga ligji ose rrezikihen të preken nga vepra penale[55]. Në përcaktimin e objektit këto kode vendosnin në plan të parë shtetin, partinë, pasurinë socialiste, etj, pra koncepte tejet të politizuara e të indoktrinuara.

Nëse do ti referoheshim teksteve të vitit 1997, si objekt janë marrëdhënie juridike, si lloji i marrëdhënieve shoqërore, të vendosura për të siguruar paprekshmërinë e të mirave juridike apo vlerave të rëndësishme të personit, të shoqërisë apo të shtetit që preket apo vihet në rrezik për t'u prekur nga vepra penale, e që mbrohen në mënyrë të posaçme nga shteti, nëpërmjet ligjit penal.

Referuar të drejtës penale të Republikës së Kosovës, si objekt i veprës penale është e mira juridike kundër së cilës është drejtuar vepra penale, ku si të mira juridike janë konsideruar jeta e njeriut që nga liritë themelore të tij, siguria, prona, martesa, familja, etj[56]. E përbashkëta e këtyre përkufizimeve, që përmënden më lart, është se si objekt janë marrëdhënie shoqërore, të cilat në disa përkufizime quhen marrëdhënie juridike, e në disa të tjera, vlera juridike.

Kur flasim për objektin e figurës së veprës penale mbahen parasysh marrëdhënie shoqërore të mbrojtura nga ligji penal. Themi të mbrojtura nga ligji penal, sepse marrëdhëniet shoqërore, të cilat cënohen, janë objekt studimi dhe i degëve të tjera të së drejtës, si e drejta civile, e drejta e punës, e drejta administrative, etj. Për shëmbull, personi që duke shkelur rregullat e qarkullimit rrugor, ka shkaktuar vdekjen, plagosjen e rëndë të një personi ose

[55] S.Spiro., Kuptimi i objektit të figurës së krimit, Revista Drejtësia Popullore Nr.2, Viti 1972, fq 9

[56] I.Salihu., E Drejta Penale, Pjesa Përgjithëshme. Prishtinë 2010. Fq. 187

plagosjen e lehtë të disa personave, kryen vepër penale, bqë parashikohet në dispozitën e nenit 290 te Kodit Penal. Kurse personi, i cili duke shkelur rregullat e qarkullimit rrugor, shkakton plagosjen e lehtë të një personi ose dëme material, nuk kryen vepër penale, por shkelje administrative, e cila rregullohet nga e drejta administrative dhe jo nga e drejta penale. Në një farë mënyre, marrëdhëniet shoqërore janë të shumëllojshme, por që të drejtës penale i interesojnë vetëm ato marrëdhënie shoqërore, të cilat mbrohen nga ligji penal dhe që preken ose vihen në rrezik për t'u prekur nga vepra penale.

Nuk është objekt i figurës së veprës penale as personi, as sendi dhe as norma juridike, por janë marrëdhënie shoqërore, të cilat vendosen midis njerëzve, janë marrëdhënie shoqërore të cilat vendosen ndërmjet tyre për shkak të këtyre sendeve. Nëse do të pranonim se sendi është objekt i figurës së veprës penale, atëherë në çdo rast, autori që e drejton veprën penale ndaj një sendi, ky send do të dëmtohej apo do të shkatërrohej, por që nuk ndodh gjithmonë kështu. Përkundrazi, autori ndaj sendit mund të tregojë kujdes të madh për ta ruajtur, ta zbukuruar me qëllim për të nxjerrë fitim. Për shëmbull, tek figura e veprës penale, "Vjedhja", autori e merr sendin, e shtie në dorë në mënyrë të fshehtë ose të hapur me qëllim që të mos e kthejë atë dhe e mban atë për të nxjerrë fitime.

Edhe në rastin e shkatërrimit të pronës, në pamje të parë, autori me të vërtëtë shkatërron pronën apo sendin, por shkatërrimi i pronës prek intresa të ndryshme që mund të jenë interesa shtetërore apo private. Janë pikërisht këto marrëdhënie shoqërore që krijohen për shkak të intresave të cilat autori prek.

Rëndësia e objektit del qartë nga fakti se duke ditur se çfarë është objekti i figurës së veprës penale, na jepet mundësia për një përcaktim të drejtë të veprës penale të kryer, dhe veçanërisht nëse ndodhemi ose jo përpara një vepre penale. Duke ditur se çfarë është objekti, arrijmë të japim edhe një cilësim juridik të drejtë ligjor të veprës penale, para së cilës vepër penale ndodhemi. Kjo mbasi rrethi i veprave penale është i ndryshëm.

Pra, duke e ditur se ç'është objekti i figurës së veprës penale, orientohemi ne Kodin Penal për të gjetur në fillim kreun e pjesës së posaçme, (mbasi në Kod janë 11 të tillë). Mandej mbasi kemi gjetur kreun, gjejmë dhe seksionin përkatës.

Rëndësia e studimit të figurës së veprës penale konsiston edhe në faktin se është ajo e cila ndihmon dhe organet e drejtësisë në praktikë për t'iu përgjigjur njërës prej pyetjeve Ç'farë ndodhi? Nga formula shtatë nyjesh romake, Ku ndodhi? Kur ndodhi? Me ç'mjet? Në ç'mënyrë? Kush e kreu? Pse e kreu?[57].

E drejta jonë penale e ndan objektin në tre lloje:

- Objekt të përgjithshëm,
- Objekt të posaçëm ose grupor,
- Objekt të drejtpëdrejtë

[57] S.Spiro., Cikël leksionesh, "Objekti I Figurës së Veprës Penale", UET, Tiranë 2008, Fq. 6

Këtë ndarje drejta jonë penale e pranon, sepse vetë ligjvënësi, renditjen e veprave penale në Kod e bën bazuar në disa kritere duke nisur që nga shkalla e rrezikshmërsë së tyre.

Objekt i përgjithshëm është tërësia e marrëdhënieve shoqërore, të cilat mbrohen nga e drejta penale. Në një farë mënyre është tërësia e objektit grupor dhe objektit të drejtpërdrejtë. Me tërësi të marrëdhënieve shoqërore, kuptohen marrëdhëniet e njerëzve ndërmjet tyre, si dhe marrëdhëniet e njerëzve me shtetin. Pra kuptohen ato marrëdhënie shoqërore që janë të mbrojtura nga ligji penal. Duke përcaktuar objektin e përgjithshëm, arrijmë të dallojmë nëse kjo vepër është ose jo e rrezikëshme dhe nëse kjo përbën vepër penale.

Objekti grupor ose i posaçëm, shpreh ato marrëdhënie shoqërore që mbrohen nga ligji penal dhe që kanë karakteristika të përbashkëta mes tyre për shkak të fushës së veprimtarisë në të cilën ato janë vendosur. Janë pikërisht këto karakteristika të përbashkëta që kanë këto marrëdhënie shoqërore dhe, që përbëjnë objektin grupor. Karakteristika të përbashkëta janë në të njëjtën sferë ose në sfera të ndryshme, të cilat mund të jenë shoqërore, shtetërore ose pasurore. Është objekti grupor i figurës së veprës penale kriteri bazë nga i cili ligjvënësi është nisur për të bërë ndarjen e pjesës së posaçme të Kodit Penal në kapituj, të cilët janë 11 dhe seksionet përkatëse të tyre.

Objekt i drejtpërdrejtë janë marrëdhëniet shoqërore që mbrohen nga ligji penal të cilat preken drejt përdrejt nga vepra penale konkrete. Në bazë të objektit të drejtpërdrejt arrijmë të gjejmë në Kodin Penal dispozitat e pjesës së posaçme, të cilat janë nga neni 73-334 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Si rregull, figura e veprës penale ka vetëm një objekt të drejtpërdrejtë si për shëmbull, vjedhja, plagosja, etj. Themi si rregull, sepse ka edhe figura të cilat kanë më shumë se një objekt ku njëri është objekti kryesor dhe tjetri është objekti dytësor. Objekti kryesor është kur si rezultat i veprës penale preken marrëdhënie shoqërore, që sjell me vete edhe prekjen e një marrëdhënie tjetër shoqërore, e cila dhe kjo është e mbrojtur nga ligji penal, (për shëmbull, vjedhja me pasoje vdekje parashikuar nga dispozita e nenit 141, ku vjedhja është objekti kryesor ndërsa vdekja e personit është objekt dytësor).

ANA OBJEKTIVE E FIGURËS SË VEPRËS PENALE

Sikundër u nënvizua më lart, ku u trajtuan elementëtë e figurës së veprës penale , një ndër katër elementët e domosdoshëm përbërës të saj është edhe ana objektive.

Trajtimi teorik i anës objektive të figurës së veprës penale, përcaktimi saktë dhe në masë të plotë i tipareve ose elementëve që përbëjnë atë, është kusht i domosdoshëm për zbatim të drejtë dhe pa devijime të dispozitave të pjesës së posaçme të Kodit Penal. Zbulimi i elementëve që përbëjnë anën objektive të figurës së veprës penale, sqarimi i kuptimit dhe përmbajtjes së vërtetë të tyre, në të gjitha rastet kur shtrohet problem për të vënë përpara përgjegjësisë persona konkretë, është kusht i domosdoshëm për zbatimin e ligjshmërisë në procesin penal.

Në të njëjtën kohë, përbën edhe garanci si për mbrojtjen e intresave të shtetit e shoqërisë, ashtu edhe të të drejtave dhe intresave të ligjëshme të shtetasve nga arbitrariteti i punonjësve të organeve të drejtësisë.

Nëpërmjet zbulimit dhe përcaktimit të elementeve të figurës së krimit, në përgjithësi dhe atyre të anës objektive në veçanti, gjen zbatim në praktikën e punës së organeve të drejtësisë, parimi i njohur i së drejtës penale, që asnjë të mos mbetet pa u dënuar dhe, asnjë të pafajshmi të mos i privohet liria.

Mospërcaktimi me saktësi i elementëve të anës objektive të figurës së veprës penale mund të sjellë, si pasojë, ose kufizimin e mundësisë reale për të vënë persona të ndryshëm përpara përgjegjësisë penale, ose zgjerimin pa të drejtë të këtyre mundësive[58]. Të dy këto raste janë me pasoja te dëmshme.

Në rastin e parë, do ti shpëtonin përgjegjësisë penale personat qe kanë kryer vepra penale. Kurse në të dytin, do t'i nënshtroheshin përgjegjësisë penale, me të gjitha rrjedhojat e saj, persona të pafajshëm.

Çfarë përfaqëson në realitet ana objektive e figurës së veprës penale? Cilët janë elementët përbërës të saj? A gjejnë pasqyrim në ligj, në dispozitat e veçanta të pjesës së posaçme të Kodit Penal, këto elementë? A ekziston ndërvarësi (lidhje), midis anës objektive dhe anës subjektive të figurës së veprës penale dhe nëse po, ku konsiston kjo?

Këto janë disa nga çështjet kryesore që kanë preokupuar penalistë të shkollave të ndryshme të së drejtës penale, të cilët, me gjithë mospërputhjet që mund të kenë për shkak të pikëpamjeve që i takojnë dhe rrymave të ndryshme filozofike që përfaqësojnë, kanë të përbashkët faktin që anën objektive të figurës së veprës penale e shohin si grumbullimin e disa tipareve ose elementëve të caktuara, të cilët i përkasin, kryesisht, botës së jashtëme, edhe që, në tërësinë e tyre, paraqesin anën e jashtëme të veprës penale.

Përdoret togfjalëshi "ana e jashtëme" e veprës penale, për ta dalluar atë nga qëndrimi psikik i personit, subjektit të veprës penale ndaj vet veprës dhe pasojave që vijnë ose mund të vijnë prej saj, anë që, përbën atë që shprehet me fjalët "ana e brendëshme" ose ana subjektive e veprës penale[59].

I përbashkët, për të gjithë penalistët, në këtë aspekt, është fakti që veprën penale ata e konsiderojnë si fenomen jo statik, por si fenomen që zhvillohet me dinamikë. E konsiderojnë si fenomen që ka si elementin e fillimit, ashtu edhe atë të mbarimit, përfundimin e saj[60]. E shohin veprën penale si një fenomen social, e cila zhvillohet në kohë dhe në vënd të caktuar.

Për të gjithë autorët e teksteve, monografive dhe shkrimeve të tjera, vepra penale është, para së gjithash veprim ose mosveprim i personit. Është pra një sjellje e caktuar e njeriut, manifestim i sjeljes së tij në botën e jashtëme, manifestim që sjell ndryshime jot ë dobishëme,

[58] S.Spiro., Cikël leksionesh, "Ana Objekti i Figurës së Veprës Penale", UET, Tiranë 2008, Fq. 1

[59] Po aty

[60] Sh.Muçi., E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithëshme, Tiranë 2012, Fq.138

port ë dëmshme për shoqërinë në përgjithësi dhe shtetin dhe qytetarët në veçanti.Disa e paraqesin anën objektive të figurës së veprës penale si “sulmin”, kriminal që drejtohet kundër raporteve të rëndësishme, shoqërore, raporte këto që mbrohen, në mënyrë të posaçme, nga e drejta penale.

Duke marrë parasysh faktin se, kur flitet për vepër penale, nënkuptohet mbi të gjitha, konstatimi, ardhja e pasojës shoqërisht e rrezikëshme, i ashtuquajturi sulm kriminal, për autorët që përdorin termin sulm, i cili u përmënd më lart, në përmabjtjen e këtij termi përfshijnë jo vetëm veprimin ose mosveprimin shoqërisht të rrezikshëm, por edhe pasojën që ka ardhur ose mund të vinte prej tij.

Përfshijnë të gjithë zinxhirin e veprimtarisë kriminale, duke filluar nga kryerja e veprimit ose moskryerja e tij, kur personi kishte për detyrë të vepronte, deri tek shkaktimi i pasojës shoqërisht të rrezikëshme, përfashirë edhe të gjitha fazat nëpërmjet të cialve kalon ky sulm, faza, gjatë të cilave pësojnë ndryshime e transformime marrëdheniet shoqerore që përbëjnë objektin e figurës së veprës penale.

Siç dhe u përmënd, ana objektive formohet nga bashkimi i të tërë hallkave përbërëse të veprimtarisë kriminale, e cila zhvillohet në kohë dhe në hapsirë. Në këtë bashkim elementësh dhe tiparesh të paraqitjes së jashtme të veprave penale, të domosdoshëm për çdo figurë vepre penale konkrete, dallohen disa elementë shumë të rëndësishëm, të cialt janë veprimi ose mosveprimi kriminal, lidhja shkakësore, pasoja, menyra, koha, vëndi dhe ambient i kryerjes së veprës penale. Analiza e hollësishme e këtyre elementëve do të përbëjë objektin e trajtimit të çështjeve të mëposhtëme të këtij punimi.

SUBJEKTI I FIGURËS SË VEPRËS PENALE

Me subjekt të figurës së veprës penale kuptohet autori i veprës penale. Kur flasim për autorin e veprës penale kemi parasysh njeriun. Kjo del dhe nga nocioni i veprës penale, të cilën e kemi trajtuar edhe më sipër. Në kuptimin e veprimit ose mosveprimit, të drejtës penale i intreson vetëm veprimi ose mosvepri i njeriut.

Që njeriu të jetë subjekt i figurës së veprës penale duhet të plotësojë kushtet për përgjegjësi penale, që është mosha dhe përgjegjshmëria. Jo çdo njëri që kryen vepër me pasoja shoqërisht të rrezikshme mund të jetë subjekt i figurës së veprës penale, në qoftë se nuk plotëson kushtet si mosha dhe përgjegjshmëria. Kur flasim për moshën dhe për përgjegjshmërinë, kemi parasysh njeriun si person fizik, sepse autori i veprës penale mund të jetë edhe personi juridik, për ato vëndë që e njohin personin juridik si subjekt të veprës penale, (Kodi Penal i Republikës së Shqiprisë, e njeh personin juridik si subjekt të figurës së veprës penale, e parashikuar në dispozitën e nenit 45 te Kodit Penal).

Rëndësia e studimit të subjektit të figurës së veprës penale është se, duke ditur kushtet që duhet të plotësojë subjekti i figurës së veprës penale, arrihet në përcaktimin dhe konkretizimin e personin të cilit do ti ngarkohet përgjegjësia penale, personi i cili ka kryer veprën penale.

Mosha për përgjegjësi penale është konsideruar mosha në të cilën një person mund të konsiderohet përgjegjës për kryerjen e një vepre penale dhe t'i nënshtrohet procedurave penale[61]. Duke qënë se mosha është një nga kushtet që duhet të plotësojë personi fizik për të qënë subjekt i figurës së veprës penale, ligjvënësi e ka përcaktuar atë në dispozitën e nenit 12 të Kodit Penal. Sipas kësaj dispozite "ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën 14 vjeç. Personi që kryhen kundërvajtje penale ka përgjegjësi penale kur ka mbushur moshën 16 vjeç". Në këtë përcaktim ligjvënësi ka marrë për bazë aftësinë e njeriut për të kuptuar rëndësinë e veprimeve që kryen dhe pasojat që mund të vijnë prej tyre.

Në varësi të moshës shkalla e aftësisë për të kuptuar është e ndryshme. Pikërisht për këtë gjë, ligjvënësi ka bërë këtë diferencim: për krimet mosha 14 vjeç dhe, për kundërvajtjet është 16 vjeç. Kjo për shkak se rrezikshmëria shoqërore e një krimi në krahasim me kundërvajtjet penale është më e lartë. Prezumohet që rrezikshmëria e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë krime, është lehtësisht më e kapshme (më e perceptueshme) se sa e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë kundërvajtje penale.

Në legjislacione të ndryshme mosha për përgjegjësi penale është e ndryshme për shëmbull, në Francë mosha për përgjegjësi penale fillon 13 vjeç, në Angli mosha për përgjegjesi penale fillon 10 vjeç. Personat e moshës për krimet 14-18 vjeç dhe për kundërvajtjet penale 16-18 vjeç, e drejta jonë penale i quan "te mitur"[62].

Mbushja e moshës për përgjegjësi penale duhet të jetë plotësuar në kohën e kryerjes së veprës penale dhe jo gjatë gjykimit të çështjes. Që personi të merret në përgjegjësi penale duhet ta ketë mbushur moshën 14 vjeç ditën që ka kryer krimin, dhe 16 vjeç ditën që ka kryer kundërvajtje penale. Për ta verifikuar këtë rrethanë i referohemi gjeneralieteve të ndodhura në aktin e lëshuar nga gjëndja civile.

Një kusht tjetër për vënien e personit përpara përgjegjësisë penale është edhe përgjegjshmëria. Ndonëse nuk është e shprehur në Kod, si kundër në shumë Kode Penale të shteteve të tjera, Kodi ynë Penal nuk e jep kuptimin e këtij termi. Përgjegjshmëria supozohet derisa nuk provohet e kundërta. Ndaj, gjatë gjykimit të çështjes mblidhen provat se a ka qënë i

[61] Cipriani.D, Children rights and the minimum age for criminal responsibility, A glogal prespective, Ashgate publishing, Londër 2009, fq.158

[62] Rreth moshës normale për përgjegjësi penale dhe miturisë, në kuptimin penal, Kodet Penale të shteteve të ndryshëm, mbajnë qëndrime të ndryshme. Për shëmbull, në Kodin Penal Kanadez (neni 13) moshë e tillë konsiderohet mosha 12 vjeç. Problemet e tjera të cilat lidhen me atë që quhet delinkuentë të rinj, në Kanada , normohen me një ligj të posaçëm i cili titullohet "Loi sur les junes contrevenants". Në legjislacionin Grek, megjithëse mituria në kuptimin e gjërë të fjalës përfshin moshën 7-17 vjeç, mituria në kuptimin penal ndahet në tre kategori: 7-12 vjeç konsiderohen fëmijë; 12-17 vjeç konsiderohen të mitur dhe 17-21 vjeç konsiderohen adoleshentë. Ndaj personave 7-17 vjeç mund të caktohen vetëm masa edukuese ose dhe mjeksore, kurse llojet e tjera të dënimeve të cilat parashikohen në kod caktohen ndaj personave 17 vjeç e lart. Për kategorinë e personave të moshës 17-21 vjeç, parashikohen disa lehtësi, përsa i përket llojit të dënimit dhe masave të tyre, si dhe mënyrën e vuajtjes së dënimeve, të dhëna nga gjykatat. Sipas Kodit të Përkohshëm të Kosovës, në dispozitën e nenit 11/2 personi nuk konsiderohet personalisht përgjegjës nëse në kohën e kryerjes së veprës penale është nën moshën 14 vjeç. Edhe sipas këtij Kodi, me shprehjen të mitur do të kuptohen personat që janë ndërmjet moshës 14-18 vjeç. Interes të veçantë paraqet dispozita e nenit 105 e këtij Kodi, sipas së cilës, ky Kod zbatohet për personat nën moshën 18 vjeçare vetëm nëse ligji në fuqi për të miturit nuk parasheh ndryshe.

përgjegjshëm apo jo, vetëm në rastet kur lind dyshimi i bazuar se autori i veprës penale mund të ketë qënë i papërgjegjshëm.

Një person konsiderohet i përgjegjshëm kur ai ka aftësi intelektuale mendore të bëjë vlerësimin e veprimeve ose mosveprimeve të tij, të arrijë të kuptojë se sa i dobishëm apo i dëmshëm është ai veprim ose mosveprim për shoqërinë apo individin. Këtë gjë e drejta jonë penale e quan ndërgjegje e cënimit[63], domethënë të jetë në gjëndie të bëjë vlerësimin, çmimin e tij. Me këtë duhet kuptuar që personi të jetë në gjëndie të vlerësojë nëse veprimi apo mosveprimi i tij është i dobishëm apo i dëmshëm për shoqërinë, apo për individë të veçantë.

Për të patur këtë lloj ndërgjegjeje, duhet që ai të jetë në gjëndje të bëjë lidhjen, perceptojë raportin që ekziston ndërmjet marrëdhënies shoqërore që cënon, në një rast konkret, me rendin juridik, në përgjithësi, në një shoqëri të dhënë. Ky nuk është gjë tjetër veçse një problem të çmuari, një process vlerësimi. Por çmimi, vlerësimi, në këtë rast, është në varësi të disa faktorëve. Është në varësi të nivelt të përgjithshëm të zhvillimit personal të secilit, nivel i cili nga njëra anë, varet nga përvoja personale e secilit për të perceptuar sendet dhe fenomenet, objektet material që e rrethojnë dhe nga aftësia subjektive e tij për të abstraguar, për të bërë përgjithësime dhe për të nxjerrë përfundime në lidhje me vlerën juridike të marrëdhënieve që janë vendosur në shoqëri dhe të cilat mbrohen në mënyrë të posaçme nga ligji, nga ana tjetër.

Për të kuptuar sa më mirë këtë që cituam më lart, na vjen në ndihmë shkenca e psikologjisë, sipas së cilës procesi i të abstraguarit, i bërjes së përgjithësimeve ose, sikurëse thuhet shpesh, procesi i të menduarit abstrakt, kalon nga perceptimi i realitetit objektiv, në nxjerrjen e përfundimeve abstrakte që kanë lidhje me këtë realitet, kalon në lindjen tek njeriu të mendimeve abstrakte, në mundësinë për të bërë prej tij përgjithësime të caktuara, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt tek ai për të marrë vendime që kryej apo të moskryej veprime të caktuara.

Zotësia për të formuar këto mendime abstrakte është veti vetëm e trurit të njeriut, është si të thuash, përparësi, avantazh i tij, i cili përbën karakteristikën bazë dalluese të njeriut nga kafshët. Funksinimi normal i këtij procesi, veprimtaria normale e të menduarit abstrakt, ekzistenca tek njëriu i ndërgjegjes së cënimit, përbën thelbin e përgjegjshmërisë së njeriut si qënie shoqërore, në përgjithësi, dhe të njeriut si subjekt i figurës së veprës penale, në veçanti.

Por, ndodh që njeriu, për shkak të një tronditjeje kalimtare apo të përherëshme të qëndrës së veprimatrisë intelektuale, të trurit, ta humbasi përkohësisht, apo përgjithmonë këtë zotësi, ndodh që njeriu të humbasë ate që më lart u quajt ndërgjegjia e cënimit. Ndodh që, për shkak të tronditjes kalimtare apo të përherëshme të trurit, të mos jetë në gjëndje të bëjë lidhjen, të perceptojë raportin që ekziston midis marrëdhënies shoqërore që cënon, me rendin juridik, në përgjithësi dhe me parashikimin e këtij cënimi nga ligji si veprim apo mosveprim që dënohet prej tij, në veçanti.

Është plotësisht e qartë se në një gjëndie të tillë, të sëmurë, njeriu nuk mund të kuptojë pikërisht atë që përbën përmbajtjen e të ashtuquajturës vullnet vlerësues, nuk mund të kuptojë

[63] S.Spiro., Revista Drejtësia Popullore Nr.2, Viti 1982, fq 7

rëndësinë e veprimit apo mosveprimit që cënon një vlerë ose marrëdhënie të caktuar shoqërore[64]. Pikërisht në këto rastet para së drejtës penale lind dhe shtrohet për zgjidhje, problem i papërgjegjshmërisë.

Në Kodin Penal në fuqi, papërgjegjshmërinë ligjvënësi e ka parashikuar në një dispozitë në vete, në nenin 17 të tij, "Papërgjegjshmëria për shkak të gjëndie mendore". Sipas kësaj dispozite, nuk ka përgjegjësi penale personi që, në kohën e kryerjes së veprës, vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe, për pasojë, nuk ka qënë në gjëndie të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen vepër penale. Përfundimi i parë që arrihet nga leximi i përmbajtjes së kësaj dispozite është se papërgjegjshmëria është rrethanë, prania e së cilës përjashton personin nga përgjegjësia penale. I papërgjegjshmi mund të vjedh, të përdhunojë, të vras, të bëj terror, të djeg etj, dhe nuk përgjigjet penalisht.

Përmbajtja e institutit të papërgjegjshmërisë, ashtu sikundër përshkruhet në dispozitën e cituar më lart, përmban disa elementë të domosdoshëm përbërës,, mungesa e trajtimit shkencor, qoftë edhe të njërit prej tyre, nga e drejta penale, cënon dukshëm jo vetëm kuptimin e tij thjesht në aspektin teorik, por dëmton rëndë zbatimin si duhet të institutit të përgjegjësisë penale në veprimatrinë praktike të organeve të drejtësisë.

Ndarja më e madhe, kryesore e këtyre elementëve, e gjithpranuar në teorinë e së drejtës penale, jo vetëm të Republikës së Shqipërisë[65], por edhe në të drejtën penale të shteteve të tjerë, përmblidhen në përcaktimin e dy kritereve, atë juridik dhe atij mjeksor, në formimin e secilit prej këtyre kritereve marrim pjesë disa komponentë, prej të cilave ato që i takojnë kriterit juridik kanë të bëjnë edhe me moment psikologjike, sikundër janë intelekti dhe vullneti, kursë ato të cilat i takojnë kriterit mjeksor kanë të bëjnë kryesisht me elementë të veçantë të shkencave mjeksore, si të neuropsikiatrisë dhe asaj të psikiatrisë ligjore. Kanë të bëjnë me disa sëmundje, të cilat studiohen pikërisht nga këto shkenca.

E veçanta këtu është se, për këto sëmundje, megjithëse nuk përmënden shpehimisht se cilat janë, gjë e cila do të ishte e pamundur të bëhej, në ligj jepet kriteri në bazë të të cilit, kur ato vërehen se ekzistojnë tek autori i një vepre me pasoja të dëmshme për individin apo shoqërinë, detyrimisht, ai deklarohet i papërgjegjshëm. Dhe ky është kriteri juridik, i cili mund të përmblidhet me fjalët, mospasja prej autorit e vetëdijes së rëndësisë së veprës, të veprimit ose mosveprimit të tij apo mundësisë për t'i kontrolluar ato dhe të aftësisë për vetpërmbajtje, për të frenuar veten që të mos kryej veprimin shoqërisht të rrezikshëm ose të shtyjë veten për të kryer një veprim që, sipas ligjit, duhet të kryhet.

[64] S.Spiro., Cikël leksionesh, "Përgjegjshmëria dhe papërgjegjshmëria", UET, Tiranë 2010, Fq. 4

[65] S.Spiro., "Kuptimi i papërgjegjshmërisë sipas së drejtës penale të R.P.S.Sh", Revista Drejtësia Popullore Nr.2, vitit 1982, Fq.19

Duket qartë se dy kriteret ai juridik dhe ai mjeksor janë të pazgjithshëm. Duhet të ekzistojne njëkohësisht të dy sëbashku, është kusht i domosdoshëm për të deklaruar papërgjegjshmërinë. Të dy bashkë, ato plotësojnë dhe janë në funksion të njëri-tjetrit. Duke patur parasysh formulimin e dispozitës së nenit 17 të Kodit Penal, fare mirë mund të thuhet se këto dy kritere janë në lidhje shkaksore midis tyre. Konstatimi tek autori i veprimit apo mosveprimit shoqërisht të rrezikshëm i një turbullimi psikik ose neuropsikik i cili ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor, konstatim ky që përbën kriterin mjeksor, përbën shkakun e mospasjes prej tij të vetëdijes së rëndësisë dhe kontrollit të veprimit apo mosveprimit, përfundim ky i cili arrihet nga vet përmbajtja e dipozitës së nenit 17 të Kodit Penal. Vetë ligjvënësi gjëndien e paaftësisë për të kontrolluar veprimet apo mosveprimet dhe as të kuptoje se po kryen vepër penale një person që, në kohën e kryerjes së tyre, vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik i cili ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor, e ka quajtur pasojë pikërisht të kësaj të fundit, të gjëndies së tij të sëmurë mendore.

Për kriterin mjekësor, ndryshe nga kodet e mëparëshme[66], në Kodin Penal në fuqi, ligjvënësi ka përdorur shprehjen, "…personi vuante nga një turbullim psikik ose neuropsikik tërësisht ekuilibrin e tij mendor", duke e përshtatur, në këtë mënyrë, formulimin e kriterit mjeksor sipas Kodit tonë Penal, me formulimet respektive të Kodeve Penale të shumë shteteve të tjerë.

Duhet vënë në dukje se termi "turbullime psikike ose neuropsikike", është term ligjor dhe më i gjërë se termi mjeksor, "sëmundje psikike".

Ligjvënësi, qëllimisht është shprehur në mënyrë abstrakte, duke u shmangur të përcaktojë gjërësinë e këtij kuptimi, duke u shmangur, në të njëjtën kohë, të rendisë listën e sëmundjeve psikike, të cilat shkaktojnë turbullime psikike apo psikozat dhe sëmundjet e tjera që prishin tërësisht ekuilibrin mendor të personit që vuan prej tyre. Krijohet mundësia që, nëse, gjatë procesist të përparimit të shkencave të mjekësore, zbulohen dhe sëmundje të tjera psikike, të panjohura deri më tani, nga ato që shkaktojnë turbullime të shkallës që sjellim pasojat e parashikuara në dispozitën enenit 17 të Kodit Penal, ato të përfshihen në numrin e sëmundjeve që sjellin si pasojë turbullimin psikik ose neuropsikik të personit që vuan prej tyre[67].

Pavarësisht nga sa më sipër, si në literaturën juridiko-penale, ashtu edhe në praktikën psikiatriko-ligjore dhe atë gjyqësore, herë pas here, janë përmëndur disa nga sëmundjet mendore që, bazuar në ekzaminimin dhe shqyrtimin gjyqësor të çështjeve penale me autore, persona që kanë qënë bartës të këtyre sëmundjeve, që vuajnë prej tyre, janë të papërgjegjshëm. Është arritur

[66] Ky kriter, në nein 7 të K.P të vitit 1952 shprehej me fjalët, "…personi, i cili kur ka kryert krimin, është ndodhur në gjëndje sëmundjeje psikike kronike, në gjëndje kumbjeje të përkohëshme të aftësisë psikike ose në gjëndje zhvillimi mendor të metë, ose nën influencën e ndonjë sëmundjeje tjetër….".

Kurse në nenin 8 të K.P të vitit 1977 shprehej me fjalët, "..personi, i cili… për shkak të sëmundjes psikike, të zhvillimit mendor të metë ose të ndonjë sëmundjeje tjetër që shoqërohet me turbullime psikike".

[67] S.Spiro., Cikël leksionesh, "Përgjegjshmëria dhe papërgjegjshmëria", UET, Tiranë 2010, Fq. 8

në përfundimin se këto sëmundje mendore janë shkaktare të prishjes tërësisht të ekuilibrit mendor të personave që vuajnë prej tyre. Të tilla janë konsideruar përshëmbull skiziofrenia dhe paraliza progresive. Megjithëse jo në të gjitha rastet, por, sëmundje e tillë është konsideruar edhe epilepsia. Pranohet, nga shumica e autorëve, që epilepsia renditet ndër sëmundjet mendore që prishin tërësisht ekuilibrin mendor, jo gjithmonë por, vetëm në rastet kur personi kryen veprimin apo mosveprimin shoqërisht të rrezikshëm, në momentet e krizës epileptike ose sikurëse thuhet ndryshe, në momentet e konvulsioneve epileptike[68],

Sëmundje që prishin tërësisht ekuilibrin mendor të personit dhe, për rrjedhojë, sjellin papërgjegjshmëri, janë konsideruar shpesh edhe disa gjëndje të veçanta, në të cilat ndodhet personi në kohën e kryerjes së veprimit apo mosveprimit shoqërisht të rrezikshëm sikurse janë psikozat reaktive, dehja patologjike, affekti patologjik, zgjimi muzgor[69], etj. Si në rasti e sëmundjeve mendore të cilat u përmëndën më lart, edhe në rastin e këtyre të fundit, konstatimi i tyre është kompetencë e mjekut neuro-psikiatër, i cili thirret për të dhënë mendimim nga oficeri i policisë gjyqësore, prokurori, gjykata apo avokati, si specialist, në rolin e ekspertit psikiatro-ligjor, në procesin penal.

Ndryshe trajtohen, në pikëpamje juridiko-penale, në lidhje me përgjegjshmërinë dhe papërgjegjshmërinë psikopatite dhe psikopatët. Përsa i përket ndryshimit midis sëmundjeve psikike dhe psikopative, dallimi midis tyre është, në rradhë të parë i natyrës mjeksore dhe në rradhë të dytë, kur ato i interesojnë së drejtës penale, i karakterit juridiko-penal.

Ndryshe nga sëmundjet psikike, të cilat e kanë bazën në prekjen e trurit të njëriut nga sëmundje, të cilat shkaktojnë çrregullime të veprimtarisë intelektuale të tij, sëmundje, të cilat kanë në bazën e tyre procese të caktuara patologjike-anatomike të vet trurit, psikopatitë nuk kanë shkaqe të kësaj natyre. Tek psikopati, ndrysha nga njerëzit normal, vullneti nuk mund t'i zotërojë sa duhet instiktet dhe emocionet. Përkundrazi, instiktet të ndjekura nga emocionet, ndikojnë në një masë të madhe, në vullnetin dhe në sjelljen e tij në përgjithësi. Tek psikopatët, si aftësia e tyre për të kuptuar rëndësinë e veprimeve të tyre, aftësia për të gjykuar, ashtu edhe mundësia për të kontrolluar veprimet e veta, mundësia për të vendosur, si rregull, janë në nivel normal. Prandaj ata janë të përgjegjshëm, por gjëndjet emocionale dhe instiktive e tyre mund të merret parasysh nga gjykata, sipas rastit, si rrethana që ndikojnë në llojin dhe masën e dënimit që mund të caktohet ndaj personave psikopatë që kryejnë vepra penale. Të njëjtin qëndrim e drejta penale mban edhe ndaj personave, të cilët kryejnë vepra penale në kushtet e një gjëndjeje të veçantë psikologjike sikurëse janë affektet psikologjike, kjo është një gjëndje e veçantë në të cilën ndodhet njëriu për shkak të disa faktorëve, kryesisht, psikologjike si, frika, trembja, hidhërimi, gëzimi, pikëllimi etj. Kjo gjëndje tek njëriu krijohet, si rregull, befas, në mënyrë të menjëherëshme dhe e pavarur prej tij. Edhe personat që kryejnë vepra penale kur ndodhen në

[68] Po aty

[69] Po aty, fq.9

gjëndjen e affekteve psikiko-psikologjike, e drejta penale nuk i përjashton nga përgjegjësia penale, i konsideron ata të përgjegjshëm[70].

Një kategori e veçantë personash të cilët paraqesin inters përtë drejtën penale janë personat me prapambetje mendore, ose siç quhen ndryshe personat me zhvillim të metë mendor, oligofrenët.

Parë nga këndvështrimi mjeksor, oligofrenë konsiderohen personat me pazhvillueshmëri të aparatit psikik, për shkak të lëndimit të trurit që në kohën kur fetusi ndodhet në organet e brëndëshme të nënës ose ne ditët e para të jetës, mbas lindjes së fëmijës.

Në literaturën psikiatriko-gjyqësore dhe juridiko-penale, oligofrenia paraqitet në tre forma, debilët, imbesiliteti, idiotia. Kurse personat me zhvillim të metë mendor, grupohen në tre kategori: debilë, imbesilë dhe idiotë. Për idiotët, shpesh thuhet që ata kanë shkallën më të lartë të mëndjes më të vogël[71]. Për debilët dhe imbesilët, megjithëse e kufizuar, ekziston, si aftësia për të kuptuar rëndësinë e veprimeve të veta edhe aftësinë për ti kontrolluar ato, prandaj ata janë të përgjegjshëm për vepra penale të kryera prej tyre[72]. Ndërsa, tek idjotët, për shkak të shkallës së lartë të zhvillimit të metë mendor që kanë, mungon si aftësia intelektuale dhe aftësia volitiv, prandaj dhe konsiderohen të papërgjegjshëm.

Trajtim i veçantë, ne literaturën juridiko-penale dhe në legjislacionet penale të çdo shteti, i rezervohet kategorisë së personave që kryejnë vepra penale duke qënë të dehur dhe vet gjëndies së dehur të ketyrë përsonave. Kjo pasi edhe veprat penale që kryhen nga personat, në gjëndie dehjej janë relativisht të shumta dhe shpesh, me pasoja shoqërisht të rrezikshme në përmasa jo të vogla.

Në të drejtën penale dehja konsiderohet si ç'rregullim i përkohëshëm i veprimatrisë normale të trurit të njeriut, ç'rregullim ky që shkakton tronditje të përkohëshme të psikikës së tij. Ka autorë, të cilët dehjen e konsiderojnë një nga format e psikozave toksike, duke e quajtur atë dhe psikozë alkoolike[73].

Në Kodin Penal të Rrepublikës së Shqipërisë, të vitit 1995, është përfshirë një dispozitë e veçantë, neni 18 "Kryerja e veprës penale në gjëndje të dehur"[74]. Sipas kësaj dispozite, nuk

[70] Sipas penalistit gjerman Roxin, po të pranohej papërgjegjshmëri në rastet e affektit psikiko-psikologjik, një ndër katër vrasës, do ti shpëtonte përgjegjësisë penale, "Taterschaft und tatherrschaft, bot 2-të, 1967"

[71] S.Spiro., Cikël leksionesh, "Përgjegjshmëria dhe papërgjegjshmëria", UET, Tiranë 2010, Fq.11

[72] E Drejta Penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Pjesa e Përgjithshme, grup autorësh, Tiranë 1982, Fq.137. problemi i të ashtuquajturës përgjegjshmëri e zvogëluar paraqet interes në vështrim të dimaikës se legjislacioni penal shqipëtar. Kodet Penale të viteve 1952 dhe 1977, kishin nga një dispozitë të veçantë, nenet 46 dhe 34 në të cilën parashikohej përgjegjshmëria e zvogluar vetëm për të miturit. Kurse në Kodin Penal të 1995, megjithëse në një dispozitë të veçantë të tij ishte parashikuar përjashtimi i të miturit nga dënimi, bazuar në tre kritere por që asnjëra prej të cilave nuk ka lidhje me përgjegjshmërinë për vepren penale të kryer prej tij.

[73] S.Spiro., Cikël leksionesh, "Përgjegjshmëria dhe papërgjegjshmëria", UET, Tiranë 2010, Fq.13

[74] Në të dy Kodet Penale të mëpërparëshme çështja e kryerjes së veprës penale nga persona të dehur, nisur nga konceptimi dhe mentaliteti i kohës kur edhe dehja konsiderohej "shfaqje e huaj"në dispozitat respektive të tyre, neni 7 i Kodit Penal të vitit 1952

përjashtohet nga përgjegjësia penale personi që ka kryer veprën penale në gjëndje të dehur. Dehja tek ne, nuk konsiderohet gjëndje që mund të shkaktojë turbullim psikik ose neuropsikik që prish tërësisht ekuilibrin mendor të personit në kuptim të nenit 17 të Kodit Penal.

Në rrethana të caktuara, ligjvënësi shqiptar, kur është fjala për vepra penale të kryer nga persona në gjëndje të dehur, në varësi të disa faktorëve të cilat do t'i quaja, të karakterit objektivë dhe subjektivë, ka dhënë zgjidhje të veçanta, specifike dhe të kundërta më njëra tjetrën.

Kështu sipas paragrafit të dytë të dispozitës së nënit 18 të Kodit Penal, kur dehja është shkaktuar në rrethana të rastit dhe ka sjellë uljen e ekuilibrit mendor, kjo rrethanë konsiderohet rrethanë lehtësuese dhe si etillë, mbahet parasysh, nga gjykata për zbutjen e dënimit.

Zgjidhje të kundërt me këtë, në lidhje me dehjen, ligjvënësi ka dhënë në paragrafin e tretë të dispozitës së nenit 18 të Kodit Penal, sipas të cilit, kur dehja është bërë me paramendim, nga personi autor i veprës, për të kryer veprën penale, kjo rrethanë mbahet parasysh, nga gjykata, për rëndimin e dënimit.

Paramendimi, në kuptimin që i ka dhënë ligjvënësi kësaj rrethane në paragrafin e tretë të dispozitës së nenit 18 të Kodit Penal, duhet të jetë i kushtëzuar me veprën penale që kryen personi, duke qënë në gjëndje dehjeje. Paramendimi këtu është në lidhje shkakësore të drejtpërdrejtë me shkaktimin e gjëndjes së dehjes tek vetja me një qëllim, me një objektivtë caktuar, të cilin e përbën kryerja prej tij e një vepre konkrete penale, kryerjen e së cilës ai e kishte paramenduar ende pa filluar përdorimin e alkoolit në atë masë, deri sa ta degradonte veten në gjëndje dehjeje. Kjo ndodh pë rata persona, të cilët e konsiderojnë gjëndjen e dehjes, si gjëndje në të cilën ata mund të arrijnë më lehtë qëllimin e paramenduar, që para shkaktimit të gjëndjes së dehjes. Për shëmbull, dikush duke qënë në gjëndje psikike krejtësisht normale, vendos të kryej një vrasje, por duke patur frikë se mos tregohet i dobët në momentin e veprimit dhe tërhiqet, e nxit kurajon nëpërmjet përdorimit të alkoolit, dehet me dashje dhe në këtë gjëndje kryen vrasjen. Përdorimi i alkoolit në të till rast është për të hequr frikën dhe për të krijuar kurajo deri në momentin që do kryej vrasjen.

Për raste të tilla, në literaturën juridike përdoret shprehja latine "*Actiones liberae in causa*", e cila përkthehet veprime të cilat janë të lira në vendim, ç'është e vërteta, legjislacione të ndryshme mbajnë qëndrime të ndryshme, pjesa më e madhe e të cilave, të kundërt me legjislacionin tonë, lidhur me këtë çështje[75].

Edhe pse Kodi ynë Penal nuk e përmënd, kur flitet për dehjen, në veçanti duhet trajtuar një formë e veçantë dehjeje, e cila në literaturën mjeksore dhe atë juridiko-penale quhet "dehja patologjike".

Që në fillim duhet thënë se, kjo, pavarësisht nga fakti që provokohet nga alkooli, nuk është e njëllojtë si dehja e zakonshme. Nga vet emërtimi i saj, kuptohet që ajo paraqitet në disa

---

dhe neni 8 i Kodit Penal të vitit 1977, është vendosur një paragraf i veçantë , sipas të cilit efektet e këtyre dispozitave, në të cilat jepej kuptimi i papërgjegjshmërisë, nuk shtriheshin mbi personat që kishin kryer veprën penale duke qënë të dehur.

[75] S.Spiro., Cikël leksionesh, "Përgjegjshmëria dhe papërgjegjshmëria", UET, Tiranë 2010, Fq.16

simptoma specifike, të ndryshme nga dehja e zakonëshme, simptoma këto, të cilat formojnë patologjinë e kësaj forme të dehjes.

Për të arritur në përfundimin nëse, në një rast dehjeje, ndodhemi apo jo para dehjes patologjike, nuk ka rëndësi sasia e alkoolit e përdorur nga personi. Zakonisht, rastet e dehjes patologjike konstatohen në persona që kanë përdorur doza të vogla dhe, ngandonjëherë, fare të vogla alkooli. Është gjëndja psiko-psikologjike e personit, gjëndja shpirtërore, në përgjithësi, në të cilën ai ndodhet në kohën ë përdorimit të alkoolit, pavarësisht nga masa, ajo që e shkakton gjëndjen patologjike të tij.

Gjëndje të tilla, zakonisht janë ato që krijohen për shkak të affekteve patologjike, si rezultat i kalimit të menjëhershëm nga një gjëndje në një tjetër, për shkak të hidhërimit, pikëllimit të personit, gëzimit të beftë të tij, ndjenjës së tmerrit etj. Janë disa faktorë të jashtëm ato të cilët shërbejnë si shkak për të krijuar tek njëriu gjëndje të kësaj natyre, efektet e alkoolit në gjakun e personit që e përdor dhe në psikikën e tij, janë më të forta dhe më të shumta.

Shpesh ato arrijnë deri sa shkaktojnë turbullime psikike ose neuropsikike, të cilat mund të sjellin uljen e ekuilibrit mendor te tij ose në raste të veçanta, edhe prishjen tërësisht të këtij ekuilibri.

Kjo është arsyeja që, si në literaturën juridiko-penale, ashtu edhe në parktikën gjyqësore të disa vëndeve, përfshirë edhe tek ne, është pranuar që, personat, të cilët kryejnë vepra penale në gjëndjen e dehjes patologjike, ose të deklarohen të papërgjegjshëm, ose kjo gjëndje merret parasysh nga gjykata, si rrethanë lehtësuese në llojin dhe masën e dënimit që do të caktohet, në varësi të shkallës së prishjes ose të uljes së ekujlibrit mendor, ndaj tij[76].

Duhet patur parasysh që, përtë arritur në përfundimin nëse ndodhemi apo jo para dehjes patologjike, gjykata, përveç hetimit të rrethanave të jashtëme, në përgjithësi, në të cilën është kryer vepra penale, rast pas rasti, duhet të hetojë edhe disa rrethana specifike, të cilat kanë të bëjnë kryesisht si me sjelljen e autorit të veprës penale siç mund të jenë veprimet dhe sjellja e tij para përdorimit të alkoolit, masa e alkoolit të përdorur, kushtet në të cilat u përdor, shkaku i përdorimit, ashtu edhe mesjelljen e tij gjatë kryerjes së veprës penale, mjetet dhe mënyra e përdorur për kryerjen e saj, shprehjet që mund të jenë përdorur prej tij para, gjatë dhe menjëherë pas kryerjes së veprës së tij etj. Rëndësi e veçantë i duhet kushtuar veprimeve, qëndrimit dhe sjelljes së autorit të veprës penale, pas kryerjes së saj. Kur thuhet, “pas kryerjes së saj”, me këtë nuk duhet kuptuar një kohë pa kufizim, por çastet e para, menjëherë pas kryerjes së veprës, reagimi rreth veprës dhe gjëndja e përgjithëshme e tij, në këto momente.

Bazuar në përgjithësimin e praktikës së hetimit dhe gjykimit të rasteve të tilla, është vënë re që, simptoma të dukshme të dehjes patologjike, janë për shëmbull mungesa e motivimit serioz, tek autori, për kryerjen e veprës, përdorimi i mjeteve të rastit prej tij, mungesat, përsa i përket

[76] sipas nenit 23 të Kodit Penal të Federatës Ruse, personat që kryejnë krim në gjëndjen e dehjes fiziologjike janë të përgjegjshëm dhe i nënshtrohen përgjegjësisë penale. Kurse në rastet kur krimi kryhet në gjëndjen e dehjes patologjike, të etheve të bardha apo të çrregullimeve të tjera të sëmura psikike, sipas kriterit mjekësor së bashku me kriterin juridik, ata zakonisht, janë të papërgjegjshëm.

koherencës së lëvizjeve dhe veprimeve të tij, gjatë kryerjes së veprës, mosmarrja prej tij e masave, të cilat zakonisht merren nga autorët e veprave penale, për të fshehur gjurmët e veprës, ose për të lehtësuar përgjegjësinë për kryerjen e saj, shpërthimet emocionale, menjëherë pas kryerjes së veprës si, të qarat, ngashërimi jot ë zakonëshme, shpërthimi i menjëhershëm i të vjellave, djersitjeve, zbehja e menjëhershme etj.

Këto dhe rrethana të tjera të kësaj natyre, të cilat kanë të bëjnë me çastin e kryerjes së veprës penale dhe menjëherë pas saj, nëse ekzistojnë, duhen grumbulluar dhe administruar nga organi i akuzës dhe gjykata është kjo e fundit që ka të drejtën dhe njëkohësisht, detyrën e vlerësimit juridiko-penal të tyre.

Domosdoshmëria e tërheqjes së mendimit të specializuar në këtë fushë, rrjedh edhe për shkak të nevojës që lind për të përcaktuar nëse rrethanat, e lartpërmëndura, janë nga ato të cilat njihen nga shkenca e mjeksisë si simptoma të personave që vuajnë nga turbullime psikike apo neuropsikike, si dhe nëpërmjet përcaktimit të shkallës së intensitetit të këtyre turbullimeve, nëse ekzistojnë, të jepet mendimi i specializuar për masën e prishjes së ekuilibrit mendor të autorit të veprës penale, e cila kur është tërësore, sipas përmbajtjes së paragrafit të parë të dispozitës së nenit 17 të Kodit Penal, sjell papërgjegjshmëri, ndërsa kur konsiston vetëm në uljen e këtij ekuilibri, sipas përmbajtjes së paragrafit të dytë, të dispozitës së nenit 18 të tij, shërben si rrethanë lehtësuese, në favor të autorit të veprës penale.

Edhe në këto raste, ashtu sikurëse, edhe në të gjitha rastet e tjera kur lind nevoja e përcaktimit të përgjegjshmërisë apo papërgjegjshmërisë, përfundimet nxirren mbas ekzaminimit të hollësishëm dhe të kujdesshëm, nga specialist neuropsikiatër, të autorit të veprës penale. Mbështetur në mëndimin e tij, për gjëndjen e shëndoshë apo të sëmurë mendore, për llojin e sëmundjes nëse ekziston, nga e cila ai ka vuajtur në kohën e kryerjes së veprës dhe ndikimin e saj në psikikën e këtij personi, është gjykata ajo që, në varësi të të gjithë rrethanave të ngjarjes dhe sidomos me ato që ireferohen vet autorit të saj, motivet, të cilat kanë shërbyer si shtysë tek ai për kryerjen e veprës, mënyra dhe mjetet e përdorura, qëndrimi mbas kryerjes së saj, vendos nëse, në secilin rast konkret objekt shqyrtimi, ndodhet para një personi të përgjegjshëm apo të papërgjegjshëm.

Ky është qëndrim diametralisht i kundërt me pikëpamjen e shprehur nga disa penalistë, sipas së cilës fjalën e fundit për përgjegjshmëri apo papërgjegjshmëri, duhet ta thotë specialist neuropsikiatër i thirrur si ekspert, prej tyre, pikëpamje kjo që nga disa penalistë të cilët e kundërshtojnë atë, që herët, është quajtur "psikiatrizim i së drejtës penale"[77], karakterizim ky, i cili sipas mendimit tim, vazhdon të përkrahet nga shumë penalistë dhe legjislacione penale edhe të kohëvë tona[78], të cilat udhëhiqen nga parimi i njohur tashmë në këtë fushë, sipas të cilit shkenca mjeksore i vjen në ndihmë shkëncave juridike dhe nuk i zëvëndëson ato.

[77] Precis de droit criminel, R.Garrand, Paris, 1926, fq.102

[78] Red.përgj. B.N.Pjetasheva., E Drejta Penale, Pjesa Përgjithshme, Moskë 1999, fq 182

Në lidhje me papërgjegjshmërinë dhe përgjegjshmërinë, duhet theksuar, se për herë të parë në Shqipëri, në Kodin Penal aktual, bëhet fjalë për efektin e narkotikëve dhe simulantëve të tjerë. Kështu, sipas paragrafit të katërt të dispozitës së nenit 18 të kërij kodi, rregullat e parashikuara nga kjo dispozitë për personat që kryejnë veprën penale në gjëndje të dehur, zbatohet edhe kur vepra kryhet nën efektin e narkotikeve apo stimulantëve të tjerë.

Megjithatë, nga informacioni që kam, në praktikën gjyqësore, deri tani, nuk ka patur raste të kësaj natyre, nga përmbajtja e paragrafit të katërt të dispozitës së cituar, kuptohet që, gjykatat, po të ndodhen para rasteve të tilla , do të zbatohen gjithçka u përmend në pjesën e mësipërme për rastet e kryerjes së veprës penale në gjëndje të dehur.

Problemi i përgjegjshmërisë së personave që veprojnë nën efektin e narkotikëve trajtohet në mënyra të ndryshme në literaturën juridiko-penale dhe nga legjislacionet penale të vëndeve të ndryshme.

Në mënyrë të dobishme, trajtohet edhe problem i shurdhmemecëve të cilët kryejnë vepra penale[79]. Tek ne, kjo kategori personash deri tani është trajtuar dhe vazhdon të trajtohrt njëlloj si të gjithë personat e tjerë, si në legjislacion, ashtu edhe në teorinë e së drejtës penale dhe praktikën gjyqësore.

Përgjegjshmëria dhe papërgjegjshmëria përcaktohen duke u bazuar në dy kritere, në kriterin juridik dhe atë mjeksor. Më i rëndësishëm prej tyre, kriteri juridik, përmbajtja e të cilit konsiston në pasjen e vetëdijes së rëndësisë së veprës dhe të aftësisë për të kontrolluar veprimet apo mosveprimet e veta dhe të frenimit gjatë kryerjes ose moskryerjes së tyre.

Pikërisht ky është edhe shkaku që, nga shumë penalistë, përgjegjshmëria konsiderohet kusht paraprak për fajin dhe përgjegjësinë penale[80] .

Dihet se, një person të merret në përgjegjësi penale, përveç të tjerave, duhet të ketë vepruar apo të mos jetë vepruar me faj. Por faji si qëndrim psikik i personit ndaj veprës dhe pasojave shoqërisht të rrezikshme, është element jo i psikikës së çdo personi. Ai është elemënt i psikikës, vetëm të personave të përgjegjshëm. Asnjëherë dhe në asnjë rrethanë nuk mund të thuhet se përsoni i papërgjegjshëm ka vepruar me faj, sado flagrante të jetë vepra e tij, sado e madhe të jetë rrezikshmëria shoqërore e pasojave të ardhura prej tij, si dhe përmasat e tyre. Kjo për arsye se, faji, si kategori juridike, nënkupton, veç të tjerash, edhe që personi, kur kryen një vepër, të ketë patur vetëdijen e rëndësisë së saj, të ketë patur atë që më lart u quajt "vetëdija e cënimit".

Me vetëdije të rëndësisë së veprës, në të drejtën penale kuptohet që, personi duhet të jetë në gjëndje të mirë mëndërisht, rëndësinë e veprimeve apo mosveprimeve të tij, të kuptojnë nëse

[79] Sipas Kodit Penal Gjerman, neni 20, shurdhmemeci është i papërgjegjshëm nëse konstatohet se nuk e kishte aftësinë intelektuale për të kuptuar kundërligjshmërinë e veprimeve të veta apo të veprojë në përputhje me perceptimin e vet në lidhje më këtë kundërligjshmëri. Të njëjtin qëndrim mban edhe Kodi Penal Grek, neni 33.

[80] S.Spiro., Cikël leksionesh, "Përgjegjshmëria dhe papërgjegjshmëria", UET, Tiranë 2010, Fq.24

ato janë të dobishme apo të dëmshme për shoqërinë, në rastin kur veprimet apo mosveprimet e tij janë të dëmshme për shoqërinë, duhet të kuptojë, të perceptojë, në masë të nevojshme, rrezikshmërinë shoqërore të tyre, të jetë pra i vetëdijshëm për qënien e tyre shoqërisht të rrezikshëme.

Por, për të qënë i përgjegjshëm, personi duhet të kuptojë vetëm rrezikshmërinë shoqërore të veprës, apo edhe kundërligjshmërinë e saj? Mendoj, pavarësisht nga fakti, që kundërligjmëria është një nga elementët përbërës të kuptimit të vetë veprës penale dhe të anës objektive të figurës së saj, mendoj se, kushtëzimi i përgjegjshmërisë edhe me pasjen prej autorit të veprës penale edhe të kuptimit të kundërligjshmërisë së pasojës, edhe të vetedijes së kundërligjshmërisë së saj, do të ishte kërkesë e panevojshme, e tepërt,

Këtu nuk është fjala për padijeninë e ligjit, mosnjohjen e tij, rrethanë kjo e cila ka gjetur rregullim në Kodin Penal, në dispozitën e nenit 4 të tij, kurse në të drejtën proceduriale penale, në parimin e prezumimit. Është fjala për rastet kur, problemi i pasjes apo mospasjes së vetëdijes së kundërligjshmërisë së veprës, ka lidhje me psikikën e autorit të veprës penale.

E drejta jonë penale, subjektet e figurës së veprës penale i ndan në tre kategori;

- Subjekt i përgjithshëm, i cili është personi që ka mbushur moshën e kërkuar nga ligji dhe është i përgjegjshëm.
- Subjekt i posaçëm, i cili është ai person që përveç kushteve të parashikuara tek subjekti i përgjithshëm si mosha dhe përgjegjshmëria, ka dhe disa cilësi të veçanta të përcaktuara në dispozitat e pjesës së posaçme të Kodit Penal. Janë këto cilësi që duhet t'i përdorë autori gjatë kryerjes së veprës penale. Mungesa e këtyre cilësive të subjektit e cilëson veprën penale sipas një dispozite tjetër. Janë pikërisht këto cilësi që e dallojnë subjektin e posaçëm nga subjekti i përgjithshëm. Për shëmbull dispozita e nenit 96 të Kodit Penal "Mjekimi i pakujdesshëm", subjekti kësaj vepre penale është i posaçëm, janë këto cilësi të veçanta që i përdor në kryerjen e veprës penale, mjeku, personeli mjekësor, etj. Kodi Penal i Rrepublikës së Shqipërisë përmban një sërë dispozitash të cilat kërkojnë një subjekt të posaçëm.

Që këtej arrihet në përfundimin se subjekti i posaçëm mund të jetë edhe subjekt i përgjithshëm, kurse e kundërta nuk mund të ndodh.

- Personat juridikë, në ndryshimet e fundit të Kodit Penal me ligjin Nr.2975, datë 16.09.2004 në dispozitën e nenit 45, ku është parashikuar dhe përgjegjësia e personave juridikë.

E drejta penale subjektet e figurës së veprës penale i ndan edhe në subjekte aktive edhe në subjekte pasive. Subjekti aktiv është autori i vrprës penale. subjekti aktiv mund të jetë çdo person fizik pavarësisht moshës apo gjinisë, port ë drejtës sonë penale i intreson ai subjekt aktiv që ka mbushur moshën dhe që është i përgjegjshëm. Subjekti pasiv është viktima e veprës penale. Me studimin e viktimave merret ajo pjesë e kriminologjisë e cila quhet viktimologji.

ANA SUBJEKTIVE E FIGURËS SË VEPRËS PENALE.

Edhe ana objektive është element kryesor dhe i domosdoshëm i figurës së veprës penale, e cila përfaqëson pjesën e brendëshme të saj, atë që nuk duket. Ajo përmban dhe shpreh qëndrimin psikik të personit ndaj veprimit ose mosveprimit shoqërisht të rrezikshëm dhe pasojave të ardhura ose që rrezikojnë të vijnë prej tyre në sjelljen e autorit të veprës penale.

Ana subjektive e figurës së veprës penale zbulohet e qartësohet edhe nëpërmjet anës objektive të saj. Kjo, pasi proceset e brendëshme psikike dhe psikologjike, jo vetëm që ngacmohen nga faktorë të jashtëm, por edhe materializohen në veprimtarinë kriminale gjatë dhe nëpërmjet procesit të zhvillimit të anës objektive.

Duke trajtuar anën subjektive, Gjykata e Lartë shprehet se "në çdo rast, për të arritur në zbulimin e anës subjektive të personit i cili kryen një vepër penale e sidomos për dashjen në vrasje, duhet të merren të dhëna e të provohet ajo duke u bazuar në rrethanat që kanë ekzistuar e nxitur për kryerjen e veprës si dhe në provat e tjera që merren gjatë shqyrtimit gjyqësor"[81].

Kur flasim për anën subjektive të figurës së veprës penale, kemi parasysh sidomos elementët përbërës të saj, fajin, motivet dhe qëllimin, përmes të cilave shprehet dhe zbulohet qëndrimi psikik, ashtu edhe elementë të tjerë të lidhur me to, si lajthitja, rasti fatkeq dhe papërgjegjshmëria e cila studiohet në kuadër të anës subjektive.

Rëndësia e studimit të anës subjektive të figurës së veprës penale është parësore në këto drejtime. Së pari, shërben për të përcaktuar përgjegjësinë penale, në se ekziston ose jo vepra penale në një rast ku shfaqen elementët e jashtëm të saj. Së dyti, ka rëndësi vendimtare për të përcaktuar cilësimin ligjor të figurave të ngjashme të veprave penale, për të cilat kryhen forma të ndryshme faji. Së treti, ka rëndësi për caktimin e dënimit, pasi format e fajita, natyra e motiveve dhe qëllimi ndikojnë në shkallën e rrezikshmërisë. Për shëmbull, kryerja e veprës penale për motive të dobëta përbën rrethanë rënduese, kurse kryerja e saj e shtyrë nga motive me vlera pozitive morale e shoqërore është rrethanë lehtësuese.

Është pranuar tashmë që, si rregull, veprat penale që kryhen me dashje, paraqesin shkallë rrezikshmërie se ato të cilat kryhen nga pakujdesia. Po kështu, veprat penale të cilat kryhen me dashje të drejtpërdrejtë, si rregull, paraqesin shkallë rrezikshmërie më të lartë se ato që kryhen me dashje indirekte. Edhe në rastin e veprave penale të cilat kryhen nga pakujdesia , është pranuar që veprat penale që kryhen nga pakujdesia në formën e mëndjelehtësisë (vetbesimit të tepruar), si rregull, paraqesin shkallë më të lartë rrezikshmërie shoqërore se ato të cilat kryhen me pakujdesi në formën e neglizhencës.

Ky përshkallëzim merrë rëndësipraktike, pasi vlen për gjykatën për të bërë diferencimin, jo vetëm logjik, por edhe shkencor të llojeve dhe masës së dënimeve, që caktohen ndaj autorëve të veprave penale, të kryera me forma të ndryshme faji dhe me nënforma të ndryshme të së njëjtës prej dy formave kryesore të fajit të cilat u përmëndën më lart.

[81] Vendimi nr.11, datë 25.06.2002, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

Faji , si element kryesor i veprës penale, parashikohet në nenin 14 parag 1 të Kodit Penal, sipas të cilit askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si vepër penale, nëse vepra nuk është kryer me faj. Kodi Penal nuk e jep kuptimin e fajita, por jep format e fajita dhe përmbajtjen e tyre, duke përcaktuar se quhet me faj personi i cili kryen veprën me dashje ose nga pakujdesia. Kuptimi i fajit jepet nga teoria e së drejtës penale nëpërmjet analizës së formave të tij, duke arritur nga të veçantat në të përgjithshmen. Faji përkufizohet si qëndrimi psikik që mban personi ndaj veprimit ose mosveprimit të kundërligjshëm dhe pasojave të dëmshme. Fajësia ose mungesa e saj në kryerjen e veprës penale vlerësohet nga gjykata dhe deklarohet në vendimin e saj përfundimtar.

Kodi Penal parashikon dy forma faji në kryerjen e veprës penale, dashjen dhe pakujdesinë. Dashja ndahet në dashje direkte ose të drejtpërdrejtë dhe në dashje indirekte, ose eventuale, ndërsa pakujdesia ndahet në pakujdesi në formën e vetbesimit të tepruar dhe pakujdesi në formën e neglizhencës.

Dashja shfaqet ose përbëhet nga dy pjesë që dallohen nga qëndrimi psikik i personit ndaj pasojës, e cila shërben si bazë për ndarjen e saj në dy lloje , direkte dhe indirekte.

Dashja direkte ose e drejtpërdrejtë ekziston kur personi parashikon pasojat e veprës penale dhe dëshiron ardhjen e tyre. Dallimi i dashjes direkte nga dashja indirekte ka rëndësi teorike dhe praktike që qëndron në dy drejtime kryesore. E para, sepse është një pjesë e konsiderueshme e veprave penale të parashikuara në Kodin Penal, veçanërisht krime që kryhen vetëm me dashje direkte, si figura e veprës penale të genocidit dhe figura e veprës penale të krimet kundër njerëzimit të cilat zhvillohen sipas një plani të paramenduar[82]. E dyta dashja direkte është forma më e lartë e fajita e cila mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e dënimit ndaj autorëve të veprave penale.

Dashja indirekte ose eventuale ekziston atëhere kur personi, megjithëse i parashikon dhe nuk i dëshiron pasojat, me ndërgjegje lejon ardhjen e tyre. Dashja indirekte dallohet nga dashja direkte nga tre moment, dallimi i parë lidhet me vullnetin. Dallimi i dytë qëndron në faktin se në dashjen direkte personi vepron për ardhjen e pasojës së dëshiruar prej tij ndërsa në dashjen indirekte lejon ardhjen e saj. Dallimi i tretë ka të bëjë me momentin intelektual, me sigurinë e parashikimit të ardhjes së pasojës.

Teoria e së drejtës penale njeh edhe disa forma të tjera dashjeje, të cilat në një mënyrë apo në një tjetër, janë variante të dashjes direkte ose indirekte, të formave më të precizuara të tyre. Këto forma janë;

Dashja e menjëherëshme ose e paramenduar (*dolus repentinus)* me të cilën kuptohet rastet kur mendimi përkryerjen e veprës vijnë aty për aty dhe personi vepron menjëherë për realizimin e saj, për shëmbull, vrasja e ndodhur në grindje e sipër.

Dashje e paramenduar (*dolus praemeditatus)* ekziston në ato raste kur mendimi kriminal për kryerjen e veprës lind kohë përpara kryerjes së saj, kur mendimi përpunohet, merren masa

[82] J.Xhafo., E Drejta Penale Ndërkombëtare, Tiranë 2009, fq.53

përgatitore dhe pastaj kryhet vepra me gjakftohtësi, për shëmbull vrasja me paramendim apo krimet e kryera në bashkëpunim.

Dashje e përcaktuar (*dolus determinatus)* ekziston atëhere kur personi ka identifikuar pasojen dhe dëshiron ta arrijë, e cila mund të jetë e vetme ose alternative.

Dashje e papërcaktuar (*dolus ideterminatus)* është ajo kur personi parashikon se me veprimin ose mosveprimin e tij do të vijë pasoja, pa i konkretizuar ato dhe duke dëshiruar ardhjen e secilës prej tyre veç e veç ose së bashku.

PAKUJDESIA, SI FORMË FAJI.

Vepra penale kryhet me pakujdesi kur personi, megjithëse nuk i dëshiron pasojat, e parashikon mundësinë e ardhjes së tyre dhe me mëndjelehtësi shpreson t'i shmangë ato, ose nuk i prashikon, megjithëse sipas rrethanave duhet dhe kishte mundësi ti parashikonte. Pakujdesia si dhe dashja përbëhet nga dy pjesë që i dallon qëndrimi i ndryshëm psikik i personit ndaj veprimit ose mosveprimit shoqërisht të rrezikshëm.

Vetbesimi i tepruar ekziston vetëm atëhere kur personi e parashikon mundësinë e ardhjes së pasojave, nuk i dëshiron ato por me mëndjelehtësi mendon se do t'i shmangë. Dallimi kryesor ndërmjet pakujdesisë me vetbesimin e tepruar dhe dashjes indirekte është mënyra e të menduarit rreth pasojave të mundshme të cilat mund t'i parandalojë ato. Shkalla dhe karakteri i parashikimt të pasojave në pakujdesi me vetbesim të tepruar nuk janë as të barabarta dhe nas të njëjta me ato të dashjes indirekte. Dallim tjetër përbën edhe shkalla e dëshirës lidhur me mosardhjen e pasojës. Pakujdesia në formën e vetbesimit të tepruar është karakteristikë e veprave penale të shkeljeve të rregullave të mbrojtjes në punë, të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, etj.

Neglizhenca ekziston atëhere kur personi nuk e parashikon mundësinë e ardhjes së pasojave, megjithëse sipas rrethanave duhej të kishte mundësi t'i parashikonte. Përgjegjësia penale ekziston në ato raste kur personi i ka aftësitë për të parshikuar pasojat e veprimeve ose mosveprimeve të tij, kur nuk ka rrethana objektive penguese në këtë veprim.

Ekzistenca e neglizhencës lidhet me detyrimin e personit për t'i parashikuar pasojat dhe me mundësinë e parashikimit. Kodi Penal përmban disa figura veprash penale të cilat kryhen vetëm me pakujdesi në formën e neglizhencës, si mjekimi i pakujdesshëm ose humbja e disa dokumentave sekrete, ndërsa shumica e figurave të veprave penale të cilat parashikohen në Kodin Penal zhvillohen me të dy format e pakujdesisë.

FORMA E NDËRLIKUAR E FAJIT

Forma e ndërlikuar e fajita është një rast përjashtimor, ku qëndrimi psikik i personit ndaj pasojave të afërta dhe të largëta është i ndryshëm. Ai parashikon se me veprimin e tij do të vijë

domosdoshmërisht ardhja e pasojës së afërt dhe vepron me dashje direkte për ardhjen e saj. Por në vënd të saj vjen një pasojë tjetër, pasoja më e largët të cilën personi nuk e ka dëshiruar.

Kodi Penal parashikon një figurë vepre penale të tillë e cila është e parashikuar në dispozitën e nenit 88 paragrafi 2, e cila është plagosja e rëndë me dashje e cila ka sjellë si pasojë vdekjen.

Rasti fatkeq është kur në kryerjen e veprës penale nga personi nuk vërtetohet asnjë formë fajsie, domethënë kur vepra kryhet pa faj ngjarja quhet rast fatkeq. Këtu mungon lidhja shkakësore midis sjelljes së personit dhe pasojës së ardhur prej saj. Ai në rrethanat e ndodhjes së ngjarjes, objektivisht nuk ka patur mundësi ta parashikonte dhe as ishte i detyruar ta parashikonte atë, rasti fatkeq e përjashton përgjegjësinë penale të autorit të veprës.

GABIMI (LAJTHITJA)

Gabim ose lajthitje në të drejtën penale quhet përfytyrimi ose vlerësimi i gabuar që i bën autori veprës penale, sjelljes së tij, pasojave dhe fakteve të lidhura me kryerjen e veprës, me fjalë të tjera, gabimi është vlerësimi i gabuar nga personi i rrethanave subjektive ose i elementëve objektiv të veprës penale. Gabimet ndahen në gabim juridik dhe gabim në fakt.

Gabim juridik (*error juris)* qëndron në përfytyrimin e gabuar të personit lidhur me tiparet juridike të veprës, me dënimin ose rrethanat e zbatimit të tij. Gabimi juridik mund të bëhet në drejtim të faktit nëse vepra penale parashikohet ose jo nga ligji si vepër penale.

Gabim në fakt (*error facti)* i cili quhet ndryshe edhe gabim real konsiston në përfytyrimin e gabuar të personit për faktet që lidhen me tiparet e jashtëme të figurës së veprës penale dhe me elementët kryesor ose dytësor të anës objektive të saj. Gabimi në fakt ndahet në gabim në objekt dhe gabim në lidhjen shkakësore. Gabimi në objekt kupton përfytyrimin e gabuar të lidhur me marrëdhënien juridiko-penale që cënon veprimin ose mosveprimin e tij. Gabimi në lidhjen shkakësore qëndron në përfytyrimin të gabuar të personit mbi procesin e zhvillimit të veprimeve ose mosveprimeve dhe të pasojave të ardhura prej tyre. Gabimi në lidhjen shkakësore bëhet në rastin kur perësoni kujton se procesi kriminal ka ecur në rrugën e duhur dhe se ka ardhur pasoja e dëshiruar, ndërsa në të vërtetë pasoja nuk ka ardhur.

Pikërisht, këto të katër tipare ose element, janë ato tipare ose element, ekzistenca e të cilave bëjnë që një vepër e caktuar (veprim ose mosveprim) të karakterizohet ose të quhet, vepër penale (krim apo kundravajtje penale).

Duhet patur mirë parasysh fakti se, të katër këto tipare, janë njëlloj të domosdoshëm për ekzistencën e figurës së veprës penale dhe nuk mund të thuhet se njëri apo disa prej tyre janë më shumë ose më pak të rëndësishëm se të tjerët. Pikërisht, kjo është edhe arsyeja që në përkufizimin teorik i cili u dha më sipër, për kuptimin e figurës së veprës penale, u theksua

shprehja "..tërësia e elementëve objektivë dhe subjektive, të cilat të marra së bashku, karakterizojnë një vepër të caktuar si vepër penale".

Mungesa qoftë edhe e njërit prej këtyre elementëve, në veprën e një personi bën që kjo vepër të mos konsiderohet vepër penale. Për shëmbull;

- Të qëllosh mbi kufomën e një njeriu (hasmit), kur e di që ai është vrarë nga dikush tjetër më parë.
- Vrasja e A-së nga rrufeja.
- Vrasja e A-së nga një fëmijë 12 vjeç.
- Vdekja e një personi gjatë operacionit (kur nuk ndodhemi para shkeljeve nga ana e mjekut, të cilat përbëjnë figurën e krimit të mjekimit të pakujdesshëm, e cila parashikohet në dispozitën e nenit 96 të Kodit Penal).

Në secilin nga këto raste, megjithëse ndodhemi para një pasoje të dëmshme, nuk ndodhemi para ndonjë figure të veprës penale. Për pasojë, nuk mund të vihet askush përpara përgjegjësisë penale. Punonjësi praktik i organeve të dretësisë, (policisë gjyqësore, prokurorisë, gjykatës dhe avokati) në çdo rast konkret kur ndodhet përpara shqyrtimit të një fakti ose të një vepre, nga pikëpamja metodiko-dialaktike, duhet të bëjë skemën e katër elementëve përbërës të figurës së veprës penale dhe, mbas kësaj, duke patur parasysh materialin faktik e rrethanat për rastin përpara të cilit ndodhet, të thellohet për të kërkuar ose gjetur nëse në këtë material faktik, të këtij rasti konkret, janë apo nuk janë të katër elementët përbërës të figurës së veprës penale.

U tha më lart se, objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive janë të katër elementët përbërës të domosdoshëm të figurës së veprës penale. Theksohet fjala të domosdoshëm pasi ato, që të katërta, siç u tha duhet të ekzistojne dhe të gjënden patjetër në çdo figurë të veprës penale. Në figurat e përgjithëshme të veprave penale, të cilat parashikohen në pjesën e posaçme të Kodit Penal, për shëmbull veprat penale kundër personit, veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, krimet kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues etj, ashtu edhe në figurat konkrete të veprës penale, për shëmbull vrasja e kryer me dashje neni 74 i Kodit Penal, vjedhja e pasurisë neni 134 i Kodit Penal, dorëzimi i territorit neni 208 i Kodit Penal, etj, ato nuk gjënden të pasqyruara në mënyrë të shprehur. Saktësisht të shprehura, apo edhe të nënkuptuara, ato pasqyrohen në dispozitat konkrete të çdo kreu apo seksioni të pjesës së posaçme të Kodit Penal.

KREU III

ANA OBJEKTIVE E FIGURËS SË VEPRËS PENALE. KUPTIMI DHE ELEMENTËT PËRBËRËS. VEPRIMI OSE MOSVEPRIMI SI ELEMENT I ANËS OBJEKTIVE TË FIGURËS SË VEPRËS PENALE

3.1 Ndarja e elementeve përbërës të anës objektive të figurës së veprës penale.

Megjithëse, pranohet që ana objektive është, grumbullimi i tipareve[83] që, në tërësinë e tyre, përbëjnë anën e jashtëme të veprës penale, jo të gjithë autorët e teksteve të së drejtës penale e përmendin grumbullin, tërësinë e këtyre tipareve në të njëjtën mënyrë dhe rradhë. Predominon pikëpamja se, elementët përbërës të anës objektive të figurës së veprës penale grupohen në dy kategori.

Në kategorine e pare, bëjnë pjesë elementë të tillë si: veprimi ose mosveprimi, rrezikshmëria shoqërore e tij, kundërligjshmëria, pasoja e dëmshme shoqërisht e rrezikshme dhe lidhja që ekziston midis veprimit ose mosveprimit shoqërisht të rrezikshëm dhe pasojës, lidhje që e emërtojnë lidhje shkakësore apo kauzale.

Përsa i përket pasojës duhet sqaruar se ky element, bën pjesë në kategorinë e parë të elementëve të figurës së veprës penale vetëm në ato figura, në të cilat për t'u konsideruar të konsumuara pra të kryera plotësisht, kërkohet medoemos që të jenë vërtetuar, të ketë ardhur edhe pasoja e dëmshme, shoqërisht e rrezikëshme. Elementët e kësaj kategorie quhen element të domosdoshëm përbërës të anës objektive të figurës së veprës penale. Më pas do të trajtoj rastet kur edhe pasoja konsiderohet element i domosdoshëm përbërës i figurës së veprës penale.

Në kategorinë e dytë bëjnë pjesë element të tillë si: koha e kryerjes së veprimit ose mosveprimit, vëndi, mënyra, mjetet e përdorura dhe, në disa raste sikundër u tha edhe pasoja. Këto, si rregull, quhen elementë jo të domosdoshëm të anës objektive të figurës së veprës penale. Thuhet, si rregull, pasi në disa figura veprash penale, konkretisht në ato figura në të cilat, në pjesën përshkruese të dispozitivit të tyre, kërkohet në formë të shprehur, prania e këtyre elementëve, për këto figura veprash penale, edhe ato janë element të domosdoshëm përbërës të tyre. Marrim si shëmbull elementin mënyrë si element i anës objektive të figurës së krimit të vrasjes më dashje në rrethana të tjera cilësuese, që parshikohet në dispozitën e nenit 79/e dhe ë të Kodit Penal. Në dispozitën e nenit 79 të Kodit Penal, në të cilën parashikohet figura e krimit të vrasjes në rrethana të tjera cilësuese, në shkronjat "e" dhe "ë" të saj, parashikohet përkatësisht,

[83] E Drejta Penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Pjesa e Përgjithshme, grup autorësh, Tiranë 1982, fq 97

vrasja me dashje e kryer në mënyrë të tillë që i shkakton mundime të veçanta viktimës (shkronja "e"), dhe vrasja me dashje e kryer në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave (shkronja "ë").

Nga interpretimi që i bëhet në tërësi përmbajtjes së kësaj dispozite rezulton që sa herë që gjykatat ndodhen para një vrasjeje të kryer me dashje, në mënyrë të tillë, që i shkakton mundime të veçanta viktimës, vepra do të cilësohet me shkronjën "e" të saj. Kurse, sa herë që ndodhen para një vrasjeje të kryer me dashje, në mënyrë të tillë, që është e rrezikshme për jetën e shumë personave, vepra do të cilësohet me shkronjën "ë" të saj. Sikundër thuhet, të dy rrethanat e mësipërme, që nuk shprehin gjë tjetër veç mënyrës së kryerjes së vrasjes, shërbejnë si rrethana cilësuese, shërbejnë pra, për zbatimin drejt të ligjit penal. Në këto dy raste, mënyra, nga elementët jo i domosdoshëm për anën objektive të figurës së veprës penale, në përgjithësi, shndërrohet në element i domosdoshëm përbërës i anës objektive, pikërisht të figurës së krimit të vrasjes në rrethana të tjera cilësuese që parashikohet në shkronjat "e" dhe "ë" të dispozitës së nenit 79 të Kodit Penal.

Në element të domosdoshëm përbërës të anës objektive të figurës së veprës penale shëndrohet edhe elementi "vënd", në rastin e figurës së veprës penale të ndërprerjes së shtatzanisë e kryer në vënde dhe nga persona të paautorizuar, që parashikohet në dispozitën e nenit 94 të Kodit Penal. Nga interpretimi që i bëhet kësaj dispozite, veç rrethanave të tjera që kanë të bëjnë me subjektin e veprës penale (personin i cili nuk është mjek), apo kohën (tej kohës së lejueshme për ndërprerje), vëndi, ndërprerja e shtatzanisë jo në ambjentet spitalore publike apo klinika private të lejuara posaçërisht, përbën rrethanë (element të anës objektive) të domosdoshëm të anës objektive të kësaj figure vepre penale, si njëra prej rrethanave prania e së cilës dikton domosdoshmërisht cilësimin ligjor të veprës pikërisht me këtë dispozitë të pjesës së posaçme të Kodit Penal.

Teoria e së drejtës penale, elementët e figurës së veprës penale i ndanë në:

a. Elementë të domosdoshëm dhe,
b. Elementë jo të domosdoshëm

Është më drejtë dhe më saktë të thuhet se, elementët e figurës së veprës penale të kategorizohen në[84]:

- Elementë të përgjithshëm, të domosdoshëm të figurës së veprës penale.
- Elementë të veçantë, të domosdoshëm të figurës së veprës penale.

Kjo, për arsye të cilat u përmëndën, kur u zhvillua trajtimi teorik i detajuar i çdo njërit prej katër elementëve të figurës së veprës penale, (objektit, anës objektive, subjektit dhe anës

[84] S.Spiro., Cikël leksionesh, "Ana Objekti I Figurës së Veprës Penale", UET, Tiranë 2008, Fq. 3

subjektive). Elementët që u përmendën si, vëndi, koha, pasojat, motivi, qëllimi etj, dhe të cilët u quajtën si jo të domosdoshëm, në vetvete janë element përbërës të domosdoshëm të ndonjërit prej katër elementëve përbërës të domosdoshëm të figurës së veprës penale, në ato raste kur në vetë dispozitën konkrete të pjesës së posaçme të Kodit Penal, ekzistenca e tyre, për të patur figurën konkrete të veprës penale që parashikohet prej saj, kërkohen në formë saktësisht të shprehur. Kështu për shëmbull, vëndi, si element i anës objektive të figurës së veprës penale parashikohet në nenet 94 (Ndërprerja e shtatzanisë e kryer në vënde dhe nga persona të paautorizuar), 107 (Marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale në vënde publike) etj, të Kodit Penal. Koha, si element i anës objektive të figurës së veprës penale përmendet në nenin 94 (Ndërprerja e shtatëzanisë e kryer në vënde dhe nga persona të paautorizuar) të Kodit Penal. Pasojat, si element i anës objektive të figurës së veprës penale, të cilat përmënden në nenet 87 (Tortura me pasoja të rënda), 97 (Mosdhënia ndihmë), 132 (Shkatërrimi ose dëmtimi i objektit të kultit), 151 (Shkatërrimi i pronës me zjarr) ku element i rëndësishëm është ardhja e pasojave të rënda materiale, 290 (Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor), nëse nuk janë sjellë pasojat e kërkuara në këtë dispozitë atëhere nuk jemi përpara kësaj figure krimi, dhe nëse jemi përballë shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor por nuk kanë ardhur pasojat, personi do të përgjigjet administrativisht, etj të Kodit Penal. Qëllimi, si element i anës subjektive të figurës së veprës penale, të cilat përmendën në nenet 73 (Genocidi), 114 (Shfrytëzimi i prostitucionit), 119 (Fyerja), 120 (Shpifja), 128\b (Trafikimi i të miturve), 214 (Sigurimi i informatave), etj të Kodit Penal. Motivi, si element përbërës i figurës së veprës penale, në nenin 74 (Krime kundër njerëzimit), etj të Kodit Penal.

Domosdoshmëria e ekzistencës së këtyre elementëve, të cilët më lart i quajtëm elementë të veçantë përbërës të figurës së veprës penale, në shumë raste, del e shprehur nga vet përmbajtja e dispozitës së posaçme të Kodit Penal, ku parashikohet figura konkrete e veprës penale. Në disa të tjera megjithëse nuk thuhet shprehimisht, del nga interpretimi që i bëhet dispozitës, dhe këtë e bën doktrina, teoria e pjesës së posaçme të së drejtës penale.

Në shumë dispozita të pjesës së posaçme të Kodit Penal, në mënyrë të shprehur për ekzistencën e njërës apo tjetrës figurë të veprës penale, ligjvënësi ka kërkuar se duhet të ekzistojnë element të veçantë përbërës të figurës së veprës penale dhe sidomos të subjektit dhe anës objektive të figurës së veprës penale. Për shëmbull, subjekti, si element i figurës së veprës penale përmëndet në nenet 94 (Ndërprerja e shtatëzanisë e kryer në vënde dhe nga persona të paautorizuar), 97 (Mosdhënia ndihmë), 98 (Mosdhënia e ndihmës nga kapiteni i anijes), 105 (Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën), 106 (Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën) etj të Kodit Penal. Ana objektive, si element i figurës së veprës penale përmendet në nenet 122 (Përhapja e sekreteve vetiake), 124 (Braktisja e fëmijëve të mitur), 139 (Vjedhja me dhunë), 140 (Vjedhja me armë), 141 (Vjedhja me pasojë vdekjen), 143 (Mashtrimi) etj të Kodit Penal.

Nga ana tjetër, ndikimi i elementëve të anës objektive në anën subjektive, në sjelljen e personit, është i padiskutueshëm. Motivet dhe qëllimi i figurës së veprës penale, vazhdimi apo tërheqja nga kryerja e saj përcaktohen nga rrethanat objektive. Mundësitë për arritjen e rezultatit kriminal nuk varen thjesht nga dëshira e personit, e cila ngelet dëshirë në trurin e tij, nëse rrethanat objektive ku zhvillohet veprimi e bëjnë të pamundur realizimin e saj. Për më tepër celementët e anës subjektive marrin vlera në të drejtën penale vetëm kur materializohen, kur shfaqen nëpërmjet elementëve të anës objektive të figurës së veprës penale.

Rëndësia e anës objektive qëndron jo vetëm në faktin se ajo është element përbërës i domosdoshëm i veprës penale, pa të cilin nuk ka figurë vepre penale por edhe për shmangien e gabimeve në caktimin e kufijëve të përgjegjësisë penale, zgjerimin ose kufizimin e padrejtë të kësaj përgjegjësie, për dallimin e një figure nga figura tjetër, për cilësimin ligjor si dhe për vlerësimin e shkalllës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe të autorit të saj. Kështu, figurat e ndryshme të krimit të vjedhjes së pasurisë dallohen nga elementët e anës objektive të secilës, nga mënyra, mjetet, pasojat.

Lidhur me rëndësinë e anës objektive në cilësimin ligjor të veprës, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arsyetojnë: "..çmojnë se veprimet e të gjykuarit, përbëjnë figurën e krimit të rrëmbimit të personit dhe jo atë të përkrahjes së autorit të krimit, parashikuar nga neni 302 i Kodit Penal. Sipas kësaj dispozite, përkrahja e autorit të krimit lidhet me veprime të kryera në favor të tij, pasi të ketë përfundiuar veprën penale dhe të ketë arritur qëllimin kriminal. Nga ana objektive kryerja e kësaj vepre realizohet nëpërmjet furnizimit të autorit me ushqime, apo mjete të tjera, sigurim banese ose vënd qëndrimi me qëllim që personi i cili ka kryer një krim, t'i shpëtojë arrestimit ose kapjes së tij. Sikurëse shihet, për të konsumuar këtë figurë vepre penale kërkohet që autori të kryerjes së një krim t'i jepet ndihmë me qëllim që të pengohet kapja ose arrestimi i tij"[85].

Ana objektive formohet nga bashkimi në një të tërë i hallkave përbërëse të veprimtarisë kriminale, e cila zhvillohet në kohë dhe në hapsirë. Në këtë bashkim elementësh dhe tiparësh të paraqitjes së jashtme të veprave penale, të domosdoshëm për çdo figurë vepre penale konkrete, dallohen disa elementë të rëndësishëm.

Koha si element përbërës i anës objektive të figurës së veprës penale.

Dihet që çdo vepër penale kryhet në një kohë të dhënë. Por elementi kohës jo gjithmonë ka rëndësi në të drejtën penale. Ai merr rëndësi të posaçme, së pari në rastet kur ka të bëjë me veprimin e ligjit penal dhe së dyti, kur në përmbajtjen e vetë dispozitës së pjesës së posaçme në

[85] Vendimi unifikues nr.2, datë 29.01.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

të cilën parashikohet figura e veprës penale, kërkohet si element i anës objektive të figurës së veprës penale.

Përsa i përket veprimit të ligjit penal, në dispozitën e nenit 3 të Kodit Penal, që titullohet "Veprimi në kohë i ligjit penal", ka gjetur sanksionin njëri prej formave të rëndësishëm të së Drejtës Penale, sikurëse është ai i zbatimit të ligjit të kohës. Janë sanksionuar gjithashtu, edhe rastet e fuqisë prapavepruese të ligjit penal.

Në këtë dispozitë sanksionohet se askush nuk mund të dënohet për një vepër që, sipas ligjit të kohës kur është kryer, nuk përbënte vepër penale. Sanksionohet gjithashtu se, ligji i ri i cili nuk e dënon veprën penale ka fuqi prapavepruese dhe, në rast se personi është dënuar, ekzekutimi i dënimit nuk mund të fillojë dhe, nëse ka filluar, pushon si dhe kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të dryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorëshme për personin që ka kryer veprën penale.

Disa figura të tjera konkrete veprash penale të Kodit Penal të cilat në përmbajtjen e tyre kanë si element përbërës të anës objektive të tyre, elementin kohë:

Neni 77: vrasja me dashje që paraprin, shoqëron…..ose pason një krim tjetër.

Neni 81: menjëherë pas lindjes.

Neni 83: kapërcimi i kufijve të mbrojtjes së nevojshme.

Neni 88: ka qënë e rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit të saj .

Neni 89: paaftësi të përkohëshme më tepër se nënt ditë.

Neni 90\2: paaftësi të përkohëshme deri në nëntë ditë.

Neni 94: tej kohës së lejueshme për ndërprerje.

Neni 109\a: lirohet vullnetarisht para mbarimit të shtatë ditëve nga rrëmbimi.

Neni 166: emëtimi i parregullt i aksioneve bërë përpara regjistrimit të Shoqërisë.

Neni 180: kur më parë janë marrë masa administrative.

Neni 181\a: moskryerja e detyrave që lidhen me vjeljen brënda afatit ligjor të taksave dhe tatimeve.

Neni 204: peshkimi në kohë….të ndaluar.

Neni 205: prerja apo dëmtimi i pyjeve pa leje në kohë….të ndaluar.

Neni 206\2 prerja e drurëve në pemtore, ullishta e vreshta, pasi është refuzuar më parë leja e prerjes nga organet kompetente.

Neni 249: kryerja e funksionit pas dhënies fund të tij.

Neni 252: mbajtja në burg pa vendim të organit kompetent tej afatit të caktuar në vendim apo në ligj.

Neni 257: përfitimi i paligjshëm i interesave nga persona me funksione shtetërore apo shërbimi publik në një ndërmarrje ose operacion, në të cilat në momentin e kryerjes së veprimit ka pasur detyrën e mbikqyrjes, administrimit ose likujdimit.

Neni 262: organizimi i grumbullimeve dhe i manifestimeve pa marrë më parë leje nga organi kompetent.

Neni 304\1: mosparaqitja menjëherë për të kallzuar ose dëshmuar para organeve të prokurorisë, gjykatës apo organeve të rendit për provën e pafajsisë.

Vendi, si element përbërës i anës objektive të figurës së veprës penale.

Sikurëse me kohën, dihet që çdo vepër penale, pavarësisht llojit dhe natyrës së saj ndodh në një vënd të caktuar. Megjithatë, edhe pse në të gjitha rastet, kur organet e procedimit penal ndodhen përpara një vepre penale duhet të përcaktojnë, veç të tjerave edhe vëndin në të cilin ajo ka ndodhur, jo gjithmonë, ky element, si vëndi merr vlera të veçanta, apo thënë ndryshe ka rëndësi juridike.

Ashtu si edhe koha, vëndi ka rëndësi juridike dhe trajtohet si e tillë, në të Drejtën Penale, kur bëhet fjalë për zbatimin e ligjit penal, për shtrirjen e fakteve të tij, në aspektin territorial.

Në një dispozitë të posaçme të Kodit Penal, në nenin 5 (Territori i Republikës së Shqipërisë), i jepet kuptimi juridiko-penal i territorit të Republikës së Shqipërisë për vepra penale të kryera brënda të cilit (shtetas shqipëtar, shtetas të huaj apo persona pa shtetësi) zbatohet ligji penal shqipëtar. Sipas kësaj dispozite, territori Republikës së Shqipërisë në kuptim të ligjit penal, quhet hapësira tokësore, gjërësia e ujrave territorial dhe të brendëshme detare, hapsira ajrore e cila shtrihet mbi hapsirën toksore dhe të ujrave territorial dhe të brendëshme detare, si dhe çdo vënd tjetër ku shtrihet sovraniteti i shtetit shqipëtar, si selitë e përfaqësive diplomatike

dhe konsullore shqipëtare, anije që mbajnë flamurin e Republikës së Shqipërisë, anijet e marinës luftarake, të aviacionit ushtarak ose civil kudo që ndodhen.

Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm dhe për shtetasin shqiptar i cili kryen një krim në territorin e një shteti tjetër, në rastet e parashikuara në nenin 7\2 (Zbatimi i ligjit penal për vepra penale të kryera nga shtetas të huaj) të Kodit Penal dhe kur ndodhemi para veprave penale që përfshihen në juridiksionin universal, që parashikohet në nenin 7\a (Juridiksioni universal) të këtij Kodi.

Mënyra, si element i anës objektive të figurës së veprës penale.

Mënyra e kryerjes së veprës penale, ashtu si edhe disa prej elementëve të tjerë të anës objektive të figurës së veprës penale të cilat u trajtuan në pjesën e mëparshme të temës si vëndi, koha, mjetet dhe pasojat, megjithëse si element përbërës i anës objektive të figurës së veprës penale, nuk është element përbërës, i domosdoshëm i anës objektive të figurës së veprës penale, për të gjitha llojet e figurave të veprave penale, të cilat parashikohen në pjesën e posaçmë të Kodit Penal. Edhe mënyra e kryerjes së veprës penale, shndërrohet në element të domosdoshëm përbërës të anës objektive, vetëm në rastet kur, në vetë dispozitën përkatëse të pjesës së posaçme të Kodit Penal, në të cilën parashikohet figura konkrete e veprës penale, përcaktohet në mënyrë të shprehur edhe mënyra e kryerjes së veprës, si njëri prej elementëve, të domosdoshëm, përbërës të anës objektive të saj.

Por, para se, sa u tha më lart, të ilustrohej më shëmbuj, dispozita konkrete të marrë nga pjesa e posaçme e Kodit Penal, mendoj që në formë të përmbledhur, të hedh disa konsiderata, lidhur me kuptimin që ka në të drejtën penale, mënyra e kryerjes së veprës penale. Në teorinë e së Drejtës Penale vetë ana objektive e figurës së veprës penale, nuk është gjë tjetër, veçse ai element i figurës së veprës penale, i cili në vetvete paraqet procesin e zhvillimit të rrugës që ndjek autori i veprës penale, që në momentin e kryerjes së veprimit ose mosveprimit, shoqërisht të rrezikshëm dhe të kundraligjshëm, deri në konstatimin e pasojës që vjen apo duhej të vinte prej tij.

Ana objektive paraqet në vetvete procesin e zhvillimit të sulmit kriminal, që bëhet kundër raporteve shoqërore të rëndësishme. Ajo paraqet sulmin criminal, të shqyrtuar nga ana e tij e jashtëme, nga pikëpamja e zhvillimit gradual ose konseguent të ngjarjeve dhe të fenomeneve të cilat fillojnë të vihen në lëvizje, me kryerjen nga ana e subjektit, të veprimit ose të mosveprimit dhe përfundojnë me ardhjen e një rezultati të caktuar Kriminal[86].

[86] E Drejta Penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Pjesa e Përgjithshme, grup autorësh, G.Gjika, Tiranë 1982, fq 96

Mjeti si element përbërës i anës objektive të figurës së veprës penale.

Edhe mjetet të cilat përdoren për kryerjen e veprave penale, e Drejta Penale i quan element të anës objektive të figurës në përgjithësi.

Veç kësaj e Drejta Penale, mjetet i trajton posaçërisht në disa aspekte. Në disa raste, sikurse për shëmbull, në dispozitat e neneve 80 (…sigurimi i kushteve dhe i mjeteve material….) dhe 142 (Sigurimi i mjeteve për vjedhje) të Kodit Penal, mjetet për shkak të shkallës së lartë të rrezikshmërisë shoqërore që paraqesin veprat penale, për kryerjen e të cilave ato do të përdoren në të ardhmen, për ligjvënësin kanë shërbyer si faktor bazë që, vetëm veprimet për sigurimin e tyre, t'i konsideroj vepër penale të kryer, të konsumuar plotësisht. Sipas nenit 80 të Kodit Penal, sigurimi i mjeteve materiale për të kryer vrasje, përbën vepër penale (krim). Po kështu edhe, sipas nenit 142 të Kodit Penal, sigurimi i mjeteve material për të vjedhur pasurinë përbën vepër penale pra krim.

Mjeti në disa raste, ka shërbyer për ligjvënësin, si kriter për të parashikuar si figurë vepre penale më vete, figura të veçanta veprash penale, brënda të njëjtit lloj vepre penale. Kështu për shëmbull, veprën penale të shkatërrimit të pronës, e cila parshikohet në seksionin e III-të të kreut të III-të, të pjesës së posaçme të Kodit Penal, ligjvënësi e ka ndarë në disa figura të veçanta krimi, duke përdorur si kriter, veç të tjerave edhe llojin e mjetit që përdoret për shkatërrimin apo dëmtimin e pronës. Të tilla janë figurat e krimeve, të shkatërrimit të pronës me zjarr (neni 151), të shkatërrimit të pronës me eksploziv (neni 152), të shkatërrimit të pronës me përmbytje (neni 153) dhe të shkatërrimit të pronës me mjete të tjera (neni 154).

3.2 Kuptimi juridiko-penal i veprimit, si element i anës objektive të figurës së veprës penale.

Veprimi ose mosveprimi në shkencën e së drejtës penale është element përbërës i anës objektive të figurës së veprës penale. Para së gjithash, veprimi ose mosveprimi, është element përbërës, i domosdoshëm, i vetë veprës penale. Pa veprim ose mosveprim, nuk mund të konceptohet vepra penale.

Nisur nga kjo rëndësi dhe interes shkencor, në këtë punim bëhen përpjekje për të evidentuar kuptimin dhe përmbajtjen e veprimit ose mosveprimit, si element i anës objektive të figurës së veprës penale sipas legjislacionit dhe doktrinës juridike penale bashkëkohore. Një analizë e veçantë, behet në këtë kuadër, lidhur me përgjegjësine penale të personave juridike sipas ndryshimeve që solli ligji Nr.9754, date 14.06.2007 "Për Përgjegjesine Penale të Personave

Juridike". Arsyja është se kjo pjesë mbetet më pak e trajtuar për shkak te periudhës relativisht te shkurtër nga çasti i hyrjes në fuqi te ligjit përkates.

Veprimi ose mosveprimi është një prej elementëve te përbashkët që teoria e së drejtës sonë penale jep, si për kuptimin e veprës penale, ashtu edhe për kuptimin e anës objektive të figurës së veprës penale[87].

Sidoqoftë, kuptimi dhe përmbajtja si e veprimit, ashtu dhe e mosveprimit, në aspektin juridiko-penal, është e njëjtë në të dy rastet : si në rastin kur ata trajtohen si elemente të veprës penale, ashtu dhe kur trajtohen si element të anës objektive të figurës së saj.

Në Kodin tonë Penal, sikurse në pjesën më të madhe të kodeve penale demokratike të botës, nuk jepet përkufizimi ligjor i veprës penale (Këtë qëndrim mbajnë, përshëmbull, edhe kodet penale të Francës, Gjermanisë, Zvicrës etj). Ndërsa, në doktrinën juridike penale perëndimore, gjejmë perkufizime të tilla formale për veprën penale si "….. një fakt njërezor te cilin ligji e lidh me një sanksion penal" [88] ose "…..propozohet përcaktimi i krimit si kombinim ose këndvështrim pikëpamjesh morale, sociologjike dhe juridike"[89], së bashku me kundërshtitë perkatëse që i bëhen ketyre pikëpamjeve.

Ka edhe pikëpamje që veprën penale e klasifikojnë "……. në krim, delikt dhe kundëravajtje " [90], ashtu sikurse ndonjë autor tjetër jep përcaktimin formal të veprës penale si "…..sjellje njerëzore, që me ligj është shpallur si vepër penale"[91]. Sipas përkufizimit në kuptimin material, i pranuar më së shumti në të kaluarën, por jo rallë edhe sot, vepra përveç anës formale , duhet të permbajë në sjelljen e autorit edhe rrezikshmërine shoqërore.

Nga përkufizimi i dhënë, del që vepra penale është në radhë të parë veprim ose mosveprim (në disa tekste, kur bëhet fjalë për veprën penale thuhet vetëm: Vepra penale është veprim).[92]

Teoria e së drejtës sonë penale, bazuar në formulimin e anës objektive të figurave konkrete të veprave penale që janë parashikuar si të tilla në pjesën e posaçme të K.Penal, (ku gjënden vepra penale që kryhen me veprim ashtu dhe vepra penale qe kryhen me mosveprim ;

[87] I.Elezi "E drejta penale e R.SH" Tirane 2000, fq.50

[88] G.Fiandaca – E.Musco "Diritto penale", Bologna 1993, f.121

[89] J.Paradel "Droit penal general", Paris 1994, f.3

[90] J.C.Soyer "Droit penal et procedure penale", Paris 1994, f.18

[91] V.Kambovski "E drejta penale", Shkup 2010, f. 123

[92] Po aty

madje, edhe vepra penale që mund të kryhen si me veprim ashtu dhe me mosveprim), pranon faktin që veprat penale kryhen edhe me mosveprim.

E drejta penale veprimin e trajton si një manifestim social të sjelljes së njeriut që perceptohet nga shqisat. Askush nuk mund të dënohet për mendimet apo idete e veta, sado mostruoze qofshin ato! Përcaktimet personale, qëndrimet dhe idetë e njëriut janë mbretëri e pacënueshme e lirisë së tij[93]. Liria e mendimit mbetet jashtë qëllimit të së drejtës penale, përveç se në ato raste kur përfshihet kërcënimi i ndonjë të mire juridike. Pra, të drejtës penale nuk i intereson çfarëdo lloj veprimi, por i interesojnë vetëm veprimet e njeriut. Lëvizjet e kafshëve apo të fenomeneve të natyrës (erës, ujit etj), pavarsisht nga pasojat e dëmshme, shpesh katastrofike, që mund të vijnë prej tyre (të tilla mund të jenë për shëmbull, shëmbja e nje çatie nga era; shëmbja e një shtepie nga orteku i deborës; vdekja nga mbytja e një grupi njerëzish, shkaktuar nga përmbytja, tërmeti etj), nuk janë veprime , në kuptimin që u jep atyre e drejta penale dhe, për rrjedhojë, nuk i interesojnë asaj. [94]

Pas miratimit të Ligjit Nr. 9754 Dt. 14.06.2007, "Për përgjëgjesinë penale të personave juridik", quhen veprime ose mosveprime – elementë të veprës penale dhe të anës objektive të një kategorie të posaçme veprash penale, për të cilat është pranuar edhe përgjegjësia penale e personave juridik, edhe veprimet ose mosveprimet e kryera, jo nga vetë personi juridik si i tillë , por të kryera nga personat fizik që kryejnë detyra të ndryshme në krye apo në përberje të organeve drejtuese të personit juridik , në emër apo në llogari të këtyre të fundit. Këto veprime ose mosveprime sjellin ose prej të cilave, mund te vijne pasoja shoqërisht të rrezikshme dhe të kundërligjshme.

Përgjegjësia penale e personave juridik, tek ne, është njohur edhe para së të miratohej ligji i sipërcituar. Në nenin 45 të Kodit Penal, që titullohet "Zbatimi i ligjit penal ndaj personave juridik thuhet:" Personat juridikë, me përjashtim të institucioneve shtetërore, përgjigjen penalisht për vepra penale të kryera në emër ose në dobi të tyre, nga organet dhe perfaqsuesit e tyre". Megjithate, sikurse del nga permbajtja e paragrafit të tretë të kësaj dispozite, "Përgjegjësia penale e personave juridik nuk përjashton atë të personave fizikë, të cilët kanë kryer ose janë bashkëpunëtorë në kryerjen e të njëjtave veprave penale". Në vëndin tonë, me miratimin dhe hyrjen në fuqi të ligjit që u përmënd më lart, zbatohet ajo qe quhet: "përgjegjësi penale paralele".[95] Mëgjithatë , duhet vënë në dukje se në nenin 45 të K. Penal , shtuar me ligjin Nr. 9275 Dt. 16.09.2004, ligjvënësi Shqiptar , ashtu si në shumë vënde të Europës, është shmangur nga ky parim, tradicionalisht i gjithëpranuar, pasi ngarkon me përgjegjësi penale personat juridik dhe njesitë e qeverisjes vendore. Të parat, për vepra të kryera në emër ose në dobi të tyre nga

[93] Po aty

[94] Ismet Saliu, " E drejte Penale Pjese e Pergjitheshme", Prishtine 2010, f.211

[95] Vllado Kambovski, cituar me lart

organet dhe perfaqesuesit e tyre; të dytat vetëm për veprime të kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Kjo për shkak se, sikurse dihet, personat juridikë janë krijesa të ligjit (fiksione) dhe, për shkak të disa të drejtave që mbartin dhe detyrimeve që marrin përsiper, si të tillë (si persona juridik), e drejta civile, për t'i dalluar nga kategoria tjetër e personave që janë persona fizikë, i quan persona juridikë.[96]

Për të drejtën penale, personat juridik si krijesa të ligjit, nuk veprojnë vetë realisht në botën e jashtme, qoftë dhe në marredhënie me të tretët. Janë personat fizikë, në përbërje të organeve drejtuese dhe përfaqësuesve të tyre, ata të cilët kryejnë veprime në emër dhe për llogari të personave juridikë. Janë pikërisht veprimet e vullnetshme të personave fizikë, në përberje të organeve të personave juridik, veprime që kur prej tyre vijnë pasoja shoqërisht të rrezikshme, i interesojnë së drejtës penale. Është pra, kjo një shmangie nga parimi romak sipas të cilit " Societas delinquere nonpotest", që përkufizohet me fjalët : Përgjegjësia penale e personave juridikë nuk njihet. Për ilustrim, në lidhje me këtë , vlen shprehja e perdorur nga juristi i njohur Robert Jakson, i cili në pozitën e prokurorit në gjyqin e Nurenbergut, duke folur për përgjegjësine personale të kriminelëve të Luftës së Dytë Botërore, që ishin duke u gjykuar, shprehej: "Parimi i përgjegjësisë penale është aq i domosdoshëm sa edhe logjik, në qofte se duam që e drejta ndërkombëtare të ofrojë ndihmesë reale në vendosjen e paqes. Vetëm sanksionet personale mund të ekzekutohen paqësisht dhe të jenë rezultative… Pikëpamja, se një shtet kryen krim, përbën artificë, fiksion. Krimet kryhen gjithmone nga vetë personat…"[97]

Si përfundim, element përbërës i anës objektive të figurës së veprës penale janë veprimet e njeriut. Duhet të mbahet parasysh se veprimi i njeriut, si shprehje e sjelljes, qëndrimit social të tij, duhet të manifestohet në botën e jashtëme, domethëne, duhet të jetë i tillë që të mund të perceptohet nga shqisat e njerëzve të tjerë. Për rrjedhojë, gjendjet e botës së brendshme si mendimet, ndjenjat, dëshirat, perderisa nuk manifestohen në botën e jashtme , nuk përbëjnë veprim në kuptimin që i jep këtij termi e drejta penale; pra, nuk përbëjnë veprim si element të anës objektive të figurës së veprës penale.[98] Manifestimi në botën e jashtme i dëshirave të njeriut, pra i veprimeve, realizohet nëpërmjet sistemit muskulor të tij, që kryen lëvizje muskulare. Por, jo cdo lëvizje muskulare mund të quhet veprim qe i intereson të drejtës penale. Të drejtës penale i interesojnë lëvizje muskulare të vetëkontrolluara, lëvizje të cilat përbejnë manifestim të kontrolluar nga njeriu në mjedisin social, (përshëmbull shkrepja e armës tek vepra penale e vjedhjes, apo marrja e sendit të huaj te vepra penale e vjedhjes). Për rrjedhojë, nuk përbëjnë veprim, në kuptimin penal të fjalës, lëvizjet e njeriut gjatë gjumit, apo veprimet e kryera prej tij në kushtet e dhunës fizike, apo në disa raste, edhe psikike, si dhe ato të diktuara

[96]S.SPIRO., Cikel leksionesh te se Drejtes Penale

[97] Ismet Saliu, " E drejte Penale nderkombtare", Prishtine 2005, f.312

[98] Ismet Saliu, " E drejte Penale Pjese e Pergjitheshme", Prishtine 2010, f.211

nga kushtet e forcës madhore. Në këto raste thuhet se nuk ndodhemi para lëvizjeve muskulore të vetëkontrolluara . Thënë ndryshe, veprimi që të konsiderohet element i anës objektive të figurës se veprës penale duhet që të jetë i vullnetshëm, në kundërshtim me normën e cila e ndalon veprimin e caktuar (përshëmbull, tek vepra penale e incestit cënohet norma e cila ndalon marrëdhënien seksuale me personin në lidhje gjaku), veprim ky i kryer me faj. [99]

Për sa i përket veprimeve të kryera në kushtet e dhunës fizike, personi, si rregull, nuk mban përgjegjësi penale për to, pasi ato nuk janë manifestim i vullnetit të tij, sikurse thuhet, në rastet e kësaj natyre, vullneti është i vesuar. i tillë mund të jetë, për shëmbull, rasti i dorëzimit nga arkëtari i një institucioni apo shoqërie tregtare i të hollave që ndodhen në arkë si rezultat i kërcënimit që i bëhet atij nga njerëz të armatosur; ose i lirimit nga toga e policisë që shoqëron të arrestuarin për në gjykatë, mbas lidhjes që u bëhet atyre nga një bandë e armatosur, etj. Për t'u shkarkuar personi nga përgjegjësia penale, në të tilla raste, dhuna qoftë fizike ose psikike, nuk duhet të jetë e çfarëdoshme. Intensiteti i dhunës duhet të jetë në atë shkallë që t'i heqë tërësisht mundësinë personit që të shfaqë lirisht vullnetin e tij në botën e jashtëme, t'a pengojë realisht atë për të vepruar. Verifikimi i llojit dhe shkallës së intensitetit të dhunës, duhet të bëhet rast pas rasti.

Po kështu, nuk quhen veprime në kuptimin penal dhe, për rrjedhojë, personi qe i kryen ato nuk mban përgjegjësi penale, edhe kur ai vepron për shkak te forcës madhore . I tillë mund të jetë, për shëmbull, rasti kur personi, për të shpëtuar banesën e tij nga zjarri që ka përfshire shtëpine e fqinjit, shkatërron pjesë të shtëpisë të këtij të fundit apo të fqinjëve të tjerë, për të krijuar hapesirë boshe midis tyre; ose boshatisja e depozitave të një distributori nga ana e punonjësve zjarrëfikës, duke e dërguar diku larg karburantit lëndën djegëse, për të evituar shpërthimin që mund të ndodhë nga një zjarr që ka rënë diku, aty afër.

Nga sa u nënvizua, më sipër, arrihet në përfundimin se për t'u quajtur veprim, në kuptimin e së drejtës penale, ai duhet: a) të jetë manifestim i lëvizjes së vetëkontrolluar muskulore; b) të shkaktojë transformime në botën e jashtëme (sikurse thuhet ndryshe, të japë rezultat fizik)[100] dhe, c) nëpërmjet transformimeve në botën e jashtëme, nëpërmjet rezultatit te ashtuquajtur fizik, të krijoje marrëdhenie të caktuara midis njerëzvë (të sjellë rezultat social). Të tre këta elementë përbëjnë veprimin në kuptimin social të termit veprim, kuptim që i intereson të drejtës penale.

Ndërmjet elementëve të mësipërme, duhet të ekzistojë një lidhje e brendshme, e cila krijon një zinxhir fenomenesh, zinxhir hallkash të cilat janë : lëvizja muskulore që prodhon rezultatin fizik dhe, ky i fundit, që prodhon rezultatin social. Lidhja që ekziston midis këtyre

[99] Luigi Delpino "Diritto Penale, parte Generale", Napoli 2010, f.902

[100] Vllado Kambovskin, veper e cituar f.152

elementëve, përbën vetë veprimin dhe, kur rezultati fizik është i dëmshëm e shoqerisht i rrezikshëm, ai përbën element të anës objektive të ndonjërës prej figurave të veprave penale që parashikohet në pjesën e posacme të Kodit Penal. Termi "rezultat fizik", përdoret në kuptimin e gjërë të tij, nënkupton cdo transformim që shkakton veprimi i njeriut në botën e jashtëme, transformim që mund te perceptohet nëpërmjet pamjes, dëgjimit ose të prekurit. Nisur pikërisht nga kjo, thuhet se cdo vepër penale ka pasojë në kuptimin e gjërë të kësaj fjale.

Sikurse dihet, pasojat në kuptimin e ngushtë të tyre, ekzistojnë vetëm në figurat e veprave penale materiale. Por, edhe në figurat e veprave penale formale, pavarsisht se për ekzistencën e tyre nuk kërkohet pasoja në kuptimin e ngushtë të saj (pasojat materiale), megjithatë edhe te keto figura veprash penale, si rezultat i veprimeve shoqërisht të rrezikshme, rezultojnë dëme në marredhenie të caktuar shoqërore, të mbrojtura posacërisht nga ligji penal.

Problemi i përgjegjësisë penale, në rastin e figurave materiale të veprës penale, mund te shtrohet vetëm atëhere kur pasojat kanë ardhur si rezultat i veprimeve të njëriut. Ndryshe, pavarsisht nga rëndësia dhe madhësia e pasojave, nuk mund të shtrohet ky problem (problem i përgjegjësisë penale).

3.3 Kuptimi juridiko-penal i mosveprimit, si element i anës objektive të figurës së veprës penale.

E drejta penale interesohet njëlloj për të dy format e manifestimit të sjelljes së njeriut në boten e jashtëme. E para, në formë aktive, duke kryer personi diçka, kurse e dyta, në formë pasive, duke mos kryer diçka që ai duhej të kryente. Në kuptimin penal, rëndësia e sjelljes së personit në të dy rastet është e barabartë. Shkalla e rëndësisë së kësaj sjelljeje ndryshon në rastin e parë nga ai i dyti, në kuptimin që veprat penale që kryhen me veprim, si rregull, paraqesin shkalle rrezikshmërie shoqërore më të madhe se veprat penale që kryhen me mosveprim.

Vepra penale me mosveprim kryhet duke moskryer veprimin që duhej të kryente, të cilin ka qënë i detyruar ta ndërmarrë. Për shëmbull, mosdhënia e ndihmës, pa shkaqe të arsyeshme nga ana e personit që me ligj ose për shkak të detyrës detyrohej t'a jepte atë, kur si pasojë e saj është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit, rrezikimi i jetës ose vdekja… (neni 97 i K.Penal) mosdhënia e ndihmës; mosdhënia e ndihmës nga kapiteni i anijes njerëzve që janë duke u mbytur në det ose në ujera të tjera, kur kjo ndihmë mund të jepej pa rrezik serioz për anijen ekuipazhin dhe udhëtarët …(neni 98 i K.Penal),etj. Në të gjitha këto raste, ndodhemi jo para veprimit, jo para qëndrimit aktiv të personit në raport me mjedisin rrethues, por para qëndrimit pasiv të tij. Tek figurat e veprave penale, të cilat kryhen me mosveprim, cënohen normat të cilat detyrojnë që të ndërmerret veprimi i caktuar.

Sikurse shihet edhe nga shëmbujt e mësipërm, të drejtës penale nuk i intereson çdo lloj qëndrimi pasiv i personit, çdo mosveprim i tij. Pra, nuk i interesojnë rastet kur personi nuk kryen asgjë, por i interesojnë rastet kur personi nuk kryen diçka që me ligj, ose për shkak të një vendimi gjyqësor, ose të detyrës se tij profesionale, ishte i detyruar t'a kryente. Prandaj, me të drejtë pranohet në doktrinën juridike penale se të drejtën penale e interesojnë mosveprimet që vijnë në kundërshtim me ligjin (në kuptimin e përgjithshëm të një rregulli sjelljeje).[101]

Si veprimi ashtu dhe mosveprimi, si elementë të anës objektive të figurës së veprës penale, si rregull, dalin nga vete permbajtja e pjesës përshkruese të dispozitës që parashikon cdo figurë konkrete vepre penale, që parashikohet në pjesën e posaçme të K.Penal, dalin nga vëtë formulimi i dispozitës përkatëse. Kështu, për shëmbull, nga vetë formulimi i dispozitave të seksionit VI, të Kreut II (nenet 100-108 të K.Penal), figura e krimit të marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me të mitur (neni 100 K.Penal); figura e krimit të marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me dhune me të mitur të moshës 14-18 vjeç (neni 101 K.Penal); figura e krimit të marrëdhënieve homoseksuale me dhunë më të rritur (neni 102/a K.Penal); figura e krimit të marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t'u mbrojtur (neni 103 K.Penal); figura e krimit të marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me kërcënim për përdorimin e armës (neni 104 K.Penal); figura e krimit të marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën (neni 105 K.Penal); figura e krimit të marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose në kujdestari (neni 106 K.Penal); figura e krimit të marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale në vënde publike (neni 107 K.Penal) dhe figura e krimit të veprave të turpshme (neni 108 K.Penal), del qartë se ato janë figura të veprave penale, të cilat nga ana objektive mund te kryhen vetem me veprime. Po keshtu, nga vete formulimi i dispozitave të neneve 97 (mosdhënia ndihme) dhe 98 (mosdhënia e ndihmës nga kapiteni i anijes) te K.Penal, rezulton qartë që këto janë figura krimi, që nga ana objektive, kryhen me mosveprim. Por, ka edhe shumë dispozita të tjera, në të cilat nga vetë formulimi, nuk del në se ato kryhen me veprim ose me mosveprim. Këto përbëjnë edhe pjesën më të madhe të figurave të veprave penale që parashikohen në pjesën e posaçme të K.Penal. Të tilla janë, përshëmbull, figura e krimit të vrasjes (neni 76 i K.Penal), ajo e vrasjes në rrethana të tjera cilësuese (neni 79 i K.Penal) etj.

Analizën e anës objektive, në përgjithësi të figurave të veprave penale dhe zbulimin e faktit nëse ato kryen me veprim ose mosveprim, në veçanti e bën teoria e së drejtës penale dhe, kryesisht, pjesa e posaçme e së drejtës penale.

Por, ka edhe disa figura veprash penale, për anën objektive të të cilave vetë ligjvënësi është shprehur, se mund të kryhet si me veprim ashtu edhe me mosveprime.[102] Të tilla janë për

[101] Ismet SALIHU, veper e cituar f.214

[102] Ismet Elezi, "E drejte penale (pjese e posaçme)", Tirane 2000, f.86

shëmbull, figura e krimit të mjekimit të pakujdesshëm, që parashikohet në nenin 96 të K.Penal (mjekimi i pakujdesshëm i të sëmurëve nga ana e mjekut ose e personelit tjeter mjekësor, si dhe zbatimi i terapisë ose e porosive të mjekut nga personeli mjekësor apo farmacist, kur ka shkaktuar dëmtimin e rëndë të shëndetit, ka rrezikuar jetën e personit ose ka shkaktuar vdekjen e tij): ose figura e krimit të shpërdorimit të detyrës, që parashikohet në nenin 248 të K.Penal (kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve ose e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jo materiale të padrejta ose kanë dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit, të shtetasve ose të personave të tjere juridikë…)

KREU IV

RREZIKSHMËRIA SHOQËRORE, SI ELEMENT I ANËS OBJEKTIVE TË FIGURËS SË VEPRËS PENALE DHE I VET VEPRËS PENALE.

5.1 Kuptimi juridiko-penal i rrezikshmërisë shoqërore, si element i anës objektive të figurës së veprës penale dhe i vet veprës penale.

Sikurëse dihet, e Drejta Penale përkufizohet si tërësia e normave juridike e cila ka për objekt studimin e veprës penale, të figurës së saj dhe të llojeve e masave të dënimit që caktohen, nga gjykata, ndaj autorëve të tyre[103].

Nga ky përkufizim del që e Drejta Penale merret me studimin e një fenomeni të caktuar shoqëror, fenomen ky që nuk është gjë tjetër, veçse cënimi i interesave të ligjëshme të shtetit dhe të individëve, përfshirë edhe personat juridik në përgjithësi. Nuk është gjë tjetër, veçse ai që quhet ndryshe edhe "fenomeni penal". Përmbajtja e fenomenit penal përbëhet nga vlera shoqërore, cënimi i këtyre vlerave dhe reagimi i shoqërisë ndaj këtij cënimi, nëpërmjet dënimit të tyre.

Mirpo, jo cënimi i të gjitha vlerave shoqërore, përbën objekt studimi të së Drejtës Penale. Përbëjnë objekt studimi të kësaj dege të së Drejtës, cënimi i atyre vlerave, të cilat shoqëria, në një periudhë të caktuar kohe, i konsideron si vlera më të rëndësishme të saj. Pikërisht për këtë arsye, ajo i merr në mbrojtje në mënyrë të veçantë, nëpërmjet dënimit penal me llojet dhe masat e ndryshme të tij, të cilat parashikohen në ligj për personat që i cënojnë apo vënë në rrezik për t'i cënuar këto vlera. Kurse, siç dihet, cënimi i vlerave të tjera shoqërore, më pak të rëndësishme se ato të cilat merren në mbrojtje nga e Drejta Penale, përbëjnë objekt studimi dhe merren në mbrojtje nga degë të tjera të së Drejtës.

Pikërisht çmimi negativ që i bën shoqëria veprave , veprimeve ose mosveprimeve të cilat cënojnë vlera të rëndësishme shoqërore, te cilat përbëjnë objekt studimi të së Drejtës Penale, kjo degë e së Drejtës e quan rrezikshmëri shoqërore e veprës.

[103] Sh.Muçi, vepër e cituar më sipër fq.139

Meqënëse, janë marrëdhëniet shoqërore-juridike që vendosen për mbrojtjen pikërisht të kësaj kategorie vlerash në një shoqëri të caktuar, në një periudhë kohore të dhënë, ato që përbëjnë thelbin e veprës penale-objektin e saj, e Drejta Penale rrezikshmërinë shoqërore e konsideron tiparin material të vetë veprës penale[104]. Ky tipar përfaqëson një nga elementët në të cilët gjen shprehje ana e jashtëme e veprës penale dhe figurës së saj. Rrezikshmëria shoqërore e veprës është cilësi e domosdoshme e veprës penale. Në qoftë se do të mungojë kjo rrezikshmëri, atëhere nuk do të kemi vepër penale[105].

Ky është një tipar themelor mbi bazën e të cilit ligjvënësi përcakton rrethin e atyre veprave të cilat në një periudhë të caktuar kohe, konsiderohen vepra penale. Mbi bazën e ndryshimeve të këtij tipari, ligjvënësi ndryshon, shton apo pakëson edhe numrin e llojin e atyre veprave, të cilat, në periudha të ndryshme i konsideron vepra penale.

Kështu për shëmbull në Shqipëri, sipas Kodeve Penale të peridhës socialiste, të viteve 1952 dhe 1977, bashkëjetesa e një burri të martuar me një grua tjetër në të njëjtën strehë me bashkëshorten e tij ligjore, përbënte vepër penale. Me ndryshimet social-ekonomike, kjo lloj vepre, jo vetëm që nuk përbën më vepër penale, por sipas Kodit të Familjes, që u miratua me ligjin Nr. 9062, datë 08.05.2003, bashkëjetesës i kushtohet rregullim i posaçëm ligjor, përfshirë edhe marrëdhëniet pasurore midis bashkëjetuesve gjatë dhe mbas mbarimit të bashkëjetesës.

Po kështu, në Kodet Penale të periudhës komuniste parashikoheshin si vepra penale, madje konsideroheshin si vepra penale me shkallë rrezikshmërie më të lartë, ato të cilat quheshin "Krime kundër shtetit". Me ndryshimin e kushteve social-ekonomike dhe me pranimin e pluralizmit politik, kapitulli i "Krime kundër shtetit", të cilat parashikoheshin në ato Kode, u shfuqizua tërësisht. Me ndryshimin e këtyre kushteve , në Kodin Penal në fuqi të miratuar me ligjin Nr.7895 datë 27.01.1995, janë përfshirë si vepra penale, vepra të tilla si ato të cilat emërtohen "Vepra penale kundër lirisë së besimit", të parashikuara në dispozitat e neneve 131 të Kodit Penal "Pengimi i veprimatarive të organizatave fetare", neni 132 "Shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve të kultit" dhe neni 133 "Pengimi i ceremonive fetare", në një kohë kur propaganda fetare, para këtyre ndryshimeve konsiderohej agjitacion e propagandë kundër pushtetit "popullor" të asaj kohe, e cila përbënte një nga veprat penale të quajtura "Krime kundër shtetit" dhe që ka shërbyer si bazëligjore për dënimin e persekutimin, për disa dekada, të një numri shumë të madh njerëzish, nga shtresa të ndryshme të popullsisë.Edhe, braktisja e Shqipërisë, konsiderohej "arratisje jashtë shtetit", veprim ky që sipas Kodeve Penale të praktikës gjyqësore të kohës, përbënte një nga format e "Krimit të tradhëtisë ndaj atdheut", dhe që konsiderohej si krimi më i rëndë. Pas ndryshimeve, në Kodin Penal në fuqi, jo çfarë do lloj braktisjeje e territorit

[104] E Drejta Penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Pjesa e Përgjithshme, grup autorësh, Tiranë 1982. Fq.111

[105] Po aty

të Rrepublikës së Shqipërisë konsiderohet vepër penale. Konsiderohet vepër penale, madje kundërvajtje penale, vetëm kalimi i paligjshëm i kufijëve shtetëror.

Mendoj se paraqet interes përmëndja e një figure të re vepre penale, sikurëse është ajo e ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit, e cila parashikohet në dispozitën e nenit 298 të Kodit Penal. Veprime të tilla si strehimi, shoqërimi, vënia në dispozicion ose përdorimi i mjeteve të lundrimit, të fluturimit apo i mjeteve të tjera të transportit, me qëllim kalimin e paligjshëm të kufirit, përbëjnë elementë të anës objektive të kësaj figure vepre penale. Për shkak të shkallës së lartë të rrezikshmërisë të cilat ato paraqesin, në kushtet aktuale, në kuadër të detyrimrvr ndërkombëtare (MSA-së dhe akteve të tjera ndërkombëtare) të Shqipërisë, veprime të kësaj natyre, ligjvënësi shqipëtar i konsideron krim dhe kur kryhen në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo kanë sjellë pasoja të rënda, dënohen me lloje dhe masa dënimi mjaft të rënda, me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet dhe me gjobë, nga gjashtë gjer në tetë million lekë dhe kur kanë sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohen jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm, si dhe me gjobë nga tetë gjer në dhjetë million lekë.

Lidhur me rrezikshmërinë shoqërore, si tipari material i veprës penale dhe figurës së saj, mendoj se duhet përmëndur së fundi, disa raste, të cilat për shkak të disa rrethanave të veçanta në të cilat kryhen veprime të caktuara, të cilat, nga pikëpamja formale-juridike, në kushte të tjera do të përbënin elementë të anës objektive të ndonjë figure vepre penale konkrete, nga ato që parashikohen në Kodin Penal, ato shërbejnë për të përjashtuar personin nga përgjegjësia penale.

Rrethana të tilla janë: mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme, ushtrimi i një të drejte apo përmbushja e detyrës, si dhe zbatimi i urdhërit dhe heqja dorë nga kryerja e veprës penale, të cilat parashikohen përkatësisht në dispozitat e neneve 19 (Mbrojtja e nevojshme)[106], neni 20 (Nevoja ekstreme), neni 21 (Ushtrimi i një të drejte apo përmbushja e detyrës) dhe neni 24 (Heqja dorë nga kryerja e veprës penale) [107]të Kodit Penal.

Rrezikshmëria shoqërore e veprës ka lidhje me veprën penale në tërësi dhe përcaktohet nga të gjitha elementët e figurës së saj. Me fjalë të tjera përt ë përcaktuar rrezikshmërinë shoqërore të saj është e domosdoshme që të analizohen 4 elementët e figurës së veprës penale në tërësi. Rrezikshmëria shoqërore e veprës konsiston në faktin se ajo ushtron influencë negative mbi raportet shoqërore. Veprat e rrezikshme mund të prekin zhvillimin normal të këtyre raporteve, ti prishin ato ose ti shkaktojnë dëme, pikërisht në mundësinë e shkatërrimit të këtyre raporteve ose në dëmtimin e tyre qëndrron edhe rrezikshmëria shoqërore e veprave penale.

Rrezikshmëria shoqërore e veprimeve kriminale ka karakter objektiv. Ajo përcaktohet në rradhë të parë nga raportet shoqërore të cilat preken ose që prishen nga vepra penale. përcaktimi

[106] Vendimi Nr. 38, datë 15.01.2003 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

[107] Vendimi Nr. 365, datë 04.04.2007 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

se një vepër është ose jo shoqërisht e rrezikshme nuk bëhet mbi bazën e gjykimit subjektiv të njerëzve, sipas dëshirës së tyre. Rrezikshmëria shoqërore e veprimit ose mosveprimit paraqet në vetvete cilësitë reale objektive të sjelljeve antishoqërore të njerëzve. Vetëm kur veprimet apo mosveprimet drejtohen kundër interesave të caktuara (publike apo private), të mbrojtura me ligj, vetëm atëhere ato konsiderohen si veprime ose mosveprime shoqërisht të rrezikshme.

Rrezikshmëria shoqërore ka karakter dianamik, është e ndryshueshme në varësi nga rrethanat, koha, vëndi, etj. Mirpo, përveç karakterit relative dhe dinamik të nocionit të rrezikshmërisë shoqërore ekzistojnë ca vlera të përgjithëshme të cilat konsiderohen universale, për shëmbull siç është jeta, shëndeti etj. Rrezikimi apo dëmtimi i tyre janë konsideruar, konsiderohen dhe do të konsiderohen vepra penale.

Shkalla e rrezikshmërisë shoqërore nuk është e njëjtë tek të gjitha veprat penale, disa vepra penale janë më shumë të rrezikshme se disa të tjera. Kështu, për shëmbull vrasja është më e rëndë se plagosja. Por edhe ndërmjet figurave të veprave penale të vrasjeve shkalla e rrezikshmërisë ndryshon nga njëra vrasje tek tjetra, për shëmbull, vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër që parashikohet në dispozitën e nenit 77 të Kodit Penal është më e rrezikshme se sa vrasja me dashje që parashikohet në dispozitën e nenit 76 të Kodit Penal, etj.

Në përcaktimin e shkallës së rrezikshmërisë shoqëroretë veprës penale sipas Kodit Penal, rëndësi kanë edhe pasojat. Për shëmbull, tek një person u gjendën 20 mijë lekë të fallsifikuara dhe te një person tjetër u gjendën 100 milion lekë të fallsifikuara. Që të dy do të përgjigjen penalisht për veprën penale të falsifikimit të monedhave të parashikar në dispozitën e nenit 183 të Kodit Penal. Por tek subjekti i parë shkalla e rrezikshmërisë shoqërore e veprës penale është më e ulët në raport me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës se kryer nga tjetri.

Interes të veçantë paraqet trajtimi i rrezikshmërisë shoqërore të veprës si element i anës objektive të figurave të veprave penale që ndërpriten dhe nuk përfundohen për shkaqe të pavarura nga vullneti i autorit, pra të veprave penale të cilat mbeten në tëntativë.

Në këto raste ndodhemi para një veprimtarie kriminale të papërfunduar, për shkak se nuk vijnë pasojat e parashikuara dhe të dëshiruara nga personi që ka kryer veprimin, i cili përbën anën objektive të figurës konkrete të veprës penale rast pas rasti. Kuptohet që ky fakt, mos ardhja e pasojës, pavarësisht shkallës së rrezikshmërisë së veprimit kriminal, ndikon ndjeshëm në pakësimin e shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të vet veprës , në raport me rastet kur nga vepra ka ardhur edhe pasoja.

Pikërisht për këtë arsye, në dispozitën e nenit 23 të Kodit Penal “Përgjegjësia për tentativën” ligjvënësi rrethanën e “shkallës së afërsisë së pasojës”, në rastet kur vepra penale mbetet në tentativë, e ka renditur të parën në raport me rrethanën tjetër “shkaqet për të cilat krimi

mbetet në tentativë" në procesin e vlerësimit nga gjykata të shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës. Në varësi të rrezultateve të këtij vlerësimi [108], gjykata sipas kësaj dispozite:

a) zbut dënimin;

b) ose ta ulë dënimin nën minimumin e parashikuar nga ligji;

c) ose mund të caktojë një lloj dënimi më të lartë nga ai i parashikuar në ligj.

Në përcaktimin e shkallës së rrezikshmërisë përveç marrëdhënieve shoqërore të cilat ato cënojnë apo pasojave rol luan edhe mënyra e kryerjes së veprës penale, mjetet që ka përdorur autori, vëndi i kryerjes, për shëmbull "vjedhja me dhunë" e parashikuar në dispozitën e nenit 139 është më pak e rrezikshme nga vjedhja me armë dhe kjo gjë duket në masën e dënimit që është dhënë. Duke u mbështetur në shkallën e rrezikshmërisë, përcaktohet pasha e veprës penale, në rastet kur rrezikshmëria është më e madhe, edhe vepra penale konsiderohet më e rëndë dhe anasjelltas, kur rrezikshmëria është më e vogël edhe vepra penale konsiderohet më e lehtë. Shkalla e rrezikshmërisë së veprës penale shprehet posaçërisht në sanksionet penale. Kështu, për veprat penale më të rrezikshme në ligj parashikohen lloje dhe masa të dënimeve më të rënda.

Rrezikshmëria është e përgjithshme dhe e posaçme. Rrezikshmëria e përgjithshme është ajo rrezikshmëri e veprës penale siç është parashikuar në ligj, në mënyrë të përgjithshme, abstrakte, për një numër të pacaktuar rastesh[109]. Përcaktimin e nocionit të rrezikshmërisë shoqërore në mënyrë të përgjithëshme e bën ligjvënësi. Të gjitha llojet e figurave të veprave penale të vrasjes apo të plagosjes janë të rrezikshme dhe kjo lloj rrezikshmërie është e karakterit të përgjithshëm. Gjithashtu përcaktimi i nocionit abstract të rrezikshmërisë të llojeve të caktuara të veprave penale, shërben si bazë për konceptimin e sistemit të sanksioneve penale në pjesën e posaçme të legjislacionit penal. Rrezikshmëria e posaçme shprehet në kryerjen e veprës penale konkrete në kuadrin e llojit të njëjtë të veprave penale[110].

Përcaktimin e shkallës së rrezikshmërisë së posaçme të veprës penale të caktuar e bën gjykata rast pas rasti, duke marrë parasysh veprën penale të kryer në tërësinë e saj siç është shkalla e rrezikut, apo e dëmtimit të marrëdhënieve juridike, mjetet më të cilat është kryer, etj.

Në përcaktimin e shkallës së rrezikshmërisë, një rol të rëndësishëm luan gjykata, e cila në dhënien e dënimit për një vepër penale, ka parasysh rrezikshmërinë e saj e parashikuar në

[108] Vendimet Nr. 690, datë 11.12.2002 dhe vendimi Nr. 344, datë 09.06.2004 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

[109] I.Salihu., E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme, Prishtinë 2010, fq.229

[110] Po aty

dispozitën e nenit 47 të Kodit Penal[111], të cilën gjykata e përcakton rast pas rasti, duke patur parasysh mjetin, vëndin, motivet apo qëllimet e autorit. Rrezikshmëria merret parasysh edhe për uljen e dënimit nën kufijtë e parashikuar nga ligji[112], për pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim[113], për pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe detyrimi për kryerjen e një pune në interes publik[114].

Siç del nocioni i rrezikshmërisë shoqërore ndonëse nuk është i shprehur si element thelbësor i veprës penale në dispozitat e para të Kodit Penal, është pranuar si kriter kryesor në dispozitat të cilat i kushtohen caktimit të dënimit. Kodi Penal i Rrepublikës së Shqipërisë, përderisa nuk jep përkufizimin e veprës penale nuk shprehet për rrezikshmërinë shoqërore të saj.

Rrethanat që përjashtojnë rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale.

Në rrethanat që përjashtojnë rrezikshmërinë shoqërore hyjnë: mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme, ushtrimi i një të drejte, përmbushja e detyrës, zbatimi i urdhërit, dhe heqja dorë nga kryerja e veprës penale.

Në doktrinën e së drejtës penale dhe në praktikën gjyqësore të disa vëndeve, përfshirë dhe atë shqiptare në të kaluarën, veç rrethanave të mësipërme të cilat parashikohen shprehimisht në ligj (përkatësisht në dispozitat e neneve 19,20,21 dhe 24 të Kodit Penal), si rrethanë që përjashton rrezikshmërinë penale, për rrjedhojë edhe mungesën e vet veprës penale konsiderohet edhe pëlqimi i të dëmtuarit[115].

Kur vepra, për shkak të rrethanave të ndryshme, apo për shkak të karakterit të saj shoqërisht të dobishëm nuk është e rrrezikshme, ajo nuk shkakton përgjegjësi penale[116], megjithëse formalisht parashikohet si e tillë nga ndonjë dispozitë e ligjit penal. Mungesa e rrezikshmërisë shoqërore të veprës, kur ka ndonjë nga rrethanat e përmendura, përjashton edhe karakterin e padrejtë të saj[117]. Kundërligjshmëria e veprës, si shprehje juridike e rrezikshmërisë

[111] Neni 47 paragrafi I 2, i Kodit Penal, "Mënyra e caktimit të dënimit", në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajita, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

[112] Neni 53 i Kodit Penal, "Gjykata, në raste të veçanta, kur çmon që vepra dhe autori i saj paraqesin rrezikshmëri të pakët dhe jane të pranishme disa nga rrethanat lehtësuese,……."

[113] Neni 59 i kodit Penal, "Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetsore apo mendore……."

[114] Neni 63 i Kodit Penal, "Gjykata, për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit dhe të rrethanave të kryerjes së veprës penale……"

[115] Trajtim krejtësisht më vete, sin ë literaturë, në legjislacion (aty ku ekziston) dhe praktikë gjyqësore, rezervohet për eutanazinë.

[116] E Drejta Penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Pjesa e Përgjithshme, A.Çela, N.Peza, I. Elezi, G.Gjika, Tiranë 1982. Fq. 171

[117] Po aty

shoqërore, është e pamjaftueshme nëse nuk ekziston vet rrezikshmëria shoqërore. Pa ekzistencën e këtij elementi të domosdoshëm që formon përmbajtjen material të veprës penale. për shkak të lidhjes organike që ekziston midis rrezikshmërisë shoqërore dhe kundërligjshmërisë, mungesa e njërës të dërgon në pavlefshmërinë e tjetrës. Edhe nëse parashikohet formalisht nga ligji si vepër penlale, në fakt ajo është në shërbim të ligjit, në pajtim me të, pasi kryhet në mbrojtje të interesave apo të të mirave të tjera juridike të shoqërisë apo individit ose për përmbushjen e një detyre të dobishme shoqërore[118].

Madje, diskutohet edhe se rrethanat e mësipërme përjashtojnë gjithashtu edhe fajin si element të domosdoshëm të veprës penale meqënëse autori, në kryerjen e veprës e cila parshikohet nga ndonjë dispozitë si krim apo kundërvajtje penale, niset nga motive shoqërisht të dobishme. Vetëm parashikimi i pasojave që mund të vijnë nga vepra dhe dëshira për të ardhur këto, nuk mjaftojnë për ta konsideruar veprën si të kryer me faj. Dashja kërkon si element tjetër edhe pasjen nga ana e personit edhe të ndërhjegjes së rrezikshmërisë shoqërore të veprës. Në rrethanat që përjashtojnë rrezikshmërinë shoqërore, autori mendon se vepra e tij është e drejtë dhe e dobishme për shoqërinë si rrjedhojë fajësia e tij përjashtohet.

Mbrojtja e nevojshme

Një nga mënyrat që ligji lejon të përdoret për ruajtjen e intresave të shtetit apo të individit apo grupi shoqëror nga veprat penale është edhe mbrojtja e nevojshme. Ajo nënkupton sprapsjen e një sulmi kriminal, e bërë brënda kufijve të lejuar, duke i shkaktuar dëm sulmuesit.

Nevoja për vetmbrojtje ka ekzistuar që në kohë të hershme, më së shumti në periudhat më shtet të pafuqishëm ose pa shtet për të mbrojtur shoqërinë apo individët nga veprimtaria kriminale. Në shekullin e XIX, janë përpunuar disa teori të studimit natyror-juridik të këtij institute, të cilat ndahen në tre grupe kryesore[119].

Sipas teorisë së parë, nëse shteti i shmanget detyrës së tij për të mbrojtur individin nga sulmi, aktivizohet e drejta e vetëmbrojtjes së individit, e cila i paraprin të drejtës së shtetit. Sipas teorisë së dytrë, gjatë mbrojtjes së nevojshme vihet jashtë fuqisë i gjithë sistemi juridik dhe krijohet një raport tjetër ku nuk mund të zbatohen kategoritë e drejtësisë dhe të padrejtësisë. Sipas teorisë së tretë, sulmi nënkupton shkeljen absolute të drejtësisë, ndërsa mbrojtja, si kundërpërgjigje, rivendosjen e drejtësisë.

Instituti i mbrojtjes së nevojshme, për shkak të rëndësisë që ai paraqet ai trajtohet gjërësisht nga e drejta penale bashkëkohore, europiane dhe ndërkombëtare. Teoritë moderne

[118] Vllado Kambovskin, veper e cituar fq.180

[119] V.Kambovski., E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme, Shkup 2010, Fq.219

argumentojnë se e drejta e vetmbrojtjes është një e drejtë themelore e njëriut, e cila në të gjitha rastet, pa përjashtime, justifikon përdorimin e dhunës e cila rrjedh nga kjo e drejtë, panvarësisht nëse mbron personin apo pasurinë[120]. Ligji penal shqiptar parashikon mbrojtjen individuale që mund dhe duhet të bëjnë vet qytetarët në kushte dhe rrethana të caktuar, e cila gjen mbështetje ligjore në institutin e mbrojtjes së nëvojshme, të parshikuar në dispozitën e nenit 19 të kodit Penal[121], nisur nga përmbajtja e dispozitës së lartpërmëndur, mbrojtje e nevojshme quhet kundërveprimi apo kundërsulmi që bëhet, brënda kufijëve të lejuar nga ligji, për mbrojtjen e një të drejte nga një sulm i padrejtë , duke i shkaktuar dëm sulmuesit.

Kjo sjellje e detyruar mbrojtjeje e përjashton autorin e saj nga përgjegjësia penale, pasi zhvillohet në rrethana që e përjashtojnë rrezikshmërinë shoqërore të veprës. Vepra e kryer në kushtet e mbrojtjes së nevojshme i ka të gjitha karakteristikat e jashtëme të një vepre penale, parashikohet edhe nga ligji penal si e tillë, por i mungon thelbi i saj, rrezikshmëria shoqërore. Mbrojtja në këtë rast bëhet për të shmangur rrezikun aktual të dëmeve që do të shkaktoheshin nga sulmi i padrejtë, i vërtetë dhe i çastit.

Për mbrojtje të nevojshme flitet vetëm në ato raste kur i mbrojturi i ka shkaktuar dëm autorit të sulmit në perosnin ose në të drejtat apo intresat e tij, pasi ndaj rasteve të tjera, kur mbrojtja është realizuar pa pasoja, e drejta penale është indiferente. Shkalla e prekjes së këtyre të drejtave dhe rëndësia e të drejtave të cënuara mund të jenë të ndryshme, gjë e cila varet nga raporti juridik i cili preket si jeta, shëndeti apo pasuria e sulmuesit. Mbrojtja e nevojshme është jo vetëm një e drejtë e ligjshme e çdo personi për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tij apo të një tjetri por edhe një detyrë morale për të reaguar në këtë drejtim. Instituti i mbrojtjes së nevojshme merr një rëndësi të veçantë juridike dhe politico-shoqërore në lidhje me punonjësit e organeve të specializuara e të ngarkuara nga ligji me mbrojtjen e rendit publik, të cilat e kanë për detyrë ndërhyrjen dhe neutralizimin e sulmeve të tilla, si dhe për organet e hetimit e të gjykimit të çështjeve penale, me qëllim që ky institut të zbatohet drejt në praktikë, duke u bërë dallimi i tij nga veprimtaria e vërtetë kriminale.

Instituti i mbrojtjes së nevojshme ka objektin dhe qëllimin e tij, përmbushjen e detyrave të veçanta në sferën e së drejtës penale, u krijon mundësi dhe hapsira individëve dhe organeve shtetërore që, në rrethana të veçanta, të mbrojë interesa dhe të drejta të ligjshme nga veprat shoqërisht të rrezikshme pa autorizim dhe pa ndjekur rrugët e zakonshme. Objekti i mbrojtjes së nevojshme dhe objekti i sulmit të padrejtë janë të njëjtë, pasi në vëmëndje të tyre qëndrojnë po ato marrëdhënie juridiko-penale, port ë para nga këndvështrime të ndryshme dhe nga qëllime të

[120]G,Castles and Caracters; Proportionalityand Juse of Deadly Force in Defense of Dëelling and Property, 1999 University of Illions Laë Reveë,1.

[121] "Mbrojtja e nevojshme "., Nuk ka përgjegjësi penale personi i cili ka kryer veprën duke qënë i detyruar të mbrojë jetën, shëndetin, të drejtat dhe interesat e tij ose të një tjetri, nga një sulm i padrejtë, i vërtet dhe i çastit me kusht që, karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e sulmit.

ndryshme të palëve në konfrontim. Sulmi i padrejtë synon dëmtimin e këtyre raporteve, kurse mbrojtja ruajtjen, moscënimin e tyre.

Instituti i mbrojtjes së nevojshme parashikohej edhe në Kodin Penal Shqiptar të vitit 1928 [122], dhe kufizohej vetëm në mbrojtjen e personit ose të nderit të tij apo të tjetrit, parashikohej gjithashtu ne Kodin Penal të Rrepublikës popullore të Shqipërisë të vitit 1952, ku objekti i këtij instituti zgjerohet dhe merr një përkufizim tjetër[123], ndësa në nenin 9 të Kodit Penal të Vitit 1977 shtohet edhe mbrojtja e "Partisë së Punës të Shqipërisë" dhe e "gjithë rendit shoqëror socialist". Pavarësisht nga diferencat e lartpërmendura, objekti i mbrojtjes së nevojshme në të drejtën penale shqipëtare dhe atë ndërkombëtare nënkuptohet kurdoherë një e drejtë, me fjalën e drejtë duhet nënkuptuar të gjitha të drejtat të cilat lidhen me jetën, shëndetin apo paprekshmërinë e personit si dhe ato të drejta të cilat lidhen me pasuritë.

Dispozita e nenit 19 të Kodit Penal, e përqëndron objektin e mbrojtjes së nevojshme të personit në jetën, shëndetin të drejhtat dhe intresat e tij ose të një tjetri. Duke qënë se të drejtat dhe interesat e njerëzve janë të ndryshme dhe të larmishme qoftë në lloj apo edhe në karakter, doktrina i ndan ato në dy grupe kryesore[124], mbrojtja e personit dhe mbrojtja e pasurisë. Në grupin e të drejtave që mbrojnë personin, përveç mbrojtjes së jetës dhe të shëndetit, futet edhe mbrojtja e lirisë seksuale, e lirisë së personit dhe disa vepra kundër moralit dhe dinjitetit, si shfrytëzimi i prostitucionit me dhunë, trafikimi I femrave më dhunë, rrëmbimi, etj.

Rastet e mbrojtjes së marrëdhënieve juridiko-penale të këtij grupi ndeshen më shpesh në parktike dhe janë më të kuptueshme, sepse për mbrojtjen e jetës, shëndetit apo të lirisë nga një sulm i çastit personi i sulmuar do të reagonte edhe në mënyrë instiktive . Ai do të vepronte aty për aty për ta shmangur vet rrezikun aktual që i kanoset, pasi befasia e sulmit dhe koha e kufizuar e venë atë në pamundësi objektive përtë kërkuar ndihmën e organeve shtetërore apo marrjen e masave të tjera. Nuk mban përgjegjësi penale personi që vret, plagos ose i shkakton lëndime të tjera autorit të një sulmi te padrejtë për të shpëtuar aty për aty jetën, paprekshmërinë seksuale apo lirinë e tij ose të një personi tjetër, të cilat rrezikohen prej këtij sulmi. Në një rast vrasjeje me thikë të personit që tentonte kryerjen e marrëdhënieve seksuale me dhunë, Gjykata e Apelit Tiranë në një vendim të saj, arsyeton se e pandehura e tronditur rëndë nga veprimet e B.R dhe duke u ndodhur në një ambient të disfavorshëm për të, në pamundësi për t'u mbrojtur nga

[122] Neni 50 i Kodit Penal të Rrepublikës së Shqipërisë , të vitit 1928, "Në të cilin përkufizohet si kundërveprim i shtërnguar nga nevoja për të sprapsur një violencë të çastit e të padrejtë, të drejtuar kundër personit ose nderit të tij ose të tjetrit, për sprapsjen e së cilës nuk ka pasur as kohë e as mjete të tjera më të lehta "

[123] Neni 8 i kodit Penal të Rrepublikës Popullore të Shqipërisë, viti 1952 "Nuk përmban përgjegjësi penale personi që kryen një vepër të parashikuar nga ligji penal për të mbrojtur pushtetin popullor, pasurinë shtetërore dhe shoqërore, personin ose të drejtat e tij ose të një tjetri nga një sulm i padrejtë, i vërtetë dhe i atëçastshëm me kusht që të mos kapërcejë kufijtë e mbrojtjes së nevojshme"

[124] Sh.Muçi., vepër e cituar, Fq.183

askush, ka sprapsur sulmin e padrejtë të B.R duke e shpuar atë me thikën e tij në bark dhe se goditjen me thikë ndaj të dëmtuarit B.R e ka kryer në gjëndje mbrojtjeje të nevojshme, për t'u mbrojtur nga një sulm i vërtetë dhe i atëçastshëm[125].

Në grupin e dytë, në të drejtat që lidhen me mbrojtjen e pasurisë , përfshihen si mbrojtja e së drejtës së pronës, ashtu edhe mbrojtja e disa të drejtave reale të lidhura me të. Sipas nenit 152 të Kodit Civil, sendet u përkasin personave fizikë, personave jurisikë dhe shtetit. Prandaj, objekt i mbrojtjes së nevojshme janë si marrëdhëniet juridiko penale të cilat lidhen me pronën private, ashtu edhe ato të cilat lidhen me pronën publike, si dhe ato të cilat u përkasin personave fizikë, ashtu edhe ato të cilat u përkasin personave juridikë ose shtetit.

E rëndësishme është që më anën e kundërsulmit të mbrohet kjo pasuri nga vjedhja, dëmtimi apo shkatërrimi imediat që i kanoset nga sulmi i padrejtë dhe i çastit. Kështu, do të quhej në mbrojtje të nevojshme personi që vepron me armë zjarri kundër një personi tjetër ose një bande që është duke sulmuar një autobus për grabitje apo për rrëmbimin e pasgjerëve, etj.

Nga nocioni i mbrojtjes së nevojshme del se për t'u konsideruar se ekziston mbrojtja e nevojshme duhet të shprehet sulmi dhe mbrojtja. Sulmi dhe mbrojtja njëherazi janë dy elementë kryesorë të mbrojtjes së nevojshme, të cilat duhet t'i përmbushin kushtet e caktuara. Përndryshe, nëse këto dy elemente kryesore nuk shprehen në kushtet dhe sipas rregullave të caktuara me ligj, nuk mund të bëhet fjalë për ekzistencën e mbrojtjes së nevojshme.

Sulmi është çdo veprim i njeriut i cili është i detajuar në dëmtimin apo rrezikimin e ndonjë të mire juridike. Zakonisht sulmi mund të kryhet vetëm me veprim. Mirëpo, përjashtimisht sulmi mund të kryhet edhe me mosveprim. Përshëmbull, mjeku i ndihmës së shpejtë refuzon t'i japë ndihmën mjeksore personit që është në gjëndje rreziku për jetën. Në rast të tillë, çdo person mund ta detyrojë mjekun që ta kryejë detyrën e vet.

Dispozita e nenit 19 të Kodit Penal përcakton tiparet që duhet të karakterizojnë sulmin dhe kriterin bazë të cilin duhet të rrespektojë mbrojtja për të parnuar ekzistencën e mbrojtjes së nevojshme. Karakteristikat e sulmit në mbrojtjen e nevojshme janë:

1- Sulmi të jetë veprim i njëriut[126].

Për të ekzistuar mbrojtja e nevojshme, sulmi duhet të ndërmerret nga njëriu. Në të drejtën tonë penale, në rastet kur sulmi vjen nga kafshët, fuqitë mbinatyrore, konsiderohet se ekziston

[125] Vendimi nr.523, datë 13.12.2002 i Gjykatës së Apelit Tiranë

[126] Vendimet Nr. 346, datë 23.05.2002; Nr. 38, datë 15.01.2003; Nr. 100, datë 16.02.2005; Nr.244, datë 06.05.2009, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

nevoja ekstreme, veprimi i njëriut, është një nga karakteristikat kryesore të dallimit të mbrojtjes së nevojshme nga instituti i nevojës ekstreme[127].

2- Sulmi të jetë i padrejtë.

Sulm i padrejtë është ai veprim i njëriut i cili është në kundërshtim më ligjin dhe që vë në rrezik të drejta dhe interesa të mbrojtura nga ligji. Është pikërisht padrejtësia e sulmit , ajo e cila e dallon atë nga veprimet e personave që përmbushin detyra shtetërore apo shoqërore sipas ligjit ose ushtrojnë të drejta, nga përmbushja e të cilave preken apo dëmtohen të drejta apo interesa të personave të ndryshëm, përgjithësisht të personave kundër të cilëve drejtohen këto veprime. Për shëmbull nuk mund të quhen sulm i padrejtë veprimet e përmbaruesit gjyqësor për zbatimin forcërisht të një vendimi gjyqësor civil ose të një titulli tjetër ekzekutiv.

Në të drejtën penale, si në teori edhe në praktikë, interes ka ngjallur problem i provokimit, nëse do të ndodhet në kushtet e mbrojtjes së nevojshme personi i cili e ka provokuar vetë sulmin e padrejtë. Teoria edhe praktika gjyqësore përgjithësisht janë të mendimit, të mospranimit të mbrojtjes së nevojshme në rastet kur personi i sulmuar e ka provokuar vetë sulmin me sjelljet e tij të padrejta. Përsa u përket rasteve të provokimeve të qëllimshme, për të nxitur një sulm ndaj vetes me qëllim për të justifikuar kundërsulmin dhe pasojat kriminale të këtij kundërsulmi, është e dukshme që nuk legjitimohet mbrojtja e nevojshme. Mbrojtja e nevojshme gjithashtu nuk legjitimohet as për personin e tretë i cili shkon në ndihmë të atij që ka provokuar sulmin.

3- Sulmi të jetë i vërtetë

Kërkesa që sulmi i padrejtë të jetë i vërtetë ose real, është vendosur për të parandaluar rastet e simulimeve ose të sulmeve imagjinare. Sulm i vërtetë është ai veprim i padrejtë i sulmuesit i cili ekziston objektivisht, i shfaqur aty pë aty në botën e jashtme dhe që rrezikon seriozisht të drejta të mbrojtura me ligj, gjë që justifikon edhe reagimin ndaj tij. Në rastin kur sulmi nuk ekziston realisht, por përfytyrohet në imagjinatën e personit ose supozohet se mund të bëhet, nuk përligjet asnjë lloj reagimi me pasoja të dëmshme nga ana e personit që epërfytyron atë, kundër autorit të supozuar të tij.

4- Sulmi të jetë i çastit (aktual)

[127] I.Salihu., vepër e cituar, fq. 238

Në kuptimin e mbrojtjes së nevojshme, sulmi konsiderohet i çastit në rastet kur në çdo moment pritet se do të fillojë, kur ka filluar të veprojë dhe derisa të zgjasë, përkatësisht deri në perfundim[128]. Nuk është e lejuar mbrojtja ndaj ndonjë sulmi i cili do të pasojë pas një kohe si dhe mbrojtja ndaj sulmit i cila ka përfunduar, ka pushuar së vepruari.

Nuk mund të cilësohet në kushtet e mbrojtjes së nevojshme vepra e kryer për të shmangur një sulm i cili përgatitet të bëhet në të ardhmen, edhe sikur të ketë të dhëna të plota se ardhja e tij është e sigurt, sepse në sulme të kësaj natyre personi i rrezikuar ka mundësi dhe kohë të mjaftueshme për ta parandaluar atë në rrugë të tjera, duke përdorur mjete dhe mënya të tjera më të përshatëshme. Nuk do të justifikohej në mbrojtjen e nevojshme vrasja e hasmit më arsyetimin e prandalimit të ardhshëm të hakmarrjes apo të gjakmarrjes, edhe sikur të jetë paralajmëruar për ardhjen e këtij rreziku prej vet atij.

Mbrojtja dhe sulmi lidhen organikisht midis tyre, aq sa nuk mund të kuptohen dot pa njëri-tjetrin. Personi që vihet në mbrojtje të nevojshme ka përgjegjësi penale për veprimet që i kanë shkaktuar dëme sulmuesit ku ato nuk kanë qënë aspak ,të nevojshme as për sprapsjen e sulmit dhe as për rivendosjen e të drejtës së cënuar.

Mbrojtja

Sulmi i kundërligjshëm i jep të drejtë të sulmuarit të mbrohet me marrjen e veprimit me të cilin realizohet figura figura ligjore[129] e ndonjë vepre penale, vrasje ose lëndim trupor i sulmuesit. Veprimi i mbrojtjes mund të jetë i orientuar nga sulmuesi dhë të mirat e tij, i pranishëm në vëndin e sulmit apo personit të cilin ai e shfrytëzon si mjet për kryerjen e sulmit. Mbrojtja duhet të jetë e domosdo e nevojshme për zbrapsjen e sulmit, ka të bëjë me parimin se e drejta nuk duhet të tërhiqet para të padrejtës dhe pot ë aplikohej do të na dërgonte në përfundimin se i sulmuari gëzon çdo herë të drejtën e mbrojtjes së nevojshme[130].

Mbrojtja është çdo veprim i njëriut me të cilën dëmtohet apo rrezikohet ndonjë e mirë nga sulmuesi. Zakonisht, në rastin e mbrojtjes sulmi zmbrapset prej vetes apo prej të mirave juridike personale. Mirëpo mrojtja e nevojshme ekziston edhe në rastet kur sulmi zmbrapset edhe nga personi i tretë.

Ligji penal mjaftohet me kushtin që karakteri I mbrojtjes të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e sulmit dhe se mos përputhja haptazi ndërmjet tyre përbën kapërcim të kufijëve

[128] Po aty, fq.239

[129] V.Kambovski., vepër e cituar, Fq.214

[130] Po aty

të mbrojtjes së nevojshme. Kërkesat të cilat e bëjnë mbrojtjen apo kundërsulmin të ligjshëm, janë përcaktuar nga teoria dhe praktika e të drejtës penale[131].

Këto kërkesa janë:

1- Mbrojtja të drejtohet kundër sulmuesit.

Qëllimi i vetëm i mbrojtjes është sprapsja e sulmit të padrejtë për të mbrojtur të drejtën që rrezikohet të preket apo të dëmtohet nga ky sulm i çastit, mbrojtja ka të drejtë të ballafaqohet e të kundërsulmojë vetëm autorin e sulmit të drejtpërdrejtë, por kurrësesi me persona të tjerë të cilët nuk kanë lidhje më të. Dëmi i cili shkatohet nga veprimet e mbrojtjen enjë personi të tretë, i cili nuk merr pjesë në sulm, megjithëse mund të jetë i nevojshëm për mënjanimin e rrezikut, duhet të konsiderohet si vepër e kryer në kushtet e nevojës ekstreme .

Nëse sulmi nuk është vepër e një personi, por kryhet në bashkëpunim nga shumë persona, mbrojtja lejohet të bëhet kundër bashkëpuntoreve ekzekutues, të cilët marrin pjesë efektivisht në sulm, kryejnë veprime të drejtpërdrejta mbi objektin e sulmuar.

2- Karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e sulmit.

Mbrojtja nuk është e pakufizuar dhe e pakontrolluar në veprimet e saj, por ka një limit, vepron brënda disa caqeve të caktuara dhe me fuqi të mjaftueshme sa për të realizuar detyrën, mbrojtjen e së drejtës së rrezikuar nga sulmi. Ndryshe nga sulmi ku tiparet e tij jepen të plota, lidhur me mbrojtjen ligji shqiptar parashikon vetëm një kusht, që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e sulmit, pa e përcaktuar këtë karakter dhe këtë proporcion, gjë të cilën do të duhet ta bëjë praktika dhe teoria e së drejtës penale.

Intensiteti i saj duhet të jetë i barabartë apo më pak i madh se intensiteti i sulmit, sipas ligjit të thjeshtë të lidhjes aksion-reaksion[132], nëse është më i vogël sulmi nuk mund të refuzohet. Por pyetja është sa më i madh? Aduhet isulmuari të shërbehet me të gjitha forcat dhe mjetet me të cilat disponon? Nuk mund të formulohet një rregull i vetëm për të gjitha rastet, përveç konstatimit se për vlerësimin e formës dhe intensitetit të nevojshëm të mbrojtjes, vendimtare janë forma dhe intensiteti i sulmit. Vetë sulmi, mënyra e shfaqjes së tij, mjetet e përdorura, fuqia, shkathtësia, vendosmëria dhe manifestimet e tjera psikologjike të sulmuesit si tërbimi, zemërimi, gjakftohtësia në çdo rast konkret e ndikojnë mënyrën e mundëshme të reagimit dhe mjetet të

[131] Sh.Muçi., vepër e cituar, Fq.191

[132] V.Kambovski., vepër e cituar, fq.215

cilat do t'i përdorë i sulmuari. Nëse i sulmuari nuk ka asnjë alternativë, sigurisht që mbrojtja etij është realizuar në mënyrën e vetme të mundshme, nëse i sulmuari ka më tepër alternative në dispozicion, etj.

Megjithate për vlerësimin objektiv të të sulmuarit për faktin se cila mënyrë apo cili mjet ka qënë domosdoshmërisht i nevojshëm për mbrojtje, duhet të merren parasysh të gjitha rrethanat, e sidomos moment psikologjik i befasisë, i frikës apo situatë e ngjashme psikologjike, prezente në situate të këtilla[133], në të cilat nuk mund të pritet një sjellje apo llogjikim i ftohtë dhe i arsyeshëm i një mbrojtjeje që plotësisht do t'i përgjigjej intensitetit të sulmit. Me përputhje ose proporcion kuptohet barazi, ose pothuajse barazi, mes intensitetit të sulmit dhe intensitetit të kundërsulmit, e cila del nga raporti që krijohet midis peshës apo rëndësisë të së drejtës së mbrojtur dhe asaj të cënuar nga kundërsulmi. Teoria e së drejtës italiane niset nga parimi i matjes së intresave në përcaktimin e proporcionit, kundërsulmi i kryer nga i sulmuari duhet të jetë më i vogël, i barabartë ose paksa më i rëndë se veprimi i sulmuesit[134].

E rëndësishme është që zmbrapsja e sulmit dhe mbrojtja e të drejtës së rrezikuar prej tij të bëhet me një mënyrë të butë, pavarësisht nga mjetet e përdorura, duke gjetur rrugën e mbrojtjes me pasoja më të vogla ose më pak të dëmshme për sulmuesin. Ky qëndrim i praktikës gjyqësore është i hershëm dhe i pandryshueshëm aktualisht. Për të qënë në gjëndjen e mbrojtjes së nevojshme, thuhet në një vendim të Gjykatës së Lartë, nuk kërkohet që të ketë barazi mjetesh sulmi dhe mbrojtjeje. Kërkohet që mbrojtja të bëhet në përputhje me karakterin dhe forcën e sulmit, me fjalë të tjera intensiteti i mbrojtjes ti përshtatet intensitetit të sulmit [135].

3- Mbrojtja të mos kapërcejë kufijtë e mbrojtjes së nevojshme.

I sulmuari nuk ka të drejtë të pakufizuar të mbrohet në çfarëdo mënyre, me cilado mjete dhe me cilindo intensitet të mbrojtjes. E drejta e tij e mbrojtjes së nevojshme është e kufizuar me elementë të përqëndruar rreth sulmit dhe mbrojtjes, e secili nga ato elementë ka përmasa të ndryshme të elementëve sasiorë dhe cilësor[136], sasia e mbrojtjes është e përcaktuar në sasinë e sulmit.

Mosrrespektimi i kërkesave ligjore të cilat u referohen sulmit dhe kundërsulmit, si rregull e bëjnë mbrojtjen të paligjshme, duke shkaktuar përgjegjësinë penale të personit për veprën e

[133] Po aty

[134] P.Rocco., Compendio del Diritto Penale, Parte Speciale, V.2002

[135] Sh.Muçi., vepër e cituar, fq.194

[136] V.Kombovski., vepër e cituar, fq.217

kryer. Megjithatë, mosrespektimi i ndonjërës prej tyre apo kryerja e veprimeve të tepërta dhe të panevojshme mund të krijojnë një gjëndie të veçantë, e cila e vendos autorin e saj përpara një përgjegjësie penale në rrethana cilësuese lehtësuese, parashikim ky i cili parashikohet në dispozitën e nenit 19 të Kodit Penal.

Kapërcimi i kufijëve të mbrojtjes së nevojshme ndodh në dy raste, kur konstatohet haptazi një mospërputhje ndërmjet karakterit të mbrojtjes dhe rrezikshmërisë së sulmit, dhe kur sulmi e humbet njërën prej cilësive të tij të domosdoshme, çastin. Në rastin e parë kapërcimi vjen si rredhojë e përdorimit të mënyrave të papërshtatshme, ndërsa në rastin e dytë si rrjedhojë e vazhdimit të veprimeve mbrojtëse edhe mbas mbarimit të sulmit, apo kur sulmi nuk është më i çastit, pasi është ndërprerë dhe nuk mund të përsëritet aty për aty ose në një periudhë relativisht të afërt, gjatë së cilës mund të merren masat e nevojshme për mënjanimin e tij në mënyra të tjera.

Mbrojtja ekziston për aq kohë sa ekziston sulmi. Ndërlidhja mes tyre bën që me përfundimin e sulmit të mbarojë edhe e drejta e mbrojtjes kundër tij, perjashtohen rastet e pamundësisë për të kuptuar nëse sulmi kishte përfunduar dhe të gabimit në fakt, të cilat konsiderohen mbrojtje e nevojshme, në të gjitha rastet e tjera autori i mbrojtjes përgjigjet penalisht për pasojat kriminale të ardhura nga veprimet e kryera pas përfundimit të sulmit. Në lidhje edhe me anën subjektive të tij, do të përgjigjet për vepër të kryer në kapërcim të kufijëve të mbrojtjes së nevojshme ose në bazë të dispozitës që parashikon veprën penale konkrete, sipas rregullave të përgjithshme.

Kur mbrojtja ndërmerret para sulmit apo pas ndërprerjes së tij duhet konsideruar se nuk ekziston mbrojtje e nevojshme dhe as tejkalim i saj[137].

NEVOJA EKSTREME

Edhe ky institut është një ndër rastet e përjashtimit të personit nga përgjegjësia penale për mungesë të rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer prej tij. Të drejtat rezikohen jo vetëm nga sulmet e njëriut, por edhe nga dukuri të tjera, fenomene natyrore. Në çdo rast, personi lufton me këto forca për të mbijetuar ose të znbrapsë prej vetes apo tjetrit rrezikun e atëçastshëm dhe të paprovokuar, i cili nuk ka mundur të evitohet në ndonjë mënyrë tjetër, me kushtin që e keqja që i është shkaktuar mos të jetë më e madhe se e keqja që i është kanosur.

Përballimi i këtyre rreziqeve mund të bëhet pa ose me shkaktimin e dëmeve personave të tjerë ose pasurisë së tyre, gjë e cila varet nga rrethanat konkrete ku zhvillohet ngjarja. Tek nevoja ekstreme, nuk kemi situatë të tillë të pastër juridike, nuk flitet për ndeshje të së drejtës me të padrejtën, por për një ndeshje ndërmjet dy të drejtave, gjërësisht dy interesa juridike të

[137] Po aty, Fq.218

njëllojta[138]. Një e drejtë duhet të humbet për të shpëtuar një tjetër, për shëmbull, mjeku gjatë një shtatzanie patologjike, nuk ja mundëson të drejtën për të jetuar foshnjes për të jetuar nëna, personi rrëmben barkën e një tjetri me qëllim që të shpëtojë jetën e nje fëmije i cili është duke u fundosur, nëse në rastin e një përmbytjeje personi i cili është fizikisht më i fortë arrin të gjeje një send dhe të mund të shpëtojë.

Nevoja ekstreme si kusht për përjashtimin nga përgjegjësia penale ka njohur një aplikim të gjërë në legjislacionet penale kombëtare, por ky institute ka patur një aplikim më të kufizuar në lidhje me krimet ndërkombëtare, kryesisht në krimet e liuftës ose ato të kryera në situate lufte[139]. Bazuar në legjislacionin Anglez nevoja ekstreme nuk përbën shkak për përjashtimin nga përgjegjësia penale për krime lufte, vepra penale e kryer në kushtet e urisë, ose në kushtet e një rreziku që cënon jetën e një personi dhe pasurinë e tij, nuk përbën kusht për përjashtimin e personit nga përgjegjësia penale për kryerjen e krimeve të luftës. Ky kusht mund të merret në konsideratë vetëm për minimizimin e sanksioneve[140]. Madje qëndrime jo uniforme janë mbajtur nga gjykatat angleze edhe për sa i përket krimeve të zakonshme[141] .

Shumëllojshmëria e situatave që i mbulon ky institute, mundëson paraqitje të teorive të ndryshme për natyrën juridike të tij dhe zgjidhje të diferencuara ligjore për veprimin e tij juridik. Për sqarimin e natyrës juridike të tij, janë zhvilluar dy grupe teorish ajo subjektive dhe objektive[142]. Sipas teorisë subjektive, vepra e kryer në nevojën ekstreme është e kundërligjshme, por autori nuk dënohet për shkaqe subjektive. Personi i cili ndodhet në nevojën ekstreme është në presion të madh psikik, kanosja e rrezikut dhe si rrjedhojë në të tilla raste nuk mund të pretendosh heroizëm. Sipas teorisë objektive, vepra e kryer në nevojën ekstreme nuk mund të konsiderohet vepër penale pasi i mungon elementi i kundërligjshmërisë.

Nevoja ekstreme ekziston kur janë të pranishëm disa kushte të cilat lidhen me natyrën e rrezikut dhe karakterin e mbrojtjes. Mungesa e njërit prej tyre na dërgon në mungesën e vetë këtij instituti. Kushtet të cilat duhen të përmbushen në rastin e rrezikut;

---

[138] Po aty

[139] J.Xhafo., E Drejta Penale Ndërkombëtare, Tiranë 2009, Fq.160

[140] Neni 20, i Manualit Ushtarak Anglez.

[141] Përmëndim çështjen Dudley and Stephen, tre peshkatarë të cilët si rrezultat i një stuhie detyrohen të qëndrojnë në det të hapur për 18 ditë pa patur asnjë mundësi ushqimi. Si pasojë dy prej tyre, Dudley dhe Stephen detyrohen të vrasin peshkatarin më të ri mes tyre me të cilin u ushqyen deri sa u shpëtuan nga një anije që rastësisht kalonte andej. Gjykata e shkallës së parë nuk e mori në konsideratë faktin se ata kishin vepruar në kushtet e nevojës ekstreme dhe i dënoi me vdekje. Më pas Dhoma e Apelit e minimizoi sanksionin në dënim me gjashtë muaj burg.

[142] I.Salihu., vepër e cituar, Fq.245

1- Rreziku që kërcënon interesa të caktuara mund të lindë si rezultat i veprimit të forcave të natyrës ose i veprimit të kafshëve[143].

Fenomenet natyrore që rrezikojnë njerëzit dhe pasurinë e tyre janë të shumëllojshme, si përmbytjet, zjarret, etj. Në rrethana të tilla, personi i rrezikuar nga këto forca ose që shkon në ndihmë të personave të rrezikuar prej tyre, në panik e sipër ose gjatë përpjekjeve për të shpëtuar, mund t'u shkaktojë dëme personave të tretë. Gjithashtu të drejtat personale ose pasurore të të tjerve mund t'i cënojnë edhe personi që mbron veten ose një tjetër nga kafshët e egra të cilat kanë dalë aksidentalisht dhe që janë duke sulmuar njerës ose bagëti, gjatë marrjes së masave për të shpëtuar jetën e tij ose të një tjetri në rrethanat e të ftohtit, etj.

Personi i cili vepron në kushtet e nevojës për përballimin e rreziqeve të tilla, nuk ka përgjegjësi penale nëqoftë se vepra e tij parashikohet formalisht si vepër penale nga ndonjë dispozitë ligjore, për shëmbull, nuk do të përgjigjet penalisht personi i cili merr forcërisht një mjek dhe e detyron që të japë ndihmën e parë në urgjencë pasi mjeku që është present refuzon ta japë atë.

Ndryshe nga mbrojtja e e nevojshme ku burimi i rrezikut është i përcaktuar vjen vetëm nga veprimi i njëriut, nga një sulm i padrejtë i tij, në nevojën ekstreme burimet e rrezikut janë të papërcaktuara dhe të shumta, dukuri të natyrës ose ngjarje.

2- Rreziku duhet të jetë real, i tillë që të ekzistojë në realitet.

Nevoja ekstreme jo vetëm që lidhet me praninë e rrezikut i cili kërcënon të drejta personale dhe pasurore, por edhe me ekzistencën e tij në realitet, pra të qënit i vërtet. Ngjarja apo veprimi i njëriut që e zhvillon atë, yë jetë i shfaqur në botën e jashtëme dhe të ketë marrë ato përmasa e drejtime që kërcënon seriozisht persona ose pasuri me shkaktimin e dëmeve të rënda. Nëse rreziku është imagjinar, i supozuar ose i perceptuar gabim në mëndjen e personit, çështja zgjidhet në bazë të rregulla të gabimit në fakt[144].

3- Rreziku duhet të jetë i çastit.

Kur rreziku kërcënues është i çastit, kuptohen rastet kur burimi i rrezikut është shfaqur dhhe rreziku është bërë i pranishëm, ka filluar kërcënimi i tij ose pritet të fillojë aty për aty. Kohëzgjatje e tij, varet nga karakteri i rrezikut, lloji, përmasa dhe forca e fenomenit natyror, nga koha që do të duhej për të siguruar e përdorur mundësi ose mënyra të tjera shmangieje, etj. Personi i cili i dorëzon nje personi të armatosur sasinë e parave të një njesie të këmbimit valuator gjatë transferimit të tyre, për të shpëtuar jetën e tij dhe të shoqëruesit të tij nga vrasja që do të ndodhte me siguri në atë moment në rast rezistence, personi ndodhet në kushtet e nevojës

[143] Komentari i Kodit Penal të Rrepublikes së Shqipërisë, vepër e cituar, Fq.161

[144] E Drejta Penale e Rrepublikës Popullore socialiste të Shqipërisë, vepër e cituar, Fq.188

ekstreme. Personi nuk do të ishte në këto kushte pasi e dorëzon pasurinë nga frika e kanosjes se mund ta vrasin në të ardhmen.

4- Rreziku të kërcënojë personin ose pasurinë nga një dëmtim i rëndë.

Objekt i rrezikut, njëkohësisht edhe objekt i mbrojtjes, janë jeta, shëndeti dhe liria e autorit të veprës ose e një personi tjetër, si dhe pasuria e tij ose e një tjetri, ku përfshihet edhe pasuria e personave juridikë ose e shtetit. Dëmtimi që mbrohet nga ky rrezik duhet të jetë i rëndë dhe jo i çfarëdoshëm[145]. Në rast se dëmtimi i mbrojtur është i vogël ose i parëndësishëm, nuk justifikohet dëmtimi i interesave të të tretëve. Rëndësia e dëmtimit përcaktohetr rast pas rasti gjatë hetimit ose gjykimit të çështjes, në raport me llojin e të drejtave të mbrojtura, personale ose pasurore.

5- Rreziku nuk duhet të jetë i provokuar.

Vepra do të cilësohet si e kryer në kushtet e nevojës ekstreme kur autori i saj ndodhet para një situate të papritur, të befasishme dhe të krijuar nga faktorë të pavarur nga vullneti i tij. Në rast se burim rreziku janë sjelljet ose veprimet e tij të kryera me faj, personi do të përgjigjet për veprën penale që kryen.

Për ekzistencën e nevojës ekstreme ligji kërkon që mbrojtja të kryhet duke rrespektuar këto kushte;

1- Dënimi të jetë i pashmangshëm me mënyra të tjera.

Personi në nevojë duhet t'i shfytëzojë të gjitha mënyrat e tjera të mundshme dhe, në pamundësi përballimi, të përdorë atë mënyrë që është më pak e dëmshme për të tretët. Vetëm pamundësia për ta shmangur dëmin me mënyra të tjera përjashton rrezikshmërinë shoqërore të veprës. Kjo është një kërkesë e domosdoshme e nevojës ekstreme në përputhshmëri me qëllimin e saj, pasi nuk lejon transferimin e rrezikut nga interesa të ligjshme të njërit tek interesat e ligjshme të tjetrit, të cilat gëzojnë mbrojtje ligjore të njëjtë.

Në mënyrë përjashtimore, ky transferim konsiderohet i pranueshëm kur diktohet nga përballimi i një domosdoshmëria e cila nuk ka zgjidhje tjetër, e cila nuk mund të zhvillohet pa dëmtuar interesat e një tjetri, dëmtim që duhet të jetë më i vogël se dëmi i shpqtuar.

2- Dëmtimi i shkaktuar të mos jetë më i madh se dëmtimi i zmbrapsur

Kusht i parashikuar në dispozitën e nenit 20 të Kodit Penal, lidhur me rraportin e dëmeve, i cili të mos jetë më i madh se dëmi i zmbrapsur, përbën një nga elementët e domosdoshëm të nevojës ekstreme. Në këtë rast dëmtohet një e drejtë apo interes më i vogël i dikujt për të

[145] Po aty, fq.190

shpëtuar një të drejtë apo një interes më të madh të dikujt tjetër, nga pikëpamja e rëndësisë ose e vlerës. Kur autori i veprë e ruan këtë raport ndërmjet dëmeve, vepra e tij e humbet rrezikshmërinë shoqërore duke marrë ndonjëherë edhe karakter shoqërisht të dobishëm[146].

Mbrojtja e të drejtave personale, të tilla si jeta, shëndeti dhe liria përgjithësisht janë më të rëndësishme se të drejtat pasurore, si rrjedhojë, dëmtimi që shkaktohet nga cënimi i tyre konsiderohet më i madh se dëmet pasurore. Vlerësimi i dëmtimit bëhet rast pas rasti, duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët dhe rrethanat të cilat ndikojnë në këtë drejtim.

Në rrethanat e përfytyrimit të gabuar të personit lidhur me rëndësinë e dëmit të ardhur dhe të atij të zmbrapsur, do të zbatohen rregullat e gabimit në fakt, sikurëse veprohet në të gjitha rastet e lajthitjes edhe për institutet e tjerë. Por, disa persona janë të detyruar me ligj të vihen në rrezik për të përmbushur detyrën të cilën e kanë të caktuar me ligj, për shëmbull, polici nuk mund të largohet nga vëndi i shërbimit, me arsyetimin se rrezikohej nga një sulm i mundshëm.

Ligji penal aktual nuk shprehet lidhur me mospërfitimin nga nevoja ekstreme i atyre personave që kanë për detyrë të rrezikojnë. Ne Kodet Penale të vitit 1952 dhe të 1977 shpreheshin për një rast të tillë, duke parashikuar se nuk është në gjëndjen e nevojës ekstreme personi i cili e ka për detyrë të vihet në rrezik dhe, megjithatë shmanget, duke shkelur detyrën e tij shtetërore ose profesionale [147] .pavarësisht këtij mosparashikim të shprehur, arrihet të nënkuptohet se këta persona nuk duhet ta braktisin detyrën nga frika e rrezikut që mund ti kanoser, dhe nëse i shmangen nuk mund të justifikohen nën institutin e nevojës ekstreme.

Ndër rrethanat të cilat përjashtojnë rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, krahas mbrojtjes së nevojshme dhe nevojës ekstreme, përfshihet edhe ushtrimi i një të drejte dhe përmbushja e detyrës si dhe pëlqimi i të dëmtuarit

USHTRIMI I NJË TË DREJTE

Ushtrimi i një të drejte shoqërohet me cënimin ose kufizimin e të drejtave ose të lirisë së personit ndaj të cilit ushtrohet ose edhe të personave të tjerë. Tipik është ushtrimi i të drejtës prindërore dhe i të drejtës së kujdestarisë[148]. I tillë do të ishte, për shëmbull moslejimi për të frekuentuar mjedise të papërshtatshme për moshën e tij, duke mos e lejuar për të dalë në mënyrë

[146] V.Kambovski., vepër e cituar, Fq.222

[147] Neni 9 i Kodit Penal, i vitit 1952, neni 10 i Kodit Penal i vitit1977.

[148]Komentari i Kodit Penal të Rrepublikes së Shqipërisë, vepër e cituar, Fq.165

të shpeshtë, me qëllim të bejë mësimet. Edhe pse formalisht ndalime ose pengime të tilla përmbajnë elementë të heqjes në mënyrë të paligjshme të lirisë së personit, veprës i mungon rrezikshmëria shoqërore, pasi kryhet për realizimin e një të drejte të njohur me ligj.

Kapërcimi i të drejtës, dhuna, keqtrajtimi ose përdorimi i formave të cilat sjellin pasoja negative në shëndetin ose edukimin e fëmijës, janë me rrezikshmëri shoqërore dhe formojnë vepër penale.

Në teorinë e së drejtës penale shqiptare, konsiderohet si ushtrim i një të drejte të njohur nga ligji edhe rasti i përdorimit të një mbrojtjeje të përshtatëshme, për të zmbrapsur aty për aty, çdo veprim i cili cënon ose e zhvesh personin nga posedimi i sendit[149]. Si shëmbull përdoret kanosja që i bëhet vjedhësit menjëherë pas vjedhjes, me qëllim që të detyrohet të kthejë sendin e vjedhur[150].

PËRMBUSHJA E DETYRËS

Në dispozitën e nenit 21 të Kodit Penal, detyrat ndahen në dy lloje, detyra të caktuara nga ligji dhe detyra për zbatimin e një urdhëri të dhënë prej një personi kompetent. Dallimi ndërmjet dy llojeve të detyrave qëndron në formë, në faktin se tek e para detyra merret drejtpërdrejt nga ligji, ndërsa tek e dyta me ndërmjetsimin e një personi tjetër, nëpërmjet urdhërit të dhënë nga ana e tij.

Përmbushja e disa detyrave shtetërore, sidomos në veprimtarinë e organeve të cilat lidhen me sigurimin e rendit publik dhe me luftënn kundër kriminalitetit, shpesh cënohen të drejta dhe interesa të personave të veçantë, në personin ose pasurinë e tyre, për shëmbull përmbaruesi ka të drejtë të bllokojë një llogari bankare të debitorit me qëllim shlyerjen e detyrimit, apo ndërhyrja e organeve të policisë gjyqësore apo të procedimit ku parashikohet në ligj, të gjitha ketoveprime apo edhe të tjera të ngjashme me to, nuk paraqesin rrezikshmëri shoqërore, por janë në interes të shoqërisë.

Zbatimi i urdhërit e përjashton zbatuesin e tij nga përgjegjësia penale lidhur me pasojat që mund të sjellë, si në rastin e urdhërit të ligjshëm edhe në rastin kur urdhëri është i paligjshëm. Kur urdhëri është i ligjshëm, nuk mund të diskutohet për përgjegjësi penale, ndërsa kur urdhëri është i paligjshëm përgjegjësinë për pasojat e mban personi i cili e ka dhënë atë. Në dispozitën e nenit 21 të Kodit Penal sipas të cilit zbatuesi i urdhërit ka përgjegjësi penale vetëm në rastin kur urdhëri është haptazi i paligjshëm, ndërsa kur vepra është kryer si rezultat i urdhërit të paligjshëm, për të përgjigjet personi i cili ka dhënë urdhërin. Ligji nuk shprehet se kur një urdhër

[149] E drejta Penale e RPSSH, vepër e cituar, fq. 193

[150] Komentari i Kodit Penal të Rrepublikes së Shqipërisë, vepër e cituar, Fq.166

është i paligjshëm. Por ekzistenca e parimeve të përgjithshme të së drejtës si dhe praktika shumvjeçare në të tilla çështjë, është arritur në përfundimin se urdhëri është haptazi i paligjshëm nëse nuk plotëson njërin nga kushtet[151].

- Të ekzistojë varësia hierarkike
- Dhënia e urdhërit të jetë në kompetencën e urdhërdhënësit
- Zbatimi i urdhërit të përfshihet në detyrat e urdhërzbatuesit
- Urdhëri të jetë në formën e kërkuar nga ligji

Mungesa e ndonjërit prej këtyre kushteve e bën urdhërin të pavlefshëm, dhe si rrjedhojë haptazi të paligjshëm.

Përsa u për ket forcave të armatosura, mbahen parasysh kritere të tjera për zbatimin e një urdhëri, konform ligjeve dhe rregulloreve ushtarake. Moszbatimi i urdhërit nga ushtaraku, i cili është i detyruar ta respektojë dhe ta zbatojë atë, formon vepra penale të parshikuara në Kodin Penal Ushtarak.

PËLQIMI I TË DËMTUARIT

Cënimi i të drejtave dhe interesave të personit mund të ndodhë edhe me pëlqimin e tij. Ky pëlqim, i dhënë në kushte të caktuara dhe për të dejta të cilat disponohen lirisht prej tij, përbën një rrethanë që përjashton rrezikshmërinë shoqërore të veprës.

Për disa vepra penale, si për shëmbull kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë, ligji kërkon si element përbërës të tyre që vepra të jetë kryer pa miratimin ose kundër vullnetit të atij që i takon e drejta ose interesi i cënuar. Në raste të tilla, përjashtohet ekzistenca e veprës penale për mungesë të një elementi të vetë figurës së posaçme të veprës penale.

Por, në raste të tjera që ligji nuk kërkon si element të veprës penale mungesën e miratimit ose vullnetit të poseduesit të së drejtës, del në pah rëndësia që mund të ketë pëlqimi i të dëmtuarit për përgjegjësinë penale të autorit. Legjislacioni penal nuk përmban ndonjë dispozitë të shprehur lidhur me këto çështje.

Duke u nisur nga parimet e përgjithshme të së drejtës, nga kuptimi material i veprës penale dhe nga detyrat e së drejtës penale, duhet pranuar se cënimi i interesave të caktuara të individit që në kushtet e caktuara, kryhet me vullnetin e tij, nuk mund të konsiderohet shoqërisht i rrezikshëm.

[151] E drejta Penale e RPSSH, vepër e cituar, fq. 194

Bëhet fjalë për të drejta dhe interesa që i takojnë individit dhe janë lënë në disponimin e lirë të tij, për të drejta të tilla, mbrojtja me anën e ligjit penal të të cilave, është e kushtëzuar nga vetë qëndrimi i të dëmtuarit, nga dëshira e tij. Të tilla mund të jenë dhurimi i gjakut, dhurimi i njërës veshkë një të sëmuri i cili ka nevojë për të, shëmbja e ndërtesës së pronarit, me pëlqimin e tij për të ndërtuar një të re, etj.

Për të qënë i vlefshëm pëlqimi i të dëmtuarit duhet të plotësohen këto kushte[152];

- Të jetë i vërtetë, të jetë dhene me vullnetin e lirë të të dëmtuarit.
- Të jepet nga personi që ka tagrën e disponimit të së drejtës.
- I dëmtuari të ketë dhënë pëlqimin në gjëndje mendore normale.
- I dëmtuari të ketë zotësinë për të vepruar.
- Pëlqimi të jetë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës.

[152] Po aty

KREU V

KUNDËRLIGJSHMËRIA DHE PASOJA SI ELEMENT TË ANËS OBJEKTIVE TË FIGURËS SË VEPRËS PENALE.

6.1Kundërligjshmëria dhe parashikimet në ligj.

Kundërligjshmëria është element i përbashkët, përbërës, si për veprën penale, ashtu dhe për anën objektive të figurës së veprës penale. Në këtë element, gjen shprehje konkrete njëri prej parimeve kryesore të së Drejtës Penale, sikurëse është parimi i ligjshmërisë, apo legalitetit. Thelbin e përbërjes së këtij parimi e përbën fakti sipas së cilit, që vepra, veprimi ose mosveprimi, të përbëjë element të veprës penale dhe të anës objektive të saj, nuk mjafton vetëm që të cënojë vlera të rëndësishme shoqërore, pra të jetë shoqërisht i rrezikshëm, por duhet të jëtë edhe i kundërligjshëm.

Përsa i përket anës së jashtëme të veprës penale dhe figurës së saj, vepra me veprim ose mosveprim, përveçse të qënit shoqërisht e rrezikshme, duhet të jetë e parashikuar në një nga dispozitat e pjesës së posaçme të Kodit Penal në të cilat parashikohen të gjitha veprat, që konsiderohen vepra penale në Rrepublikën e Shqipërisë, krime apo kundërvajtje penale qofshin ato.

Ky parim është shumë i hershëm i së drejtës penale dhe prej kohësh është i shprehur në terminologjinë latine, *Nulla crimen sine lege*, nuk ka krim pa ligj , parim nga i cili rrjedhin dhe

dy parime të tjera komplementare me të si; *Nulla poena sine crimen,* nuk ka dënim pa ligj dhe *Nullum poena sine crimen*, nuk ka dënim pa krim. Për shkak të rëndësisë së madhe që ka, me kalimin e viteve , me kalimin nga e drejta zakonore në të drejtën pozitive, shprehja *Nullum crimen sine lege,* penalistët e kushtëzuan edhe me mbiemrin shtesë "*scriptium*", duke e formuluar, *Nulla crimesine lege scriptium,* nuk ka krim pa ligj të shkruar[153].

Në Kodin Penal të Rrepublikës së Shqipërisë ky parim gjen shprehje, më së miri në dispozitën e nenit 2 te Kodit Penal. Sikurse u përmënd sipas kësaj dispozite, askush nuk mund të dënohet penalisht për një vepër, e cila më parë, nuk është e parshikuar shprehimisht në ligj si krim ose kundërvajtje penale, si vepër penale, paragrafi i parë dhe askush nuk mund të dënohet me një lloj dhe masë dënimi të paparashikuar në ligj, paragrafi i dytë.

Ky parim plotësohet edhe me një parim tjetër i cili rrjedh prej tijë, parimin e ligjit të kohës që gjen shprehje juridike në paragrafin e parë të dipozitës se nenit 3 të Kodit Penal. Sipas kësaj dispozite, askush nuk mund të dënohet për një vepër që, sipas ligjit të kohës kur është kryer nuk përbënte vepër penale, që përbën rregullim[154].Kundërligjshmëria, konsiderohet se është e natyrës objektive. Kjo përcaktohet duke vënë në korelacion veprimin ose mosveprimin e individit me normat e së drejtës penale, në të gjitha rastet kur sjellja e njëriut është në kundërshtim me normat e legjislacionit penal të cilat urdhërojnë apo ndalojnë ndonjë veprim atëhere nund të themi se sjellja e njëriut është në kundërshtim me normat e legjislacionit penal të cilat urdhërojnë apo ndalojnë ndonjë veprim atëhere mund të konstatojnë se sjellja e njëriut është e kundërligjshme.

Sipas përkufizimit ligjor, kundërvajtjet janë cënime të rendit publik të përcaktuara me ligj dhe dispozita të tjera, për të cilat janë parashikuar dënime kundërvajtëse dhe masa mbrojtëse. Veprat penale janë janë vepra të rrezikshme, kundërvajtjet janë cënime të rendit publik dhe sit ë tilla paraqesin cënime të disiplinës shoqërore[155]. Me anë të veprave penale cënohen apo dëmtohen vlerat themelore të individit dhe të shoqërisë, kurse me kundërvajtje cënohen vlerat më të vogla të individit dhe të shoqërisë. Në teori mbizotron mendimi de kriteri kryesor për dallimin e veprave penale nga kundërvajtjet eshtë shkalla apo intensiteti i rrezikshmërisë shoqërore. Vepra penale është më rrezikshme, më e rëndë, më e padrejtë dhe për këtë arsye për veprat penale, në krahasim me kundërvajtjet, parashikohen dënime më të rënda.

[153] S.Spiro., Cikël leksionesh, "Ana Objekti I Figurës së Veprës Penale", UET, Tiranë 2008, Fq. 4

[154] Theksohet që përbën rregullim, pasi në paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 3 të Kodit Penal, përcaktohen dy rastet e fuqisë prapavepruese të ligjit penal, të cilat si përjashtime, përforëcojnë këto rregulla juridike. Ekzekutimi i dënimit nuk mund të filloje dhe nëse ka filluar, pushon. Kur ligji i ri nuk e konsideron ne figurë vepre penale këtë vepër, dhe zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që e ka kryer veprën penale. deri në momentin që vendimi nuk ka marrë formë të prerë, nëse vendimi ka marrë formë të prerë atëherë nuk ka fuqi.

[155] I. Salihu., vepër e cituar, Fq.208

Mirëpo, kundërligjshmëria edhe pse sipas natyrës së saj është komponent i natyrës objektive në disa raste ajo përmban edhe elementë subjektiv. Për shëmbull në dipozitën e nenit 247 "mbajtja pa të drejtë e uniformës, e një dokumenti apo e një shenje dalluese që tregojnë cilësinë e një punonjësi që kryen detyrë shtetërore apo një shërbim publik". Deri këtu përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet, por nëse kjo mbajtje e uniformës është bërë me qëllim fitimi ose ka prekur liritë apo të drejtat e shtetasve përbën vepër penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet. Nga ekzistenca ose jo e këtij elementi varet dhe cilësimi ligjor i veprës penale. Si konkluzion themi se veprimi ose mosveprimi është i kundërligjshëm, kur ai shkel ndonjë normë ndaluese apo urdhëruese, e cila me ligj është e parashikuar si vepër penale.

Ndonëse nga studimi i dipozitave të Kodit Penal kjo gjë nuk eshtë e shprehur qartazi, por lihet të nënkuptohet. Për shëmbull, dispozita e nenit 113 "ushtrimi i prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet". Ndonëse, nuk është thënë shprehimisht kundërligjshmëria ajo supozohet. Supozimi i tillë është plotësisht i arsyeshëm, sepse nëse një vepër nuk është e kundërligjshme, ajo nuk do mund të konsiderohet si vepër penale. Ndërsa në disa figura kundërligjshmëria shprehet qartazi, për shëmbull dispozita e neni 198 "vënia në dispozicion e lokaleve për organizimin apo luajtjen e llotarive, lojrave të fatit apo të bixhozit, në kundërshtim me dispozitat ligjore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj". Përmëndja në mënyrë të shprehur e elementit të kundërligjshmërisë në disa figura të veprës penale, nuk do të thotë se në veprat e tjera penale, te të cilat nuk është përmëndur ligjshmëria në figurën e tyre nuk janë të kundërligjshme. Përkundrazi kundërligjshmëria është element themelor dhe konstuitiv i të gjitha veprave penale, mirpo në disa rate për shkaqe praktike ky element përmëndet në mënyrë të shprehur.

Në rastet kur figura e ndonjë vepre penale ka tipare të njëjta apo identike me ndonjë kundërvajtje, shtrohet pyetja se a do të përgjigjet autori i veprës penale edhe për veprën penale edhe për kundërvajtje. Lidhur me këtë duhet theksuar se është përjashtuar mundësia e përgjegjësisë së dyfishtë apo paralele edhe për vepër penale edhe për kundërvajtje, personi i cili është dënuar për veprën penale nuk mund të dënohet edhe për kundërvajtje. Nocioni i figurës së veprës penale është më i gjërë se sa i kundërvajtjes, figura e veprës penale e përfshin kundërvajtjen e caktuar.

Disa autorë të së drejtës penale bëjnë dallimin midis kundërligjshmërisë, në aspektin formal dhe, kundërligjshmërisë në aspektin material[156]. Kundërligjshmëria në aspektin material, është dimension i brëndshëm paralel i shkeljes formale të normës që përbëhet nga cënimi i së mirës juridike, si një raport negative ndërmjet veprimit dhe të mirës juridike, me të cilën cënohet

[156] V. Kambovski., vepër e cituar, Fq.202

ekzistenca e saj stabile në rregullimin shoqëror nëpërmjet dëmtimit, prishjes apo vënies në rrezik.

Caktimi i kundërligjshmërisë është i rëndësishëm sepse kompleton anën objektive të veprës penale. Ana subjektive, fajsia, do të caktohet vetëm pasi të konstatohet se vepra penale është e kundëligjshme. Vlerësimi i kundërligjshmërisë është i rëndësishëm edhe në raport me institute të tjera penalo juridike, zbatimi i masave të sigurisë ndaj personave të papërgjegjshëm apo masat edukuese ndaj të miturve, kur mendohet se është kryer vepër e kundërligjshme.

Vlerësimi për kundërligjshmërinë bazohet në dy element: njëri prej të cilëve është pozitiv, duhet të ekzistojë patjetër; ndërsa i dyti, është është negativ, nuk ekziston. Si shkallë e parë dhe shpeshherë edhe e vetme në konstatimin e kundërligjshmërisë, supozohet se vepra është penale kur veprimi i plotëson të gjitha cilësitë e figurës ligjore të saj. Së dyti, në konstatimin e kundërligjshmërisë *in concreto,* kalohet vetëm nëse është shpallur kundërshim se, në rastin konkret, vepron ndonjë rrethanë për përjashtimin e kundërligjshmërisë.

Kundërligjshmëria ka dy dimensione, anën e saj formle, të cilën e përbën norma ndaluese, e përfshirë në figurën e veprës penale dhe, norma lejuese, e përfshirë në rrethanat për pëjashtimin e kundërligjshmërisë. Ana materiale e kundërligjshmërisë, e cakton esencën, e padrejtësisë e cila ndodhet në cënimin e marrëdhënieve juridike dhe është pjesë e përbashkët e figurës së veprës penale dhe i themelit për përjashtimin e kundërligjshmërisë. Cënimi i marrëdhënieve juridike, si anë materiale e kundërligjshmërisë ka disa kuptime [157]. Së pari, paraqitet si një kriter themelor për vlerësimin nga ana e ligjvënësit se cilat forma të prishjes së marrëdhënieve juridike do të konsiderohen figura vepra penale. Pesha e cënimit të së mirës juridike është një ndër rrethanat për matjen e dënimit nga ana e gjykatës. Bazat për përjashtimin e kundërligjshmërisë si pjesë e përbashkët e anës material, e kanë mungesën e cënimit të marrëdhënieve juridike, por përveç saj, mund të ekzistojë edhe mbrojtje e së mirës më të vlefshme si pjesë më vete, e pavarur, jashtë procesit penalo-juridik, për shëmbull nëse mjekut do ti duhet të shpëtojë nënën duke sakrifikuar embrionin gjatë shtatzanisë patologjike. Në aspektin material, rrethanat për përjashtimin e kundërligjshmërisë i përcakton elementi injëjtë material, që e përcakton edhe realizimin e figurës së veprës penale, cënimi i marrëdhënieve juridike. Gjatë përcaktimit të normave ndaluese dhe të rrethanave për përjashtimin e tyre, duhet të merren parasysh dy rregulla [158]. Së pari, nëse një veprim është juridikisht i urdhëruar me normë imperative, nuk mund të jetë njëkohësisht edhe juridikisht i ndaluar me normë ndaluese. Së dyti, veprimi juridikisht i lejuar nuk mundet njëkohësisht të jetë juridikisht i ndaluar, diçka e cila është parimisht e ndaluar në një fushë juridike, nuk mund të jetë parimisht e lejuar në një fushë tjetër juridike.

[157] Po aty, fq.205

[158] Po aty, fq.207

I takon juristit, gjykatësit, prokurorit, avokatit, të cilësojë, në bazë të thellimit shkencor të strukturës së veprës penale konkrete me anë të njohurive të përgjithëshme rreth teorisë së veprës penale, nëse jemi përpar një elementi që duhet analizuar nën faktin tipik objektivisht i kundërligjshëm apo të fajësisë. Si shëmbull, për të kuptuar konkretisht rëndësinë e analizës strukturore të veprës penale nën ketë profil, është i nevojshëm. Në figurën e veprës penale të vrasjes se kryer në gjëndje të tronditjes së fortë psikike, neni 82 i Kodit Penal, elementi i fyerjes së rëndë nga ana e viktimës duhet të krijojë një situatë tronditjeje të rëndë psikike të subjektit aktiv i cili në bazë të kësaj situate shkakton vdekjen e subjektit pasiv, në të kundërt kemi të bëjmë me një vrasje me dashje sipas dispozitës së nenit 76 e Kodit Penal. Lind pyetja, fyerja e rëndë duhet të konsiderohet nga ana objektive apo nga ana subjektive[159].

Pasoja, si element i anës objektive të figurës së veprës penale, kuptimi juridiko-penal i pasojës[160].

Në doktrinën e së drejtës penale shqiptare, me pasoja të veprës penale kuptohen ndryshimet që ndodhin nga veprimi ose mosveprimi i paligjshëm i personit dhe që prekin apo cënojnë marrëdhëniet juridike të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal[161].

Pasoja që vjen ose që mund të vijë nga kryerja e veprës penale, në literature juridike[162] ka gjetur trajtim të gjerë dhe të gjithanshëm. Kjo, për shkak të rëndësisë që ajo paraqet si, nga pikëpamja teorike, për dallimin e figurave të veprave penale në figura material dhe formale në përgjithësi, ashtu edhe nga pikëpamja praktike. Vetë veprimi, nuk ka rëndësi nëse nuk prodhon ndonjë efekt në marrëdhëniet shoqërore të mbrojtura nga ligji penal.[163]

Rëndësia e studimit të pasojës, nga pikëpamja praktike, qëndron:

---

[159] Për një kuadër të vendimeve të Gjykatës së Lartë mbi veprën penale të vrasjes shih:Vendimi i Gjykatës së Lartë, nr.216 datë 23.02.2011;Vendimi i Gjykatës së Lartë, nr.205 datë 09.02.2011;Vendimi i Gjykatës së Lartë, nr.1157 datë 07.07.2010;Vendimi i Gjykatës së Lartë, nr.519 datë 16.12.2009;Vendimi i Gjykatës së Lartë, nr.816 datë 10.02.2010;Vendimi i Gjykatës së Lartë, nr.1563 datë 01.12.2010;Vendimi i Gjykatës së Lartë, nr.486 datë 18.11.2009;Vendimi i Gjykatës së Lartë, nr.521 datë 02.12.2009;Vendimi i Gjykatës së Lartë, nr.514 datë 16.12.2009;Vendimi i Gjykatës së Lartë, nr.41 datë 01.04.2009

[160] Vendimet: Nr. 60, datë 15.02.2006; Nr. 291, datë 15.03.2007; Nr 62, datë 14.02.2007; Nr.63, datë 14.02.2007; Nr. 450, datë 09.05.2007; Nr.687, datë 31.10.2007; Nr. 732, datë 21.11.2007; Nr. 286, datë 04.06.2008; Nr. 201, datë 29.09.2008; Nr. 447, datë 08.10.2008; Nr. 494, datë 05.11.2008, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

[161] Elezi,I., Kaçupi, S., Haxhia, M., "Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë", Tiranë 2012, fq 118

[162] Robbin M.Perkins- Ronald N. Boyce, "Criminal laë and procedure", fq 1-2, 5-6

[163] Kambovski,V., "E drejta penale (Pjesa e përgjithshme)", Shkup 2010, fq 156

Së pari, në faktin se, duke u nisur prej saj, bëhet dallimi ndërmjet fazave të veprimtarisë përmes të cilave kalon vepra penale (kategoria e veprave penale që kryhen me dashje), veçanërisht, ndërmjet fazës së tentativës dhe kryerjes së plotë të veprës.

Së dyti, shprehet në faktin, se duke u nisur nga prania ose jo e saj (pasojës), në disa raste, arrihet në përfundimin nëse veprimet ose mosveprimet e një personi përbëjnë ose jo vepër penale.

Së treti, qëndron në faktin, se në rastet kur ajo kërkohet si element përbërës i anës objektive të figurës së veprës penale, pasoja shërben si një nga elementët bazë për të cilësuar veprën penale, sipas njërës apo tjetrës dispozitë konkrete të pjesës së posaçme të Kodit Penal, apo paragrafëve përbërës të tyre.

Së katërti, nuk janë të pakta rastet, që në varësi të pasojës (që ka ardhur ose që mund të vinte nga kryerja e veprës penale), natyrës, shkallës dhe madhësisë së saj, përcaktohet edhe shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, faktor ky që ndikon në llojin dhe masën e dënimit që duhet të caktohet ndaj personit që e ka kryer veprën penale.

Format e trajtimit të pasojës nga e drejta penale[164].

1.1 E drejta penale, pasojën e trajton si në kuptimin e gjërë, ashtu edhe në kuptimin e ngushtë të saj. Me pasojë, në kuptimin e gjërë të saj, e drejta penale kupton prekjen (cënimin) e marrëdhënieve shoqërore, që mbrohen në mënyrë të posaçme nga veprat penale nëpërmjet ligjit penal.Me këtë duhet kuptuar se nga veprat penale preken një kategori mjaft e gjërë marëdhëniesh shoqërore, marrëdhënie, të cilat përbëjnë dhe objektin e përgjithshëm të veprës penale. Ligjvënësi, këto lloj marrëdhëniesh shoqërore, i ka përfshirë në përmbajtjen e dispozitës së nenit 1/b të Kodit Penal[165] si një detyrim i ligjit penal për mbrojtjen e pavarësinë e shtetit, dinjitetin e njeriut, mbrojen e pronës, mjedisit etj.

Me pasojë, në kuptimin e ngushtë të saj, duhet kuptuar pasoja që vjen apo që mund të vijë nga cilado vepër e veçantë penale që parashikohet në njërën prej dispozitave konkrete të pjesës së posaçme te Kodit Penal[166]. Pasoja, mund të jetë materiale dhe jomateriale (formale).

[164] Vendimet: Nr. 770, datë 24.12.2007; Nr. 62, datë 06.02.2008; Nr. 115, datë 19.03.2008; Nr 221, datë 21.05.2008; Nr. 281, datë 04.06.2008; Nr. 471, datë 29.10.2008, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

[165]Kodi Penal i R.SH, Neni 1/b, Detyrat e legjislacionit Penal "Legjislacioni penal i R.Sh ka për detyrë të mbrojë pavarsinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin e njëriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues,pronën, mjedisin, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shqipëtarëve me pakicat kombëtare, si dhe bashkejetesën fetare nga veprat penale, si dhe parandalimin e tyre".

[166] Salihu, I., "E drejta penale (Pjesa e përgjithshme)", Prishtinë 2010, fq 261

Materiale, pasoja është atëherë kur ajo, jo vetëm që është e prekshme, që mund të perceptohet nga shqisat e njeriut, por ka një vlerë të caktuar, që është e shprehur në të holla (para)[167]. E tillë është, për shëmbull, pasoja e cila vjen nga krimi i vjedhjes së pasurisë, parashikuar ne nenin 134 (Vjedhja)[168] të Kodit Penal.

Për të patur këtë figurë krimi, është e domosdoshme që, veç elementëve të tjerë që i përkasin si anës objektive, ashtu edhe anës subjektive të saj, duhet që të jetë vërtetuar edhe pakësimi i pasurisë. Pikërisht, ky pakësim përbën edhe pasojën. Kurse, madhësia, vlera e saj, përbën shkallën e dëmit që përcakton, në fund të fundit, edhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale në çdo rast vjedhjeje të pasurisë. Madje madhësia e pasojës (pakësimit të pasurisë), sipas paragrafit III të dispozitës së nenit 134 (Vjedhja) të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, shërben si kriter përcaktues për cilësimin ligjor të veprës sipas këtij paragrafi. Kjo ka gjetur trajtim edhe në vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Duke bërë interpretimin e përmbajtjes së paragrafit të III të dispozitës së nenit 134 të Kodit Penal, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë , lidhur me madhësinë e pasojës (pakësimit të pasurisë) shprehen se: një ndër kriteret bazë për të përcaktuar pasojën e rëndë është vlera e pasurisë së vjedhur, e cila do të merret në çdo rast e lidhur me rrethanat e tjera që kanë ndikuar te subjekti i dëmtuar. Për të përcatuar "pasojën e rëndë" duhet patur parasysh se ajo do të jetë e ndryshme mes subjekteve që dëmtohen nga vepra penale e vjedhjes, që ndahen në, individë, persona juridikë dhe shteti. Kolegjet e Bashkuara përcaktojnë si kritere orientuese për vlerën si pasojë të rëndë:

- shuma ose sende me vlerë mbi 1000 000 lekë, kur ato u vidhen individëve.
- Shuma ose sende me vlerë mbi 2 000 000 lekë, kur vjedhja është realizuar në dëm të personave juridikë dhe pasurisë shtetërore.

sigurisht që këto vlera janë relative në varësi të vëndit, kohës apo subjektit i cili dëmtohet[169].

Edhe në rastin e figurave të krimit të shkatërrimit të pronës[170] pasoja që vjen ose që rrezikohet të vijë nga vepra penale, është materiale e vlerësuar në të holla, pavarësisht nga lloji i pronës, e cila e pëson nga shkatërrimi mëpërmjet mjeteve dhe formave të përdorura nga autori i veprës penale. Kur trajtohet pasoja e veprës penale në kuptimin e ngushtë të saj, duhet nënvizuar se, nëse ajo ekziston, d.m.th kur ajo ka ardhur si rezultat i veprimit ose mosveprimit shoqërisht të

[167] Muçi, Sh., "E drejta penale (Pjesa e përgjithshme)", Tiranë 2012, fq 146

[168] Kodi Penal i R.SH, Neni 134, Vjedhja "…..e njëjta vepër,kur ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga katër deri në dhjetë vjet "

[169] Vendim Unifikues Nr 5 datë 11.11.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

[170] Kodi Penal i R.Sh, seksioni III, Shkatërrimi I Pronës

rezikshëm të autorit të veprës penale, sipas teorisë së të drejtës penale, vepra penale konsiderohet e kryer plotësisht apo e thënë ndryshe, e konsumuar. Kurse, kur veprimi ose mosveprimi është kryer, por pasoja nuk ka ardhur për shkaqe të pavarura nga vullneti i autorit të veprës penale, vepra penale konsiderohet se ka mbetur në tentative.

Sa i përket, shkallës së madhësisë së pasojës vlen të trajtohet edhe nocioni i veprës së rëndësisë së vogël. Rrezikshmëria, si element i çdo vepre penale eshte e lidhur ngushtësisht me shkallën e dëmtimit të së mirës juridike e cila është e mbrojtur me të drejtën penale[171]. Mund të ndodhin raste që një person të kryej një vepër e cila i ka të gjitha tiparet e veprës penale të përcaktuara në ligjin penal, mirpo për shkak se vepra perbën një rrezikshmërisë të vogël, ajo nuk konsiderohet si vepër penale. Për shëmbull, personi A, vjedh në vetshërbim nje produkt ushqimor (biskotë,çokollatë), në veprimin e personit A janë përmbushur të gjithë elementët e veprës penale të vjedhjes, por shkalla e rezikshmërisë së kësaj vepre penale është e vogël, kësisoj kjo vepër nuk do të konsiderohet vepër penale pasi e humb karakterin kriminal dhe del jashtë sferës së të drejtës penale[172].Edhe pse vepra e rëndësisë së vogël, e cila paraqet shkallë të vogël të rrezikshmërisë apo nuk konsiderohet vepër penale, ajo do të mbetet vepër e kundërligjshme, por jo për të drejtën penale por për nje disipline tjeter[173], mund të trajtohet si një formë tjetër e veprës së ndaluar siç mund të jetë për shëmbull masë disiplinore, për të cilën mund të jepet ndonjë sanksion jopenal.

Për t'u vlerësuar një vepër e rëndësisë së vogël, duhet patur parasysh të gjithë elementët objektivë dhe subjektivë të cilat përbëjnë figurën e posaçme të veprës penale të kryer. Nocioni i institutit të veprës së rëndësisë së vogël parashikon: "Nuk është vepër penale ajo vepër e cila , edhe pse përmban tiparet e veprës penale të përcaktuar me ligj, është e rëndësisë së vogël. Vepra është e rëndësisë së vogël kur rrezikshmëria e saj nuk është e rëndësishmë për shkak të natyrës ose peshës së veprës, të mungesës ose pasojave të dëmshme të parëndësishme, të rrethanave në të cilën është kryer vepra, të shkallës së ulët të përgjegjësisë penale të autorit të veprës ose për shkak të rrethanave personale të autorit"[174].

Që të mund të aplikohet në praktikë ky institut duhet të përmbushen dy kritere, së pari kriteri objektiv (rrezikshmëria e veprës të jetë e vogël, e parëndësishme), dhe së dyti kriteri subjektiv (shkalla e ulët e përgjegjësisë penale të autorit dhe e rrethanave të tij personale) në mënyrë kumulative. Si kusht i natyrës objektive për t'u konsideruar një vepër e rëndësisë së

[171] Salihu,I., "E Drejta Penale (Pjesa e Përgjithshme)", Prishtinë 2010, fq 258

[172] Po aty

[173] Po aty

[174] Neni 7 i Kodit të përkohshëm penal të Kosovës

vogël, është që pasoja e dëmshme të jetë e parëndësishme apo të mungojë fare. Pasoja është e parëndësishme në rastet kur dëmtimi nuk e zvogëlon dukshëm vlerën e objektit të mbrojtur[175].

Nëse është pasoja e veprës e parëndësishme ap oe rëndësisë së vogël, kjo është një çështje faktike, të cilën gjykata duhet ta konstatojë në çdo rast konkret, duke pasur parsysh edhe natyrën dhe rëndësinë e saj.

Instituti i veprës së rëndësisë së vogël është parashikuar edhe nga legjislacioni Shqipëtar i para viteve '90. Në Kodin Penal të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë të vitit 1952 përcaktohej, "Nuk quhet krim një vepër, e cila, ndonëse parashikohet formalisht nga ndonjë dispozitë penale, nuk është shoqërisht e rrezikshme për shkak të rëndësisë së saj të vogël dhe të mungesës së pasojave të dëmshme"[176]. Të njëjtin qëndrim mban edhe Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqiperisë i vitit 1977, në të cilin përcaktohet "Nuk është vepër penale ajo që, ndonse parashikohet nga një dispozitë e ligjit penal, nuk është shoqërisht e rrezikshme për shkak të rëndësisë së saj të vogël"[177].

1.2 Efekti kryesor praktik i dallimit ndërmjet rasteve kur vepra penale është e konsumuar me rastet kur ajo ka mbetur në tentativë, qëndron midis shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, e cilësuar kjo rast pas rasti. Si rregull, veprat penale të konsumuara paraqesin shkallë rrezikshmërie më të madhe se veprat penale që kanë mbetur në tentativë. Në kuadër të se Drejtës Penale Ndërkombëtare për krimet ndërkombëtare, tentativa ndëshkohet, panvarësisht ardhjes ose jo te pasojës kriminale[178], me qëllimin që të parandalohet shkelja e mëtejshme e rregullave ndërkombëtare.

Pasoja jo materiale, përfaqëson cënimin e disa kategorive të tjera marrëdhëniesh shoqërore që mbrohen, në mënyrë të vaçantë, nga ligji penal, marrëdhënie këto që nuk vlerësohen në të holla[179]. Ato përfaqësojnë vlera të tjera shoqërore, jo më pak të rëndësishme dhe, shpesh më të rëndësishme se vetë marrëdhëniet, cënimi i të cilave shprehet në të holla.

Të tilla janë marrëdhëniet e vendosura në Republikën e Shqipërisë, në pajtim me normat e Kushtetutës, të së drejtës ndërkombëtare, me statutet e gjykatave ushtarake dhe penale ndërkombëtare si dhe konventat e ndryshme ndërkombëtare. Në fushën penale, për të siguruar të drejtën e të jetuarit, të mbrojtjes së shëndetit e të drejtat e tjera dhe lirive të njeriut të mbrojtura posaçërisht nëpërmjet dispozitave të kreut te parë të Kodit Penal, mardhëniet e vendosura për

[175] Salihu,I., "E Drejta Penale (Pjesa e Përgjithshme)", Prishtinë 2010, fq 261

[176] Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, i vitit 1952, Neni 2 paragrafi 3 (Përcaktimi i Krimit)

[177] Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, i vitit 1977, Neni 3 paragrafi 3 (Kuptimi i Veprës Penale)

[178] Xhafo, J., "E Drejta penale ndërkombëtare", Tiranë 2009, fq 140

[179] Muçi, Sh., "E drejta penale (Pjesa e përgjithshme)", Tiranë 2012 fq 146

mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të personit, që përbëjnë objektin e përgjithshëm të figurave të veprave penale, përfshihen në kreun e dytë të Kodit Penal.

Marrëdhëniet shoqërore të vendosura për mbrojtjen e mjedisit, që përbëjnë objektin e përgjithshëm të figurave të veprave penale, përfshihen në kreun IV të Kodit Penal. Marrëdhëniet shoqërore që janë vendosur për mbrojtjen e pavarësisë dhe rendit kushtetues të Republikës së Shqipërisë, përfshihen në kreun V të Kodit Penal. Raportet e vendosura për mbrojtjen e marrëdhënieve të Republikës së Shqipërisë me shtetet e tjera, parashikohen nga kreu VI i Kodit Penal.

Pasoja, si element i domosdoshëm përbërës i anës objektive të figurës së veprës penale[180].

2.1 Kur bëhet fjalë për pasoja, në kuptimin e ngushtë të fjalës, të drejtës penale i interesojnë, në mënyrë të veçantë, rastet kur pasojat janë elemente të domosdoshme përbërëse të anës objektive të figurës së veprës penale dhe, që janë pikërisht pasojat, të cilat bëjnë që vepra penale të cilësohet sipas njërës apo tjetrës dispozitë konkrete të pjesës së posaçme të Kodit Penal[181]. Në Kodin tonë Penal janë të shumta dispozitat, të cilat parashikojnë figura të veprave penale, që në anën objektive të tyre, veç të tjerash, si element të domosdoshëm, kanë edhe pasojën. Të tilla dispozita janë gjithësej 53, kurse në Kodin Penal Ushtarak janë 27 dispozita.

Në disa nga këto figura veprash penale, prania e pasojës kërkohet si element i domosdoshëm për praninë e anës objektive të tyre dhe të vetë figurës së veprës penale, në tërësinë e saj[182]. Mungesa e pasojës, në këto raste, passjellë dhe mungesën e vetë figurës së veprës penale. Kështu për shëmbull, për të patur figurën e krimit të torturës me pasoja të rënda, parashikuar nga neni 87 i Kodit Penal, kërkohet që nga ana objektive, tortura, si dhe çdo akt tjetër çnjerëzor të ketë sjellë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim të përhershëm të shëndetit të personit apo vdekjen e tij. Nëse, si rezultat i torturës apo i çfardo akti tjetër çnjerëzor, nuk ka ardhur ndonjëra nga katër prej pasojave që u përmëndën në mënyrë alternative, në përmbajtjen e kësaj dispozite, vepra penale nuk do të cilësohej sipas kësaj dispozite.

Nëse vërtetohet kryerja e veprimeve që cilësohen "torturë"ose "akt tjetër çnjerzor apo poshtërues", të pashoqëruara me gjymtimin, ose me çdo dëmtim të përhershëm të shëndetit të personit, ose me vdekjen e tij, vepra penale do të cilësohet torturë, parashikuar në nenin 86 të Kodit Penal.

---

[180] Vendimet: Nr. 60, datë 15.02.2006; Nr. 494, datë 05.11.2008; Nr. 447, datë 08.10.2008; Nr. 201, datë 29.09.2008; Nr. 286, datë 04.06.2008; Nr. 291, datë 15.03.2007; Nr. 62, datë 14.02.2007; Nr.63, datë 14.02.2007; Nr. 732, datë 21.11.2007; Nr 687, datë 31.10.2007 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

[181] Elezi,I., Kaçupi, S., Haxhia, M., "Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë" ,Tiranë 2012, fq 119

[182] Elezi,I., Kaçupi, S., Haxhia, M., "Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë", Tiranë 2012, fq 119

Po kështu, për të patur figurën e krimit të shpërdorimit të detyrës , parashikuar në nenin 248 të Kodit Penal, është kërkesë e domosdoshme, që përveç veprimeve ose mosveprimeve që vijnë në kundërshtim me ligjin dhe që përbëjnë mospërmbushje të rregullt të detyrës nga personi që ushtron funksione publike, duhet që, nga ana objektive, këto veprime ose mosveprime t'i kenë sjellë vetë personit që ushtron një funksion publik (që i kryen ato ose personave të tjerë), përfitime materiale ose jo materiale të parregullta apo ato (veprimet apo mosveprimet) të kenë dëmtuar interest e ligjëshme të shtetit, të shtetasve ose të personave juridikë .

Nëse, nuk vërtetohet ndonjëra prej këtyre pasojave, që edhe këtu, përmënden në mënyrë alternative, edhe pse nga ana e personit që ushtron një funksion publik mund të jenë kryer me dashje veprime ose mosveprime në kundërshtim me ligjin dhe që përbëjnë mospërmbushje të rregullt të detyrës, ai nuk mund të merret në përgjegjësi penale[183]. Mospërmbushja e rregullt e detyrës prej tij, por e pa shoqëruar me ndonjërën prej pasojave që u përmëndën, mund të jetë shkak për ta vënë atë para përgjegjësisë disiplinore, civile apo materiale, por jo penale.

2.2 Në pjesën dërmuese të dispozitave të Kodit Penal, në të cilat për ta cilësuar veprën penale, sipas tyre, nga ana objektive, përveç të tjerave, kërkohet edhe pasoja. Ekzistenca e pasojës tregon për një shkallë rrezikshmërie më të madhe të veprës dhe, bën që vepra penale të cilësohet me paragrafin përkatës (zakonisht të II ose të III) të dispozitës që parashikon figurën e veprës penale para së cilës ndodhemi, rast pas rasti[184].

Kështu për shëmbull, figura e veprës penale e ndërprerjes së shtatzanisë, e kryer në vënde dhe nga person të paautorizuar, parashikuar në nenin 94 të Kodit Penal, nga ana objektive kryhet me anë të ndërprerjes së shtatzanisë, që realizohet jo në ambjente spitalore publike ose klinika private të lejuara posaçërisht për këtë qëllim ose, tej kohës së lejueshme për ndërprerje (veç rastit kur ajo diktohet nga një shkak shëndetsor i justifikuar). Kur ndërprerja e shtatzanisë, në kushtet e përmendura më lartë, nuk shoqërohet me ndonjë pasojë, vepra penale do të cilesohet kundravajtje penale, me paragrafin e parë të dispozitës të nenit 94 të Kodit Penal.

Ndërsa, në qoftë se si rezultat i ndërprerjes së shtatzanisë, por në kushtet e lartpërmendura , ka ardhur ndonjëra prej pasojave që u përmëndën, në mënyrë alternative, në paragrafin e dytë të kësaj dispozite, si rrezikimi i jetës së gruas shtatëzënë ose vdekja e saj, vepra përbën krim dhe cilësohet me paragrafin e dytë të saj.

Karakteristikat konkrete të pasojës

[183] Spiro,S., Cikël leksionesh "Elementët përbërës të figurës së veprës penale", UET, Tiranë 2009, fq13

[184] Spiro,S., Cikël leksionesh "Elementët përbërës të figurës së veprës penale", UET, Tiranë 2009, fq 15

3.1 Përsa i përket pasojës, duhet patur parasysh rregulli sipas të cilit, për ta quajtur element të anës objektive të figurës së veprës penale, në të gjitha rastet, pasoja duhet të ketë karakteristikat konkrete të saj, ashtu sikurse është përshkruar në dispozitën e norms juridike penale përkatëse të pjesës së posaçme[185] të Kodit Penal, ose të ndonjë ligji të veçantë penal, sikurse është Kodi Penal Ushtarak.

Po të merret parasysh përmbajtja e dispozitave konkrete të pjesës së posaçme të Kodit Penal dhe të Kodit Penal Ushtarak të Republikës së Shqipërisë për pasojat, në ato figura veprash penale, prania e të cilave është e domosdoshme për ekzistencën e tyre ose e bën veprën penale të cilësuar[186], janë përdorur shprehje të tilla si: "pasoja të rënda",(nenet 87,134/III, 138/a, 141/a-II, 143/II,143/a-II, 183/II etj të Kodit Penal); "dëmtimi i rëndë i shëndetit" (nenet 96, 97, 114/b-II, 124, 276/II etj të Kodit Penal); "pasoja të rënda për jetën e shëndetin e njerësve" (nenet 151/III, 152/III, 154/III, 201, 207 etj të Kodit Penal); "vuajtje të rënda fizike" (neni110/II etj të Kodit Penal); "rrezikimi i jetës" (neni 97 etj të Kodit Penal); "vdekje" (nenet 88/II, 100/III, 101/III, 102/III, 102/a-III, 103/III etj të Kodit Penal); "vetëvrasje" (nenet 100/III, 101/III, 102/III, 102/a-III, 103/III etj të Kodit Penal).

3.2 Në disa dispozita në lidhje me pasojën, ligjvënësi ka përdorur karakterizime të veçanta, konkrete. Të tilla janë, për shëmbull, karakteristikat e pasojave që kërkohen për praninë e figurës së krimit të plagosjes së rëndë me dashje, të parashikuar nga paragrafi i parë i dispozitës së nenit 88 të Kodit Penal, të cilat ligjvënësi i përshkruan ose si "gjymtim", ose si "shëmtim", ose si "çdo dëmtim tjetër të përhershëm të shëndetit", ose si "ndërprerje të shtatzanisë" ose "që ka qënë e rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit të saj". Të tilla janë edhe karakteristikat e pasojave që kërkohen për ekzistencën e figurës së krimit të shkatërimit ose të dëmtimit të objekteve të kultit, parashikuar ne nenin 132 të Kodit Penal ku karakteristikat e pasojave që kërkohen për ekzistencën e saj janë: "humbja plotësisht ose pjesërisht e vlerave të tyre (të objekteve të kultit)".

3.3 Kërkesa për të mbajtur parasysh kurdoherë karakteristikat që përmban dispozita konkrete e Kodit Penal për pasojën që kërkohet për praninë e saj, ka rëndësi për zbatimin drejt të ligjit penal, për cilësimin ligjor të saktë të veprës penale, rast pas rasti[187].

Për realizimin e këtij qëllimi, veç interpretimit që u bëhet karakteristikave të pasojës nga teoria e së drejtës penale, kryesore është interpretimi që u bëhet atyre nga gjykata, të cilat, duke u bazuar në të dhënat konkrete të tyre, sipas natyrës së çështjes penale në shqyrtim, zbatojnë,

[185] Kambovski,V., "E drejta penale (Pjesa e përgjithshme)", Shkup 2010, fq 157

[186] Muçi, Sh., "E drejta penale (Pjesa e përgjithshme)", Tiranë 2012 , fq 147

[187] Delpino, L., "Diritto penale (Parte generale)", Napoli 2010, fq 878

sipas rastit, dispozitat që parashikojnë figurat e veprës penale që,kanë si element përbërës të domosdoshëm, edhe pasojën.

Ky proces, në praktikë, shpesh paraqitet i vështirë e i ndërlikuar. Për realizimin e tij, kërkohet mendimi i specializuar profesional, sipas fushave të veçanta të shkencës (mjeksi, financë, shkencat inxhinierike etj)[188]. Specialistë të fushave të ndryshme, të pajisur me njohuri shkencore, si mjekë, financierë, inxhinierë etj, thirren si ekspert për të dhënë mendimin shkencor në lidhje me faktin nëse, pasojat që vijnë nga veprime ose mosveprime të ndryshme shoqërisht të rezikshme, përmbajnë karakteristikat tekniko-shkencore të pasojës që kërkohet në dispozitën konkrete të Kodit Penal[189]. Një interes të veçantë paraqesin veprat penale të kryera në ndërmarrje[190].

Janë juristët (prokurorë, gjyqtarë), ata që, më pas duke u bazuar në përfundimet shkencore që kanë arritur ekspertet, vendosin, në pajtim me ligjin, për praninë në veprën e një personi konkret të pasojës (në kuptimin juridiko penal), që kërkohet në dispozitën përkatëse, sipas së cilës cilësohet vepra penale e kryer prej tij.

Kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim përbën unifikimi i praktikës gjyqësore, nëpërmjet vendimeve unifikuese që jepen me rastin e shqyrtimit të çështjeve konkrete penale. I tillë është, për shëmbull, Vendimi Nr. 5, datë 11.11.2003, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me të cilin është unifikuar praktika gjyqësore disa vjeçare në lidhje me kuptimin dhe përmbajtjen e karakteristikave që përbëjnë togfjalëshin (termin) “pasoja të rënda”, prania e të cilave përcakton që figura e krimit të vjedhjes së pasurisë, të cilësohet me paragrafin e tretë të nenit 134 të Kodit Penal.

Sipas këtij vendimi, nisur nga formulimi i bërë nenit 134/III të Kodit Penal, duke pranuar se ekzistenca qoftë edhe vetëm e rrethanës “pasojë e rëndë”, në rastin e vjedhjes së pasurisë , është e mjaftueshme që vepra e kryer të cilësohet sipas këtij paragrafi. Vetëm fakti që vjedhja e pasurisë të ketë sjellë pasoja të rënda, bën që ajo të konsiderohet e cilësuar.

Interpretimi i termit “pasoja të rënda”, duhet shqyrtuar në raport me vetë figurën e veprës penale, me raportet që ajo mbron dhe, duhet analizuar në çdo rast me disa rrethana që lidhen me dëmin e shkaktuar nga vjedhja, tipologjia e krimit etj[191].

---

[188] Mantovani, “Diritto penale (Parte generale)”, Padova 2001, fq 375

[189] Clifford E.Simonsen - Marshall S. Gordon III, “Juvenile Justice in America”, fq 318,348,373. Pikërisht, këto çështje paraqesin interes juridik në veprat penale të kryera nga të rinjtë, ku rëndësi të veçantë merr parandalimi i tyre.

[190] Philippe Conte, “Le risquë pënal dans l’enterprise”, Paris 2003

[191] Larry J. Siegel “Criminology”, fq 245-247

3.4 Nisur nga fakti që figura e veprës penale të vjedhjes ka si pasoje pakësimin e pasurisë së tjetrit në mënyrë të kundraligjshme, Kolegjet e Bashkuara evidentojnë faktin se një ndër kriteret bazë për të përcaktuar pasojën e rëndë është vetë vlera e pasurisë së vjedhur, e cila do të merret në çdo rast e lidhur me rrethanat e tjera që kanë ndikuar te subjekti i dëmtuar.

Ligjvënësi, nuk e kushtëzon vjedhjen me vlerën, dhe në paragrafin e tretë nuk përmëndet fjala vlerë. Prandaj, për të përcaktuar "pasojën e rëndë", duhet patur parasysh se ajo do të jetë e ndryshme mes subjekteve që do të dëmtohen nga vepra penale e vjedhjes, që ndahen në individë, persona juridikë dhe shteti.

Në raport me zhvillimin aktual ekonomik e gjëndjen social ekonomike të individit dhe të shoqerisë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, përcaktojnë si kritere orientuese për vlerën si "pasojë të rëndë", rastet e vjedhjes të parashikuara në nenin 134/III i Kodit Penal:

1.Shuma ose sende me vlerë mbi 1.000.000 lekë, kur ato u vidhen individëve.

2.Shuma ose sende me vlerë mbi 2.000.000 lekë, kur vjedhja është realizuar në dëm të personave juridikë dhe pasurisë shtetërore.

Këto vlera do të jenë relative, duke patur parasysh edhe pasojat e tjera që mund të shkaktohen nga kryerja e kësaj vepre penale. Gjykatat, rast pas rasti, duhet ta marrin atë lidhur me vëndin e kryerjes së veprës penale, kohën e kryerjes së saj, subjektin e dëmtuar dhe me pasojat e tjera jo ekonomike që mund të vijnë të cilat, kur rëndojnë rrethanat e faktit pavarësisht se vlerat mund të jenë më të vogla nga përcaktimet e mësipërme, mund ta bindin gjykatën për përfundimin se vjedhja ka sjellë pasoja të rënda, e ta kualifikojnë atë në bazë të nenit 134/III të Kodit Penal.

Gjykatat, detyrimisht kur arijnë në "përfundimin se ndodhemi para pasojës së rëndë, kërkohet të evidentojnë rrethanat konkrete, të cilat ndikojnë në një përcaktim të tillë e t'i arsyetojnë hollësisht në vendimet e tyre" [192].

Më së shumti, legjislacionet moderne bashkohore, ndër ta edhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, konsiderojnë si shkak kryesor të veprës penale atë veprim ose mosveprim të drejtpërdrejtë, që sjellë në mënyrë të domosdoshme ardhjen e pasojës (ose mundësinë e ardhjes së saj), të cilin e quan shkak i domosdoshëm i drejtpërdrejtë (determinant).

Në këtë mënyrë, duke përcaktuar atë që e quhet shkaku kryesor, e drejta penale, bën njëkohësisht edhe dallimin ndërmjet tij dhe shkaqeve të tjerë, të cilët, edhe pse mund të kenë një farë lidhje me pasojën, nuk luajnë rol, përsa i takon marrjes ose jo të një apo disa personave në përgjegjësi penale.

[192] Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.5, datë 11.11.2003

E drejta penale e Republikës së Shqipërisë, ashtu sikurse edhe teoritë penale bashkohore, pranojnë faktin që, për t'u konsideruar veprimi ose mosveprimi shkak i një pasoje, duhet që ai të jetë kryer në kohë, përpara ardhjes së pasojës. Pra, do të konsiderohet shkak për ardhjen e pasojës nisur edhe nga afërsia apo distanca në kohë e tij (veprimit ose mosveprimit) me vet pasojën.

Pasoja mund të jetë element i domosdoshëm i veprës penale ose rrethanë cilësuese e figurës së veprës penale. Dëmtimi i pronës nga pakujdesia, është vepër penale kur ka sjellë pasoja të rënda material. Kurse, kundravajtja penale e mosdhënies së ndihmës, është vetëm kur, si pasojë e saj, është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit, rrezikimi i jetës. Këto figura veprash penale nuk mund të ekzistojnë pa pasojën e parashikuar në dispozitën ligjore përkatëse. Në këto raste, pasoja është element përbërës i domosdoshëm i veprës penale.

Disa figura veprash penale nuk kërkojnë ardhjen e pasojës. Ardhja e pasojave e bën veprën të cilësuar, pra formon një tjetër figurë juridike të saj. Prodhimi i mjeteve për falsifikim, formon vepër penale pa qënë e nevoja e ardhjes së pasojës. Ndërsa, ardhja e pasojës së rëndë, formon figurë tjetër te kësaj vepre. Në këtë rast, ajo shërben si rrethane cilësuese e figurës së veprës penale .

Në shumë raste, vepra penale ose figura e saj, lidhen me ardhjen e pasojave alternative ose me ardhjen njëkohësisht të dy ose më shumë pasojave. Kur pasoja është alternative, mjafton ardhja e njërës prej tyre për të ekzistuar vepra penale ose figura e saj. Me dy a më shumë pasoja, janë veprat penale të përbëra dhe ato me dy objekte, si vjedhja me pasojë vdekjen e personit, (ku njëra pasojë është e nënkuptuar dhe tjetra është e shprehur në dispozitën përkatëse).

Në të tilla figura veprash penale, njëra pasojë quhet kryesore, ajo e cila mbrohet nga dispozita e shkelur, kurse tjetra ose të tjerat, të cilat mbrohen nga dispozita të tjera, quhen sekondare ose të prejardhura.

Pasojat kanë rëndësi jo vetëm për praninë e veprës penale ose të figurave të veprës penale, por edhe për shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale. Sa më të mëdha të jenë pasojat kriminale, aq më e lartë është rezikshmëria shoqerore e veprës penale, gjë e cila mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e dënimit, (sanksionit penal).

KREU VI

LIDHJA SHKAKËSORE (KAUZALE), SI ELEMENT I DOMOSDOSHËM I ANËS OBJEKTIVE TË FIGURËS SË VEPRËS PENALE.

Lidhja shkakësore (kazuale) si element përbërës i domosdoshëm i anës objektive të figurës së veprës penale[193].

E drejta penale shqipëtare ka përqafuar pikëpamjen sipas së cilës, lidhja që ekziston midis veprimit dhe mosveprimit shoqërisht të rrezikshëm dhe pasojës që ka ardhur ose që, mund të vijë prej tij, quhet lidhje shkakësore, kauzale[194].

[193] Për të hartuar këtë pjesë të temës, përveç teksteve të së Drejtës Penale që kam përmëndur në pjesën e mëparshme të temës, kam shfrytëzuar edhe artikuj shkencorë të botuar në revistën "Drejtësia Popullore", Nr 2, viti 1973, me autor Hajri Shehu, nr 2 viti 1975 dhe nr 6 viti 1982, me autor Spiro Spiro.

E drejta penale shqipëtare, udhëhiqet nga parimi sipas të cilit, veprimi apo mosveprimi i një personi, shërben si premisë për t'a vënë atë para përgjegjësisë penale, vetëm me kushtin që ai të ketë sjellë pasojën e dëmshme, ose kur prej tij, mund të vijë një pasojë e tillë, në kuptimin e gjërë të fjalës.

Kur bëhet fjalë për anën objektive të figurës së veprës penale, edhe sipas së drejtës penale shqipëtare, veprimi ose mosveprimi trajtohen si element përbërës i saj, vetëm në rastin kur ai është kusht për ardhjen e një pasoje të dëmshme ose për mundësinë e ardhjes së saj, bëhet fjalë për figura veprash penale material dhe jo ato formale ose të cunguara.

Por, ndryshe nga teoritë më të vjetra mbi lidhjen shkakësore, e drejta penale shqipëtare, si shkak për një apo disa pasoja të dëmshme, nuk konsideron të gjitha ato veprime ose mosveprime të cilat i paraprijnë këtyre pasojave, pavarësisht nga aftësia apo largësia që ato kanë në raport me këto pasoja.

Por, ndryshe nga teoritë e tjera, e drejta jonë penale ka përqafuar pikëpamjen e penalistëve , të cilët marrin në konsideratë edhe disa faktorë të tjerë kur shtrohet për zgjidhje secili nga veprimet ose mosveprimet kur bëhet fjalë për më shumë se një , dhe që të gjitha janë kryer në kohë, para ardhjes së pasojës, do të konsiderohen shkak për këtë pasojë.

Do të konsiderohen të gjitha veprimet apo mosveprimet të cilat janë kryer, në kohë para ardhjes së pasojës, një apo disa prej tyre? Çfarë do të shërbej si kriter për veçimin e njërit apo të disa prej tyre, për të arritur në përfundimin se ai apo ato kanë qënë shkaku i ardhjes së pasojës së dëmshme, rast pas rasti? Për t'i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, e drejta jonë penale, përkrah pikëpamjen sipas së cilës, për të arritur në përfundimin nëse një apo disa nga veprimet ose mosveprimet, të cilat, janë kryer në kohë, para ardhjes së pasojës, do të konsiderohen shkak për ardhjen e saj, niset edhe nga aftësia apo largësia e veprimit ose mosveprimit me vetë pasojën.

Aftësia apo largësia këtu, nuk duhet kuptuar vetëm në aspektin e distancës kohore, e cila përcaktohet nga koha që kalon nga momenti kur është kryer veprimi ose mosveprimi, deri në momentin kur vjen pasoja. Ky moment, megjithëse, herë pas here ka rëndësinë e vet, nuk është i vetmi. Aftësia apo largësia e veprimit apo mosveprimit, në raport me pasojën, duhet kuptuar edhe në aspektin e vijmësisë së pandërprerë të zhvillimit të lidhjes midis këtij veprimi apo mosveprimi, me pasojën domethënë në aspektin e vijmësisë së pandërprerë të zhvillimit të atij, që në të drejtën penale është bërë zakon të quhet "zinxhiri i zhvillimit të lidhjes shkakësore".

Sa më e lartë të jetë shkalla e vijmësisë së zhvillimit të zinxhirit të lidhjes shkakësore, aq më i afërt konsiderohet, si rregull, veprimi apo mosveprimi konkret që përbën hallkën e parë të këtij zinxhiri, me hallkën e fundit të tij, të cilën e përbën pasoja dhe e kundërta.

---

[194] Neni 13 (Lidhja shkakësore), Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

Nuk janë të paktat rastet kur, në praktikën e punës së tyre, punonjësit e organeve të ndjekjes penale dhe gjykatave, ndodhen para ngjarjeve në të cilat, veç veprimit ose mosveprimit të fillimit pra të atij që është kryer i pari deri në ardhjen e pasojës, të jenë kryer edhe veprime ose mosveprime të tjera , qoftë nga i njëjti person, qoftë edhe nga persona të tjerë. Veprimet ose mosveprimet që kanë shkaktuar pasojën, thënë ndryshe, veprimi ose mosveprimi, i cili në fund të fundit, ka qënë, pikërisht ai i cili ka sjellë pasojën edhe pse para, menjëherë, ose mbas tij, mund të jenë kryer edhe veprime të tjera të cilat mund të kenë një farë lidhjeje me pasojën, është ai që i intereson të drejtës penale.

Ky është veprimi ose mosveprimi i cili ka luajtur rol kryesor në ardhjen e pasojës. Ky, sikurëse thuhet shpesh, ka determinuar në ardhjen e pasojës. Roli i tij përcaktohet duke u bazuar në disa faktorë. Një nga këta faktorë, përcaktohet nga shkalla e lidhjes së veprimit ose mosveprimit, në raport me pasojën. Nisur nga ky kriter, pra nga shkalla e lidhjes së veprimit ose mosveprimit, në raport me pasojën, thuhet se, për t'u konsideruar nëse ka qënë ky apo ai veprim i cili ka sjellë pasojën, që ka determinuar në ardhjen e saj, duhet të plotësohet kushti që veprimi ose mosveprimi të ketë patur lidhje direkte, të drejtpërdrejtë me pasojën.

Lidhja direkte, e drejtpërdrejtë, që duhet të ekzistojë midis veprimit ose mosveprimit dhe pasojës, bën që veprimi ose mosveprimi që e plotëson këtë kusht, të emertohet shkaku kryesor ose shkaku determinant. Dhe është pikërisht lidhja midis veprimit dhe mosveprimit i cili përbën shkakun kryesor të pasojës, fenomeni të cilin e drejta penale e përkufizon lidhja shkakësore. Pikërisht, për këtë lloj lidhjeje shkakësore interesohet e drejta penale. Jo çfarëdo lloj lidhje shkakësore që mund të ekzistojë në fenomenet shoqërore, përfshirë edhe fenomenin penal, mund t'i interesojë së drejtës penale.

Duke e përcaktuar atë që e quan shkaku kryesor, e drejta penale, bën njëkohësisht edhe dallimin midis tij dhe shkaqeve të tjerë, të cilët edhe pse mund të kenë një farë lidhjeje me pasojën, nuk luajnë rol, përsa i takon, marrjes ose jo të një apo disa personave, në përgjegjësi penale.

Megjithatë, edhe për veprimet ose mosveprimet e personave, të cilat, megjithëse nuk kanë lidhje të drejtëpërdrejtë, por kanë njëfarë lidhjeje me pasojën, e drejta penale nuk është krejtësisht indiferente. Kjo ndodh atëhere kur veprimet ose mosveprimet e këtij lloji ndikojnë disi, deri në një farë mase, pozitivisht apo negativisht, në ardhjen e saj.

Lidja shkakësore sipas ligjeve të natyrës

Siç është e përcaktuar nga doktrina, por jo vetëm, që një veprim apo mosveprim të përbëjë vepër penale duhet të plotësojë të gjithë elementët e saj: objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive. Në këtë punim do të trajtoj vetëm një aspekt të elementëve të së drejtës

penale dhe kjo është lidhja shkaksore si element i anës objektive. Lidhja shkaksore është përmëndur për herë të parë nga filozofë si, Aristoteli, e më pas, është zhvilluar dhe trajtuar gjërësisht nga filozofët si Hymi, Kant, Bergson etj.

Rëndësia e lidhjes shkaksore, qëndron në kuptimin ndërmjet shkakut dhe pasojës së ardhur nga kryerja e veprës penale. Mungesa e mosplotësimit të këtij elementi të anës objektive, passjellë mungesën e përgjegjësisë penale të autorit të saj. Praktika ka treguar, se përcaktimi i lidhjes shkaksore në një vepërt penale, nga organet e procedimit, nuk është aq e thjeshtë, madje jo në pak raste është keqinterpretuar. Trajtimi dhe kuptimi i saktë i lidhjes shkaksore, ka qënë dhe është gjithnjë një pikë e nxehtë e doktrinës dhe jurisprudencës.

Struktura e fakteve të veprave penale gërshetohet me sjelljen e individit që mund të konsistojë në një veprim apo mosveprim mbi ngjarjen. Por që vepra penale të mund të quhet e kompletuar, duhet domosdoshmërisht ekzistenca e një elementi të tretë, një lidhje shkaksie mndërmjet sjelljes së mbajtur dhe faktit se çfarë ajo ka sjellë, duhet, pra që ngjarja të lidhet me sjelljen e një individi të përcaktuar, në mënyrë që t'i ngarkohet përgjegjësia për ngjarjen e ndodhur[195]

1. Fillesat e lidhjes shkaksore, si kategori filozofike

Sipas Aristotelit, Kronologjia e lidhjes shkaksore gjatë shekujve është e larmishme, ku mendimet e filozofëve herë janë ndërthurur dhe herë janë përplasur me njëra-tjetrën, por falë kësaj "përplasjeje", lidhja shkak pasojë u evidentua si një element shumë i rëndësishëm i sjelljes njerëzore dhe ku nga kjo sjellje vinte një pasojë. Mund të themi se nëse shkenca merret me sasinë dhe cilësinë e sendeve me ndihmën e kategorive, ndërkohë që filozofia dëshiron të jetë shkenca e shkaqeve dhe e qënies[196].

I pari, i cili ka trajtuar lidhjen shkaksore ndërmjet filozofëve ka qënë Aristoteli. Sipas tij, ekziston një shkak i pare, dhe ajo është qënia si qënie në vetvete[197]. Për Aristotelin, vendimtare është dëshira. Koncepti i shkakut tek ky filozof është i ndryshëm nga koncepti shkakut në ditët e sotme, ku shkaku zbatohet në kohë, në të cilën cilido term është një pasojë e termit paraardhës dhe shkak i termit pasardhës. Por, për Aristotelin ky koncept është i ndryshëm. Aristoteli dallon katër shkaqe, shkakun material, shkakun formal, shkaku efiçent dhe shkakun final.

[195] Cfr.Fiandaca. Causalita (raporto di), in Digeso delle disipline penalistiche, vol.II, Torino, 1988 fq.199

[196] Zhanë Hersh, Habia filozofike, një histori e filozofisë, "Aristoteli", fq 36

[197] Po aty fq 36

Për Aristotelin arritja e qëllimit final është shkaku i çdo procesi, duke patur parasysh se pa të ai nuk do të kishte ndodhur[198]. Qëllimi, është pra kushti i realizimit të veprës , ky qëllim mund të ishte i gjithëpërfshirës. Qëllimi, është shkaku vendimtar i ekzistencës aë veprës, për këtë filozof,shkaku final nuk ka të bëjë vetëm me veprimin e njerëzve ai mund të gjëndet kudo në strukturën e botës dhe të vet qënies.

Të katër shkaqet, në një farë kuptimi, janë ontologjikisht përbërës të qënies[199]. Aristoteli heton tranzicionin që ekziston nga materia e ngrirë dhe deri tek shkaku final. Gjithsesi mendimi i tij për shkakun final, nuk është përfundimtar dhe pikërisht, në tre shekujt e fundit, koncepti i lidhjes shkaksore u trajtua dhe u soll fuqishëm në vëmëndjen e filozofëve të asaj kohe.

Sipas Emmanuel Kant, përderisa shkenca ekziston, duhet të ekzistojnë gjykime të domosdoshme dhe universale, për më tepër për të qënë shkencore ata duhet të japin një dije të re, pra duhet të jenë sintetike, por për të qënë të domosdoshme dhe universale duhet që ato të jenë apriori. Sipas Kantit, gjykimet sintetike apriori janë të mundëshme, sepse shkakësia është një kategori e aftësisë sonë për të njohur arsyetimin tonë sepse është apriori, dhe nuk na vjen nga zakoni.

Sigurisht që zakoni mund të luajë një rol atëhere kur, vërehet përshëmbull, që një fenomen A pasohet rregullisht nga një fenomen B dhe ne zbatojmë atëhere për këto dy fenomene kategorine e shkaksisë. Kjo kategori (shkaksia), nuk ka qënë e prejardhur nga zakoni i vazhdimsisë së përhershme, ajo i përket apriori arsyetimit i cili i është ai që e bën atë të domosdoshëm dhe universal në procesin e njohjes[200]. Siç shihet, Kanti, pohon se në kohën në të cilën ndodhen[201], shkenca, tashmë është një realitet i cili nuk mund të mohohet më.

Sipas Henri Berkson, shkenca pozitive nisej nga parimi sipas së cilit çdo shjegim shkencor do të ishte i vlefshëm vetëm me kusht që të kishte një natyrë mekaniciste. Kjo gjë nënkupton se të gjitha fenomenet zhvillohen ne nivelin ku sundon shkaksia dhe e vetmja formë për ta shpjeguar në mënyrë të vlefshme ardhjen e tyre njëra pas tjetrës është ajo që mbështetet në mekanizmat në bazë të të cilave lidhen në një zinxhir të vetëm shkaqet dhe pasojat, në mardhëniet shkaksore ajo që ndodh më parë përcakton atë që vjen më pas[202].

Për ta kuptuar sakt konceptin e lidhjes shkaksore në aspektin filozofik, do të hasen vështirësi në interpretimin e saj ne sistemet juridike. Kjo sepse filozofia është e vetmja dije që

[198] Po aty fq 38

[199] Po aty fq 39

[200] Po aty "Emmanuel Kant" fq 144

[201] Njohja e shkencës në periudhën e kohës në të cilën Kanti jetoi. (Emmanuel Kant 1724-1804)

[202] Zhanë Hersh,Habia filozofike, një histori e filozofisë, "Henri Bergson", fq 234

arsyeton mbi arsyetimin[203]. Në konceptin e kazualitetit, nëse nuk bëjmë lidhjen shkak-pasojë, nuk mund të aplikohet sanksioni. Arsyetimi juridik bëhet gjithmonë mbi lidhjen shkak-pasojë kjo nënkupton që shkaku i një pasoje është një i vetëm dmth që arsyetimi nuk ka vetëm një shkak. Por filozofia nuk mund të pranojë vetëm një shkak, sepse gjithnjë del një "pse", cili ishte shkaku dhe po të mos ishte ai nuk do të ndodhte. Sistemi juridik pranon vetëm një shkak, gjykatësi nuk mund të pranojë shumë shkaqe[204].

2. Kapërcimi i problemeve të teorive shkakësore duke u referuar tek ligjet shkencore

Kritikat që u janë bërë teorive shkakësore sipas ligjeve të natyrës, të treguara deri këtutani, kalohen vetëm nëse bëjnë një shpjegim të shkakut të përgjithshëm, domethënë nëpërmjet referimit tek ligjet e vlefshme shkencore. Nga ana tjetër vetë parimi i legalitetit nuk lejon që të mos meret parasysh një shpjegim kazual i bazuar në parametra objektivë, të qartë dhe që ti nënshtrohen kontrollit. Që problemi i lidhjes shkaksore të paraqitet si një problem njohje e njeriut mbi kontrrollin e sjelljeve të tija , duke vepruar apo të dominojnë fenomene të caktuara , është e pamohueshme, dhe këtu duhet të vlerësohet Aristoteli i cili arriti ta kap këtë element dhe të fillonte kërkimet e tij.

Gjithsesi, ky kërkim nuk mund të bëhej vetëm mbi bazën e eksperiencës së njohjes sepse, në të kundërt, do të kemi shumë nocione të kazualitetit, aq sa janë të ndryshme nivelet e njohjes së njerëzve[205], dhe as me eksperiencën mesatare të njohjes së njerëzve sepse, për ndryshe, do të ribëhej i njëjti gabim si në teorinë adekuate, por mbi bazën më të mirë shkencore dhe të eksperiencës në këtë lëndë dhe në këtë periudhë historike të caktuar[206], duhet veprimi i kazualitetit njerëzor nën ligjet natyrale-shkencore që shprehin rregulla të caktuara për ngjarje, që mund të ndodhin dhe kanë një vlefshmëri për kontrollueshmërinë e tyre empirike.

Është pikërisht ky concept, që e rilidh teorinë kondicionaliste të orientuar sipas modelit të veprimit nën ligjet e natyrës[207], për të përcaktuar nëse një fakt që ka ndodhur me parë, mund të konsiderohet shkaku i një ngjarje të mëvonshme, do të jetë e nevojshme të kontrollohet që ajo futet në bashkësinë e atyre ndodhive që , në bazë të një vazhdimësie të rregullt sipas një ligji të natyrës, dërgojnë në ngjarje si ajo që ka ndodhur në rastin konkret.

---

[203] Artan Fuga, cikël leksionesh, "Përse nevoitet Filozofia e së drejtës",leksioni I . U.E.T Tiranë 20.03.2010

[204] Po aty

[205] MANTOVANI, Diritto penale, 2001 fq 108

[206] Luigi Delpino, DIRITTO PENALE, Parte Generale, Simone 2006 fq 283

[207] Këtë e kanë pohuar edhë autorë të tjerë si: STELLA:la nozione penalmente rilevante di causa, la condizione necesaria, in Riviste italiana di diritto e procedura penale, 1988, pag 1217

Gjetja e një ligji të natyrës, që e mbulon ngjarjen, krijon premisën për ta shtrirë atë në faktin (në sensin) e verifikimit nëse një sjedhje njerëzore , është apo jo shkaku i një ngjarje të caktuar. Sigurisht që ligji që e mbulon këtë ngjarje , nuk duhet të jetë domosdoshmërisht universal, rrjedhimisht e aftë të pohojë që asaj sjellje i përket gjithmonë kjo ngjarje, por sigurisht mund të jetë edhe statike, domethënë duke u bazuar vetëm në mundësi të lartë probabiliteti të verifikimit të ngjarjes, si pasojë e asaj sjellje të caktuar, por, në këtë rast të fundit, ligji duhet të jetë i tillë që të shpjegojë numrin më të madh të ngjarjeve, dhe, ngjarja konkrete mbi të cilën diskutohet nuk duhet të ketë shpjegime të tjera të mundshme[208].

Kazualiteti i një ngjarjeje, është bashkësia e të gjitha fakteve që paraprijnë, pa të cilat ngjarja nuk do kishte ndodhur. Për të patur ekzistencën e lidhjes shkaksore, mjafton që individi të ketë realizuar njërën nga kushtet e ngjarjes. Çdo ngjarje provokohet nga një sërë ndodhish te cilat paraprijnë (të pandashëm dhe të padallueshëm), nga njëri-tjetri për efekshmërinë kazuale. Që sjellja te mund të konsiderohet shkaku i ngjarjes mjafton që të përbëjë njërën nga veprimet që kanë paraprirë në pasojën e ardhur[209]

Pasi gjëndet ligji, kontrollohet nëse fakti konkret mund t'i nënshtrohet atij. Për këtë, është i nevojshëm një sqarim, ripërshkrimi i ngjarjes së ndodhur duhet të bëhet, me qëllim që ngjarja specifike t'i bashkëngjitet kuptimit të përgjithshëm të ligjit, jo në mënyrë abstrakte, por as në mënyrë shumë të plotësuar dhe specifike, që të merren parasysh, të gjitha modalitetet, mënyrat se si shprehet një veprim, dhe rrethanat që kanë shoqëruar sjelljet dhe bën të mundur zhvillimin e ngjarjes, sepse këto modalitete jo gjithmonë janë të njohura, por duke përfshirë ato aspekte pasive[210] të përsëritshme, në mungesë të të cilave, ngjarja nuk do të kishte mundur të ndodhte " këtu" ose nuk do te kishte ndodhur "tani"[211].

Kuptimi i përgjithshëm i lidhjes shkakësore[212]

Struktura e fakteve të veprave penale gërshetohen me sjelljen e individit që mund të konsistojë në një veprim ose mosveprim mbi ngjarjen. Por që vepra penale të mund të quhet e kompletuar, duhet domosdoshmërisht një element i tretë, një lidhje shkakësie ndërmjet sjelljes se

[208] Po aty

[209] Luigi Delpino.Diritto Penale, parte generale- il rapporto di causalita, generalita. Simone, 2006 fq 279

[210] Termi "pasiv", në këtë rast, është një sinonim që është përdorur për të shprehur një objekt i cili mund të jetë i ndikueshëm nga faktorë dhë proçese të jashtme

[211] Luigi Delpino. Diritto Penale parte generale- il rapporto di causalita, Simone 2006 fq 285

[212] Vendimet: Nr. 6, datë 15.02.2006; Nr. 26, datë 19.01.2006; Nr 778, datë 20.12.2006; Nr. 119, datë 05.03.2008; Nr. 50, datë 04.07.2007; Nr. 537, datë 27.06.2007 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

mbajtur dhe faktit që ajo ka rrjedhur, duhet pra, që ngjarja të lidhet me sjelljen e një individi të përcaktuar, në mënyrë që t'i ngarkohet përgjegjësia mbi ngjarjen e ndodhur[213].

Domosdoshmëria e nevojës së këtij elementi të tretë, shprehet edhe nga legjislacioni shqipëtar të Republikës së Shqipërisë. Kështu, sipas dispozitës së nenit 13 të Kodit Penal të Rrepublikës së Shqipërisë "askush nuk ka përgjegjësi penale kur ndërmjet veprimit apo mosveprimit të tij dhe pasojave apo mundësisë së ardhjes së tyre, mungon lidhja shkakësore"[214]. Këtu gjen shprehje edhe një parim kushtetues, sipas së cilit përgjegjësia penale është individuale, duke mohuar kështu mundësinë e ndëshkimit për vepra penale që nuk janë kryer nga individi.

Në këtë pikë është e rëndësishme të qartësoht çështja se në çfarë konsiston lidhja shkakësore?

Përgjigjia e kësaj pyetjes nuk nxjerr në pah ndonjë gje të madhe, sepse përpunimi i mendimit shkencor dhe filozofik siç përmëndet edhe me lart, ofron një nocion mbi kazualitetin, e cila mund të transferohet dhe përdoret edhe nga fusha juridike, ku mund të përmendim parimin e përgjegjësisë individuale, e cila është shumë e rëndësishme në të drejtën penale. Dhënien e përkufizimit të lidhjes shkakësore, përcaktimin e përmbajtjes dhe karakterit objektiv të saj, në përgjithësi e bën teoria e disiplinës të së drejtës penale.

Ajo e konsideron lidhjen shkakësore si një nga elementët e domosdoshëm përbërës të anës objektive të figurës së veprës penale[215]. Mund të pranohet pra, që termi lidhje shkakësore, do të thotë qëndrim bashkë të kushteve empirike që paraprijnë, afërsinë në hapsirë dhe të vazhdueshme në kohë, nga të cilat varet vërtetimi i ngjarjes, sipas një uniformiteti të rregullt, qartësisht e shprehur më parë në një ligj[216].Duke marrë parasysh siç u tha më lart, se çdo ngjarje është rezultati i një sërë bashkimi ndodhish apo episodesh të cilat paraprijnë, rrjedhimisht kazualitetin. Në sensin natyralist, përbëhet nga bashkësia e kushteve të domosdoshme dhe të mjaftueshme, edhe, që sjellja e njëriut formon vetëm njërën nga këto kushte , por jo vetëm, duke u përsëritur bashkë me atë në një mori kushtesh të tjera të jashtëme, të realizuara nga persona të tjerë apo nga natyra, mund të shtrohet pyetja, se kur është njeriu autori i asaj ngjarjeje, dhe kur është përgjegjës për të, dhe çfarë rëndësie ka në aspektin penal ata faktorë të cilët hyjnë, pavarësisht nga sjellja njerëzore, në serinë kauzale dhe të cilat të dërgojnë tek ngjarja.

Dhënia përgjigje këtyre pyetjeve, përbën problemin e shkakësisë në të drejtën penale[217]. Është e rëndësishme që organet e drejtësisë, të gjejnë dhe të përcaktojnë shkakun kryesor që ka

[213] Cfr.Fiandaca. Causalita, in Digeso delle Disipline Penalistiche, vol.II, Torino 1988, fq 199

[214] Neni 13 i Kodit Penal të Rrepublikës së Shqipërisë

[215] S.Spiro,. Cikël leksionesh, Lidhja shkakësore në të drejtën penale, UET, Tiranë 2008, Fq 6

[216] L.Delpino., Diritto Penale, parte generale, Napoli 2010, fq.280

[217] Po aty, Fq. 280-281

sjellë pasojën, shkakun e domosdoshëm të drejtpërdrejtë, sepse jo çfarëdolloj shkaku mund të jetë ai që sjell pasojën. Për ta bërë më të qartë le të marrim një shëmbull: A-ja, për shkak të shpejtësisë tej normave të lejuara të qarkullimit rrugor, aksidenton B-në duke i shkaktuar atij plagë të shumta në trup.pas mbërritjes gjallë në spital, B-ja, nuk kurohet në kohë nga personeli mjeksor dhe pas pritjes së gjatë në koridoret e pavionit, ai vdes. Ekspertiza mjeko ligjore, konstaton se nëse B-së do ti ishte dhënë ndihma mjeksore në kohë, ai edhe mund të mos kishte vdekur.

Në përgjigjen e këtij kazusi, nuk mund të arrihet në përfundimin që shkaku determinant për vdekjen e B-së, nuk është aksidenti i tij nga ana e A-së si pasojë e shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, i cili megjithëse është një ndër shkaqet, nuk mund të thuhet se ai është shkaku i cili ka sjellë pasojën e vdekjes, por vdekja mund të ketë ardhur si pasojë e mosveprimit nga ana e personelit mjeksor. A-ja në këtë rast do të përgjigjet për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor me pasojë plagosjen e rëndë, kurse personeli mjeksor për vepër tjetër penale, sipas rastit.

Pra, siç shihet, në një rast të tillë, lind nevoja e përcaktimit të sakt të lidhjes shkakësore, sepse për vdekjen e B-së, kanë vepruar edhe faktorë të tjerë të cilët kanë ndërhyrë në rrjedhën normale kazuale, sepse nëse B-ja do të kishte vdekur në vënd nga aksidenti i A-së, përgjigjia do të ishte e thjeshtë, por në variantin se cilët do të përgjigjen penalisht dhe cilët prej tyre jo, lind domosdoshmërisht nevoja e argumentimit të këtij diferencimi. Lind nevoja e përcaktimit të bazës së përgjegjësisë penale të personave që duhet të merren në përgjegjësi penale.

Po njëlloj, lind nevoja e argumentimit të shkakut se përse, për një apo disa persona që kanë kryer veprimet ose mosveprimet që i paraprijnë pasojës, vdekjes së viktimës, nuk ka bazë për t'i vënë para përgjegjësisë penale. Dhënia e një përgjigje të drejtë, të bazuar shkencërisht, kësaj pyetjeje, shërben si kriter përcaktues nëse vënia ose jo përpara përgjegjësisë penale të një apo disa personave, për një ose disa pasoja të dëmshme, të konstatuara në rrethana të caktuara, është e bazuar në ligj dhe e kundërta. Ka të bëjë pra, me respektimin e parimit të ligjshmërisë në procesin penal[218].

Karakteri objektiv i lidhjes shkakësore, fillon të shfaqet menjëherë mbas kryerjes së veprimit apo mosveprimit shoqërisht të rrezikshëm dhe vazhdon deri në ardhjen e pasojës së dëmshme, deri në shkaktimin e saj[219]. Për ta bërë më të qartë, mjafton të sjellim një shëmbull, personi A, shtie me pistoletë ndaj personit B. Në momentin që A-ja tërheq këmbëzën e pistoletës, i cili është një veprim i vullnetëshëm, zhvillimi i situatës së mëtejshme, nuk varet më prej tij, por i nënshtrohet ligjeve të fizikës, të cilat zhvillohen objektivisht. Goditja e B-së ose jo, nuk varet më nga A-ja, mund të rastisë që pistoleta të jetë me defekt, predha mund të jetë e dëmtuar, vjaska

[218]S.Spiro,. Cikël leksionesh, Lidhja shkakësore në të drejtën penale, UET, Tiranë 2008, Fq. 5

[219] Po aty, Fq 10

e pistoletës mund të jenë të dëmtuara dhe të mos realizohet shkrepja apo mund të ndodh që B-ja të pengohet dhe të rëzohet në momentin që A-ja shtie me pistoletë etj, etj. Por, pavarësisht se pasoja e dëshiruar nga A-ja mund të mos vijë, ai përsëri do të merret në përgjegjësi penale, sepse vetë formulimi i nenit 13 të Kodit Penal, përcakton se "…apo mundësisë së ardhjes së tyre…".

Ekzistenca e lidhjes shkakësore në veprat e kryera me veprim ashtu edhe në ato të kryera me mosveprim.

Lidhja shkakësore ekziston si në veprat penale të kryera me veprim, ashtu edhe në veprat penale të kryera me mosveprim, si në veprat e kryera me dashje, ashtu edhe në ato të kryera nga pakujdesia[220], por sigurisht në rastet e mosveprimit dhe pakujdesisë, shkalla e vështirësisë në përcaktimin e shkakut kryesor, bëhet edhe më e madhe. Në Kodin Penal aktual, figurat e veprave penale, të cilat nga ana objektive, kryhen me mosveprim, ndahen në dy kategori. Në kategorinë e parë, bëjnë pjesë ato figura veprash penale të cilat, nga ana objektive kryhen me mosveprime, për ekzistencën e të cilave , kërkohet edhe pasoja, nenet 96 (Mjekimi i pakujdesshëm), 97 (Mosdhënia ndihmë), 181\a midis kryerjes së detyrimeve që lidhen me vjeljen e taksave dhe pasojës, dëmit të shkaktuar shtetit , sistemit fiskal duhet të ketë lidhje shkakësore të drejtpërdrejtë (Moskryerja e detyrave nga organet tatimore), etj të Kodit Penal, dhe në kategorinë e dytë, bëjnë pjesë ato figura veprash penale, të cilat nga ana objektive kryhen me mosveprim, që për ekzistencën e tyre, nuk kërkohet ardhja e ndonjë pasoje, në nenet 125 (Mosdhënia e mjeteve për jetesë), 126 (Mosnjoftimi i ndryshimit të vëndbanimit), 180 (fshehja e të ardhurave ose i objekteve që i nënshtrohen tatimeve dhe taksave), 300 (moskallzimi i një krimi që është kryer apo që është duke u kryer) etj[221].

Nga pikëpamja objektive, mund të ekzistojë lidhje e padyshimtë midis veprimit dhe pasojës së ardhur prej tij, por kjo nuk është e mjaftueshme për të pranuar lidhjen shkakësore, në qoftë se në kryerjen e veprimit mungon vullneti i autorit të saj. Ndërmjet lidhjes shkakësore dhe anës subjektive ekziston lidhje e ngushtë me ndikim të ndërsjelltë. Për derisa vepra penale është produkt i njeriut të përgjegjshëm, edhe lidhja shkakësore, si kusht i ekzistencës së saj, ekziston kur personi është në gjëndje të kuptojë në përgjithësi zhvillimet e saj, pasojat e dëmshme që sjellin veprimet ose mosveprimet e tij.

Lidhja shkakësore, ekziston edhe në rastet e bashkëpunimit. Nëse vepra penale e ardhur, është pasojë e bashkëpunimit, sigurisht që shkaqet e ardhjes së pasojës apo mundësisë së ardhjes së saj janë të ekzekutorit, por duke iu referuar nenit 27 të Kodit Penal, përgjegjësia e bashkëpuntorëve, është e barabartë, në kuptimin që ata përgjigjen për të njëjtën vepër penale, por gjykata duhet të çmojë pjesmarrjen dhe rolin e secilit në pasojën e ardhur.

[220] Sh.Muçi., E drejta penale, Pjesa e përgjithshme. Tiranë 2012, fq 119

[221] S.Spiro.,Cikël leksionesh,Lidhja shkakësore në të drejtën penale, UET, Tiranë 2008,Fq 40-42

Trajtimi doktrinal i lidhjes shkakësore në të drejtën penale bakëkohore në përgjithësi dhe në të drejtën penale të Republikës së Shqipërisë.

Është vëndi për tu vënë në dukje se, në shumicën e Kodeve Penale , të vëndeve të ndryshme, jo vetëm që nuk jepet ndonjë përkufizim për lidhjen shkakësore, por as që përmendet thjesht si nocion. Zakonisht, nevoja e ekzistencës së lidhjes shkakësore del nga përmbajtja e dispozitave të veçanta të këtyre kodeve, kuptohet nga mënyra e formulimit të tyre (kjo ndodh sidomos në figurat e veprave penale materiale).

Megjithatë, ka edhe shtete, që në Kodet Penale të të cilëve, përveç nënkuptimit të ekzistencës së lidhjes shkakësore nga vetë përmbajtja dhe formulimi i dispozitave të veçanta të tyre , ka dispozita të posaçme, të cilat, në forma të ndryshme, kanë lidhje posaçërisht me element të anës objektive të figurës së veprës penale.

Këtë linjë ka ndjekur tradicionalisht edhe ligjvënësi shqiptar, në të tre Kodet Penale që janë miratuar në Shqipëri, pas çlirimit. Kështu ne Kodin Penal të vitit 1952, titulluar "*Kauzaliteti*", ishte parashikuar se "*Një person është përgjegjës penalisht vetëm kur ka lidhje kauzale ndërmjet veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojave shoqërisht të rrezikshme* ". Edhe Kodi Penal i vitit 1977 ka patur një dispozitë të veçantë , e cila titullohej "*Lidhja shkakësore*", në të cilën ishte parashikuar që, "*Personi ka përgjegjësi penale , kur midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojave shoqërisht të rrezikshme ka lidhje shkakësore* ". Për këtë element, edhe në Kodin Penal të vitit 1995, ka një dispozitë të posaçme, e titulluar edhe kjo "*Lidhja shkakësore*", ligjvënësi ka parashikuar që, "*Askush nuk ka përgjegjësi penale kur midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojave apo mundësive së ardhjes së tyre , mungon lidhja shkakësore*".

Sikundër shihet, ndryshe nga përcaktimet e Kodeve Penale të mëparshëm, Kodi Penal në fuqi, veç faktit që , në lidhje me këtë element të anës objektive të figurës së veprës penale, shprehet në formë përjashtuese (*duke përdorur fjalën "askush", përjashton nga përgjegjësia penale personat veprimet ose mosveprimet e të cilëve nuk kanë lidhje …..*), në krahasim me dy Kodet e mëparëshme, veç pasojave që kanë ardhur, ka përfshirë në formë qartësisht të shprehur, edhe mundësinë e ardhjes së tyre. Kjo, për mendimin tim jo vetëm që përbën risi, por çka është më e rëndësishme, duke shtuar shprehjen "*…apo mundësisë së ardhjes së tyre…*", plotëson tablonë, kufijtë deri në të cilat mund të shtrihet lidhja shkakësore edhe më ligj, detyrë që para miratimit të këtij Kodi, e realizonte vetëm teoria e së drejtës penale.

Që në fillim, duhet thënë se , kanë qënë pikërisht vështirësitë që paraqet zbulimi i lidhjes shkakësore dhe rëndësia që ka konkretizimi i lidhjes shkakësore për vënien e personit para përgjegjësisë penale, rast pas rasti, faktorët për shkak të të cilëve , që herët (viti 1858) janë formuluar teori të shumta rreth saj.

Problemi i lidhjes shkakësore ka qënë dhe vazhdon të mbetet edhe sot, kudo si një nga më të ndërlikuarit e Pjesës së Përgjithshme të së drejtës penale. Kujdes i madh, trajtimit të kësaj çështjeje, i është kushtuar në literaturën juridiko-penale gjermane, italiane dhe greke[222]. Trajtim mjaft të gjërë, ajo ka gjetur edhe në literaturën juridiko-penale të vendeve të ish-demokracive popullore, sidomos në atë ruse[223]. Kurse në vëndin tonë, megjithëse , kjo çështje vazhdimisht, ka gjetur pasqyrim në ligj dhe i është dhënë rëndësi në praktikën e punës së organeve të drejtësisë, me përjashtim të pak shkrimeve të botuara në revistat juridike të kohës [224], dhe trajtimit të shkurtër në tekstet mësimore[225], por duhet të thuhet që nga pikëpamja teorike ajo nuk është zhvilluar sa duhet. Ka edhe shtete të tjera, sikurse në Francë[226] në të cilat mbizotëron mendimi se çështja e lidhjes shkakësore është çështje praktike, të cilën duhet ta zgjidh jurisprudenca, kështu që, trajtimit teorik të saj, i kushtojnë rëndësi më të vogël.

Doktrina e së drejtës penale shqipëtare, midis qëndrimeve të shumta, me nuanca të ndryshme, shpesh thelbësore për lidhjen shkakësore, ka përqafuar pikëpamjen sipas së cilës lidhja shkakësore është një kategori objektive , si një kategori që shpreh lidhjen midis shkakut dhe pasojës të një fenomeni, në linjat e përgjithshme të saj, ajo zhvillohet jashtë dhe pavarësisht vullnetit të njeriut[227]. Duhet sqaruar që, deri në momentin e kryerjes së veprimit ose mosveprimit që ka sjellë pasojën, kemi të bëjmë me veprime dhe mosveprime të vullnetëshme, kryerja dhe moskryerja e të cilave varet nga personi konkret [228]. Janë pikërisht, këto veprime dhe mosveprime , të cilat paraqesin interes për të drejtën penale.

Përqasja e kësaj teorie nga jurispridenca e vëndeve fqinje

Përsa i përket përqasjes me këtë teori nga ana jurisprudencës, zhvillim solli Vendimi nr.4793 i datës 29 PRILL 1991 të Seksionit të Pestë të Gjykatës së Kasacionit të Italisë, mbi katastrofën e Stavës, e cila, me këtë vendim, pranoi në fakt në mënyrë të plotë përqasjen ndaj

[222] E Drejta Penale, Pjesa e përgjithshme, I.Manoledhaqis, Selanik 1996, fq.153

[223] E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme, Redaktor, Prof.Dr. B.N.,Pjetrasheva , Moskë 1999, fq 168-176

[224] Revista Drejtësia Popullore e vitit 1972,1975

[225] E Drejta Penale e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Pjesa e Përgjithshme, A.çela, N.Peza, I. Elezi, G.Gjika, Tiranë 1982, fq 115-128

[226] E Drejta Penale, N.Sërzentiq, A.Stajiq, Prishtinë 1972, fq 70

[227] Sh.Muçi., vepër e cituar, fq.146

[228] V.Kambovski., vepër e cituar, fq.124

teorisë së veprimit të lidhjes shkaksore me ligjet e natyrës. Për ta kuptuar më sakt përqasjen ndaj kësaj teorie , po paraqes disa paragraf të vendimit të kësaj gjykate.

Në vërtetimin e lidhjes shkaksore, "ligjet e përgjithshme që i mbulojnë" të sjelljes ose të ngjarjes të cilat gjyqtari mund të hyjë, janë ato "universale", të cilat janë të afta të pohojnë që vërtetimi i një ngjarje, si tek ligjet "statike", që kufizohen vetëm në fakt, duke pohuar, që kryerja e një ngjarje është e shoqëruar nga ekzistenca e një ngjarje tjetër në disa raste, me pasojë që këto të fundit kanë më tepër vlerë shkencore dhe për më tepër, mund të gjesh aplikimin e një numëri të mjaftueshëm (suficent) çështjesh, dhe mund të gjejnë konfirmim, duke ju referuar metodave provuese racionale dhe të verifikueshme.

Referimi tek ligjet statike te gjyqtarit, është mëse e legjitimuar, sepse modeli i veprimit tek ligji (sussunzione[229] sotto leggi), e përdorshme në fushën penale, nënkupton në shumicën e rasteve, si domosdoshmëri ekzistencën e distancës nga një shpjegim kazual deduktiv (deduttiva)[230], i cili do të përfshinte pamundësinë që të njheshin të gjitha faktet e të gjitha ligjet në fushën penale.

Gjyqtari nuk mund të njohë, të gjitha fazat e ndërmjetme nëpërmjet secilës shkaku prodhon pasojën e saj, dhe të mund të procedoj apo të vazhdojë më pas, me një shpjegim të thellë mbi një seri ngjarjesh të vazhdueshme, në një shpjegim kauzual duhet t'i referosh një sërë pranimesh logjike (assunzioni nemologiche) të heshtura, prandaj lidhja e kushtëzuar nëpërmjet veprimit dhe ngjarjes mund të njihet vetëm nëpërmjet qartësimesh të shumta, por që të jenë të arsyetuara, jo domosdoshmërisht, duhet të përjashtohet ndërhyrja e një procesi tjetër kazual.

Gjyqtari, duke përdorur modelin e veprimit të ligjeve statike (sussunzione sotto leggi statistiche, aty ku nuk disponon ligje universale, do të thotë që, është e mundur që sjellja e individit përbën coeteris paribus, nje kusht i domosdoshëm i ngjarjes, probabiliteti që ajo ka mundësi të shprehë vetëm probabilitet logjik ose besueshmëri rracionale, e cila duhet të jetë e një shkalle të lartë, në sensin që gjyqtari duhet të vërtetojë, që, pa sjelljen e individit ngjarja nuk do te kishte ndodhur, pikërisht, me një përqindje të lartë mundësie.

Një fakt i ndodhur përpara, mund të kualifikohet si kusht i domosdoshëm i ngjarjes, kur shkenca sëbashku me ligjet e saj e lidh këtë me ngjarjen, si kusht i domosdoshëm apo "sine qua non", gjë e cila ndodh, mbi të gjitha kur egziston një ligj shkencor, universal apo statik, i cili e mbulon sjelljen apo ngjarjen dhe për më tepër, kur në të gjitha proceset shpjeguese nëpërmjet

[229] Sussunzione-(një çështje/apo ngjarje specifike, ta lidhësh me një ngjarje të përgjithshme të parashikuar nga një norme ligjore)

[230] Metoda deduktive (deduttiva) është një metodë arsyetimi që nxjerr një pëerfundim logjikisht të nevojshëm, duke u nisur nga parime të përgjithshme

ligjeve të cilët kanë qënë, të aftë të shprehin qartë një koncept në kohë, një fakt specifik që ka paraprirë, do të shprehet si një kusht i domosdoshëm apo i nevojshëm i ngjarjes[231] .

Siç shihet, në çështjen në fjalë, Gjykata konfirmojë vendimin se, duke ju referuar katastrofës së Stavës (cd.disastro di Stava)[232], e cila përcaktoj shkakun penalisht rilevant në sjelljen, në formën e veprimit apo të mosveprimit te gjithë se cilit që ka marrë pjesë dhe ka kontribuar në kohë në ndërtimin e baseneve, në fazat e ndryshme të projektimit, vazhdimit, ndërtimit dhe zhvillimit.

Mbetet akoma për t'u diskutuar, pasi në çështjen, me temën e përgjesisë profesionale të mjekut, e njëjta gjykatë, nxori në pah që, në kërkimin e lidhjes kazuale ndërmjet sjelljes dhe ngjarjes, aplikohet kriteri i mundësisë dhe i aftësisë (indeoneita) së sjelljes që prodhon ngjarja, nga kjo rjedh që raporti i shkaksise, ka vlerë atje ku me punën e mjekut do ishte pasur një mundësi suksesi, e cila do të bënte që gjykata të vlërsonte që jeta e pacientit, me probabilitet do të ishte shpëtuar[233].

Funksioni i teorive shkakësore.

Përcaktimi i shkakut kryesor, në praktikë nuk është gjithmonë i lehtë. Mbi lidhjen shkakësore janë ngritur shume teori të ndryshme dhe janë krijuar shumë debate, me të drejtë lind pyetja, Cili është funksioni i teorive shkakësore? Vështrimet e fundit e dërgojnë juristin të pyes mbi funksionet e teorive shkakësore. Përse këtyre teorive u jepet kaq shumë rëndësi, përse krijojnë kaq shumë debat, përse përpiqen të dominojnë njëra-tjetrën?

Një përgjigje e shpejtë dhe e thjeshtë do të ishte që, lidhja shkakësore është ngushtësisht e lidhur me atë që është ose që duhet të ishte e drejtë. Një e tillë, e quajtur "Teori e Drejtësisë", kërkon një teori shkakësore dhe kjo edhe sikur të shkohet drejt një drejtësie korigjuese. Teoritë shkakësore "justifikojnë" në kuptimin e mirëfilltë vendimet e gjyqtarëve, duke përcaktuar ose mohuar një lidhje, midis faktit dhe subjektit.

Përgjigjia e dytë, gjysëm juridike është që funksioni i lidhjes shkakësore,është që t'i bëjë sa më teknike vendimet, kësisoj më të kontrollueshme. Teoritë shkakësore përcaktojnë kalimin

[231] Vendimi nr.4793 datë 29 Prill 1991. Seksionit të Pestë të Gjykatës së Kasacionit të Italisë

[232] Katastrofa e Stavës, ndodhi më 19 Korrik 1985, kur u shëmbën dy basenet e dekantimit të plerave gjysëm të lëngshme të minierës në Prenstavel. Nga shëmbja, u derdhën 180.000 m3 baltë, të cilat morën përpara 53 shtëpi, 3 hotele, 6 kapanone, 8 ura, qindra pemë dhe 268 të vdekur, ku ndërmjet tyre kishte edhe turist.

[233] Vendimi nr.1594, datë 22 Shkurt 1993. Gjykata e Kasacionit të Italisë, tema e përgjegjësisë për faj të profesionit të mjekut, në kërkimin e lidhjes shkaksore ndërmjet sjelljes së të pandehurit dhe ngjarjes, gjen zbatim jo kriteri i sigurisë (certezza), por ai i mundësisë së sjelljes

nga një drejtësi natyrore në një drejtësi të finalizuar e cila ka objektiva, kësisoj kërkon përdorimin e instrumentave logjikë koherentë.

Një përgjigje e tretë, është që teoritë shkakësore duhen jo aq shumë për vendimin, se sa mbi të gjitha të përcaktojnë rregulla ndaj shtetasve. Formulimi i tyre teknik, synon të kanalizojë sjelljen duke e parashikuar atë. Një fuksion social i teorive shkakësore, i bën ato të prodhojnë modele shkencore, duke paracaktuar linja drejtuese në sektorë të ndryshëm. Në të shumtën e rasteve, këto funksione dhe të tjera, janë prezente pavarësisht se ato shkelen apo nuk zbatohen. Leximet funksionale të lidhjes shkakësore, kanë si pasojë pyetjen jo shumë mbi ndarjen abstrakte të këtyre teorive , por mbi koherencën dhe vlefshmërinë e tyre, me objektivat e vendosur. Dhe, rrjedhimisht, duke legjitimuar varietetin e madh të orientimeve dhe konkretizimin e së drejtës[234].

Siç do ta trajtojmë më poshtë, teoritë mbi lidhjen shgkakësore, janë të ndryshme, por ajo e cila vlen të theksohet, është se e drejta penale shqipëtare dhe praktika e saj gjyqësore, konsiderojnë shkak kryesor të veprës penale atë veprim ose mosveprim të drejtpërdrejtë i cili sjell në mënyrë të domosdoshme ardhjen e pasojës, apo mundësinë e ardhjes së saj, të cilin e quan shkaku i domosdoshëm i drejtpërdrejtë, determinant[235]. Duke përcaktuar atë që e quan shkaku kryesor, e drejta penale, bën njëkohësisht edhe dallimin midis tij dhe shkaqëve të tjerë, të cilët edhe pse mund të kenë një farë lidhjeje me pasojën, nuk luajnë rol, përsa i takon, marrjes ose jo të disa personave, në përgjegjësi penale[236].

Kur bëhet fjalë për anën objektive të veprës penale, edhe sipas së drejtës penale shqipëtare, veprimi ose mosveprimi trajtohet si element përbërës i saj, vetëm në rastin kur ai është kusht për ardhjen e një pasojë të dëmshme ose për mundësinë e ardhjes së saj, bëhet fjalë për figurat e veprave penale material dhe jo ato formale ose të cunguara[237].

Në diferencë nga teoritë e vjetra mbi lidhjen shkakësore, e drejta penale shqipëtare, si shkak për një apo disa pasoja të dëmshme, nuk konsiderohen të gjitha ato veprime ose mosveprime që i paraprijnë kësaj pasoje, pavarësisht nga afërsia apo largësia që ato kanë në raport me këtë pasojë. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe praktika gjyqësore se, për të arritur në

---

[234] Vincenzo Zeno-Zencovich., Il nesso Causale: Profili di diritto comparato. Leksion i mbajtur në Consiglio Superiore della Magistratura, Romë 24-26 Janar 2007. Marrë nga http://appinter.csm.it/incontri/relaz/13897.pdf, parë për herë të fundit 10.10.2013

[235]Sh.Muçi., E drejta penale, Pjesa e përgjithshme. Tiranë 2012, fq 120

[236]S.Spiro.,Cikël leksionesh,Lidhja shkakësore në të drejtën penale, UET, Tiranë 2008,Fq 34

[237] Veprat penale material, quhen ato të cilat shkaktojnë pasoja ose mundësinë e ardhjes së tyre. Kryerja e tyre e plotë shoqërohet kurdoherë me pasoja materiale ose pasoja të tjera shoqërisht të rrezikshme. Veprat penale të cunguara, janë ato që quhen të konsumuara me kryerjen e veprimit që bëhet për kryerjen e veprave penale në të ardhmen, siç janë organizatat kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, të cilat do të konsiderohen vepra të konsumuara që në momentin e krijimit, organizimit dhe drejtimit të tyre apo i pjesëmarrjes në to.(Nenet 333 dhe 333\a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë).

përfundimin që është kryer një vepër penale, është e nevojshme të përcaktohet çfarë veprime të ndryshme janë bërë, kronologjia e bërjes së tyre, sepse mënyra e kryerjes së veprës penale ka të bëjë me renditjen e veprave, mënyrën e përdorur si dhe karakteri kronologjik i veprimeve që ka bërë personi….veprimet e të pandehurit mund të konsiderohen si shkak për ardhjen e pasojave të dëmshme vetëm në se do të provohet se ato kanë qënë shkaku kryesor dhe jo ndër shkaqet pra, vetëm në se do të pranohej se veprimet e mosveprimet e tij në kushtet që u përshkuan do të sillnin patjetër pasojën[238].

E drejta penale shqipëtare, ashtu sikurëse edhe teoritë të cilat do të trajtohen në vijim, në lidhje me lidhjen shkakësore, pranon faktin që, për t'u konsideruar veprimi ose mosveprimi shkak i një pasoje, duhet që ai të jetë kryer, në kohë, përpara se të ketë ardhur kjo pasojë. E drejta penale shqipëtare, përkrah pikëpamjen sipas së cilës, për të arritur përfundimin nëse një apo disa nga veprimet ose mosveprimet, të cilat janë kryer në kohë, para ardhjes së pasojës, do të konsiderohen shkak për ardhjen e saj, niset edhe nga aërsia apo largësia e veprimit ose e mosveprimit me vet pasojën. Aërsia apo largësia e veprimit ose mosveprimit, në raport me pasojën, duhet kuptuar edhe në aspektin e vijmësisë së pandërprerë të zhvillimit të lidhjes midis këtij veprimi apo mosveprimi, me pasojën. Domethënë në aspektin e vijmësisë së pandërprerë të zhvillimit të atij, që në të drejtën penale është bërë zakon të quhet zhvillimi i lidhjes shkakësore. Sa më e lartë të jetë shkalla e vijmësisë së zhvillimit të zinxhirit të lidhjes shkakësore, aq më i afërt konsiderohet, si rregull, veprimi apo mosveprimi korrekt që përbën hallkën e parë të këtij zinxhiri, me hallkën e fundit të tij, të cilën e përbën pasoja dhe e kundërta[239].

Teoria, "*condition sine qua non…(kushti pa të cilin nuk…)*".

Kjo teori është quajtur ndryshe, si teoria ekuivalente ose teoria e barazisë së shkaqeve[240].Sipas kësaj teorie, kazualiteti i një ngjarjeje, është bashkësia e të gjitha fakteve që paraprijnë, pa të cilën ngjarja nuk do të kishte ndodhur, për të patur lidhjen shkakësore, mjafton që individi të ketë realizuar njërën nga kushtet e ngjrjes. Kjo teori ka lindur dhe është themeluar në Gjermani[241]. Kjo teori, niset nga vlerësimi, i kritikueshëm në profilin natyralist, që çdo ngjarje provokohet nga një sërë ndodhish që paraprijnë, të pandashëm dhe të padallueshëm nga njëri-

[238] Vendimi Nr.778 datë. 20.12.2006 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë

[239] S.Spiro.,Cikël leksionesh,Lidhja shkakësore në të drejtën penale, UET, Tiranë 2008,Fq 28-30

[240] Teoria "conditio sine qua non…" është themeluar nga penalistët gjermanë, I.Glaser 1858, pasuar nga M.V.Buri 1873, të cilët e kishin emërtuar "Bedingungs- theorie Aquivelenztheorie".

[241]Teoria "conditio sine qua non…" është themeluar nga penalistët gjermanë, I.Glaser 1858, pasuar nga M.V.Buri 1873, të cilët e kishin emërtuar "Bedingungs- theorie Aquivelenztheorie". Marrë nga S.Spiro.Cikël leksionesh Lidhja shkakësore në të drejtën penale, UET, Tiranë 2008,Fq 15

tjetri për efektshmërinë kazuale. Kësisoj duke u quajtur të gjitha ekuivalente në pasojën e ardhur, me qëllim që, sjellja njerëzore të mund të konsiderohet shkaku i ngjarjes mjafton që të përbëjë njërën nga veprimet të cilat kanë paraprirë në pasojën e ardhur[242].

Për të pranuar ekzistencën e një lidhje shkakësore të tillë, është e nevojshme t'i referohemi një gjykimi në të kundër, nëse eleminojmë për një moment, duke menduar me mëndje sjelljen që është marrë në konsideratë, ngjarja përsëri qëndron, kjo sjellje nuk është shkaku i së cilës, nëse në të kundërtën, duke eleminuar me mëndje sjelljen, eleminohet edhe ngjarja e cila shkaktohet nga ajo[243].

Analizë, anët negative.

Kjo teori, siç mund të shihet, ka mangësitë e saj, pasi na dërgon në një shtrirje shumë të madhe të përgjegjësisë. Duke i konsideruar ekuivalente të gjitha sjelljet të cilat konkurojnë në ndodhjen e një ngjarje, përfundohet duke i konsideruar sit ë rëndësishme edhe sjelljet fare të hershme të cilat paraprijnë duke arritur kështu në konkluzione paradoksale[244].

Kështu për shëmbull, nëse është e pamohueshme që vdekja e një personi, ka ardhur si pasojë e qëllimit të tij nga një individ tjetër me një armë zjarri, duke marrë për bazë këtë teori, është ekuivalente që përgjegjës do të jetë edhe ai i cili ka fabrikuar armën, ai i cili ja shiti vrasësit dhe për më tepër edhe prindërit e këtij të fundit, të cilët nëse nuk do ta kishin sjellë në jetë, atëherë nuk do të kishte ndodhur vrasja!

Është e vërtetë, siç pohohet nga përkrahësit e kësaj teorie, që në realitet duhen marrë në konsideratë vetëm ngjarjet që paraprijnë, të cilat kanë rëndësi të menjëherëshme me ngjarjen që po diskutohet, dhe është e vërtetë, akoma që thirrja e elementit subjektiv dashja apo faji, kufizon shtrirjen e ndëshkueshmërisë, nëse do të aplikohej rigorozisht kjo teori.

Por, në të kundërtën thuhet se, nga njëra anë nuk ka asnjë kriter bazë në të cilin të kufizosh kërkimin mbrapa të kushteve rilevante, dhe nga ana tjetër ndotja e elementëve objektivë lidhja shkakësore me ato të elementëve subjektivë si dashja apo faji, jo vetëm që nuk është e saktë, por e panevojshme.

Kufizimi i vërtetë i teorisë ekuivalente, qëndron në faktin e paaftësisë së saj për të shpjeguar motivin e një sjellje të përcaktuar në të gjitha ato raste kur nuk njihet, a priori, në se ai veprim i përket apo jo numrit të sjelljeve të nevojshme që e prodhuan. Nëse faktikisht, përpara një njeriu që është vrarë me thikë, kjo teori e ka të thjeshtë duke argumentuar se shkaku i vdekjes

[242] L.Delpino, Diritto Penale, Parte generale. Napoli 2010, Fq 279

[243] Po aty, fq 280

[244] po aty, fq 281

së personit, është goditja me thikë, por në rastin kur një puntor në një fabrikë e cila përdor lëndë helmuese, vdes nga tumori në mushkëri, kjo teori mund t'i eleminojë pafundësisht me mëndje kontaktin ndërmjet njeriu dhe lendëve helmuese, por, kurrë nuk do të arrijë në një konkluzion mbi shkaqet e vdekjes. Nëse nuk e di që më përpara nga shkencat mjeksore, që kontakti me lëndët helmuese, është një nga shkaqet e tumorit në mushkëri.

Për më tepër, kjo teori lë mënjëanë përsëritjen e një fenomeni të caktuar, port ë huaja për sjelljen e subjektit, madje edhe të jashtëzakonëshme, duke treguar paevitueshmërisht inefiçencën e saj në gjetjen e sakt të faktit kriminal[245].

Nga sa u tha më sipër, kjo teori krijon një situatë kaotike në përcaktimin e lidhjes shkakësore, e cila mbart me vete, në mënyrë të pashmangshme, rrezikun e arbitraritetit në dëm të një apo më shumë personave, të ciulët mund të vihen padrejtësisht, para përgjegjësisë penale. Kjo teori, jo vetëm që ekspozon për keq, punonjësit e organeve të ndjekjes penale dhe gjykatës para opinionit publik, por dëmton edhe dhënien e drejtësisë.

Të ndodhur përpara gjithë këtyre mungesave, pasaktësive dhe të metave të cilat u përmendën në mënyrë të përmbledhur të teorisë "*Conditio sine qua non…*", u bënë përpjekje nga penalistë të shumtë për korigjimin e tyre, duke shkuar deri në zëvëndësimin e kësaj teorie me disa teori të reja, për lidhjen shkakësore në të drejtën penale[246].

Teoria e shkakut tipik, "causa adequate".

Teoria causa adequate ose teoria e shkakut tipik, lindi dhe u zhvillua fillimisht në Gjermani, nga filozofi dhe natyralisti I.V.Kries më 1856 [247]. Kjo teori lindi pas teorisë ekuivalente, e cila e zgjaste shumë konceptin midis shkakut e pasojës dhe rrjedhimisht zgjeronte përgjegjësitë që kjo teori sillte.

Siaps teorisë së shkakut tipik, në fakt shkaku i ngjarjes nuk është fakti se kush nga veprimet apo mosveprimet të cilët kanë paraprirë ngjarjen, por vetëm ai veprim ose mosveprim i cili ka realizuar atë psojë, i cili ka qënë adekuat apo tipik, që sipas eksperiencës së përgjithshme, është më e mundëshmja që ta prodhojë pasojën, me kusht që të ekzistojë një raport kazualiteti juridikisht i rëndësishëm, kësisoj duhet që individi të ketë sjellë ngjarjen më një veprim adekuat që ajo të prodhohet[248].

[245] Po aty, fq 281

[246] S.Spiro.,Cikël leksionesh,Lidhja shkakësore në të drejtën penale, UET, Tiranë 2008,Fq. 19

[247] Po aty, Fq 21

[248] L.Delpino, Diritto Penale, Parte generale. Napoli 2010, Fq 281

Përkrahësit e kësaj teorie, shkaqet e një pasoje konkrtete i ndajnë në:

Tipike, domethënë, në përgjithësi të përshtatshëm që të sjellin, të prodhojnë, një pasojë të tillë. Dhe, si shëmbull i tillë në literaturën juridike, për të ilustruar shkakun tipik, sillet shkaktimi i vdekjes si pasojë e qëllimit të personit me armë zjarri, thikë, sëpata etj.

Jo tipike, domethënë në përgjithësi jo të përshtatshëm për të sjellë një pasojë të tillë shkakësore. Lidhja shkakësore, sipas tyre, ekziston vetëm në rastin e parë. Si shëmbull për të ilustruar shkakun jo tipik, përkrahësit e kësaj teorie, sjellin goditjen me grusht të një personi, pasi goditja me grusht bazuar në eksperiencën e njërëzve nuk është veprim i cili zakonisht shkakton vdekjen.

Vërtetimi i lidhjes kazuale, bëhet tashmë jo nëpërmjet metodës së eleminimit nga ajo e cila mendohet, por duke imagjinuar dhe rindërtuar ngjarjen sipas një zhvillimi logjik normal[249]. Kësisoj, për shëmbull në rastin kur një person i plagosur që vdes në spital për shkak të gabimit të mjekut të urgjencës, subjekti i cili e plagosi, nuk mund të përgjigjet për vrasje nga pakujdesia, sepse nëse do të kishim një zhvillim normal të situatës, i plagosuri do të kurohej dhe do të shërohej.

Analizë, anët negative.

Sigurisht, që edhe kjo teori ka kritikat e saj. Referimi tek eksperienca e përgjithshme apo zhvillimit normal të ngjarjes, në fakt e bën në praktikë, një teori pak të ashpër dhe eskluzivisht empirike, sepse ajo i referohet koncepteve gjenerike dhe të dykuptimsisë, edhe përse konsideron atipike efektet, ato të cilat vijnë nga pasoja që janë të panjohura, për më tepër edhe mekanizmat e proçesit të verifikimit.

Kjo teori, në ndryshim nga teoria ekuivalete e cila kishte një shtrirje të madhe të lidhjes shkakësore, duke krijuar kështu një masë kaotike në përcaktimin e lidhjes shkakësore, ka një avantazh pasi e ngushton rrethin e lidhjes shkakësore, por në mënyrë paradoksale, ajo që ishte dhe cilësia e kësaj teorie, është edhe vet vesi i saj. Mbi të gjitha, kjo teori përfundon duke kufizuar së tepërmi fushën e përgjegjësive penale, jo vetëm se përjashton të gjitha shkaqet atipike, por mbi të gjitha, sepse përfundon duke mohuar përgjegjësitnë penale tek shfrytëzimet me dashje që i bëjnë aftësive të tyre individuale.

Sjellim si shëmbull, nëse një individ ka njohuri të mjaftueshme në fushën farmaceutike, kur një ilaç që deri në atë periudhë konsiderohej i padëmshëm, por që e cila mund të shkaktojë vdekjen nëse jepet me doza të caktuara, dhe individi e përdor këtë zbulim për të shkaktuar vdekjen e dikujt. Duke iu referuar kësaj teorie, individi nuk mund të përgjigjet për vrasje, sepse veprimi i tij sipas l`id quad pleremque accidit, është e papërshtatëshme që të shkaktoj vdekjen.

[249] Po aty, Fq. 281

Për të bërë një pardoks historik, nëse teoria adekuate e shkakësisë do të kishte ekzistuar dhe do të ishte aplikuar në atë epokë. Do t'i kishte mohuar përgjegjësinë Arkimedit për vënien flakë të anijeve romake, që në komandën e Marçelos, po sulmonin Sirakuzën në vitin 212 p.e.s, sepse në atë periudhë, askush tjetër përvç Arkimedit, nuk e dinte që duke përqëndruar dritën e diellit me disa lente specifike, mund të provokohej një zjarr, kësisoj veprimi i tij do të konsiderohej jo-adekuat, sipas eksperiencës së përgjithëshme e cila ekzistonte në atë kohë[250].

E meta kryesore e teorisë së shkakut tipik, konsiston në faktin se ndarja e shkaqeve në tipike dhe jo tipike dhe pohimi sipas të cilit, për këtë ndarje duke u bazuar në eksperiencën e njerëzve ose në atë që, shpesh në literaturë është quajtur normat e përvojës së përbashkët[251], domethënë veçimi i atij që, sipas përkrahësve të kësaj teorie, emërohet shkak tipik përgënjeshtrohet shpesh nga vet realiteti dhe praktika gjyqësore e shumicës së vëndeve, përfshirë edhe në ato vënde në të cilat kjo teori ka lindur[252]. Kjo për faktin se, veçimin e një shkaku për ta vendosur në kategorinë e shkaqeve tipike për një pasojë të caktuar, punonjësit e organeve të ndjekjes penale dhe gjykatave, gjatë veprimtarisë së përditëshme të tyre, nuk mund ta gjejnë as në legjislacionet penale të vëndeve të tyre, as në tekstet, traktatet apo monografitë e shkruara nga penalistë.

Supozohet që këtë lloj veçimi duhet ta bëj dikush, mbi bazën jo të ndonjë apo më shumë kritereve objektivë, por në bazë të perceptimit personal të tij, rreth përvojës së njerëzve në përgjithësi, gjë e cila krijon premisa të shumta për të gabuar. Kjo, pasi këtij dikushi i bie barra që në fillim të bëjë vlerësimin se çfarë përbën shkak tipik dhe çfarë përbën shkak jo tipik, në raste analoge dhe në rrethana të ngjashme. Mbas kësaj, po këtij personi, i bie përsëri barra që të transferojë procesin e ndarjes së shkaqeve, si më sipër në rrethanat konkrete në të cilat ka ndodhur rasti në shqyrtim.

Po kush do të jetë ky person që duhet të merret me një proces të tillë? Nga shkalla e suksesit apo dështimit të këtij personi, në realizimin e këtij procesi do të varet fati i zgjidhjes së një problem aq të rëndësishëm, sikurse është ai i përgjegjsisë penale. Nga shkalla e suksesit apo e dështimit të tij, do të varet në fund të fundit, fati i personit për të cilin diskutohet se duhet marrë ose jo në përgjegjsi penale për pasojën e dëmshme, nga njëra anë, si dhe plotësimi i kërkesave apo thënë ndryshe, "kënaqja " e dëshirave të personave që kanë pësuar dëmin, rast pas rasti, nga ana tjetër. Ka të bëjë në fund të fundit, me zbatimin drejt të ligjit, për personin konkret në veçanti dhe me respektimin e parimit të ligjshmërisë në procesin penal në përgjithësi.

[250] Po aty, fq 282

[251] I.Manoledhaqis, E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme, Selanik 1996, fq 157

[252] S.Spiro.,Cikël leksionesh,Lidhja shkakësore në të drejtën penale, UET, Tiranë 2008,Fq. 22

Teoria e shkakut ligjërisht të rëndësishëm, "*Relevanz theorie*"

Duke konstatuar këto e të tjera boshllëqe e të meta që paraqet teoria "*causa adeguate*", mbi lidhjen shkakësore, përkrahës të mëvonshëm të saj, e zhvilluan më tej atë duke i shtuar ndarjes së deritanishme edhe një kategori tjetër shkaqesh, bazuar kjo e fundit tashmë jo më në përvojën e njerëzve por në një kriter ligjor, e quajtur "teoria e shkakut ligjërisht të rëndësishëm".

Përkrahësit e kësaj teorie, për të zgjidhur problemin e shkakësisë , nisen nga kritere ligjore. Në vëndin e origjinës së saj, Gjermani kjo teori është emërtuar "*Relevanz theorie*". Sipas kësaj teorie, duhet dalluar "shkakësia fizike", nga problemi i përgjegjsisë penale të autorit të një veprimi apo mosveprimi, për një pasojë konkrete. Përkrahësit e kësaj teorie, pohojnë se, për zgjidhjen e këtij problem, nuk paraqesin interes të gjitha veprimet ose mosveprimet të cilat lidhen saktësisht me pasojën, (d.m.th veprimtaritë që kanë lidhje me shkakësinë fizike), por vetëm ato veprime ose mosveprime, të cilat juridikisht (ligjërisht) janë të rëndësishme.

Nga kjo del se, "shkaku tipik", që pranonte deri në këtë fazë, teoria "*causa adequata*", i shtohet edhe një shkak i tretë, i përcaktuar mbi bazën e kriterit të ashtuquajtur kriteri juridikisht i rëndësishëm, kriter ky, që sikurse kuptohet fare qartë, është thjesht ligjor.

Kritika specifike që i bëhët *relevanztheorie* nga disa penalistë, është se sipas tyre, përkrahësit e saj bien në pozitat e rrethit vicioz. Kurse disa të tjerë shprehen se, përkrahësit e saj bëjnë analogji[253].

Analizë-anët negative.

Argumentat që përdorin kritiket e të dy këtyre varianteve është se, përkrahësit e *relevanz theorie* kërkojnë të shpjegojnë një fenomen ligjor, sikurëse është lidhja shkakësore, nëpërmjet një fenomeni po ligjor, sikurëse është kriteri juridikisht i rëndësishëm. Mirpo dihet se, kundërligjshmëria e veprimit ose mosveprimit, është kriter që në fakt, nuk paraprin por ndjek ekzistencën e lidhjes shkakësore, që sikurëse u tha, megjithëse kriter ligjor për përcaktimin e përgjegjësisë penale, mbetet së qëni një fenomen objektiv.

Me këtë duhet kuptuar që, më parë duhet të çmohet në se një veprim ose mosveprim është apo jo shkaku i një pasoje dhe mbas kësaj, të kalohet në fazën tjetër, në atë të dhënies përgjigje të pyetjes që, nëse ky veprim ose mosveprim është i kundërligjshëm apo jo.

Në rastin kur, mbas ezaurimit të fazës së parë, arrihet në përfundimin se një veprim apo mosveprim konkret, është shkaku i një pasoje të dëmshme po konkrete dhe kur kemi kaluar në fazën e vlerësimit të tij nga ana juridike, konkludohet se veprimi apo mosveprimi vjen në

[253] S.Spiro.,Cikël leksionesh,Lidhja shkakësore në të drejtën penale, UET, Tiranë 2008,Fq. 24

kundërshtim me ligjin, pra është i kundraligjshëm, na lind e drejta që personi i cili e ka kryer atë, veprimin ose mosveprimin, nëse plotëson edhe kushtet e tjerë si mosha, përgjegjshmëria dhe faji, ta marrim në përgjegjësi penale.

E kundërta ndodh në rastet kur, megjithëse, në përfundim të fazës së parë, konkludohet që veprimi apo mosveprimi i personit konkret, është ai i cili solli pasojën e dëmshme, porn ë mbarim të fazës tjetër, arrihet në përfundimin që veprimi apo mosveprimi, për shkak të rrethanave në të cilat është kryer, ka humbur karakterin shoqërisht të rrezikshëm, çka do të thotë që nuk është juridikisht i rëndësishëm, në kuptimin i cili u trajtua më lart. Para rasteve të fundit do të ndodhemi, atëhere kur personi vepron, në kushtet e mbrojtjes së nevojshme, të nevojës ekstreme dhe të ushtrimit të një të drejte apo përmbushje të detyrës.

Në të tre këto raste, personat, edhe pse me veprimet apo mosveprimet e kryera prej tyre shkaktojnë pasoja të dëmshme, nuk përgjigjen penalisht për to, pasi veprimet ose mosveprimet nuk janë të kundërligjshme, për shkak se, në vet dispozitat që u përmëndën, parashikohen disa rrethana, prania e të cilave bën që ato të humbasin karakterin shoqërisht të rrezikshëm të tyre.

Në bibliografinë juridike të vëndeve të ndryshme janë formuluar një sër teorishë të tjera me tipare si, deri diku të përbashkëta, ashtu edhe dalluese, nga dy teoritë që shtjelluam më siper për lidhjen shkakësore[254].

Njohja e të metave dhe mangësive të trajtuara më lart, të ketyre teorive, shërben edhe për të krijuar terren, realisht të favorshëm për të kuptuar dhe zbatuar drejt, në veprimtaritë e përditëshme, përkufizimet dhe kërkesat teorike, të teorive më bashkëkohore mbi lidhjen shkakësore, të cilat prej kohësh, janë përhapur dhe vazhdojnë të gjejnë zbatim si në teorinë e së drejtës penale, ashtu edhe gjatë zbatimit të saj.

[254]Teori të tilla janë: teoria e shkakut të fundit, (Ortmann 1876); Teoria e "*causa efficiens*", (Birkmeyer 1885); Teoria që përkrah pikëpamjen sipas së cilës shkak kryesor është shkaku, i cili, sipas arsyes kryesore, sjell pasojën, (Binding); Teoria sipas së cilës si shkak kryesor konsideron fuqinë që krijon pasojën, (Kohler 1890). Në bibliografinë e re gjermane ka gjetur përkrahje teoria e kriterit rrezik. Sipas saj, një person do të përgjigjet penalisht për një pasojë të dëmshme, vetëm nëse veprimi i tij, përbën një rrezik të provuar tashmë nga e drejta. Ky rrezik, sipas kësaj teorie, duhet të jetë i përfshirë në vet pasojën e dëmshme që parshikohet nga ligji. Të gjitha këto teori janë kundërshtuar në mënyra dhe argumente të ndryshëm, kryesori është se, që një veprim ose përbën ose nuk përbën, objektivisht shkak të një pasoje, ai nuk mund të bëhet shkak mbi kritere ligjorë.

KREU VII

KOHA, VËNDI, MJETET E MËNYRA E KRYERJES SË VEPRËS PENALE, SI ELEMENT PËRBËRËS TË ANËS OBJEKTIVE TË FIGURËS SË VEPRËS PENALE

Kur u trajtua kuptimi i anës objektive, si element përbërës i figurës së veprës penale dhe elementët përbërës të saj, u theksua se ndër elementët përbërës të anës objektive të figurës së veprës penale janë edhe koha, vëndi, mjetet, mënyra e kryerjes së veprës penale

Që në fillim duhet nënvizuar se, bazuar në formulimin e dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, të katër këto të cilat u përmendën, duke shtuar edhe pasojën, nuk janë elementët e domosdoshëm përbërës të anës objektive për të gjitha figurat e veprave penale të cilat parashikohen në këto dispozita. Kjo është arsyeja që në teorinë e së drejtës penale ato konsiderohen element jo të domosdoshëm përbërës të anës objektive të figurës së veprës penale. Të tilla, domethënë elementët jo të domosdoshëm të anës objektive të figurës së veprës penale, këto element janë në përgjithësi, kurse në veçanti ne disa figura veprash penale nga ato që parashikohen në pjesën e posaçme të Kodit Penal, jot ë gjitha së bashku, por diku njëri dhe diku gjetkë të tjerat, veç e veç, për ta cilësuar veprën penale me njërën apo tjetrën dispozitë, këta element, herë njëri dhe herë tjetri, paraqiten dhe janë element përbërës të domosdoshëm të anës objektive të figurës së veprës penale dhe për rrjedhojë, edhe të vetë figurave të veçanta të veprave penale që parashikohen në këto dispozita.

Kuptimi dhe kushtet që duhen të plotësohen nga secili prej tyre për t'u konsideruar element përbërës të anës objektive të figurës së veprës penale trajtohen veç e veç, për secilin prej këtyre pesë elementëve, pasi ato nuk janë të njëjtë. E përbashkët për të gjithë ato është fakti se për t'u konsideruar element të domosdoshëm të anës objektive, secili prej këtyre elementëve, duhet të jetë përmendur shprehimisht, në dispozitën konkrete të pjesës së posaçme të Kodit Penal, në të cilën parashikohet figura konkrete e veprës penale.

Koha si element përbërës i anës objektive të figurës së veprës penale.

Kuptimi i elementit kohë merr një dimension shumë domëthënës ne lidhje me çdo sjellje të njeriut, koha është caktuar me ligjj si pjesë përbërëse të shumë institutive të rëndësishëm dhe është objekt i interpretimit të normave juridike të ndryshme. Nocioni i kohës mendore të njeriut, e përcakton kohën si diçka që mund të matet, si një realitet i vazhdueshëm, e cila na lejon të caktojmë kohëzgjatjen e fakteve dhe ngjarjeve natyrore, e cila ndahet në të kaluar, në të tashme

dhe e ardhmja. Në kuptimin juridik koha mund të ndahet në disa kategori por që më të rëndësishmet janë koha objektive dhe koha historike[255].

Në legjislacionin pozitiv nuk ka një parashikim ligjor të njëjtë për elementin kohë. Rezulton e vështirë, për të mos thënë e pamundur, që të japësh një definicion të vetëm të kohës në kuptimin juridik. Rëndësia e kohës në figura të veçanta të veprave penale është e ndryshme. E vetmja rrethanë e përbashkët është fakti që, realizimi i pasojave të parshikuara nga ligji varet nga kalimi i kohës ose kryerjen e një veprimi në një moment të caktuar historik[256].

Koha e kryerjes së veprës penale ka një lidhje mjaft të ngushtë edhe me një element të domosdoshëm të anës objektive, me lidhjen shkakësore, pasi shkaku dhe pasoja janë gjithmonë një *prius* dhe një *posterius,* në ritmin e kohës. Lidhja shkakësore zhvillohet në një kohë dhe në një hapsirë të caktuar, studiohen ato shkaqe që janë vënë në lëvizje para se të vinte pasoja e veprës penale. shkaku i paraprin kurdoherë pasojës, por, sigurisht jo cilido shkak që i paraprin mund të jetë vendimtar, i domosdoshëm për ardhjene pasojës. Që një veprim të jetë i lidhur me pasojën që ka ardhur pas një kohe të caktuar, duhet që të ketë një lidhje shkakësore të tillë që pasoja të ketë ardhur pikërisht prej atij veprimi. Elementi kohë këtu duket pikërisht në kohën në të cilën vjen pasoja e cila do të lidhet me veprimin e kryer. Zhvillimi normal i lidhjes shkakësore mund të ndërpritet nga veprime ose mosveprime të cilat ndryshojnë rrjedhën normale të ngjarjes. Raste të tilla mund të ndodhin me persona të shtruar në spital për mjekim nga një e çarë, por që u shkaktohet vdekja nga dhënia e një terapie tjetër të kundërt, me atë që e ka këshilluar mjeku

Ekzistojnë raste kur kemi një ndërhyrje në lidhjen shkakësore midis veprimit të kryer dhe pasojës së ardhur duke bërë që pasoja të mos jetë rezultat i veprimit të kryer që në fillim por i një veprimi tjetër që ka ndodhur në një kohë të mëvonëshme. Këtu elementi kohës shihet në faktin se sado që veprimi dhe pasoja ndodhin në kohë të ndryshme dhe mund të ketë një lidhje shkaksore ndërmjet tyre, përsëri mund të kemi një ndërhyrje me anë të një veprimi apo mosveprimi tjetër që do ta prishte lidhjen shkakësore duke përjashtuar kësjhtu autorin e veprimit të parë nga përgjegjësia penale dhe pasojën e ardhur në një kohë të mëvonëshme.

Mes veprës penale dhe elementit kohë ka një lidhje të dyfishtë. Nga njëra anë koha është një element përbërës në strukturën e saj dhe nga ana tjetër vepra penale i nënshtrohet kohës, që me ndryshimet që bën ligjvënësi ajo mund të ndryshojë në të njëjtën kohë. Koha mund të veprojë tek vepra penale duke dërguar në përfundime të ndryshme. Koha shërben si element i veprës penale duke krijuar një figurë konkrete të veprës penale, të kundërligjshme, shoqërisht të rrezikshme dhe të kryer me faj. Në një aspect tjetër që ka të bëjë me gjëndjen e personit është

[255] Leone, il tempo nel diritto penale sostantivo e processuale, Napoli 1974, Fq.14

[256] Për shëmbull shfuqizimi i ligjit penal në njëkohë të caktuar, aplikimi i parimit dhe lejimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal.

dhe kryerja e veprës penale në kushtet e tronditjes psikike. Kjo gjëndie ndryshon dhe ka tipare të veçanta të cilat hërë e përcaktojnë atë si rrethanë cilësuese e herë si rrethanë lehtësuese.

Koha është një element i anës objektive dhe ka një rëndësi për përcaktimin e shkallës së rrezikshmërisë shoqërore, rrjedhimisht edhe për përcaktimin e dënimit ndaj autorit të veprës penale. tjetër rrezikshmëri paraqet e njëjta vepër penale kryer në kohë paqeje dhe tjetër një e kryer në kohë lufte. Saktësimi i kohës së kryerjes së veprës penale merr rëndësi të veçantë për zbatimin e afateve të parashkrimit të ndjekjes penale ose të ekzekutimit të dënimit dhe për rehabilitimin e të dënuarit.

Dihet që çdo vepër penale kryhet në një kohë të dhënë. Por elementi kohës jo gjithmonë ka rëndësi në të drejtën penale. Ai merr rëndësi të posaçme, së pari në rastet kur ka të bëjë me veprimin e ligjit penal dhe së dyti, kur në përmbajtjen e vetë dispozitës së pjesës së posaçme në të cilën parashikohet figura e veprës penale, kërkohet si element i anës objektive të figurës së veprës penale.

Përsa i përket veprimit të ligjit penal, në dispozitën e nenit 3 të Kodit Penal, që titullohet "Veprimi në kohë i ligjit penal", ka gjetur sanksionim njëri prej formave të rëndësishëm të së Drejtës Penale, sikurëse është ai i zbatimit të ligjit të kohës. Janë sanksionuar gjithashtu, edhe rastet e fuqisë prapavepruese të ligjit penal.

Në këtë dispozitë sanksionohet se askush nuk mund të dënohet për një vepër që, sipas ligjit të kohës kur është kryer, nuk përbënte vepër penale. Sanksionohet gjithashtu se, ligji i ri i cili nuk e dënon veprën penale ka fuqi prapavepruese dhe, në rast se personi është dënuar, ekzekutimi i dënimit nuk mund të fillojë dhe, nëse ka filluar, pushon si dhe kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të dryshëm, zbatohet ai ligj dispozitat e të cilit janë më të favorëshme për personin që ka kryer veprën penale.

Trajtim të veçantë e Drejta Penale, kohës i kushton në rastet kur në dispozitën përkatëse të pjesës së posaçme të Kodit Penal, ajo kërkohet si njëri prej elemntëve përbërës të anës objektive të figurës së veprës penale që parashikohet prej saj. Konstatoj se, dispozitat e pjesës së posaçme të Kodit Penal në fuqi, të cilat kohën e konsiderojnë element përbërës, madje, në forma të ndryshme, element të domosdoshëm të kësaj anë të figurës së veprës penale, janë disa. Të tilla janë përshëmbull, dispozitat e neneve 81 (vrasja e foshnjës e kryer me dashje nga nëna, menjëherë pas lindjes…); neni 89 (plagosja e lehtë me dashje); neni 90 (dëmtime të tjera me dashje); neni 94 (ndërprerja e shtatëzanisë..tej kohës së lejueshme për ndërprerje, veç rastit kur kjo diktohet nga një shkak shëndetësor i justifikuar); neni 109\a (lirimi para mbarimit të shtatë ditëve, të personit të rrëmbyer ose të mbajtur peng); neni 166 (emërtimi i parregullt i aksioneve, bërë përpara regjistrimit të shoqërisë..); neni 180 (fshehja e të ardhurave ose i objekteve që i nënshtrohen tatimeve dhe taksave, kur më parë janë marrë masa administrative..); neni 181 (mospagimi i taksave apo tatimeve brënda afatit të caktuar); neni 181\a (moskryerja e detyrave

të cilat lidhen me vjeljen brënda afatit të caktuar ligjor të taksave dhe tatimeve….); neni 204 (…në kohë, vende të ndaluara…); neni 205 (prerja apo dëmtimi i pyjeve pa leje apo në kohë dhe vënde të ndaluara…); neni 249 (kryerja e funksionit pas dhënies fund të tij); neni 252 (mbajtja në burg …tej afatit të caktuar në vendim apo në ligj…); neni 262\II (pjesmarrja në një grumbullim apo manifestim të paligjshëm edhe pas paralajmërimit të bërë për shpërndarje…) etj.

Siç shihet nga përmbajtja e këtyre dispozitave, elementi kohë, i shprehur në forma të ndryshme nga ligjvënësi, merr rëndësi të dorës së parë për ekzistencën e anës objektive të figurave të veprave penale dhe të vetë figurave të veprave penale që parashikohen prej tyre. Në disa prej tyre, sikurëse janë për shëmbull, dispozitat e neneve 81 (Vrasja e foshnjës) elementi kohë është shumë i domosdoshëm, …menjëherë pas lindjes, 166 (Emëtimi i parregullt i aksioneve), 180 (Fshehja e të ardhurave), 181 (Mospagimi i taksave dhe tatimeve) etj koha është element përcaktues për ekzistencën e anës objektive të figurës së veprës penale dhe të vetë figurave të veprave të cilat parashikohen prej tyre.

Kështu, për të patur figurën e kundravajtjes penale, e cila parashikohet në nenin 81 (Vrasja e foshnjës) të Kodit Penal, duhet që vrasja e foshnjës të jetë kryer nga nëna, menjëherë pas lindjes. Në këtë rast, vrasja kushtëzohet nga procesi i lindjes, nga gjëndja e tronditjes psikike të gruas për shkak të lindjes. Ligjvënësi mbron jetën e foshnjes menjëherë pas lindjes dhe jot ë fetusit, e cila ndodhet në barkun e nënës, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet apo mosveprimet kriminale[257]. Si vrasje e foshnës konsiderohet vetëm vrasja e foshnjës pas ndarjes së fetusit nga barku i nënës dhe fillimit të jetës indipendente të foshnjes dhe jo vrasja e kryer gjatë lindjes, kur foshnja nuk ka filluar akoma jetën e pavarur jashtë barkut të nënës[258]. Një rëndësi në këtë dipozitë zë dhe shprehja menjëherë pas lindjess, duhet patur parasysh se sa zgjat gjëndie e nënës e shkaktuar nga dhimbjet e lindjes, kur bëhet fajalë për vrasjen e kryer nga vetë nëna. Problemet në lidhje me interpretimin e kësaj dispozite, në veçanti i referohet faktit që ligjvënësi, përmes kësaj shprehje, ka përcaktuar momentin e fillimit, nga i cili mund të konkretizohet sjellja vrasëse e foshnjës. Por nuk ka përcaktuar se kur përfundon kjo sjellje, tej së cilës nuk mund të kryhet më, pasi kjo sjellje mund të formojë dhe figurën e veprës penale të vrasjes të parashikuar në nenin 76, si vrasje e thjeshtë. Mendimi dominues në teorinë e së drejtës, është se kushti menjëherë pas lindjes, duhet të vlerësohet rast pas rasti dhe duhet të konsiderohet si i qënë aq herë sa ekziston dhe një marrëdhënie pavarësie mes këtyre kushteve dhe veprimeve të kryera nga ana e nënës[259].

Po kështu, njëri prej rasteve kur ndodhemi para kundravajtjes penale të emërtimit të parregullt të aksioneve, që parashikohen në nenin 166 të Kodit Penal, është edhe kur emërtimi i

[257] I.Elezi., E drejta Penale, Pjesa Posaçme, Tiranë,2009, Fq.59

[258] Taushani, Papuli, Nova, Komentar i Kodit Penal të R.P.S.SH, vëllimi i parë, botim i Ministrisë së Drejtësisë, 1964

[259] Patalano, i delitti contra vita. Fq.183

aksioneve është bërë përpara regjistrimit të shoqërisë tregtare. Kurse, për të patur figurat e veprave penale, të cilat parashikohen përkatësisht, në nenet 180 e 181 të Kodit Penal, duhet që më parë, ndaj subjektit tatimpagues, të jenë marrë masa administrative.

Në disa raste të tjerë, ky element pra koha, shërben si kriter ndarës, për të dalluar njërën figurë vepre penale nga një figurë tjetër me objekt të përafërt. I tillë është për shëmbull rasti i figurave të kundravajtjeve penale të plagosjes së lehtë me dashje dhe asaj të dëmtimeve të tjera me dashje, që parashikohen, përkatësisht në nenet 89 (Plagosja e lehtë me dashje) dhe 90\II (Dëmtime të tjera me dashje) të Kodit Penal. Në të dyja këto figura vepre penale bëhet fjalë për dëmtimin e shëndetit të personit. Ai i cili shërben si kriter ndarës, dallues ndërmjet tyre, është shkalla e këtij dëmtimi, shkallë kjo e cila përcaktohet nga ndryshimi që ekziston nga njëra figurë tek tjetra në anën objektive të tyre, përsa i përket kohës së paaftësisë për punë të cilat vijnë si pasojë e dëmtimit të shëndetit të personit të dëmtuar. Kur kjo kohë është më tepër se nëntë ditë, dëmtimi i shëndetit përbën figurën e kundravajtjes penale të plagosjes së lehtë, kurse kur është deri në nëntë ditë, përbën figurën e kundravajtjes penale të dëmtimeve të tjera me dashje.

Në disa raste të tjera, elementi kohë, veprën e penale e bën të kryer në rrethana lehtësuese. E tillë është për shëmbull figura e krimit të rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit, neni 109\a (Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit në rrethana lehtësuese) i Kodit Penal kusht i parë për ekzistencën e së cilës është që, personi i rrëmbyer apo i mbajtur peng, të jetë liruar para mbarimit të shtatë ditëve nga dita e rrëmbimit ose mbajtjes peng.

Një tjetër aspekt nga i cili mund të marrim në shqyrtim kohën e kryerjes së veprës penale si një element të rëndësishëm në përcaktimin e saj, është edhe e drejta penale ushtarake. Në veprat penale ushtarake, koha shërben më së shumti si një element për të përcaktuar përgjegjësinë penale në bazë të kohës në të cilën është kryer vepra penale, pra nëse kjo vepër është kryer në kohë paqe apo në kohë lufte ose në gjëndie të jashtëzakonëshme.

Koha është një element i rëndësishëm i anës objektive të veprës penale ushtarake, për shkak të specifikimeve që ajo ka. E cila do të trajtohet në dy aspekte:

- Vepra penale ushtarake mund të kryhen në kohë paqe apo në gjëndje lufte ose gjëndie të jashtëzakonëshme.

- Vepra të caktuar mund të kryhen në periudha kohore ose kanë një kohëzgjatje të veprimit ose mosveprimit kriminal[260].

Si rrethanë e cila e bën veprën të cilësuar, koha është përdorur si kriter, nga ligjvënësi, në një seri veprash penale, të cilat parashikohen nga Kodi Penal Ushtarak. Kur kryhet në kohë lufte, veprat penale të cilat parashikohen në nenet: 16\III (Shmangia nga thirrja për shërbim ushtarak);

[260] M.Leskoviku., E drejta penale ushtarake, Fq.43

17\II (Shmangia nga detyrimi për dorëzime teknike); 20\II (Pengimi i stërvitjeve dhe detyrave në fushën e mbrojtjes civile); 22 (Shmangia nga detyrimet e mbrojtjes civile); 23 (Shkelja e rregullave të sjelljes shoqërore në gjëndje lufte); 24 (Përhapja në gjendje lufte e informatave që ngjallin panik); 31\III (Ndihma spiunëve); 32\III (Rebelimi); 33\II (Dezertimi); 34\II (Dezertimi i kuadrit komandues); 35\III (Largimi pa leje); 36 (Mosparaqitja në repart ose në vëndin e shërbimit); 37\II (Mosparaqitja e oficerëve dhe nënoficerëve aktivë); etj. Konsiderohen figura të cilësuara të këtyre veprave penale.

Një problem që lind në lidhje me këto vepra penale që kryhen vetëm në kohë paqe është fakti se si do të veprohet në rast së këto vepra penale ushtarake do të kryhen në gjëndie lufte apo në gjëndie të jashtëzakonëshme. Në lidhje me këtë çështje ekziston një vakum ligjor, kështu, në këto dispozita nuk parashikohet si rrethanë cilësuese kryerja e këtyre veprave në gjëndie lufte apo gjëndie të jashtëzakonëshme, Kodi Penal Ushtarak i Republikës së Shqipërisë nuk e parshikon si rrethanë rënduese kryerjen e veprës penale ushtarake në gjëndie lufte apo gjëndje të jashtëzakonëshme[261]. Për pasojë nëse këto vepra do të kryhen në gjëndie lufte apo në gjëndie të jashtëzakonëshme, ato do të dënohen sipas dispozitës që parashikon vetëm kryerjen e tyre në kohë paqe, por kjo bie ndesh me frymën dhe parimet e Kodit Penal Ushtarak, me rrezikshmërinë shoqërore të veprës si dhe ndikon në llojin dhe në masën e dënimit.

Në ndryshimet që ju bënë Kodit Penal ushtarak, termi “kohë lufte” u zëvëndësua me “gjëndie lufte”. Kjo për të qënë në koherencë me frymën dhe dispozitat kushtetuese, me parimet e së drejtës ndërkombëtare, për të bërë një përcaktim më të drejtë dhe të saktë të elementit kohë në dispozitat e pjesës së posaçme të Kodit Penal Ushtarak[262]. Duke ju referuar Kushtetutës së Rrepublikës së Shqipërisë, gjëndja e luftës shpallet nga Presidenti i Rrepublikës në rast agresioni të jashtëm të armatosur ndaj Rrepublikës së Shqipërisë më kërkesë të Këshillit të Ministrave.

Si fillim të kohës së gjëndjes së luftës do të merret pikërisht fakti se kur kanë filluar veprimet përkatëse luftarake, pra si fillim të kësaj kohe, do të konsiderohet fillimi konkret i veprimeve luftarake, ndërsa fundi i saj do të jetë mbarimi i këtyre veprimeve[263]. Shihet që shtrirja në kohë e kësaj gjëndjeje të luftës varet pikërisht nga koha e veprimeve luftarake, dhe më saktë nga koha kur këto veprime kanë filluar konkretisht të kryhen si dhe nga koha kur këto veprime luftarake kanë përfunduar plotësisht.

Në lidhje me elementin kohë, merr rëndësi në vepra të caktuara periudha kohore apo kohëzgjatja e veprimit apo e mosveprimitt kriminal, si “Largimi pa leje” (më shumë se 5 ditë, më tepër se 24 orë, etj.), “Dezertimi” (përgjithmonë), “Shmangie të tjera nga shërbimi ushtarak”

[261] Po aty, fq.44

[262] Po aty, fq.44

[263] Po aty, fq.45

(deri në një muaj apo mbi një muaj), “Ulja e dinjitetit ushtarak” (dhatë kohës së shërbimit apo jashtë tij), “Goditja ose kundërshtimi i eprorit” (gjtë kohës që është në detyrë), etj. Siç shihet, elementi kohë në veprat penale ushtarake të cilat shtrihen apo zgjsin në një periudhë të caktuar kohore, ka rëndësi për faktin se këto veprime të kryera në kontekstin e veprave penale ushtarake, e marrin emërtimin si të tilla vetëm nëse këto veprime apo mosveprime do të kenë një kohëzgjatje të caktuar. Në rast se këto veprime nuk zgjasin në kohë dhe do të ishin veprime të kryera aty për aty nuk do të quheshin vepra penale ushtarake. Si shëmbull mund të marrim rastin e veprës penale ushtarake të “Largimit pa leje”. Veprimi i largimit pa leje do të përbëjë vepër penale vetëm në rastin kur ky veprim ka një kohëzgjatje të caktuar e cila në bazë të Kodit Penal Ushtarak të Rrepublikës së Shqipërisë, atëhere nuk do të ndodhemi përpara një vepre penale ushtarake. Këtu del qartë dhe rëndësia që ka koha si element kryesor në disa vepra penale ushtarake.

Disa figura të tjera veprash penale sipas Kodit Penal, të cilat në përmbajtjen e tyre kanë si element përbërës të anës objektive të tyre, elementin kohë:

Neni 77: vrasja me dashje që paraprin, shoqëron…..ose pason një krim tjetër.

Neni 81: menjëherë pas lindjes.

Neni 83: kapërcimi i kufijve të mbrojtjes së nevojshme.

Neni 88: ka qënë e rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit të saj .

Neni 89: paaftësi të përkohëshme më tepër se nënt ditë.

Neni 90\2: paaftësi të përkohëshme deri në nëntë ditë.

Neni 94: tej kohës së lejueshme për ndërprerje.

Neni 109\a: lirohet vullnetarisht para mbarimit të shtatë ditëve nga rrëmbimi.

Neni 166: emëtimi i parregullt i aksioneve bërë përpara regjistrimit të Shoqërisë.

Neni 180: kur më parë janë marrë masa administrative.

Neni 181\a: moskryerja e detyrave që lidhen me vjeljen brënda afatit ligjor të taksave dhe tatimeve.

Neni 204: peshkimi në kohë….të ndaluar.

Neni 205: prerja apo dëmtimi i pyjeve pa leje në kohë….të ndaluar.

Neni 206\2 prerja e drurëve në pemtore, ullishta e vreshta, pasi është refuzuar më parë leja e prerjes nga organet kompetente.

Neni 249: kryerja e funksionit pas dhënies fund të tij.

Neni 252: mbajtja në burg pa vendim të organit kompetent tej afatit të caktuar në vendim apo në ligj.

Neni 257: përfitimi i paligjshëm i interesave nga persona me funksione shtetërore apo shërbimi publik në një ndërmarrje ose operacion, në të cilat në momentin e kryerjes së veprimit ka pasur detyrën e mbikqyrjes, administrimit ose likujdimit.

Neni 262: organizimi i grumbullimeve dhe i manifestimeve pa marrë më parë leje nga organi kompetent.

Neni 304\1: mosparaqitja menjëherë për të kallzuar ose dëshmuar para organeve të prokurorisë, gjykatës apo organeve të rendit për provën e pafajsisë.

Vendi, si element përbërës i anës objektive të figurës së veprës penale.

Sikurëse dihet, që çdo vepër penale, pavarësisht llojit dhe natyrës së saj, ndodh në një vënd të caktuar. Megjithatë, edhe pse në të gjitha rastet, kur organet e procedimit penal ndodhen përpara një vepre penale duhet të përcaktojnë, veç të tjerave edhe vëndin në të cilin ajo ka ndodhur. Jo gjithmonë ky element, si vëndi, merr vlera të veçanta, apo thënë ndryshe ka rëndësi juridike.

Ashtu si edhe koha, vëndi ka rëndësi juridike dhe trajtohet si e tillë, në të Drejtën Penale, kur bëhet fjalë për zbatimin e ligjit penal, për shtrirjen e fakteve të tij në aspektin territorial.

Në një dispozitë të posaçme të Kodit Penal, në nenin 5 (Territori i Republikës së Shqipërisë), i jepet kuptimi juridiko-penal i territorit të Republikës së Shqipërisë për vepra penale të kryera brënda të cilit (shtetas shqipëtar, shtetas të huaj apo persona pa shtetësi) zbatohet ligji penal shqipëtar. Sipas kësaj dispozite, territori Republikës së Shqipërisë në kuptim të ligjit penal, quhet hapësira tokësore, gjërësia e ujrave territorial dhe të brendëshme detare, hapsira ajrore e cila shtrihet mbi hapsirën toksore dhe të ujrave territorial dhe të brendëshme detare, si dhe çdo vënd tjetër ku shtrihet sovraniteti i shtetit shqipëtar, si selitë e përfaqësive diplomatike dhe konsullore shqipëtare, anije që mbajnë flamurin e Republikës së Shqipërisë, anijet e marinës luftarake, të aviacionit ushtarak ose civil kudo që ndodhen.

Ligji penal i Republikës së Shqipërisë është i zbatueshëm dhe për shtetasin shqiptar i cili kryen një krim në territorin e një shteti tjetër, në rastet e parashikuara në nenin 7\2 (Zbatimi i ligjit penal për vepra penale të kryera nga shtetas të huaj) të Kodit Penal dhe kur ndodhemi para

veprave penale që përfshihen në juridiksionin universal, që parashikohet në nenin 7\a (Juridiksioni universal) të këtij Kodi.

Trajtim të veçantë e Drejta Penale, vëndit i kushton në ato raste kur ai nuk shërben për të përcaktuar, thjesht dhe vetëm mjedisin hapsinor ku kryhet vepra penale rast pas rasti, por në rastet kur vëndi përbën element të anës objektive të disa figurave të veprave penale konkrete, të cilat parashikohen në pjesën e posaçme të Kodit Penal. Të tilla janë figurat e veprave penale të cilat parashikohen për shëmbull në nenet: 94 (nderprerja e shtatzanisë e kryer në vënde të paautorizuara); neni 98 (mosdhënia e ndihmës nga kapiteni i anijes njerëzve të cilët janë duke u mbytur në det ose në ujrat e tjera…); neni 107 (marëdhenie seksuale ose homoseksuale në vënde publike); neni 114\a-5 (shfrytëzimi i prostitucionit), i kryer ndaj një personi që shtyhet ose shtërngohet për të ushtruar prostitucion jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë); neni 117 (prodhimi, shpërndarja, reklamimi, etj i materialeve pornografike në ambjentet e të miturve…); neni 128 (ndërrimi i fëmijëve, nga pakujdesia , në vëndet ku fëmijët mbahen për rritje, mjekim ose ne shtëpi lindjeje); neni 136 (vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit); neni 202 (transportimi transit apo depozitimi në territorin shqipëtar të mbeturinave toksike dhe radioactive); neni 203 (ndotja e ujrave të deteve, lumenjëve, liqeneve apo burimeve të rrjetit grumbullues e shpërndarës të ujrave….); neni 204 (peshkimi në vënde të ndaluara); neni 206 (prerja e drurëve dekorativë dhe dëmtimi i lulishteve dhe parqeve nëpër qytete…); neni 226 (veprat e dhunëshme ndaj përfaqësuesve të shteteve të huaja të cilat ndodhen zyrtarisht në Republikën e Shqipërisë), etj

Në të gjitha këto figura veprash penale, vëndi, pavarësisht formës me të cilën shprehet ligjvënësi për të, përbën element të domosdoshëm të anës objektive të figurave të veprave penale, të cilat parashikohen në dispozitat përkatëse, dis prej të cilave u renditën më lart të pjesës së posaçme të Kodit Penal. Përbën element të domosdoshëm, në kuptimin që, pa ekzistencën krahas elementëve të tjerë objektivë e subjektivë, të secilës prej këtyre figurave të veprave penale edhe të elementit vend, si element i anës objektive të tyre, nuk mund të ekzistojnë edhe vetë këto figura.

Kështu për shëmbull është pikërisht vëndi apo vëndet publike ose ambjente të ekspozuara nga vështrimi i njerëzve, rrethana e anës objektive të figurës së veprës penale e cila parashikohet në nenin 107 të Kodit Penal, rrethana përcaktuese e cila bën që kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me persona të rritur dhe me dëshirën e tyre, të përbëjë vepër penale. Ose është pikërisht vëndi, ambjentet e të rriturve, elementi i anës objektive të figurës së kundravajtjes penale të pornografisë, e cila parashikohet në nenin 117 të Kodit Penal, ai element që, veprime të tilla si: prodhimi, shpërndarja, reklamimi, importimi, shitja dhe botimi i materialeve pornografike, përbëjnë vepër penale.

Në disa raste të tjera, si për shëmbull në figurën e krimit të shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese, të cilat parashikohen ne piken pesë të dispozitës së nenit 114\a të Kodit

Penal, është elementi vënd, rrethana që shfrytëzimin e prostitucionit e bën të cilësuar. Kjo rrethanë konsiston në shfrytëzimin e prostitucionit të kryer ndaj një personi që shtyhet ose shtërngohet për të ushtruar prostitucion jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Ajo e cila vlerësoj së duhet të vihet në dukje edhe për elementin vënd , ashtu si edhe për disa element të tjerë të anës objektive të figurës së veprës penale kohën, pasojat është fakti që edhe pse vëndi nuk përbën element të domosdoshëm përbërës për anën objektive të të gjitha figurave të veprave penale, që parashikohen në pjesën e posaçme të Kodit Penal, ai shndërrohet në element të domosdoshëm të saj, në të gjithë ato raste kur ligjvënësi praninë e tij e kërkon, në formë të shprehur në vetë dispozitën përkatëse të Kodit Penal, që parashikon figurën e veprës konkrete penale, rast pas rasti.

Vëndi ka rëndësi për përcaktimin e kompetencës territorial të gjykatës që do të gjykojë çështjen dhe për zbatimin e ligjit sipas parimit territorial dhe të shtetësisë, në rastet kur veprimtaria kriminale shtrihet edhe në shtete të tjerë ose kur vepra penale është kryer jashtë territorut të vëndit tonë.

Mënyra, si element i anës objektive të figurës së veprës penale.

Mënyra e kryerjes së veprës penale, ashtu si edhe disa prej elementëve të tjerë të anës objektive të figurës së veprës penale të cilat u trajtuan në pjesën e mëparshme të temës si vëndi, koha, mjetet dhe pasojat, megjithëse si element përbërës i anës objektive të figurës së veprës penale, jo gjithmonë është element përbërës, i domosdoshëm i anës objektive të figurës së veprës penale, (për të gjitha llojet e figurave të veprave penale, të cilat parashikohen në pjesën e posaçmë të Kodit Penal). Edhe mënyra e kryerjes së veprës penale, shndërrohet në element të domosdoshëm përbërës të anës objektive, vetëm në rastet kur, në vetë dispozitën përkatëse të pjesës së posaçme të Kodit Penal, në të cilën parashikohet figura konkrete e veprës penale, përcaktohet në mënyrë të shprehur edhe mënyra e kryerjes së veprës, si njëri prej elementëve, të domosdoshëm, përbërës të anës objektive të saj.

Por, para se, sa të spjegohem më lart, e të ilustrohen më shëmbuj, dispozitat konkrete të marra nga pjesa e posaçme e Kodit Penal, mendoj që në formë të përmbledhur, të hedh disa konsiderata, lidhur me kuptimin që ka në të drejtën penale, mënyra e kryerjes së veprës penale.

Në teorinë e së Drejtës Penale vetë ana objektive e figurës së veprës penale, nuk është gjë tjetër, veçse element i figurës së veprës penale, i cili në vetvete paraqet procesin e zhvillimit të rrugës që ndjek autori i veprës penale, që në momentin e kryerjes së veprimit ose mosveprimit, shoqërisht të rrezikshëm dhe të kundraligjshëm, deri në konstatimin e pasojës që vjen apo duhej të vinte prej tij. Ana objektive paraqet në vetvete procesin e zhvillimit të sulmit kriminal, që bëhet kundër raporteve shoqërore të rëndësishme. Ajo paraqet sulmin kriminal, të shqyrtuar nga

ana e tij e jashtëme, nga pikëpamja e zhvillimit gradual ose konseguent të ngjarjeve dhe të fenomeneve të cilat fillojnë të vihen në lëvizje, me kryerjen nga ana e subjektit, të veprimit ose të mosveprimit dhe përfundojnë me ardhjen e një rezultati të caktuar Kriminal[264].

Gjatë zhvillimit të këtij procesi, në të gjitha rastet kur ndodhemi para një vepre penale autori i saj, pra subjekti sillet në një mënyrë të caktuar, sjellje kjo e cila dhe brënda së njëjtës vepër penale, në varësi të rrethanave konkrete në të cilat ajo njihet dhe karakteristikave individuale të vetë përsonit që e kryen atë, është e ndryshme, rast pas rasti. Në këtë kuptim mendoj që në të gjitha veprat penale, pavarësisht llojit të tyre, autori përdor, si të thuash një mënyrë të caktuar. Fjala këtu, mendoj se duhet të jetë vetëm për këtë lloj mënyre të kryerjes së veprës penale, si formë e përgjithëshme sjelljeje e autorëve të veprave penale në botën e jashtëme. Mendoj se, kur bëhet fjalë për mënyrën e kryerjes së veprës penale, si element përbërës i anës objektive të figurës së saj, duhen trajtuar karakteristikat e veçanta juridike të kësaj sjelljeje, rast pas rasti.

Bazuar, pikërisht në këto karakteristika, mendoj se mënyra e kryerjes së veprës penale duhet trajtuar në kuptimin e gjërë të dhunës për të kryer ose mos kryer një veprim të caktuar, për të përfituar padrejtësisht pasuri etj (neni 109\b i Kodit Penal); po kjo vepër kur kryhet duke përdorur a kërcënuar me përdorimin e dhunës, torturës, akteve çnjerëzore e poshtëruese… (neni 109\b-II i Kodit Penal); vjedhja e kryer duke shpërdoruar detyrën (neni 135 i Kodit Penal) etj. Nga leximi i përmbajtjes së këtyre dispozitave del se, për të patur secilën prej këtyre figurave të veprave penale të cilat u renditën më lart, duhet që për kryerjen e secilës prej tyre, subjektet të kenë vepruar pikërisht me mënyrën ose me ndonjërën nga mënyrat që përmbajnë karakteristikat, të cilat gjënden të përcaktuara, në formë të shprehur, në formë të shprehur, në vetë dispozitën e pjesës së posaçme të Kodit Penal, në të cilën parashikohet figura e veprës penale përkatëse. Vetëm në këto raste, mund të thuhet që mënyra e kryerjes së veprës penale është element i domosdoshëm, i figurës së veprës penale.

Mjeti si element përbërës i anës objektive të figurës së veprës penale[265].

Edhe mjetet të cilat përdoren për kryerjen e veprave penale, e Drejta Penale i quan element të anës objektive të figurës në përgjithësi.

Veç kësaj e Drejta Penale, mjetet i trajton posaçërisht në disa aspekte. Në disa raste, sikurse për shëmbull, në dispozitat e neneve 80 (…sigurimi i kushteve dhe i mjeteve material….) dhe 142 (Sigurimi I mjeteve për vjedhje) të Kodit Penal, mjetet për shkak të shkallës së lartë të

[264] E Drejta Penale e Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë, Pjesa e Përgjithshme, A.çela, N.Peza, I. Elezi, G.Gjika, Tiranë 1982, fq 96

[265] Vendimet: Nr. 1, datë 03.02.2006, Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë; Nr. 444, datë 08.10.2008; Nr. 410, datë 17.09.2008; Nr. 158, datë 02.04.2008; Nr.48, datë 16.01.2008; Nr.248, datë 15.10.2008; Nr. 410, datë 18.04.2007; Nr. 65, datë 14.02.2007, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

rrezikshmërisë shoqërore që paraqesin veprat penale, për kryerjen e të cilave ato do të përdoren në të ardhmen, për ligjvënësin kanë shërbyer si faktor bazë që, vetëm veprimet për sigurimin e tyre, t'i konsideroj vepër penale të kryer, të konsumuar plotësisht. Sipas nenit 80 të Kodit Penal, sigurimi i mjeteve materiale për të kryer vrasje, përbën vepër penale (krim). Po kështu edhe, sipas nenit 142 të Kodit Penal, sigurimi i mjeteve material për të vjedhur pasurinë përbën vepër penale pra krim.

Mjeti në disa raste, ka shërbyer për ligjvënësin, si kriter për të parashikuar si figurë vepre penale më vete, figura të veçanta veprash penale, brënda të njëjtit lloj vepre penale. Kështu për shëmbull, veprën penale të shkatërrimit të pronës, e cila parshikohet në seksionin e III-të të kreut të III-të, të pjesës së posaçme të Kodit Penal, ligjvënësi e ka ndarë në disa figura të veçanta krimi, duke përdorur si kriter, veç të tjerave edhe llojin e mjetit që përdoret për shkatërrimin apo dëmtimin e pronës. Të tilla janë figurat e krimeve, të shkatërrimit të pronës me zjarr (neni 151), të shkatërrimit të pronës me eksploziv (neni 152), të shkatërrimit të pronës me përmbytje (neni 153) dhe të shkatërrimit të pronës me mjete të tjera (neni 154).

Duke përdorur si kriter, mjetin, ligjvënësi ka krijuar një figurë të posaçme të veprës penale të vjedhjes, sikurëse është figura e krimit të vjedhjes me armë, e cila parashikohet në nenit 140 të Kodit Penal. Sipas kësaj dispozite, vjedhja e pasurisë, e shoqëruar me mbajtjen e armëve dhe municioneve luftarake ose me përdorimin e tyre, është njëra prej llojeve të veçanta të figurave të cilësuara të veprës penale të vjedhjes së pasurisë. Lidhur me këtë figurë krimi, pikërisht për shkak të mjetit, armë dhe municione luftarake, që shoqërojnë vjedhjen e pasurisë apo përdoren gjatë vjedhjes, si element përbërës të domosdoshëm të saj, ligjvënësi e ka parashikuar atë si figurë, të veçantë të veprës penale të vjedhjes. Dhe për shkak të rëndësisë që paraqet ky element, për ekzistencën e kësaj figure të krimit të vjedhjes së pasurisë dhe interpretimeve të ndryshme shpesh të kundërta rreth kuptimit të tij. Kolegjet e bashkuara të Gjykatës së Lartë, njehsuan praktikën gjyqësore[266]. Disa nga drejtimet kryesore të unifikimit që përmban ky vendim janë:

- përkufizimi se ç'farë quhet armë është dhënë në nenin 1 të ligjit Nr 7566 datë 25.05.1992, "Për armët", sipas të cilit janë të tilla "armët e zjarrit të çdo lloj kalibri, municionet e tyre, bombat e minat si dhe armët e ftohta si shpatat, bajonetat, thikat dhe mjetet e tjera të përgatitura dhe destinuara për sul kundër personave ose vetmbrojtje".
- Mjafton që vjedhja e pasurisë të jetë e shoqëruar me mbajtjen pa leje[267] të armës, edhe pse pa e përdorur atë, vepra do të cilësohet si vjedhje me armë.

[266] Vendim unifikues Nr.1 datë 03.02.2006, i Kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Lartë

[267] Me ligjin Nr.9686 datë 26.02.2007, janë hequr fjalët "pa leje".

- Vjedhja e shoqëruar me përdorimin e një arme lodër ose mjeti tjetër që, në pamje të parë duket si armë, por që në fakt nuk është e tillë, edhe pse tek i dëmtuari mund të jetë krijuar përshtypja sikur ajo është armë, nuk duhet kualifikuar si vjedhje me armë.
- Krijimi tek i dëmtuari i përshtypjes së mjeti që shoqëron autorin në kryerjen e vjedhjes është armë, ndërkohë që provohet se nuk ka qënë e tillë, bën që vepra të cilësohet si vjedhje me dhunë dhe jo vjedhje me armë.

Për ndikimin e ndërsjelltë të anës subjektive të figurës së veprës penale tek ana objektive e saj dhe anasjelltas[268].

Megjithëse ana objektive e figurës së veprës penale, sikurëse u tha, përfaqëson grumbullimin e tipareve të jashtme të saj, thënë ndryshe, paraqet anën e jashtëme të figurës së veprës penale, ajo nuk mund të kuptohet e shkëpurtur nga elementët që përbëjnë anën subjective të figurës së veprës penale, e cila sipas teorisë të së drejtës penale, paraqet anën e brendëshme, psikike të saj.

Të drejtës penale, sikurëse u tha edhe më lart, nuk i interesojnë të gjitha llojet e veprimeve ose mosveprimeve të njeriut. Të drejtës penale i interesojnë vetëm ato kategori veprimesh ose mosveprimesh, ato sjellje të njeriut në botën e jashtëme, të cilat shkaktojnë ndryshime ose transformime jo të çfarëdoshme.I interesojnë ato veprime ose mosveprime që shkaktojnë ndryshime ose transformime të dëmshme për interest e shoqërisë, shtetit dhe individit. I intresojnë ato veprime ose mosveprime që në gjuhën e së drejtës penale, emërtohen veprime ose mosveprime shoqërisht të rrezikshme.

Por, edhe sa më sipër, kjo nuk mjafton. Pasi, të drejtës penale nuk i interesojnë të gjitha veprimet ose mosveprimet shoqërisht të rrezikshme, por vetëm ato veprime ose mosveprime shoqërisht të rrezikshme, të cilat janë shprehje e vullnetit të personit, domethën i interesojnë veprimet ose mosveprimet shoqërisht të rrezikshme të përgjegjëshme të njeriut, ato që kanë të bëjnë me vullnetin dhe kontrollin e këtij vullneti nga ndërgjegjia e tij.

Prej këtej del përfundimi se vullneti dhe ndërgjegjia e njeriut që qëndrojnë në themel të përmbajtjes së anës subjektive, janë faktorët që udhëheqin dhe kontrollojnë edhe veprimet ose mosveprimet shoqërisht të rrezikshme, ose me fjalë të tjera, ndikojnë në vetë anën objektive të figurës së veprës penale.

[268] Vendimet: Nr. 631, datë 08.11.2006; Nr. 691, datë 22.11.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Në shume raste, ambienti rrethues, kushtet material në të cilat jeton njeriu, ndikojnë në një masë jo të vogël, në shprehjen e vullnetit dhe bëhet fjalë për vullnet negativ të njeriut në botën e jashtëme, për shëmbull konstatimi i derës së kasafortës me të holla të pa mbyllur, etj.

Por, ndërvarësia e anës subjektive të figurës së veprës penale nga ana objektive e saj haset më shpesh në praktikë, në procesin e të provuarit ku nuk janë të pakta rastet kur, nga analiza e elementëve të anës objektive të figurës së veprës penale arrihet në përfundime të drejta, të bazuara, edhe për anën subjektive të saj. Nevoja e një proçesi të tillë paraqitet sidomos në rastet kur, për shkak të mohimit të qëllimit apo motivit për kryerjen e veprës penale nga vetë autori I saj ose për shkak të mungesës apo shmangies së autorit të veprës penale gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjes penale në ngarkim të tij, bëhet i vështirë zbulimi i anës subjektive të vërtetë të autorit konkret të veprës penale konkrete. Nuk janë të pakta rastet që në rrethana të tilla, gjykatat për të zbuluar anën subjektive të autorit të veprës penale, madje shpesh, për të përcaktuar edhe formën e fajit me të cilën ai ka vepruar gjatë kryerjes së saj, bazohet kryesisht në element të veçantë të anës objektive të figurës së veprës penale, si vëndi, mënyra, mjeti dhe koha e kryerjes së veprës penale.

Kështu shprehet, Kolegji penal i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij[269], në të cilin ndër të tjera, thekson " Për të arritur në përfundime të drejta , të bazuara në kërkesat e ligjit material penal, gjykatat edhe kur dëgjojnë shpjegimet e sinqerta të autorit, në lidhje me anën subjektive të tij, për kryerjen e veprës penale, duhet të marrë në konsideratë dhe të analizojë me kujdes rrethanat në të cilat është kryer kjo vepër, të cilat përbëjnë dhe anën objektive të figurës së saj".

Nga aktet që ndodhen në dosje, rezulton se, vet i gjykuari G., në deklarimet si person që tregon rrethanat e hetimit, bërë para oficerit të policisë gjyqësore, më 01.04.2001, duke treguar për ngjarjen, ka deklaruar se kishte shkuar për të takuar të dëmtuarit, për t'u sqaruar me të dhe kur ky I fundit, sipas tij e shan, ai e godet dy-tre herë me thikë në gjoks e më pas ai u largua. Në lidhje më thikën që ai përdori, i gjykuari në të njëjtin proces-verbal, deklaroi se e kishte patur në shtëpi dhe e kishte marrë me vete, sikurëse u shpreh ai, më shumë për vetmbrojtje dhe më pas nga nervat pasi më shau e kam goditur, dhe pas këtyre veprimeve u largua, kurse thikën, sikurëse deklaroi vetë, e hodhi gjatë rrugës.

Në këto rrethana, duke patur parasysh edhe faktin se dëmtimet që pësoi i dëmtuari Gj., ishin në pjesën e përparme, të sipërme të trupit të tij, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon se, përfundimi në të cilin ka arritur gjykata e shkallës së parë, e cila veprën e të gjykuarit G., e cilëson si vrasje e mbetur në tentativë, sipas nenit 76 të Kodit Penal, në lidhje me nenin 22 të tij, është i bazuar në ligj dhe si rrjedhojë vendimi i saj duhet të lihet në fuqi.

[269] Vendim Nr.95 datë 26.02.2003, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Sqaroj se, nga aktet e këtij procedimi penal, rezulton që Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin Nr 480 datë 30.10.2002, kishte vendosur prishjen e vendimit Nr 394, datë 24.05.2002 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe pushimin e çështjes, pasi kishte pranuar pretendimet e të gjykuarit për heqje dorë nga kryerja e veprës penale të vrasjes së Gj-së.

Shumë interes, për mendimin tim, në këtë aspekt paraqet vendimi nr 535, datë 20.06.2007, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në të cilin thuhet "..përsa i përket cilësimit ligjor të veprës së të gjykuarit V., që ka lidhje me të shtënat me armë, prej tij, në drejtim të të dëmtuarit L., të dy vendimet e mësipërme[270] duhet të ndryshohen dhe vepra duhet të cilësohet si vrasje me dashje, mbetur në tentativë, që parashikohet në nenin 76 të Kodit Penal, në lidhje me nenin 22 të tij.

U arrit në këtë përfundim, pasi ndryshe nga sa pranojnë dy gjykatat…ky Kolegj çmon se janë pikërisht rrethanat në të cilat u zhvillua ngjarrja, në të cilën mbeti i dëmtuar dëshmitari L.D., mjeti i përdorur nga i gjykuari, pjesa e trupit mbi të cilën u shti me armën e zjarrit, fakti që vrima e hyrjes së predhës është në pjesën e përparme të kraharorit në të cilën ndodhen organe nga më jetësore të njeriut, si zemra e mushkëritë, intensiteti i lartë i të shtënës, etj..,të cilat duhet t'i kishin dërguar gjykatat në përfundim të drejtë, të bazuar në ligj dhe në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, për anën subjektive të të gjykuarit, në raport me veprimin e kryer prej tij, shtënien me armë zjarri në kraharorin e të dëmtuarit dhe pasojën që mund të vinte prej saj, dëmtimi i organeve jetësore rë cilat u përmëndën, mosardhja e së cilës në rastin në shqyrtim, sikurëse me të drejtë, u pretendua nga prokuroria, i dedikohet vetëm rastësisë".

Gjykata e Shkallës së Parë Lezhë ka deklaruar fajtor të gjykuarin V., për kundravajtjen penale të kanosjes, e cila parashikohet në nenin 84 të Kodit Penal. Kurse, Gjykata e Apelit, megjithëse pranonte që ndodheshim para vrasjes së mbetur në tentativë, gabimisht zbatoi nenin 24 të Kodit Penal, (duke pranuar heqjen dorë nga kryerja e veprës penale të vrasjes). Në këtë rast ndodheshim përpara tentativës së plotë, nga e cila, sikurse dihet, nuk mund të hiqet dorë.

[270] Vendimi Nr. 56 datë 14.06.2005, i Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhe, dhe vendimin Nr.169 datë 05.06.2006, i Gjykatës së Apelit Shkodër.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Nga gjithë studimi i temës, rezultojnë disa përfundime e rekomandime, të parashtruara në punim.

Studimi i figurës së veprës penale, identifikimi, rast pas rasti, i elementëve përbërës të saj, ndihmon juristin për të bërë dallimin e qartë ndërmjet veprave penale. Kësisoj, do të jemi në gjëndje të përcaktojmë saktë dispozitën (nenin) konkrete të pjesës së posaçme të Kodit Penal, me të cilën do të cilësohet (kualifikohet) juridikisht vepra penale dhe, mbi bazën e së cilës, do të akuzohet autori i saj.

Në këtë kuptim, nënvizohet se, figura e veprës penale është kusht paraprak për përgjegjësine penale. Sa më i bazuar të jetë proçesi i përcaktimit të figurës së veprës penale, aq më ligjore do të jetë veprimtaria e organeve të proçedimit penal dhe të drejtësisë penale në vazhdimin e veprimeve të mëtejshme.

Ana objektive e figurës së veprës penale, si një ndër katër [271] elementët e domosdoshëm përbërës të figurës së veprës penale, nga ana e saj, përbën ndihmesë shumë të rëndësishme në këtë drejtim. Përcaktimi i përpiktë i elementëve përbërës të saj, rast pas rasti, është parakusht për

[271] Ne disa botime juridike penale franceze pranohet se tre jane elemente te domosdoshem te figures se vepres penale (objekti,ana objektive dhe ana subjektive). Shih per shembull, profesorin e shquar francez te se drejtes penale,Ph.Conte.

zbatimin e parimit të ligjshmërisë në procesin penal. Është parakusht për shmangien e rasteve të zbatimit të ligjit penal me analogji, e cila, sikurse percaktohet ne nenin 1/c paragrafi II i Kodit Penal, është e ndaluar.

Në rastet, kur prania e elementëve të tillë të anës objektive si: pasoja, vendi, koha, mjetet dhe mënyra (megjithëse nuk janë elemente të domosdoshëm për të gjitha figurat e veprës penale), kërkohet shprehimisht në dispozitën përkatëse të Kodit Penal, zbulimi dhe përcaktimi me saktesi i tyre, është kusht për cilësimin e drejtë ligjor të veprës penale. Por, çdo të ndodhte në rastet kur një person nuk ndërmerr ndonjë veprim, të cilin ka patur mundësi ta ndërmerte për të penguar ardhjen e pasojes së ndaluar, por sipas ligjit, nuk ka qënë i detyruar që ta ndermerte këtë veprim. Në këtë rast, personi nuk mund të ketë përgjegjësi penale. Për sjelljen e tij pasive, do të shtrohet çështja e zbatimit të sanksioneve morale.

Kemi konstatuar se ka një prirje në rritje të veprave penale të kryera me mosveprim, e kushtëzuar kjo nga vete zhvillimi shoqëror-ekonomik, varësia e funksionimit të institucioneve të ndryshme etj. Si rrjedhojë, do të rekomandoja me këtë rast parashikimin nga legjislacioni ynë (Kodi Penal), i një numri më të madh të figurave të veprave penale që mund të kryhen me mosveprim. Këto raste, shërbejnë ose si element cilësues të veprës penale, ose për të bërë dallimin ndërmjet figurave të ndryshme të veprave penale, brënda së njëjtes lloj vepre penale,(në shumë raste të tjera, elementë të tillë shërbejnë për gjykatën ose si rrethana lehtësuese ose si rrethana rënduese). Në këto kushte, pasurimi dhe përditësimi i planeve, programeve e teksteve mësimore universitare të fakulteteve të drejtësisë si dhe të Shkollës së Magjistraturës, përbëjnë detyrë të përherëshme të kohës.

Pjesa më e madhe e doktrinës, bashkkohore botërore, por edhe një pjesë e jurisprudencës, pëqafon teorinë e tridegëzimit të veprës penale. Përveç, justifikimit nën profilin e kundërligjshmërisë, si element vlerësues i faktit tipik, dhe jo si element objektiv negativ, juristët të cilët mbështesin këtë doktrine, sjellin një varg argumentash për të justifikuar analogjinë në *bonam partem* ne fushën e së drejtës penale, gjë që sikundër u vu në dukje disa herë në këtë punim, sipas legjislacionit penal të Republikës së Shqiprisë nuk është e lejuar.

Parimi i fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues, si në rastin që parashikon shfuqizimin e veprës penale, apo kur e modifikon atë në *bonam part,* nuk vepron për ligjet e jashtëzakonëshme dhe për ligjet kalimtare. Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë shprehet mbi to dhe lidhjen me parimet e nenit 3 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë edhe pse një gjë e tillë nuk parashikohet shprehimisht nga Kodi jonë Penal. Si ligjet kalimtare ashtu edhe ato të jashtëzakonshme nuk shfuqizojnë parimin e ndalimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal, dhe nuk mund të aplikohen për vepra të kryera pas shfuqizimit të tyre.

Në dallim nga e drejta penale materiale, ku zbatohet parimi se ligji i ri nuk ka fuqi prapavepruese, me përjashtim të rasteve kur ai është në favor të të pandehurit, në të drejtën proceduriale penale vepron parimi sipas të cilit, ligji i ri ka fuqi edhe ndaj marrëdhënieve proceduriale të lindura para hyrjes së tij në fuqi, për çështje që janë në hetim apo gjykim, me përjashtim të rasteve e për një kohë kur vetë ligji shprehimisht ka vendosur atë.

Kryesisht, theksohet se dispozitat, si mbrojtja nevojshme, nevoja ekstreme, përmbushja e detyrës, apo zbatimi i urdhërit janë dispozita në të cilat kur përmbushen kushtet e kërkuara shprehimisht prej tyre, përjashtojnë personin (autor të veprës), nga përgjegjësia penale.

Ndryshe ndodh në fusha të tjera të së drejtës, si për shëmbull, në të drejtën Civile ku Prania e këtyre dispozitave, si parime të përgjithëshme të të gjithë sistemit juridik, bën që këto norma të mund të aplikohen edhe në mënyrë analogjike, pasi analogjia në këto fusha të së drejtës nuk është e ndaluar. Përkundrazi, analogjia në këto degë është një mjet interpretues për të zgjidhur rastet që nuk gjejnë zgjidhje të përshtatshme në një dispozitë ligjore.

Një argument tjetër gjëndet në faktin se, një nga parimet bazë të së drejtës penale është prezumimi i pafajsisë, i cili në dinamikën e tij shpreh parimin *in dubio pro reo*. Në raste dyshimi mbi fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit, ky i fundit duhet të deklarohet i pafajshëm. Baza e këtij parimi gjëndet në faktin se drejta penale krijon garanci për individin, i cili për tu dënuar penalisht duhet që akuza të provohet përtej çdo dyshimi objektivisht të arsyeshëm. Ky parim, përbën bazën e të gjithë sistemit penal dhe tregon se e drejta penale duhet interpretuar gjithmonë në favor të të pandehurit, pasi vetëm kështu mund të garantohen të drejtat e tij.

Për mendimin tonë është i drejtë qëndrrimi sipas të cilit, analogjia nuk mund të pranohet edhe për dispozita në favor të të pandehurit, pasi roli tyre është disaplikimi i një dispozite ndëshkuese nga ana e gjykatës. Aplikimi me analogji i këtyre dipozitave, ka si pasojë sjelljen e një mungese sigurie në aplikimin e ligjit duke shkelur si rrjedhojë parimin taksativ[272]. Në një sistem penal bazuar në parimin e ligjshmërisë, nuk mund të pranohen zgjidhje subjektive. Zgjidhjet duhet të jenë objektive, zgjidhje që gjejnë plotësisht bazat e tyre në dispozitat penale si ndëshkuese ashtu edhe në ato në favor të të pandehurit.

Ky interpretim, për mendimin tonë është më korrekti, pasi i përgjigjet parimit të sigurisë juridike, i cili është baza e parimit të ligjshmërisë, duke evituar gjykime të ndryshme, për raste të ngjashme, që mund të jepen nga gjykatat[273].

Vlerësime konkrete mbi situatën, të cilat nuk prezantojnë të gjithë elementët e faktit tipik të lejueshëm, nuk mund të justifikojnë realizimin e një vepre penale. Mbështetësit e teorisë së dydegëzimit, preferojnë një interpretim të rreptë të dispozitave penale, gjë që shpjegohet edhe nga prejardhja e shkollës sonë, formatizimin juridik të së drejtës penale, të njohur ndryshe si shkolla e konceptimit formal të veprës penale.

Për korrektesë, duhet të pranojmë se zgjidhjet e ofruara nga pasuesit e teorisë së tridegëzimit, të cilët identifikohen nga ana dogmatike me shkollën e interpretimit substiancial të së drejtës penale, i përgjigjet premisave dogmatike të përcaktuar nga ndjekësit e kësaj teorie. Si rrjedhim, na duket e arsyeshme të pohojmë se edhe interpretimi i dhënë nga këta të fundit, nuk është i gabuar.

Mbështesim dhe cilësojmë më korrekt interpretimin formal, pasi kemi bindjen se vetëm me anë të këtij interpretimi, ligji penal mund të realizojë funksionin e tij kryesor, që është siguria dhe garancia e individit në interpretimin dhe në aplikimin e ligjit.

Për sa i përket rëndësisë së analizës metodologjik të strukturës së veprës penale, besojmë se shëmbujt e dhënë tregojnë se sa është e rëndësishme një analizë e thellë e elementëve

[272] F.Ramacci, Corso di diritto penale, Fq.249

[273] G.Marini, Milano 1978, Fq.958

thelbësor të veprës penale, duke filluar nga dy shtyllat kryesore, si element objektivë dhe elementi subjektivë. Nga shëmbujt e sjellë në lidhje me Kodin Penal të Rrepublikës së Shqipërisë si dhe nga analiza të vendimeve të jurisprudencës shqiptare, nuk ka dyshim se shtjellimi shkencor i elementëve thelbësorë të veprës penale, vërteton pikërisht sa më sipër. Në kuadrin e strukturës së veprës penale, në të cilët duhet domosdoshmërisht të klasifikohen, edhe një mjet tepër i rëndësishëm për të vërtetuar korrektësinë metodologjike, interpretuese dhe dogmatike të vendimit të gjykatave në lidhje me cilësimin juridik të fakteve në bazë të dispozitave të Kodit Penal, plotëson arsyetimin tonë për rëndësinë e këtij elementi

Më së shumti, legjislacionet moderne bashkohore, ndër ta edhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, konsiderojnë si shkak kryesor të veprës penale, atë veprim ose mosveprim të drejtpërdrejtë, që sjellë në mënyrë të domosdoshme ardhjen e pasojës (ose mundësinë e ardhjes së saj), të cilin e quan shkak i domosdoshëm i drejtpërdrejtë (determinant).

Në këtë mënyrë, duke përcaktuar atë që quhet shkaku kryesor, e drejta penale, bën njëkohësisht edhe dallimin ndërmjet tij dhe shkaqeve të tjerë, të cilët, edhe pse mund të kenë një farë lidhje me pasojën, nuk luajnë rol, përsa i takon marrjes ose jo të një apo disa personave në përgjegjësi penale.

E drejta penale e Republikës së Shqipërisë, ashtu sikurse edhe teoritë penale bashkohore, pranojnë faktin që, për t'u konsideruar veprimi ose mosveprimi shkak i një pasoje, duhet që ai të jetë kryer në kohë, përpara ardhjes së pasojës. Pra, do të konsiderohet shkak për ardhjen e pasojës nisur edhe nga afërsia apo distanca në kohë e tij (veprimit ose mosveprimit) me vet pasojën.

Pasoja mund të jetë element i domosdoshëm i veprës penale ose rrethanë cilësuese e figurës së veprës penale. Dëmtimi i pronës nga pakujdesia, është vepër penale kur ka sjellë pasoja të rënda material. Kurse, kundravajtja penale e mosdhënies së ndihmës, është vetëm kur, si pasojë e saj, është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit, rrezikimi i jetës. Këto figura veprash penale nuk mund të ekzistojnë pa pasojën e parashikuar në dispozitën ligjore përkatëse. Në këto raste, pasoja është element përbërës i domosdoshëm i veprës penale.

Disa figura veprash penale nuk kërkojnë ardhjen e pasojës. Ardhja e pasojave e bën veprën të cilësuar, pra formon një tjetër figurë juridike të saj. Prodhimi i mjeteve për falsifikim, formon vepër penale pa qënë e nevoja e ardhjes së pasojës. Ndërsa, ardhja e pasojës së rëndë, formon figurë tjetër te kësaj vepre. Në këtë rast, ajo shërben si rrethane cilësuese e figurës së veprës penale .

Në shumë raste, vepra penale ose figura e saj, lidhen me ardhjen e pasojave alternative ose me ardhjen njëkohësisht të dy ose më shumë pasojave. Kur pasoja është alternative, mjafton ardhja e njërës prej tyre për të ekzistuar vepra penale ose figura e saj. Me dy a më shumë pasoja, janë veprat penale të përbëra dhe ato me dy objekte, si vjedhja me pasojë vdekjen e personit, (ku njëra pasojë është e nënkuptuar dhe tjetra është e shprehur në dispozitën përkatëse).

Në të tilla figura veprash penale, njëra pasojë quhet kryesore, ajo e cila mbrohet nga dispozita e shkelur, kurse tjetra ose të tjerat, të cilat mbrohen nga dispozita të tjera, quhen sekondare ose të prejardhura.

Pasojat kanë rëndësi jo vetëm për praninë e veprës penale ose të figurave të veprës penale, por edhe për shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale. Sa më të mëdha të jenë pasojat kriminale, aq më e lartë është rezikshmëria shoqerore e veprës penale, gjë e cila mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e dënimit, (sanksionit penal).

Në përfundim, mund të thuhet se kuptimi i saktë i lidhjes shkaksore, do të ndihmojë organet e proçedimit penal dhe gjykatën, në përcaktimin e saktë dhe të drejtë të përgjegjsisë penale të subjektit, i cili me veprimet apo mosveprimet e tij, ka sjellë ose ekzistonte mundësia që ato të vinin, duke shkaktuar një pasojë shoqerisht të rrezikshme. Huazimi i saj si kategori filozofike dhe zbatimi i saj në të drejtën penale, ka bërë të mundur që drejtësia penale, t'i përshtatet nevojave të shoqërisë dhe gjykimit të drejtë të subjektit, i cili ka shkaktuar ose ekzistonte mundësia që të shkaktonte me veprimet ose mosveprimet e tij, një fakt shoqërisht të rezikshëm.

Sigurisht koncepti i lidhjes shkaksore, e ka burimin tek filozofia. Rruga e zbatimit të saj në të drejtën penale, ka qënë e gjatë dhe e larmishme. Fillimisht, lidhja shkakësore në të drejtën

penale, u përfaqësua nga teoria ekuivalente apo condicio sine qua non (kushti pa të cilin nuk...), ku sipas kësaj teorie, kazualiteti i një ngjarje, është bashkësia e të gjitha fakteve që paraprijnë , pa ekzistencën e të cilave ngjarja nuk do kishte ndodhur, dhe se për të pasur lidhje shkaksore, mjafton që individi të ketë realizuar njërën nga kushtet e ngjarjes. Pikërisht në përkufizimin e kësaj teorie, gjejmë edhe të metën e saj më të madhe, sepse ajo na çon ne një shtrirje shumë të gjërë të përgjegjsisë, duke konsideruar ekuivalent të gjitha sjelljet që konkurojnë në ndodhjen e ngjarjes. Kështu, duke e konsideruar të rëndësishme edhe sjelljet fare të hershme që paraprijnë, arrihet në konkluzione paradoksale.

Kjo teori, nuk është e aftë të tregojë motivin, e një sjelljeje të përcaktuar në të gjitha ato raste kur nuk njihet, nëse ai veprim i përket apo jo numrit të sjelljeve të nevojshme që e prodhuan. Kështu, ajo mban mbi vete, rrezikun e arbitraritetit në dëm të një apo më shumë personave, të cilët mund të vihen, padrejtësisht para përgjegjsisë penale.

Nisur nga problemet e shumta në zbatimin e kësaj teorie dhe shtrirjen e madhe që ajo kishte në Gjermani, filozofi dhe natyralisti I.V.Kries, në 1856, formuloi teorinë adekuate apo teoria e shkakut tipik. Kjo teori, në të kundërt të asaj që bënte teoria ekuivalente, e ngushtonte shumë fushën e shtrirjes së veprimit. Kjo teori, përcaktonte se shkaku i ngjarjes nuk është fakti se kush nga veprimet apo mosveprimet, të cilat kanë paraprirë ngjarjen por vetëm ai veprim ose mosveprim i cili ka realizuar atë pasojë, që ka qënë shkaku tipik, sipas eksperiencës së përgjithshme që është më e mundëshmja që të prodhojë pasojën.

Përkrahësit e kësaj teorie, i ndanin shkaqet në tipike dhe jo tipike. Kjo teori solli si avantazhin e saj, duke e ngushtuar rrethin e lidhjes shkaksore, por në mënyrë paradoksale, u bë edhe vesi i kësaj teorie, sepse mbi të gjitha, kjo teori përfundonte duke kufizuar së tepërmi fushën e përgjegjsive pennale, jo vetëm se përjashton të gjitha shkaqet atipike, por mbi të gjitha, sepse përfundon duke mohuar përgjegjsinë penale tek shfrytëzimet me dashje që disa i bëjnë aftësive të tyre. Pikërisht, ndarja e shkaqeve sipas kësaj teorie në shkaqe tipike dhe jotipike duke u bazuar në eksperiencën e njërëzve, përgënjeshtrohen nga vetë realiteti dhe praktika gjyqësore (jurisprudenca) e shumicës së vëndeve, përfshirë edhe atyre në të cilat ajo ka lindur.

Shumica e legjislacioneve moderne bashkohore, në të cilën bën pjesë edhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, kanë konsideruar si shkak kryesor të veprës penale, atë veprim apo mosveprim të drejtpërdrejtë, që sjell në mënyrë të domosdoshme ardhjen e pasojës (ose

mundësinë e ardhjes së saj), të cilin e quan shkak i domosdoshëm (i drejtpërdrejtë, determinant). Në këtë mënyrë, duke përcaktuar atë që quhet shkaku kryesor, e drejta penale, bën njëkohësisht edhe dallimin ndërmjet tij dhe shkaqeve të tjerë, të cilët edhe pse mund të kenë nje farë lidhjeje me pasojën, nuk luajnë rol përsa i takon marrjes ose jo të një apo disa personave në përgjegjësi penale.

E drejta penale shqiptare, ashtu sikurse edhe teoritë bashkohorë mbi lidhjen shkaksore, pranon faktin që për t'u quajtur veprimi ose mosveprimi shkak i një pasoje, duhet që ai të jetë kryer në kohë para ardhjes së pasojës. Do të konsiderohet shkak për ardhjen e saj, niset edhe nga afërsia apo largësia e tij (veprimit ose mosveprimit) me vet pasojën.

Nga studimi i kryer, duke evidentuar përfundimet e rëndësishme të mësipërme, do të paraqesim edhe disa sugjerime ose rekomandime, që sipas meje, në mënyrë modeste do të kishin impakt në modernizimin e legjislacionit tonë penal, posaçërisht në pjesën e anës objektive të figurës së veprës penale, por edhe të procedurës penale.

Në këtë pjesë, Kodi ynë Penal, ka nevojë për reformim, sipas parimeve të përgjithëshme juridike-penale, për tu përsosur dhe përafruarmë shumë me qëndrimet dhe shkollat bashkëkohore të së Drejtës Penale si dhe me praktikën europiane përkatëse. Kështu Kodi ynë Penal ka nevojë të plotësohet më tej me dispozita sqaruese, ndërsa ai procedurial me reformën e Gjykatës së Krimeve të Rënda si dhe me reformën e KLD-së.

Organizimi më i shpeshtë i konferencave shkencore, seminareve, kombëtare e ndërkombëtare, do ta gjallëronin më shumë jetën juridike penale në vëndin tonë. Gjithashtu, zgjerimi i botimeve në këtë fushë, i artikujve shkencor, monografive, teksteve alternative penale, do të perbënin kontribut të çmuar në përpunimin e mendimit shkencor juridik penal.

Edhe rishikimi i kurikulave Universitare në lëndët e së drejtës penale, në tre ciklet e studimit, duke i dhënë më shumë hapsirë orëve mësimore në auditor, por edhe në organet e zbatimit të ligjit penal, do të shërbenin pa dyshim, në forcimin e formimit shkencor profesional të studentëve të drejtësisë të universiteteve publike dhe private në vëndin tonë.

Është i rëndësishëm edhe redaktimi gjuhësor, mënyra e të shkruajturit të disa dispozitave të Kodit Penal të Rrepublikës së Shqipërisë, pasi lënë shumë për dëshiruar nga ana e teknikës legjislative, (në paragrafë apo në dispozita të caktuara ndodhen fjali të gjata).

BIBLIOGRAFIA

I. Burime doktrinore

ELEZI.I, E drejta penale, Pjesa e përgjithshme, 2008

ELEZI.I, KAÇUPI.S, HAXHIA.M, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, 2012

ÇELA, PEZA, ELEZI, GJIKA, E Drejta Penale e Republikës Populllore Socialiste të Shqipërisë, Pjesa e Përgjithshme, 1982

ELEZI.I, E Drejta Penale, Pjesa Posacme, Botime Erik, 2007

ISLAMI. H, HOXHA. A, PANDA.I, Procedura Penale, Tiranë 2007

SPIRO.S., "Elementët përbërës të figurës së veprës penale", Cikël leksionesh, UET, Tiranë 2009.

SHEGANI.A, Penale Krahasuar, Tiranë 2002

XHAFO.J, E Drejta Penale Ndërkombëtare, Tiranë 2009

MUÇI.SH, E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme, Tiranë 2012

SALIHU.I, E Drejta Penale, Pjesa e Përgjithshme, Prishtinë 2010

KAMBOVSKI.V, E Drejta Penale, Pjesa Përgjithshme, Shkup 2010

DELPINO.L, Diritto Penale, Parte Generale, Napoli 2010

G. FIANDACA- E.MUSCO, "Diritto penale (parte generale)", Bologna 1993

J.PARADEL, "Droit penal", Paris 1994

J.C.SOYER, "Droit penal", Paris1994

Ph.CONTE, "Le risqué pënal dans l'entreprise", Paris 2003

J.PRADEL,G.CORSTENS,G.VERMEULEN, "E drejtë penale europiane", përkthim shqip, Tiranë 2010

MANTOVANI, "Diritto penale (Parte generale)", Padova 2001.

PERKINS.R.M.-BOYCE.R.N., "Criminal laë and procedure".

SIMONSEN.C.E.-GORDON.M.S. III, "Juvenile Justice in America".

J. HERRING., "E Drejta Penale. Teori, kazuse dhe materiale", përkthim, botuar nga "UET Press", Tiranë 2013.

M. FROMONT., "Sistemet e huaja më të mëdha të se drejtës", përkthim, botimet "Papirus", Tiranë 2009.

ZËEIGERT & KATZ., "Njohuri për të drejtën e krahasuar", përkthim, Skanderbeg Books, Tiranë 2008.

M.FONCAULT., "Disiplinë dhe ndëshkim, (lindja e burgut)", përkthim , "Odeon", Tiranë 2010.

S.J.BURTON., "Hyrje në të drejtën dhe arsyetim ligjor", përkthim, "UET Press", Tiranë 2007

GROSSO., "Legittima difesa", pubbl.IV, 2006.

M.CONDE., G. ARAN., "Derecho penal, Parte Generale", Valencia 2004

PEVERATI., “Osservazioni sulla legittima difesa”, Torino 1942

II. Akte normative

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

Kodi Procedurës penale të Republikës së Shqipërisë.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës

Kodi Procedurës penale të Republikës së Kosovës.

Kodi Penal Italian, Milano 1992

Kodi Penal Francez., Paris 1997

Kushtetuta e SH.B.A

Karta e OKB-së

Ligji nr.8984, datë 23.12.2002 “Për Ratifikimin e Statutit të Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale”

Ligji Nr. 9754 Date. 14.06.2007, “Për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridikë”

Konventa Europiane e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

Karta Sociale Europiane

Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat e Njëriut.

Rekomandimet e Këshillit të Europës në fushën penale.

Rekomandimet e Bashkimit Europian në fushën e drejtësisë

Përmbledhje e akteve ndërkombëtare për drejtësisnë, botim i Qëndrës së Publikimeve Zyrtare, Tiranë 2010.

III. Jurisprudencë

Vendime Unifikuese të Gjykatës të Lartë.

Vendime e kolegjeve penal të Gjykatës së Lartë

Vendime te Gjykatës Kushtetuese, publikimet periodike të viteve 1999-2010.

L.BIANKU., "Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut", "EDLORA", Tiranë 2005

Vendime të Kastacionit të Italisë

Vendimi Nr. 1, datë 03.02.2006 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 5, datë 11.11.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 2, datë 29.01.2003 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 11, datë 25.06.2002 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 38, datë 15.01.2003 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 365, datë 04.04.2007 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 346, datë 23.05.2002 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 100, datë 16.02.2005 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 244, datë 06.05.2009 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.216, datë 23.02.2011 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 205, datë 09.02.2011 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 1157, datë 07.07.2010 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 816, datë 10.02.2010 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 1563, datë 01.12.2010 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 486, datë 18.11.2009 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 60, datë 15.02.2006 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 29, datë 15.03.2007 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 450, datë 09.05.2007 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 201, datë 29.09.2008 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 494, datë 05.11.2008 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 770, datë 24.12.2007 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 221, datë 21.05.2006 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 281, datë 04.06.2008 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 732, datë 21.11.2007 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 6, datë 15.02.2006 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 778, datë 20.12.2006 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 50, datë 04.07.2007 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 56, datë 14.06.2005 i Gjykatës së shkallës së parë Lezhë.

Vendimi Nr. 169, datë 05.06.2006 i Gjykatës së Apelit Shkodër.

Vendimi Nr. 4793, datë 29.04.1991 i seksionit të pestë të Gjykatës së Kasacionit të Italisë.

Vendimi Nr. 1594, datë 22.02.1993 i Gjykatës së Kasacionit të Italisë.